   - ***Z. Qerim Hasan Merkja*** disponon aktin e dhënies dhe të marrjes në dorëzim të banesës shtetërore për privatizimin e apartamentit të përbëre nga një dhomë dhe një kuzhinë (1+1), të ndodhur në lagjen "Beqir Dardha", pallati nr. 83, hyrja B, kati 5, apartamenti nr.17, Elbasan, <u>në emër të pjestarëve që përfitojnë sipas çertifikatës të gjëndjes familjare të datës 01.12.1992.</u>

   - ***Z. Xhemail Ali Zeneli*** disponon aktin e dhënies dhe të marrjes në dorëzim të banesës shtetërore për privatizimin e apartamentit të përbëre nga një dhomë dhe një kuzhinë (1+1), të ndodhur në lagjen "Vullnetari", pallati nr. 631, hyrja A, kati 5, apartamenti nr.1, Elbasan, <u>në emër të pjestarëve që përfitojnë sipas çertifikatës të gjëndjes familjare të datës 01.12.1992.</u>

   - ***Z. Tomorr Xhaferr Goga*** disponon aktin e dhënies dhe të marrjes në dorëzim të banesës shtetërore për privatizimin e apartamentit të përbëre nga dy dhoma dhe një kuzhinë (2+1), të ndodhur në lagjen "5 Maj", pallati 717, kati 1, apartamenti nr.1, Elbasan, <u>në emër të pjestarëve që përfitojnë sipas çertifikatës të gjëndjes familjare të datës 01.12.1992.</u>

2. Tarifat e pagesës së privatizimit do të bëhen në mbështetje të VKM nr.179 datë 26.02.2020.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të . Ardhurave Aseteve, Buxhetit dhe Financës

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi:	R. Thanasi	M.Hasa
Drejtore e DAPS:	A. Suli	
Drejtor i DPPAABF:	L. Dervishi	
Drejtore e Financës:	A.Merkja	
Drejtore e Buxhetit:	M.Beluli	
Drejtore e Dr.Juridike:	O. Deliallisi	
Zv/Kryetar:	I.Sina	

SEKRETARI

Klajd GRIPSHI

KRYETARI

Hektor ÇIFTJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

624
25.5.2021

3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.2210/1 Prot. **Elbasan, më 27.05.2021**

V E N D I M

Nr. 44 Datë: 24 .05.2021

"Mbi dhënie me qira (rinovim kontrate) të ambjentit "kuzhinë" në konviktin e shkollës së mesme profesionale "Luigj Gurakuqi""

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.05.2021 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave) bazuar në ligjin Nr.139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, V.K.M Nr. 416 datë 11.07.2007 *"Për miratimin e listës përfundimtare të Pronave të Paluajteshme të Shtetit që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan"*, V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 *"Për përcaktimin e kritereve, të proçedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore"*, i ndryshuar, V.K.B Nr. _____ datë 24.05.2021 *"Për një ndryshim në V.K.B Nr. 145 datë 27.11.2020 "Mbi miratimin e tarifave të ambjenteve që jepen me qira nga Bashkia Elbasan dhe shfuqizimin e V.K.B nr. 24 datë 24.02.2009""*;

V E N D O S I :

1. Miraton dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit "kuzhinë" të konviktit të shkollës së mesme profesionale "Luigj Gurakuqi" me nr. pasurie 7/93 ndodhur në Lagjen "Luigj Gurakuqi", Z.K. 8521 me sipërfaqe 153 m^2, për t'u përdorur për "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për nxënësit e konviktit të shkollës së mesme profesionale" (Katering) të Bashkisë Elbasan, me tarifë qiraje mujore 300 (treqind) lekë/m^2, subjektit "Olta Sharra" me afat 1 (një) vit nga data 26.04.2021 deri më 25.04.2022.

2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave), Drejtoria Buxhetit dhe Drejtoria Financës.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

SEKRETAR
Klajd Gripshi

KRYETAR
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Sektori Pronave: A. Risha
Drejtoria A. P. S.:
Drejtoria Buxhetit:
Drejtoria Financës:
Drejtoria P.P.A.A.B.F.:
Drejtoria Juridike:
Zv/Kryetari:

R. Thanasi
A. Suli
M. Behluli
A. Merkja
L.Dervishi
O. Deliallisi
I. Sina

K. BASHKIAK

5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA ASETEVE PRONAVE DHE STREHIMIT

Nr.829/1 Prot. **Elbasan, më 3 .06.2021**

KONTRATË QIRAJE

Lidhur sot më datë ____.06.2021 , u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë vijon :

Me cilësinë e ***"Qiradhënësit"***: Bashkia Elbasan përfaqësuar nga Kryetari, **Z.Gledian Llatja**.

Me cilësinë e ***"Qiramarrësit"***: **Znj. Olta Sharra** (Person Fizik me TVSH) me nr. Nipt: L32517203Q, me Adresë: Lagja "Haxhias", Rr. "Ismail Zyma", përfaqësuar me "Prokurë të Përgjithshme" me Nr. Rep 2640, Nr. Kol 1566, datë 06.07.2020 nga **Z. Albert Kaçuli**.

I-OBJEKTI I KONTRATËS

Kjo kontratë ka si objekt dhënien me qira të ambjentit "kuzhinë" me sipërfaqe 153 m^2, e cila ndodhet në konviktin e shkollës së mesme profesionale "Luigj Gurakuqi", në lagjen "Luigj Gurakuqi", me tarifë mujore qiraje 300 lekë/m^2 subjektit ***"Qiramarrës"*** Znj. Olta Sharra, për t'a përdorur "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për nxënësit e konviktit të shkollës së mesme profesionale" (Katering).

II-BAZA LIGJORE

1. Ligji Nr.139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore";*
2. Ligjit Nr. 7850 datë 29.07.1994 *"Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar;
3. V.K.M. Nr. 54 datë 05.02.2014 *"Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të menyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore"*, i ndryshuar;
Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 145 datë 27.11.2020 *"Mbi miratimin e tarifave të ambjenteve që jepen me qira nga Bashkia Elbasan dhe shfuqizimin e V.K.B nr. 24 datë 24.02.2009";*
4. Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 49 datë 24.05.2021 *"Për një ndryshim në V.K.B nr.145 datë 27.11.2020 "Mbi miratimin e tarifave të ambjenteve që jepen me qira nga Bashkia Elbasan dhe shfuqizimin e V.K.B nr. 24 datë 24.02.2009";*
5. Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr. 44 datë 24.05.2021 *"Mbi dhënie me qira (rinovim kontrate) të ambientit "kuzhinë" në konviktin e shkollës së mesme profesionale "Luigj Gurakuqi"".*

III-PAGESA E QIRASË

Pagesa e qirasë prej 45 900 (Dyzet e pesë mijë e nëntëqind) lekë/muaj do të bëhet me bankë në llogarinë e Bashkisë Elbasan, brenda datës 30 të muajit. Pagesa për 5 (pesë) ditët e muajit Prill 2021 dhe pagesa e plotë e muajit Maj 2021 do të paguhen brenda muajit Qershor të vitit 2021 referuar tarifave të miratuara me V.K.B nr.145 datë 27.11.2020.

Mospagesa brenda afateve të caktuara me sipër e ngarkon "Qiramarrësin" me kamatvonesa e cila është 0,2% e qirasë mujore për çdo ditë vonesë të pagesës së qirasë.

IV-TE DREJTAT DHE DETYRIMET E "QIRADHËNËSIT"

1. ***"Qiradhënësi"*** ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e ***"Qiramarrësit"***.
2. ***"Qiradhënësi"*** është i detyruar të garantojë gëzimin e qetë të ambjentit, objekt i kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrejnë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.
3. ***"Qiradhënësi"*** ka të drejtën e zgjidhjes së kontratës dhe njofton me shkrim me afat prej 15 – diteve që nga momenti i konstatimit se ***"Qiramarrësi"*** nuk është kujdesur për mirëmbajtjen e ambjenteve, nuk ka kryer pagesat e qirasë, nuk ka zbatuar kushtet e kontratës.

V-TË DREJTAT DHE DETYRIMET E "QIRAMARRËSIT"

1. ***"Qiramarrësit"*** nuk i lejohet të bëjë asnjë adoptim të ambjentit të marrë me qira që do të konsistonte në ndërhyrje të strukturave ndërtimore pa marrë miratimin nga ana ***"Qiradhënësit"*** dhe nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Bashkia Elbasan.
2. ***"Qiramarrësi"*** është i detyruar të riparojë të gjitha dëmtimet e mundshme që mund t'i bëhen ambjenteve të dhënë me qira si pasojë e keqpërdorimit apo pakujdesisë së tij, në të kundërt është i detyruar të dëmshpërblejë ***"Qiradhënësin"*** në masën e dëmit të shkaktuar të vlerësuar sipas eksperteve.
3. ***"Qiramarrësi"*** ka të drejtë që sipas legjislacionit në fuqi të përdorë e të gëzojë pronën e marrë në qira dhe përmirësimet e bëra në të, për të gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.
4. ***"Qiramarrësi"*** ka për detyrë që të përdorë ambjentin sipas objektit të kësaj kontrate.
5. ***"Qiramarrësit"*** nuk i lejohet që ambientin e marrë me qira t'a japë me nënqira ose t'ia kalojë kontratën një tjetri.
6. Janë në ngarkim të ***"Qiramarrësit"*** të gjitha shpenzimet për mirëmbajtjen e përditëshme të ambjentit të marrë me qira. ***"Qiramarrësi"*** duhet të shlyejë të gjitha detyrimet ndaj subjekteve përkatës në lidhje me konsumin e energjisë elektrike, ujit, etj. Për këtë ***"Qiramarrësi"*** do të instalojë matësat përkatës dhe do të kontaktojë me subjektet furnizues.
7. Janë në ngarkim të ***"Qiramarrësit"*** të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

VI-KOHËZGJATJA E KONTRATËS

Kjo kontratë lidhet me afat 1 (një) vit, dhe efektet financiare fillojnë nga data 26.04.2021 deri më 25.04.2022.

Kësaj kontrate i bashkëngjitet proçes-verbali i dorëzimit të ambjentit nga ana e Bashkisë Elbasan si ***"Qiradhënës"*** dhe ***"Qiramarrësit"*** Znj. Olta Sharra.

VII-ZGJIDHJA E KONTRATËS

"Qiradhënësi" ka të drejtën e zgjidhjes së Kontratës së Qirasë, nëse konstaton se ***"Qiramarrësi"*** nuk kujdeset për mirëmbajtjen e ambjentit, nuk kryen pagesat e qirasë apo nuk zbaton kushtet e kontratës.

VIII-ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve gjatë regjimit të kontratës së qirasë, do të zgjidhen me mirëkuptim midis tyre, në të kundërt kopetence për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata Administrative Shkallës Parë, Durrës.
Kjo kontratë hartohet në gjashtë kopje origjinale, ku katër kopje i mban ***"Qiradhënësi"*** (Arkiva, Drejtoria e Buxhet Financë, Sektori i Pronave, K.Bashkiak), një kopje e merr ***"Qiramarrësi"*** dhe një kopje dërgohet në D.Sh.Publike pranë Prefekturës.

"Qiramarrës"
Olta Sharra
Përfaqësuar me Prokurë
Albert Kaçuli

OLTA SHARRA
NUIS: J32517203Q
Elbasan - Albania

"Qiradhënës"
KRYETARI
Gledian Llatja
Me urdhër e porosi
ZV/KRYETARI
Adi Qose

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

625
25.05.2024

4 (3)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2211/1 **Prot.** **Elbasan, më** 24.05.2021

V E N D I M

Nr. 45 **Datë:** 24.05.2021

"Mbi miratimin e fillimit të proçedurave për kërkimin e kalimit në pronësi të Bashkisë Elbasan, të objektit "pallat" nr.733/2 ndodhur në lagjen "5 Maji ".

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës____.05.2021, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë *"Mbi miratimin e fillimit të proçedurave për kërkimin e kalimit në pronësi të Bashkisë Elbasan, të objektit "pallat" nr.733/2 ndodhur në lagjen "5 Maji "*, bazuar në ligjin nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* si dhe ligjin nr. 8744, datë 22.01.2001 *"Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësinë e qeverisjes vendore"*, i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 20/2020 *"Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"*

V E N D O S I:

1. Miraton fillimin e proçedurave për kërkimin e kalimit në pronësi të Bashkisë Elbasan, të objektit "pallat" nr.733/2 ndodhur në lagjen "5 Maji", me qëllim përfundimin e proçedurave të privatizimit.

2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Sektori Pronave : A.Pisha *R. Thanasi*
Drejtoria A. P. S.: *A. Suli*
Drejtoria Buxhetit: *M. Behluli*
Drejtoria Financës: *A. Merkja*
Drejtoria P.P.A.A.B.F.: *L.Dervishi*
Drejtoria P.Sh.O.: *E. Kënuti*
Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*
Zv/Kryetari: *I. Sina*

626
25.05.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.2212 Prot. **Elbasan, më 25.05.2021**

V E N D I M

Nr.46 Datë:24 .05.2021

"Mbi dhënie në përdorim, pa kundërshpërblim (rinovim kontrate) të ambjentit ish-DRSHTRR Lagja"Hekurudha", U.K.E sh.a. nga Bashkia Elbasan"".

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.05.2021 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, bazuar në ligjin Nr.139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 *"Për përcaktimin e kritereve, të proçedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore"*, i ndryshuar; ligjin Nr. 7850 datë 29.07.1994 *"Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar;

V E N D O S I :

1. Miraton dhënien në përdorim, pa kundërshpërblim (rinovim kontrate) të ambientit ish-DRSHTRR me sipërfaqe 209 m^2 ndërtesë dhe 740 m^2 truall, ndodhur në Lagjen "Hekurudha", Z.K 8523, për t'u përdorur si zyra të U.K.E Sh.A., për periudhën 1 (një) vjeçare nga data 01.04.2021 deri më 31.03.2022 (planvendosje bashkëlidhur).
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Përgjithëshme Operacionale.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Sektori Pronave: A. Pisha R. Thanasi
Drejtoria A. P. S.: A. Suli
Drejtoria Buxhetit: M. Behluli
Drejtoria Financës: A. Merkja
Drejtoria P.P.A.A.B.F.: L. Dervishi
Drejtoria P.Sh.O.: E. Kënuti
Drejtoria Juridike: O. Deliallisi
Zv/ Kryetar: I. Sina

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

K. BASHKIAK.

5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr 2117/1 Prot. Elbasan 03 .06. 2021

KONTRATË HUAPËRDORJE

Lidhur sot më datë 03 .06.2021, midis palëve kontraktuese si më poshtë vijon:

Me cilësinë e "Huadhënësit": Bashkia Elbasan përfaqësuar nga kryetari **Z. Gledian Llatja.**

Me cilësinë e "Huamarrësit": Subjekti **"Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sh.a** me NIPT L43121201L, përfaqësuar nga administratori **Z. Leli Kaja.**

I-OBJEKTI I KONTRATËS

Kjo kontratë ka si objekt dhënien në përdorim pa pagesë të ambjentit ish-DRSHTRR, me sipërfaqe 209 m^2 ndërtesë dhe 740 m^2 truall, ndodhur në Lagjen "Hekurudha", Z.K. 8523 (Planimetria bashkëlidhur), subjektit **"Huamarrës"** U.K.E sh.a, për t'a përdorur për zyra të administratës.

II-BAZA LIGJORE

1. Ligji Nr.139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*;
2. Ligjit Nr. 7850 datë 29.07.1994 *"Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar;
3. V.K.M. Nr. 54 datë 05.02.2014 *"Për përcaktimin e kritereve, të proçedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore"*, i ndryshuar;
4. Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 46, datë 24.05.2021 *"Mbi dhënie në përdorim, pa kundërshpërblim (rinovim kontrate) të ambjentit ish-DRSHTRR Lagja"Hekurudha", U.K.E sh.a. nga Bashkia Elbasan""*.

III-TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

1. **"Huadhënësi"** ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e **"Huamarrësit".**
2. **"Huadhënësi"** për nevoja të ngutshme sipas gjykimit te tij, ka të drejtë të pezullojë përkohësisht përdorimin e ambjentit nga ana e **"Huamarrësit"**, duke i dërguar në mënyrë të menjëhershme njoftim me shkrim.
3. **"Huamarrësit"** nuk i lejohet të bëjë asnjë adoptim të ambjenteve të marra në përdorim që do të konsistonte në ndërhyrje të strukturave ndërtimore të ambientit pa marrë miratimin nga ana "**Huadhënësit"** dhe nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit pranë Bashkisë.
4. **"Huamarrësi"** është i detyruar të riparojë të gjitha dëmtimet e mundshme që mund t'i bëhen ambjenteve të marra në përdorim si pasojë e keqpërdorimit apo pakujdesisë së tij në të kundërt **"Huamarrësi"** është i detyruar të dëmshpërblejë Bashkinë në masën e dëmit të shkaktuar të vlerësuar sipas ekspertëve.
5. **"Huamarrësi"** ka të drejtë që sipas legjislacionit në fuqi të përdorë, të gëzojë pronën e marrë në përdorim dhe përmirësimet e bëra në të, për të gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.
6. **"Huamarrësi"** ka për detyrë që në raste të situatave të jashtëzakonshme që gjykohen si të tilla nga "**Huadhënësi"** të dorëzojë menjëherë dhe pa kushte ambjentin Bashkisë.
7. **"Huamarrësit"** nuk i lejohet që pronën e dhënë në përdorim t'a japë me qira ose t'ia kalojë kontratën një tjetri ose të ndryshojë destinacionin e saj.
8. Janë në ngarkim të **"Huamarrësit"** të gjitha shpenzimet për mirëmbajtjen e përditëshme të ambjenteve të marra në përdorim. **"Huamarrësi"** duhet të shlyejë të gjitha detyrimet ndaj subjekteve përkatës në lidhje me konsumin e energjisë elektrike, ujit, etj. Për këtë **"Huamarrësi"** do të instalojë matësat përkatës dhe do të kontaktojë me subjektet furnizues. Janë në ngarkim të **"Huamarrësit"** të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë në përdorim.

IV-KOHËZGJATJA E KONTRATËS

Kjo kontratë lidhet me afat 1 (një) vit, nga data 01.04.2021 deri më 31.03.2022
Kësaj kontrate i bashkëngjitet proçes-verbali i dorëzimit të ambjentit nga ana e Bashkisë Elbasan si **"Huadhënëse"** dhe **"Huamarrësit"** U.K.E sh.a.

V-ZGJIDHJA E KONTRATËS

Bashkia ka të drejtën e zgjidhjes së menjëhershme të Kontratës, nëse konstaton se **"Huamarrësi"** nuk kujdeset për mirëmbajtjen e Ambjentit, apo nuk zbaton kushtet e kontratës.

VI-ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve gjatë regjimit të kontratës së qirasë, do të zgjidhen me mirëkuptim midis tyre, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës.
Kjo kontratë hartohet në 5 (pesë) kopje origjinale ku katër kopje i mban **"Huadhënësi"**, Bashkia (Arkivë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Sektori i Pronave, Këshilli Bashkiak), një kopje e merr **"Huamarrësi"**.

"Huamarrësi"
Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a
Leli Kaja

UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN

"Huadhënësi"
KRYETARI
Gledian Llatja
Me urdhër e porosi
ZV/KRYETAR
Adi Qose

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2225/1 **Prot.** **Elbasan më,** 24 **.5.2021**

VENDIM

Nr. 47 **datë:** 24 **.5.2021**

"Për caktimin e numrit të strukturave komunitare për çdo lagje, datën e zgjedhjeve për këshillat komunitare dhe komisionet për strukturat komunitare, që do të ndjekin proçesin zgjedhor në qytet"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.5.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Koordinimit të Njësive Administrative dhe Lagjeve "*Për caktimin e numrit të strukturave komunitare për çdo lagje, datën e zgjedhjeve për këshillat komunitare dhe komisionet për strukturat komunitare, që do të ndjekin proçesin zgjedhor në qytet"*, mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) dhe në VKB nr.172 datë 24.12.2020 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e strukturave komunitare në qytet, Bashkia Elbasan"";

VENDOSI:

1. **Numri i strukturave komunitare në qytet, për çdo lagje, do të jetë:**

Lagja Nr.1	5 struktura;
Lagja Nr.2	5 struktura;
Lagja Nr.3	7 struktura;
Lagja Nr.4	5 struktura;
Lagja Nr.5	3 struktura;
Lagja Nr.6	5 struktura;
Totali	*30 struktura*

2. **Datat e zgjedhjeve për këshillat komunitar në qytet do të jenë:**

Lagja Nr.1 datë 05 - 06.7.2021;

Lagja Nr.2 datë 05 - 06.7.2021;

Lagja Nr.3 datë 05 - 06.7.2021;

Lagja Nr.4 datë 05 - 06.7.2021;

Lagja Nr.5 datë 05 - 06.7.2021;

Lagja Nr.6 datë 05 - 06.7.2021;

3. **Komisionet për strukturat komunitare në qytet, për çdo lagje, që do të ndjekin proçesin zgjedhor të strukturave komunitare, do të përbëhen nga 7 veta, nga të cilët 3 anëtarë këshilli bashkiak, 3 anëtarë nga shoqëria civile dhe 1 anëtar administratori i lagjes:**

- ***Lagja Nr.1***

1) Arbër Gjeta anëtar i Këshillit Bashkiak;
2) Ermira Bajrami anëtar i Këshillit Bashkiak;
3) Luan Rama anëtar i Këshillit Bashkiak;
4) Ilir Gjoni shoqëri civile;
5) Fatma Spahiu shoqëri civile;
6) Diana Kasa shoqëri civile;
7) Dorina Rroseni administrator i lagjes;

- ***Lagja Nr.2***

1) Ermira Hrupi anëtar i Këshillit Bashkiak;
2) Enelda Sejdiu anëtar i Këshillit Bashkiak;
3) Arjon Somorriu anëtar i Këshillit Bashkiak;
4) Mirela Gjoni shoqëri civile;
5) Dhoksa Qyku shoqëri civile;
6) Alketa Hasani shoqëri civile;
7) Elsid Zyma administrator i lagjes;

- ***Lagja Nr.3***

1) Eva Bica — anëtar i Këshillit Bashkiak;
2) Kejsi Çoçja — anëtar i Këshillit Bashkiak;
3) Ermir Çela — anëtar i Këshillit Bashkiak;
4) Elona Deliu — shoqëri civile;
5) Sokol Lulgjuraj — shoqëri civile;
6) Arben Rankaj — shoqëri civile;
7) Eugert Salla — administrator i lagjes;

- ***Lagja Nr.4***

1) Elsei Gullhaj — anëtar i Këshillit Bashkiak;
2) Meta Fevra — anëtar i Këshillit Bashkiak;
3) Endrit Abdia — anëtar i Këshillit Bashkiak;
4) Enver Mustafaraj — shoqëri civile;
5) Elvis Çota — shoqëri civile;
6) Esmeralda Mallosi — shoqëri civile;
7) Arben Demiri — administrator i lagjes;

- ***Lagja Nr.5***

1) Hada Teta — anëtar i Këshillit Bashkiak;
2) Brisolda Gjoza — anëtar i Këshillit Bashkiak;
3) Sokol Sinani — anëtar i Këshillit Bashkiak;
4) Rudina Çollaku — shoqëri civile;
5) Bukuroshe Manaj — shoqëri civile;
6) Indrit Abdiaj — shoqëri civile;
7) Agron Lulaj — administrator i lagjes;

- ***Lagja Nr.6***

1) Sokol Papa anëtar i Këshillit Bashkiak;
2) Rakli Rakipi anëtar i Këshillit Bashkiak;
3) Nadire Pisha anëtar i Këshillit Bashkiak;
4) Besnik Bodurri shoqëri civile;
5) Fatmir Popja shoqëri civile;
6) Elvis Kotherja shoqëri civile;
7) Gëzim Keçi administrator i lagjes;

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Koordinimit të Njësive Administrative dhe Lagjeve, Administratorët e 6 lagjeve dhe Këshilli Bashkiak.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI **KRYETARI**

Klajd Gripshi **Hektor Çiftja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Konceptoi:
Juristi i DKNjAL: *D. Çomo*
P/Sektori i DKNjAL: *E. Mezini*
Pranoi:
Drejtori i DKNjAL: *Sh. Bullari*
Drejtori Juridik: *O. Deliallisi*
Konfirmoi:
Drejtori i DPShO: *B. Çabiri*
Miratoi:
Sekretari i Përgjithshëm: *A. Bylykbashi*
Zv/Kryetari: *E. Muço*

628
25.05.2024

7 (3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.7124 Prot.

Elbasan më, 25 .5.2021

VENDIM

Nr. 48 datë: 24 .5.2021

"Për shpërblimin e kryetarëve të fshatrave dhe ndërlidhësave komunitar"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.5.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Koordinimit të Njësive Administrative dhe Lagjeve ***"Për shperblimin e kryetarëve të fshatrave dhe ndërlidhësave komunitar",*** mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), ligjin nr.10405, date 24.03.2011 "Per kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve" dhe në VKM nr.165 datë 02.3.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" (i ndryshuar);

VENDOSI:

1. Miratimin e shperblimit mujor te kryetareve te fshatrave ne masen:
   - 9% te pages bruto te administratorit te njesise administrative, per fshatrat me deri ne 500 banore;
   - 10% e pages bruto te administratorit te njesise administrative, per fshatrat me mbi 500 banore;
2. Miratimin e shperblimit mujor te nderlidhesave komunitar ne masen 9% te pages bruto te administratorit te lagjes.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hekton Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Konceptoi:
Juristi i DKNjAL: *D. Çomo*
P/Sektori i DKNjAL: *E. Mezini*
Pranoi:
Drejtori i DKNjAL: *Sh. Bullari*
Drejtori i DABNj: *L. Balliu*
Drejtori i Buxhetit: *M. Beluli*
Drejtori i Financës: *A. Merkja*
Drejtori Juridik: *O. Deliallisi*
Konfirmoi:
Drejtori i DPShO: *B. Çabiri*
Drejtori i DPPAABF: *L. Dervishi*
Miratoi:
Sekretari i Përgjithshëm: *A. Bylykbashi*
Zv/Kryetari: *E. Muço*

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q. Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

628
25.5.2021

15 9

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.2253/1 Prot. **Elbasan, më 25.05.2021**

V E N D I M

Nr. 49 Datë: 24.05.2021

"Për një ndryshim në V.K.B nr. 145 datë 27.11.2020 "Mbi miratimin e tarifave të ambjenteve që jepen me qira nga Bashkia Elbasan dhe shfuqizimin e V.K.B nr.24 datë 24.02.2009"".

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.05.2021 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Operiacionale dhe Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave) bazuar në ligjin Bazuar në ligjin nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, V.K.M Nr. 672, datë 02.09.2020 *"Për disa ndryshime në Vendimin nr. 54 datë 05.02.2014 te Keshillit te Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të proçedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore""*, të ndryshuar Urdhërit Nr 865,date 27.10.2020, të Kryetarit të Bashkisë, "Për vlerësimin dhe përcaktimin e vlerës së qirasë ", dhe Realcionit me nr. 5171/2 prot., datë 07.05.2021 "Për vlerësimin dhe përcaktimin e vlerës së qirasë ";

V E N D O S I :

1. Miraton ndryshimin në V.K.B nr. 145 datë 27.11.2020 *"Mbi miratimin e tarifave të ambjenteve që jepen me qira nga Bashkia Elbasan dhe shfuqizimin e V.K.B nr.24 datë 24.02.2009""* me tarifat e propozuara nga grupi i punës si më poshtë:

- Ndërtesë — 300 lekë/m^2
- Truall i lirë — 100 lekë/m^2 në zonën urbane; 40 lekë/m^2 në zonën rurale
- Tunelet dhe vendstrehimet — 200 lekë/m^2

2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e proçedurës së mëtejshme ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Operacionale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETAR
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Sektori Pronave : A.Pisha *R. Thanasi*
Drejtoria A. P. S.: *A. Suli*
Drejtoria Buxhetit: *M. Behluli*
Drejtoria Finances: *A. Merkja*
Drejtoria P.P.A.A.B.F.: *Q. Tusha*
Drejtoria P.Sh.O.: *E. Kënuti*
Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*
Zv/Kryetari: *I. Sina*

630
26.5.2024

6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2227/1 **Prot.** **Elbasan, më** 25.5.2021

VENDIM

Nr. 50 **datë** 24.5.2021

"Për miratimin e dhënies me qira të ambjenteve në godinën e pallatit të sportit "Tomorr Sinani", në lgj. "Dyli Haxhire", nga Bashkia Elbasan"

Këshilli Bashkiak Elbasan, në mbledhjen e tij të datës ___.5.2021, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Klubi Shumësportesh Bashkia Elbasan, bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), në VKM nr.416 datë 11.7.2007 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme të shtetit, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Elbasan" (i ndryshuar), në VKM nr.54 datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të proçedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore" (i ndryshuar).

V E N D O S I:

4) Të miratojë dhënien me qira të ambjenteve në godinën e pallatit të sportit "Tomorr Sinani", në lgj. "Dyli Haxhire", subjekteve private si mëposhtë vijon:

   f. Subjektit qiramarrës, ***zj. Vetiana GICA,*** (duke i bashkëlidhur dokumentacionin e kërkuar, sipas VKM nr.54 datë 05.02.2014), i jep me qira një ambjent, "dhomë", që ndodhet në katin përdhes, hyrja lindore e godinës, me sipërfaqe 56.7 m^2, me tarifë mujore qiraje 600 lekë / m^2, me afat 1 vjeçar, nga 01.01.2021 - 31.12.2021;

   g. Subjektit qiramarrës, ***zj. Vetiana GICA,*** (duke i bashkëlidhur dokumentacionin e kërkuar, sipas VKM nr.54 datë 05.02.2014), i jep me qira një ambjent, "dhomë", që ndodhet në katin përdhes, hyrja lindore e godinës, me sipërfaqe 32.4 m^2, me tarifë mujore qiraje 600 lekë / m^2, me afat 1 vjeçar, nga 01.01.2021 - 31.12.2021;

   h. Subjektit qiramarrës, ***z. Mario KOÇIAJ,*** (duke i bashkëlidhur dokumentacionin e kërkuar, sipas VKM nr.54 datë 05.02.2014), i jep me qira një ambjent, "dhomë", që ndodhet në katin përdhes, hyrja juglindore e godinës, me sipërfaqe 34.41 m^2, me tarifë mujore qiraje 600 lekë / m^2, me afat 1 vjeçar, nga 01.01.2021 - 31.12.2021;

   i. Subjektit qiramarrës, ***z. Jorgji BIQIKU,*** (duke i bashkëlidhur dokumentacionin e kërkuar, sipas VKM nr.54 datë 05.02.2014), i jep me qira një ambjent, "dhomë" (riparime elektrike dhe elektronike), që ndodhet në katin përdhes, hyrja perëndimore e godinës, me sipërfaqe

752
29.6.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 743/1 **Prot.** **Elbasan, më** 29 **.06.2021**

V E N D I M

Nr. 68 **Datë:** 29 **.06.2021**

"Mbi miratimin e fillimit të proçedurave për kërkimin e kalimit në pronësi të Bashkisë Elbasan, të pasurisë me emërtimin "Zyrat e Sektorit të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor".

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës____.06.2021, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë "*Mbi miratimin e fillimit të proçedurave për kërkimin e kalimit në pronësi të Bashkisë Elbasan, të pasurisë me emërtimin "Zyrat e Sektorit të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor"*, bazuar në ligjin Nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, ligjin Nr. 8744, datë 22.01.2001 *"Për transferimin e pronave të paluajsthsme të shtetit në njësinë e qeverisjes vendore"*, i ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Miraton fillimin e proçedurave për kërkimin e kalimit në pronësi të Bashkisë Elbasan, me qëllim zhvillimin social – ekonomik në fushën e turizmit te pasurisë me emërtimin "Zyrat e Sektorit të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor", ndodhur në Njësinë Administrative Gjinar, Elbasan.

2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Sektori Pronave : *R. Thanasi*
Drejtoria A. P. S.: *A. Suli*
Drejtoria Buxhetit: *M. Behluli*
Drejtoria Financës: *A. Merkja*
Drejtoria P.P.A.A.B.F.: *L. Dervishi*
Drejtoria P.Sh.O.: *D. Meta*
Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*
Zv/Kryetari: *I. Sina*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.2744 Prot.

Elbasan, më 29.06.2021

V E N D I M

Nr. 69 Datë: 29.06.2021

"Mbi miratimin në parim të fillimit të proçedurës së shpronësimit për zgjerimin e varrezave publike të qytetit të Elbasanit"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.06.2021 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Operiacionale dhe Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave) bazuar në nenin 9/1/1.2 pika b, nenin 23/7 dhe nenin 54 të ligjit nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*; ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"*, i ndryshuar; V.K.M nr. 712 datë 29.10.2014 " *Për miratimin e rregullores teknike për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqiperisë*";

V E N D O S I :

1. Miraton në parim fillimin e proçedurës së shpronësimit për pasuritë pronë private që preken nga realizimi projektit me interes publik *"Për zgjerimin e varrezave publike të qytetit të Elbasanit"*, ndodhur në Z.K 8522, nga Bashkia Elbasan, paraqitur në planimetrinë bashkëlidhur.

2. Miraton burimin e financimit nga Buxheti i Bashkisë Elbasan miratuar me V.K.B. nr.168 datë 24.12.2020 "*Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2021*", për shpronësinuin e pasurisë të prekur nga projekti i lartpërmendur.

3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e proçedurës së mëtejshme ngarkohet Komisioni i Shpronësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Operacionale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës.

4

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETAR
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Sektori Pronave : *R. Thanasi*
Drejtoria A. P. S.: *A. Suli*
Drejtoria Buxhetit: *M. Behluli*
Drejtoria Finances: *A. Merkja*
Drejtoria P.P.A.A.B.F.: *L. Dervishi*
Drejtoria P.Sh.O.: *D. Meta*
Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*
Zv/Kryetari: *I. Sina*

754
29.06.2021

15

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2859/1 **Prot.** **Datë** 29 **.06. 2021**

VENDIM

NR. 70 **DATË** 29 **. 06. 2021**

MBI

"Transferim fonde për investime, nga të ardhurat",

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___ .06. 2021, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi "Transferim fonde për investime, nga të ardhurat", bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", udhëzimin nr.4, datë 25.01.2021 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021" dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.168, datë 24.12.2020 mbi "Miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2021", i ndryshuar,

VENDOSI :

1. Transferimin e fondeve në buxhetin e vitit 2021, për investime nga të ardhurat, njësia shpenzuese Bashkia, si më poshtë :

Paksohet :
- 6,431 mijë lekë, "Ndërtim kënde sportive në lagjen "Skenderbej", programi 08130;
- 7,208 mijë lekë,"Rikonstruksion i shkollës së mesme artistike "Onufri" (në bashkf.me FZHR),

13,639 mijë lekë gjithsej programi 09230;

Shtohet :
-11,540 mijë lekë, "Rehabilitim i sheshit urban në lindje të rrugës "Iliaz Kosova", tek xhamia Fushë Mbret, në lagjen "Skënderbej", programi 04520;
- 2,099 mijë lekë, "Blerje pajisje per rilevim topografik (GPS ose total station), shtese fondi,

13,639 mijë lekë gjithsej programi 01110.

16

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Prokurimeve.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Klajd Gripshi

KRYETAR
Hektor Ciftja

Dr.Buxhetit : M.Belyli

Dr. Pergj.: L.Dervishi

Dr.Juridike: O.Deliallisi

Zv/kryetar : I.Sina

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

755
29.6.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr2969 **prot.** **Elbasan më** 29 **.06.2021**

VENDIM

Nr. 71 **Datë** 29.06.2021

PËR MIRATIMIN E FUSHATËS SË PARTNERITETIT TË KËSHILLIT BASHKIAK ME QYTETARËT.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015, Për vetëqeverisjen vendore, neni 16, pika 1, neni 18, neni 19 dhe neni 54, pika k, ligjit 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" dhe Rregullores së Këshillit Për marrëdhëniet me Publikun dhe Mediat (Konsultimeve Publike) me propozim të Kryesisë së Këshillit,

VENDO S I

1. Të miratojë zhvillimin e aktivitetit **"Fushata e Partneritetit të Këshillit me qytetarin".**
2. Aktiviteti do të zhvillohet sipas programit të detajuar bashkangjitur këtij vendimi.
3. Për realizimin e aktivitetit të kryhen shpenzime nga buxheti i Këshillit të Bashkiak për vitin 2021.
4. Për këtë vendim ngarkohet Këshilli Bashkiak, Kryetari I Këshillit, Sekretariati dhe komisionet e Këshillit Bashkiak të mbështetura nga specialstët e administrates së Bashksië.
5. Ky vendimhynnëfuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd GRIPSHI

KRYETAR

Hektor ÇIFTJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 3499/Prot

Elbasan më 30/07/2021

VENDIM

Nr 72 datë 29/07/2021.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin QERSHOR 2021

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 27.01.2021 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin QERSHOR 88 familje me fond 278.860 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr.Sh. K. Soc Komunit Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi

Drejtori Buxheti M. Beluli
Drejtori Financës A.Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

917
02.08.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 3498/1 Prot

Elbasan më 30/07/ 2021

VENDIM
Nr. 73 datë 29 /07/2021

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin QERSHOR 2021

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 27.01.2021 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike"

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike dhe pagese dyfishe nga fondet e kushtëzuara per muajin **QERSHOR 2021** gjithsej 229 familje me një fond prej 1.361.816 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi:
Dr. Sh. K. S Komunitar Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi

Drejtori Buxheti M. Beluli
Drejtori Finances P/A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

916
02.08.2021

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Nr3500/1 prot

Elbasan me30/07/2021

VENDIM

Nr74/datë29/07/2021

Për vendosjen në institucionet rezidenciale të shërbimeve sociale.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës /07/2021 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar dhe vendimin e "Komisionit të vlerësimit të nevojave dhe vendosjes në institucionet rezidenciale të shërbimeve sociale dhe kujdestarisë", bazuar në ligjin nr.121/206 datë 24.11.2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në R.Sh.", neni 28 dhe VKM nr.518 datë 04.09.2018 "Për përcaktimin e kritereve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror",

VENDOSI

I. Të miratojë vendosjen në Qendrën Sociale Balashe si më poshtë:

1. I moshuri Z. Mihal Siko Dukoli i datëlindjes 10.I1.1945, vendbanimi Elbasan, lagjia " Haxhias " me nr. ID E51110018U.
2. I moshuri Ismail Zenun Berati i datelindjes 04.11.1946, vendbanimi Elbasan, lagjia "Brigada 17 Sulmuese" me nr. ID E61104002F.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar si dhe Drejtoria e Qendres Sociale Balashe.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Drejtori K.Social Sh.Lika

Drejtori Buxhetit M.Beluli

Drejtori Juridik O. Deliallisi

Drejtori Finances A.Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA ELBASAN

PROCES VERBAL

I mbajtur sot më date 29.07.2021 ora 11.00 ne zyrën e N/kryetarit të bashkisë Z.Adi Qosja, mbi zhvillimin e mbledhjes të këshillit bashkiak. Prezent ne zyrë jane Kryetari këshillit bashkiak Z.Hektor Ciftja, sekretari këshillit bashkiak Z. Klajd Gripshi , N/kryetari bashkisë Z.Adi Qosja..
Mbledhja zhvillohet online.Marrin pjesë online 36 antarë të këshillit bashkiak, gjithashtu, sekretare përgjithshme Zj. Aulona Bylykbashi, drejtore drejtorie dhe specialiste te ndryshem.

Pika e 2-te e rendit të ditës - Per vendosjen e dy te moshuarve ne institucionet e rezidenciale te sherbimeve sociale.

Adi Qosja – N/Kryetar i Bashkise Elbasan.
Siç e dimë në QSB bëhet aplikim për përzgjedhjen e dy personave.

Hektor Ciftja – Kryetar i Keshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin.
Këshilli bashkiak me 36 vota pro kunder abstenim nuk ka miraton sa më sipër.

Mbajtëse Proces Verbalit
Aida TALELLI

Sekretari Këshillit Bashkiak
Klajd GRIPSHI

Kryetari Këshillit Bashkiak
Hektor CIFTJA

915
02.08.2021

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3501/1 **Prot.** **Datë** 30 **.07. 2021**

VENDIM

NR. 75 **, DATË** 29 **. 07. 2021**

MBI

"TAVANET PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE, TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2022-2024"

Këshilli Bashkiak i Qytetit Elbasan i mbledhur sot më datë ____. 07. 2021, pasi mori në shqyrtim materialet e përgatitura nga Bashkia e Qytetit Elbasan, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, "Mbi tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024", mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise", i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm, të njësive të vetëqeverisjes vendore" dhe Udhëzimin nr.20, datë 09.07.2021 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024",

VENDOSI :

1. Miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve, të programit buxhetor afatmesëm për tre vitet e ardhshme 2022-2024, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi për Menaxhimin Strategjik.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR
Klajd GRIPSHI

KRYETAR
Hektor ÇIFTJA

Dr.Buxhetit : M.Beluli
D.P.Sh.M : L.Dervishi
D.P.SH.O : D.Meta
D.P.SH.I : S.Mehmeti
D.P. Sh. O: B.Çabiri
D.P.P.Zh : A.Gashi
Dr.T.T,V .: Q.Tusha
Dr.Juridike: O.Deliallisi
Zv/kryetar : A.Qose
Zv/kryetar : E. Muço
Zv/kryetar : V. Liço
Zv/kryetar : I.Sina

Bashkia Elbasan

Programi Buxhetor Afatmesem 2022-2024

Tavanet perfundimtare te shpenzimeve per vitet 2022-2024

ne 000/leke

Nr.	Emertimi programit	Programi	Viti 2022				Viti 2023				Viti 2024			
			Shpenzime personeli	Shpenzime te tjera korente	Shpenzime Kapitale	Totali buxhetit	Shpenzime personeli	Shpenzime te tjera korente	Shpenzime Kapitale	Totali buxhetit	Shpenzime personeli	Shpenzime te tjera korente	Shpenzime Kapitale	Totali buxhetit
1	Planifikim Menaxhim & Administrim	01110	284,150	99,425	12,000	**395,575**	289,833	98,419	12,360	**400,612**	289,833	97,403	12,600	**399,837**
2	Çeshtje finaciare dhe fiskale	01120	47,300	5,400	2000	**54,700**	48,246	5,454	2,200	**55,900**	48,246	5,563	3,000	**56,809**
3	Gjendja Civile	01170	15800	764	0	**16,564**	15,800	778	**0**	**16,578**	15800	800	0	**16,600**
4	Pagesa per sherbimin e borxhit te brendshem	01710		100,606		**100,606**	0	88,680	0	**88,680**	0	85,276	0	**85,276**
5	Sherbimet e Policise Vendore	03140	28,230	2,900	1000	**32,130**	28,795	2,929	1,100	**32,824**	28,795	2,958	1,320	**33,073**
6	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	03280	29,181	85,205	2,000	**116,386**	29,765	86,057	2,200	**118,022**	29,765	86,918	2,640	**119,322**
7	Mbeshtetje per zhvillim ekonomik	04130	1,731	70	0	**1,801**	1,733	3,070	0	**4,803**	1,733	4,100	0	**5,833**
8	Sherbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	04160	2,690	300	6,000	**8,990**	2,744	1,565	6,600	**10,909**	2,744	1,581	7,920	**12,244**
9	Sherbimet bujqesore, inspektimi, siguria ushqimore	04220	14,450	500	11,000	**25,950**	14,739	705	12,100	**27,544**	14,739	712	14,520	**29,971**
10	Menazhimi i infrastruktures se ujitjes dhe kullimit	04240	10,550	8,240	10,000	**28,790**	10,761	9,064	11,000	**30,825**	10,761	9,155	13,200	**33,116**
11	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	04260	15,600	15,560	25,000	**56,160**	15,912	15,716	27,500	**59,128**	15,912	15,873	33,000	**64,785**
12	Rrjeti rrugor rural	04520	50,261	22,400	128,500	**201,161**	51,266	22,624	128,619	**202,509**	51,266	23,816	155,843	**230,925**
	"Rikualif.urban i infrast.rrugore dhe rekreativiteti..."PPP			156,000		**156,000**		156,000		**156,000**		156,000		**156,000**
13	Transporti publik	04570	21,830	16,523	2,400	**40,753**	22,267	16,688	2,640	**41,595**	22,267	16,855	3,168	**42,290**
14	Menaxhimi i mbetjeve	05100	9,200	103,080	7,500	**119,780**	9,384	110,296	8,250	**127,930**	9,384	111,399	9,900	**130,683**
15	Menaxhimi i ujrave te zeza dhe kanalizimeve	05200	0	0	11,000	**11,000**	0	0	12,100	**12,100**	0	0	14,520	**14,520**
16	Programe te mbrojtjes se mjedisit	05320	7,830	608	1,000	**9,438**	7,987	670	1,100	**9,756**	7,987	676	1,320	**9,983**
17	Planifikimi urban vendor	06140	0	0	6,814	**6,814**	0	0	7,214	**7,214**	0	0	8,094	**8,094**
18	Sherbimet publike vendore	06260	49,710	94,132	30,000	**173,842**	50,704	95,073	33,000	**178,778**	50,704	96,024	39,600	**186,328**
19	Furnizimi me uje	06330	0	0	2,500	**2,500**	0	0	2,750	**2,750**	0	0	3,300	**3,300**
20	Ndriçim rrugesh	06440	8,960	107,000	15,000	**130,960**	9,139	114,490	16,500	**140,129**	9,139	115,635	19,800	**144,574**

21	Sherbimet e kujdesit paresor	07220	1,319	600	1,000	**2,919**	1,345	606	1,100	**3,051**	1,345	612	1,320	**3,277**
22	Sport dhe argetim	08130	25,730	28,500	10,000	**64,230**	26,245	28,710	11,000	**65,955**	26,245	28,922	13,200	**68,367**
23	Trashegimia kulturore, eventet artistike dhe kulturo	08220	44,800	25,600	2,000	**72,400**	45,696	28,856	2,600	**77,152**	45,696	29,145	3,120	**77,961**
24	Arsimi baze (perfshire parashkollor)	09120	314,034	99,695	41,701	**455,430**	320,315	104,345	45,871	**470,531**	320,315	109,228	55,045	**484,588**
25	Arsimi mesem pergjithshem	09230	33,157	21,500	30,250	**84,907**	33,820	22,400	33,275	**89,495**	33,820	23,345	39,930	**97,095**
26	Arsimi profesional	09230/09240	8,546	55,648	8,000	**72,194**	8,717	55,767	8,800	**73,284**	8,717	56,368	10,560	**75,645**
27	Kujdesi social per personat e semure & aftesi te kufi	10140	0	3,400	0	**3,400**	0	4,434	0	**4,434**	0	4,567	0	**4,567**
28	Sigurimi shoqeror (te moshuarit)	10220	4,770	5,525	1,000	**11,295**	4,865	5,580	1,100	**11,546**	4,865	5,748	1,320	**11,933**
29	Kujdesi social per familjet dhe femijet	10430	54,430	2,014,862	2,500	**2,071,792**	55,519	2,015,146	2,750	**2,073,415**	55,519	2,016,006	3,300	**2,074,825**
30	Strehimi social	10661	3,310	18,451	2,300	**24,061**	3,376	18,499	2,530	**24,405**	3,376	18,548	3,036	**24,960**
31	F.Rezerve & Kontigjenca	04980		12,000		**12,000**	0	12,120	0	**12,120**	0	13,014	0	**13,014**
	Gjithsej :		**1,087,569**	**3,104,494**	**372,465**	**4,564,528**	**1,108,972**	**3,124,741**	**396,259**	**4,629,972**	**1,108,972**	**3,136,246**	**474,577**	**4,719,795**



5

814
08.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3508/1 **Prot.** **Elbasan më** 30 **.7.2021**

VENDIM

Nr. 76 **datë** 29**.7.2021**

"Për miratimin e ngritjes, përbërjes dhe funksionimit të Komisionit të Strehimit"

Këshilli Bashkiak Elbasan, në mbledhjen e tij të datës ___.7.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit, mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar);
- Ligjin nr.22/2018 "Për strehimin social";
- VKM nr.384 datë 12.6.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore";

V E N D O S I:

1) Të miratojë ngritjen e Komisionit të Strehimit, me përbërje si mëposhtë:

- Kryetar - Zv/kryetari i Bashkisë;
- Anëtar - Përfaqësues i Drejtorisë së Aseteve, Pronave dhe Strehimit;
- Anëtar - Përfaqësues i Drejtorisë së Buxhetit;
- Anëtar - Përfaqësues i Drejtorisë së Financës;
- Anëtar - Përfaqësues i Drejtorisë Juridike;
- Anëtar - Përfaqësues i Drejtorisë së Kujdesit Social;
- Anëtar - Përfaqësues i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit;
- Anëtar - Drejtori i Drejtorisë së Koordinimit të Njësive Adm. / Lagjeve;
- Anëtar - Përfaqësues i Drejtorisë së Informacionit;

2) Pjesëmarrjen, si dëgjues në takimet e këtij komisioni, të përfaqësuesve të organizatave jofitimprurëse me aktivitet në juridiksionin e Bashkisë Elbasan, si mëposhtë:

- *Përfaqësues të shoqatave të jetimëve;*
- *Përfaqësues të shoqatave në mbrojtje të grave;*
- *Përfaqësues të shoqatave në mbrojtje të PAN;*
- *Përfaqësues të të persekutuarve politikë;*
- *Përfaqësues të komunitetit, shoqatave në mbrojtje të të drejtave të minoriteteve rome dhe egjiptiane;*
- *Përfaqësues të shoqatave në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve;*

3) Ky komision strehimi të funksionojë sipas kuadrit ligjor që rregullon fushën e strehimit social.

4) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni i Strehimit.

1090093	Supervizim " " "	177	2021	2021		177					
1090094	Kolaudim " " "	18	2021	2021		18					
1090578	Vendosje e sistemit te kamerave per Biblioteken	120	2021	2021		120	119	119			
1090579	Rikonstruksion tualete dhe rrjeti elektrik i Bibliotekes	488	2021	2021		469					
1090091	Supervizim " " "	11	2021	2021		11					
1090092	Kolaudim " " "	1	2021	2021		1					
1090580	Riparim i Xhybes	120	2021	2021		53					
1090616	Blerje dhe montim kondicioneri per biblioteken " Qemal Baholli"	79	2021	2021		79	79	79			
	Blerje e dy aparateve thithes lageshtire per nevojat e muzeut etnografik	67	2021	2021		67					
1090570	Blerje qilima dhe rrugica per muzeun etnografik	120	2021	2021		120					
1090595	Blerje pajisje elektro-shtepiake (sobe gatimi, aspirator, hekur me kaldaje, frigorifer etj..)	415	2021	2021		415					
1090596	Blerje kompjuter, printer- fotokopje, hp scaner jet	85	2021	2021		85					
1090595	Blerje ene guzhine (tenxhere me presion 150 racione)	80	2021	2021		80					
1090596	Blerje kompjutera, fotokopje printer, etj	120	2021	2021		120					
1090598	Blerje kondicionere	220	2021	2021		220					
1090597	Blerje pajisje elektroshtepiake (televizor 50")	80	2021	2021		80					
	Supervizim ndertimi ures metalike kembesore prane qendres komunitare Rome(bashk finac,projekti ROMATECD)	75				75	75	75			
	Blerje kompjutera (bashkfinacim projekti ROMATECD)	35				35					



1090533	Blerje pajisje per funksionimin e banesave sociale (pompa uji, etj.).	250	2021	2021		250				
1090533	Blerje fotokopje printer	50	2021	2021		50				
1090602	Blerje tabela 24-sekondeshe per basketbollin	200	2021	2021		140	115	115		
1090187	Blerje shtylla volejbolli	160	2021	2021		220				
1090556	Blerje makine korrese bari	250	2021	2021		250				
1090613	Blerje bolier dushi	100	2021	2021		100				
	TOTALI I INVESTIMEVE nga buxheti I bashkise(gr.00)					625,884	101,739	52,142	252,992	
	Investime nga te ardhurat jashte limiti									
1090128	Blerje pajisje zyre per gjendjen civile	109	2021	2021		110				
1090094	Kolaudim " Restaurim i zyrave te gjendjes civile"Elbasan	1			1	1	1	1		
	Riparim i shkollave dhe kopeshteve,demtuar nga termeti i dates 21.09.2019(demshperblim Sigal)	4030	2021	2021		4,030				
	TOTALI I INVESTIMEVE nga te ardhurat jashte limiti					**4,141**	**1**	**1**	**0**	**0**
	Investime nga Transfeta e kushtezuar									
M100399	Permiresimi I kushteve te banimit per kom.te pafavorizuara(bashkfinancim:80 % ministria,)	22,359	2020	2021	18,079	2,814			11,650	
	Total (transferta te kushtezuara)					2,814	0	0	11,650	

	Totali investimeve :					**632,839**	**101,740**	**52,143**	**264,642**	

Projektet me financim te huaj (ne 000/leke)

kod proje	Emertimi i Projektit	grant/kredi	Vlera e plote e projektit	Viti i fillimit te projektit	Viti I perfundimit te projektit	Buxheti _____ kontraktuar	Plani I buxhetit vitit _____	Realizimi per periudhen e raportimit(4-mujore/vjetore	Realizimi Progresiv nga fillimi i vitit deri ne periudhen aktuale	Realizimi Progresiv nga fillimi I projektit deri ne periudhen aktuale

1085
01.10.2024

(10

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.4402/1 **Prot.** **Datë** 30 **.09. 2021**

VENDIM

NR.93 **DATË** 29 **. 09. 2021**

MBI

"Transferim fonde në buxhetin e vitit 2021"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___ .09. 2021, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi "Transferim fonde në buxhetin e vitit 2021", bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", udhëzimin nr.4, datë 25.01.2021 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021" dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.168, datë 24.12.2020 mbi "Miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2021", i ndryshuar,

VENDOSI :

1. Transferimin e fondeve në buxhetin e vitit 2021, nga të ardhurat, njesia shpenzuese Bashkia, si më poshtë :

Paksohet :
- 275,309 lekë, "Sistemim i rrugës kryesore të kishës së "Shën Thanasit", fshati Shelcan Nj.Admin. Shushicë, (tepricë prokurimi), programi 04520;
- 1,002,525 lekë, shpenzime programi 01110, artikulli 604, (transferta K.Qarkut)), Bashkia;

1,277,834 lekë gjithsej

Shtohet :
- 450,000 lekë, pjesë këmbimi dhe shërbime për mjetet zjarrfikës, prog. 03280, artikulli 602,
- 420,000 lekë, blerje pajisje zjarrfikëse (radio ndërlidhje, rapitator komplet, motosharrë druri,etj,) programi 03280, artikulli 231.
- 63,495 lekë, bursë e plotë për nxënësin Musa Astrit Xhyra, shkolla "Ali Myftiu", për vitin shkollor 2020-2021 (9 muaj), programi 09120, artikulli 606, Bashkia.
- 307, 290 lekë, supervizim "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara", programi 06140, artikulli 231;
- 37,049 lekë, kolaudim " " " "

1,277,834 lekë gjithsej

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Prokurimeve.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Klajd Gripshi

ZV/KRYETAR
Sokol Sinani

Dr.Buxhetit : M.Beluli

Dr. Pergj.: L.Dervishi

Dr.Juridike: O.Deliallisi

Zv/kryetar : I.Sina

1086
01.10.2021

6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9403/1 **Prot.** **Elbasan, më** 30.09.**2021**

VENDIM

Nr. 84 **dt.** 29.09 **2021**

MIRATIMIN ÇMIMIT TË SHITJES, DRU ZJARRI NË FUSHËN E DEPOZITIMIT TË BASHKISË ELBASAN

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ____.____.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit, mbështetur në:

- Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 54;
- Ligjin nr 57/2020 datë 30.4.2020 "Për pyjet",
- Ligji nr. 5/2016 "Për shpalljen e Moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë";
- VKM nr.438, datë 08/06/2016 "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore" të ndryshuar;
- Udhëzimi Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr.2, datë 03.03.2017 "Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje" Kreu I, dispozita të përgjithshme pika 14;
- Kontratën nr. 4553/6 prot, datë 17/11/2020 "Për prerje dhe transport dru zjarri".

V e n d o s i:

1. Çmimin e shitjes së materialit drusor, dru zjarri, në fushën e Bashkisë, për plotësimin e nevojave të banorëve dhe enteve publike të Bashkisë Elbasan dhe në rast teprice bashkive të tjera do të jetë në vlerën **3315** (tremijë e treqind e pesëmbëdhjetë) Lekë /mst pa TVSH.
2. Furnizimin me dru zjarri sipas planit të shpërndarjes të enteve publike si kopshte, çerdhe, shkolla si dhe institucionet në vartësi të Bashkisë Elbasan, do të realizohet nga drutë e zjarrit që do depozitohen në fushën e bashkisë.
3. Materiali drusor i sekuestruar nga strukturat e ndryshme pas depozitimit në fushën e Bashkisë do përdoret:

c) Drutë e zjarrit i shiten popullatës me çmimin e përcaktuar në pikën 1, ose përdoren për furnizimin e enteve publike sipas pikës 2;

d) Lënda e punimit, që mund të rezultojë gjatë shfrytëzimit do të shitet drejtpërsëdrejti popullatës (plotësimi i nevojave më emergjente) ose do të shitet në treg të lirë nëpërmjet procedurave të konkurimit të hapur, pas testimit të çmimit tregut;

4. Të ardhurat nga shitja e materialit drusor do të arkëtohen në llogarin nr. 7035011, me objekt "Të ardhura nga materiali drusor";

5. Çmimi i shitjes së materialit drusor, dru zjarri, i miratuar në këtë vendim do të aplikohet për volumin e kontraktuar në kontratën nr. 4553/6 prot, datë 17/11/2020 "Për prerje dhe transport dru zjarri".
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria Shërbimeve Publike; Qendra Ekonomike e Arsimit dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit.
7. Ky vendim hynë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

Me Urdher e Porosi

Nenkryetari Keshillit

Sokol Sinani

REPUBLIKA E SHQIPERISE-BASHKIA ELBASAN

Konceptoi:

Specialisti i Menaxhimit:	Q. Poka
P/Sektorin e Admin_Menaxhimit:	J. Bodurri
Drejtori i DSHPBVM:	Sh. Çullhaj
Drejtoria Juridike:	O. Deliallisi
Zv/ Kryetari:	I. Sina

1071
29.05.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4459/1 **Prot.** **Elbasan, më** 29.09.**2021**

VENDIM

Nr. 95 **datë** 29.09.**2021**

"Për miratimin e projekt-propozimit të Bashkisë Elbasan mbi Programin ndërkufitar Republika e Maqedonisë së Veriut - Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Para-anëtarësimit, Ndarjet e Ndihmës (IPA II) për 2018 – 2020 për aplikimin IPA/2021/170339/28 Krushevë dhe Elbasan - destinacione të njohura të turizmit ndërkufitar"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.___.2021, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve ***"Për miratimin e projekt-propozimit të Bashkisë Elbasan mbi Programin ndërkufitar Republika e Maqedonisë së Veriut - Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Para-anëtarësimit, Ndarjet e Ndihmës (IPA II) për 2018 – 2020 për aplikimin IPA/2021/170339/28 Krushevë dhe Elbasan - destinacione të njohura të turizmit ndërkufitar"***, mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar);
- Ligjin 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar;
- Ligjin nr. 57/2020, datë 30.04.2020, "Për pyjet";

VENDOSI:

1. Të miratojë projekt-propozimin e Bashkisë Elbasan mbi Programin ndërkufitar Republika e Maqedonisë së Veriut - Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Para-anëtarësimit, Ndarjet e Ndihmës (IPA II) për 2018 – 2020 për aplikimin IPA/2021/170339/28 Krushevë dhe Elbasan - destinacione të njohura të turizmit ndërkufitar.

2. Bashkia Elbasan, si përfituese e grantit të këtij programi, merr angazhimin të ndjeki hartimin e projektit teknik, aplikimin dhe miratimin e lejes së ndërtimit (sipas detyrimit ligjor të Republikës së Shqipërisë), detyrimin për pagesën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar

(TVSH) sipas kushteve dhe kritereve nga nënshkrimi i kontratës, për aktivitetet dhe funksionet e përcaktuara në aplikim, pjesë e territorit të Njësisë Administrative Funar, Bashkia Elbasan.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore, si dhe Drejtoria Juridike në Bashkinë Elbasan.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Konceptoi:

Përgjegjësi i SUL: *S. Hyskja*

Pranoi:

Drejtori i DPTP: *A. Canaj*

Miratoi:

Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*

Drejtori i Buxhetit: *M. Beluli*

Konfirmoi:

Sekretari i Përgjithshëm: *A. Bylykbashi*

Zv/Kryetari: *I. Sina*

1087
01.10.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4576/2 **Prot.** **Datë** 30 **.09. 2021**

VENDIM

NR. 96 **DATË** 29 **. 09. 2021**

MBI

"Miratim investime me dy vite financimi"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 29. 09. 2021, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi ""**Miratim investime me dy vite financim**", bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", udhëzimin nr.4, datë 25.01.2021 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021" dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.168, datë 24.12.2020 mbi "Miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2021", i ndryshuar,

VENDOSI :

1.Miratimin e financimit me dy vite buxhetore (2021-2022) të objektit të investimeve nga të ardhurat, njësia shpenzuese Bashkia, si më poshtë :

Paksohet : (në lekë)

	Viti 2021	**viti 2022**
-"Rikonstruksion dhe ndërhyrje në linjën KUZ dhe ndërtim i sheshit të parkimit të Varrezave Publike"	36,476,186	-
-Supervizim " " "	467,691	-
-Kolaudim " " "	56,123	-
Gjithsej :	**37,000,000**	

Shtohet : (në lekë)

	Viti 2021	**viti 2022**
-"Rikonstruksion dhe ndërhyrje në linjën KUZ dhe ndërtim i sheshit të parkimit të Varrezave Publike",	36,476,186	18,983,714
-Supervizim " " "	467,691	233,694
-Kolaudim " " "	56,123	11,753
Gjithsej :	**37,000,000**	**19,229,161**

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Prokurimeve.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Klajd Gripshi

ZV/KRYETAR
Sokol Sinani

Dr.Buxhetit : M.Beluli

Dr. Pergj.: L.Dervishi

Dr.Juridike: O.Deliallisi

Zv/kryetar : I.Sina

1088

01.10.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4530/1 **Prot.** **Elbasan më,** 30 **.9.2021**

VENDIM

Nr. 97 **datë** 29 **.9.2021**

"Për miratimin e akt marrëveshjes midis Bashkisë Elbasan dhe fondacionit "Mirënjohja për ndërtimin e qëndrës shëndetësore në lagjen "Haxhias" Bashkia Elbasan"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.9.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Operacionale *"Për miratimin e akt marrëveshjes midis Bashkisë Elbasan dhe fondacionit "Mirënjohja për ndërtimin e qëndrës shëndetësore në lagjen "Haxhias" Bashkia Elbasan"*, mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjin nr.10296, date 8/7/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin";

VENDOSI:

1. Miratimin e Akt Marreveshjes midis Bashkisë Elbasan dhe fondacionit "Mirënjohja" për ndërtimin e qëndrës shëndetsore në lagjen "Haxhias" Bashkia Elbasan"
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Operacionale dhe Zyra e Investimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

Me urdber e porosi

Zv/ KRYETARI

Sokol Sinani

Konceptoi:

Pergjegjes sek. P.Sh.I. :	*M. Avllazagaj*
Drejtor DPTP:	*A. Canaj*
Drejtori D.P.P.S.,S.Sh.K.I:	*A. Gashi*
Drejtoria Juridike:	*O. Deliallisi*
Zv/Kryetari:	*E. Muco*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDACIONI "MIRENJOHJA"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. A/164 *Prot.*
Dt. 29/09/2021

Nr. 4888 *Prot.*
Dt. 1 10 *.2021*

AKT - MARRËVESHJE

E lidhur sot, më datë 29.09.2021, në ambjentet e Bashkisë Elbasan, mes palëve të mëposhtme:

- **Pala e parë**
  Fondacioni "MIRENJOHJA", i organizuar dhe i regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë; me NUIS K91603454H dhe adresë: Rruga "Don Bosko", Pall. "Aurora Construcion", Shk.1, kati 1, ap.A03 dhe A04, Tirane; përfaqësuar nga Drejtori ekzekutiv i saj, **z. Samet Shehu,** i datëlindjes 10.3.1953, banues në Tirane, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me ID nr. F30310292U; për efekt të kësaj marrëveshje, më poshtë do të emërtohet ***"Pala e parë";***

dhe

- **Pala e dytë**
  Bashkia Elbasan, me NUIS K52905207B, përfaqësuar nga Kryetari i saj, **z. Gledian Llatja,** me adresë: Lagjja "11 Nëntori", Rruga "Qemal Stafa"; për efekt të kësaj marrëveshje, më poshtë do të emërtohet ***"Pala e dytë";***

Parakushte:

MEQENËSE:

A. Pala e parë paraqitet në këtë marrëveshje në funksion të misionit të saj për të mbështetur grupe të ndryshme shoqërore, në përputhje me parimet e dinjitetit njerëzor dhe drejtësisë sociale, në bashkëpunim me partnerët e zhvillimit dhe veprimet humanitare.

B. Pala e dytë shpreh dëshirën për të bashkëpunuar me Palën e parë, për të rregulluar aspektin infrastrukturor përsa i përket Qendrave Shëndetësore të zonave në administrim të Palës së dytë.

A. Pala e parë merr përsipër të investoj, për ndërtimin e Qëndrës Shëndetsore në Lagjen "Haxhias", e ndodhur në zonën Kadastrale 8525, Nr.Pasurie 3/94 (referuar hartës së vitit1996) Elbasan, sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 1
Objekti i Marrëveshjes

1.1 Ndërtimi i Qëndrës Shëndetsore në Lagjen "Haxhias", qyteti Elbasan.
1.2 Pala e parë, me zyrë në Shqipëri, ka dhënë dakordësi për ndërtimin e 1 Qendre Shëndetësore në Lagjen "Haxhias", qyteti Elbasan, si dhe dorëzimin e saj pranë Palës së dytë.
1.3 Vendi i investimit do të jetë Nr.Pasurie 3/94, e ndodhur në zonën Kadastrale 8525, në Lagjen "Haxhias" Bashkia Elbasan, me përfitues institucionet shtetërore: Bashkia, në Lagjen "Haxhias" qyteti Elbasan.
1.4 Pala e parë do të kontribuojë në ndërtimin e 1 Qendre Shëndetësore në Lagjen "Haxhias" qyteti Elbasan, dhe në përfundim të punimeve duhet të firmoset, nga ana e Palës së dytë, proçesverbali i marrjes në dorëzim të ketij objekti.

Neni 2
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e kësaj marrëveshje përcaktohet për një periudhë 8 (tete) mujore, deri në datën e dorëzimit të objektit të ndërtuar nga fondacioni "MIRENJOHJA", duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

Neni 3
Detyrimet e Palës së Parë

3.1 Pala e parë merr përsipër hartimin e projekt zbatimit nëpërmjet palëve të treta.
3.2 Punimet duhet të kryhen nën drejtimin e Palës së parë.
3.3 Pala e parë do të realizojë proçesin e punës gjatë etapave të ndërtimit të objektit, përfshirë punimet për sistemet elektrike, sistemet hidraulike, sanitare dhe të gjitha punimet e tjera të nevojshme dhe gjithçka do të provohet përpara dorëzimit të objekteve.
3.4 Pala e parë ka të drejtën të transferojë punimet, tërësisht ose pjesërisht, si dhe detyrimet e tij sipas kësaj marrëveshje, duke kërkuar dhënien e shërbimit prej subjekteve të treta.
3.5 Pala e parë nuk mban përgjegjësi për mosrealizimin e objektit të investimit për arsye natyrore.
3.6 Për efekt të motit të keq dhe forcave madhore afati i punimeve do të zgjatet me të njëjtën kohë, pas miratimit të dy palëve.

Neni 4
Detyrimet nga Pala e Dytë

4.1 Të propozojë vendin ku do të ndërtohet ky objekt.
4.2 Pala e dytë merr përsipër të realizojë lirimin e sheshit të ndërtimit që konsiston në evadimin e mbetjeve të ndryshme që mund të jenë krijuar ndër vite aty dhe prishjen e objekteve të ndryshme që bëhen pengesë në realizimin e investimit.
4.3 Të ndjekë të gjitha proçedurat e fillimit të punimeve në vendin ku është propozuar ndërtimi i objektit.
4.4 Pala e dytë merr përsipër të krijojë kushte të favorshme për zhvillim e punës duke mos u bërë pengesë për vijim normal të punimeve.
4.5 Pala e dytë merr përsipër miratimin e lejes së ndërtimit apo veprime të tjera administrative.
4.6 Pala e dytë duhet të zgjidhë të gjitha problemet që kanë lidhje me administratën shtetërore gjatë

fazave të punimeve.

4.7 Pala e dytë merr përsipër të marrë në dorëzim objektin pasi të jetë kryer kolaudimi i saj.

4.8 Pala e dytë merr përsipër sistemimin e territorit pas përfundimit të punimeve.

4.9 Pas kolaudimit të objektit dhe marrjes në dorëzim nga Pala e dytë, Pala e parë nuk ka asnjë lloj përgjegjësie për ruajtjen, mirëmbajtjen apo përdorimin e objektit. Të gjitha shpenzimet do të jenë për Palën e dytë dhe përfituesin.

Neni 5

Modifikime dhe Shtesa të Marrëveshjes

5.1 Modifikimet dhe shtesat që i bëhen kësaj marrëveshjeje janë të vlefshme vetëm nëse janë të shkruara dhe të firmosura nga të dyja palët.

5.2 Marrëveshja është e pandryshueshme dhe nuk mund të ndryshohet në mënyrë të njëanshme nga palët.

Neni 6

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet palëve zgjidhen me mirëkuptim. Në të kundërt, palët drejtohen për zgjidhjen e tyre në gjykatën kompetente.

Neni 7

Njoftimet

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis palëve në këtë marrëveshje bëhen me shkrim, duke iu dorëzuar personalisht personave të kontaktit, si më poshtë vijon:

a) *Për Palën e Parë, fondacionin "MIRENJOHJA.":*
Ermal Çela
e-mail: ermal.cela@hotmail.com
Tel: 0692539778

b) *Për Palën e Dytë, Bashkia Elbasan:*
Marvis Avllazagaj
e- mail: mavllazagaj@yahoo.com
Tel: 0695281648

Neni 8

Tërësia dhe Interpretimi i Marrëveshjes

8.1 Kjo marrëveshje do të interpretohet duke konsideruar afatet dhe kushtet e saj në tërësi. Në çdo rast, secili nen apo formulim që do të krijojë paqartësi do të vlerësohet në kontekstin e të gjithë marrëveshjes dhe në lidhje me qëllimet që kanë nxitur të dyja palët për të lidhur këtë marrëveshje.

8.2 Kjo marrëveshje dhe të gjitha drejtimet e punimeve, do të kryhen në bazë të legjislacionit shqiptar.

8.3 Nëse ndonjë nga pikat e kësaj marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme, e paligjshme dhe e pamundur për t'u ekzekutuar, ajo do të veçohet nga marrëveshja. Pavarësisht nga kjo, të gjitha

parashikimet e tjera të marrëveshjes, do të mbeten në fuqi dhe do të prodhojnë pasoja për palët. Asnjë pikë e kësaj marrëveshjeje nuk do të varet nga ndonjë pikë tjetër, përveç në rast të kundërt kur parashikohet nga kjo marrëveshje.

8.4 Marrëveshja duhet të interpretohet në mirëbesim nga palët.

Neni 9
Hyrja në Fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët.

Neni 10
Forca Madhore

10.1 Asnjëra nga palët nuk do të jetë përgjegjëse për çdo vonesë në përmbushjen e detyrimeve të saj nëse kjo vonesë është shkaktuar nga një forcë madhore. Megjithatë, kjo dispozitë zbatohet vetëm në qoftë se forca madhore ndodh pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, në mënyrë që kjo e bën të pamundur ose tepër të rëndë për një nga palët që të përmbushë detyrimet e saj.

10.2 Forca madhore përfshin luftë, embargo, revolucion, bllokadë, greva, ndërhyrje ushtarake, apo qarkullim të rendit kushtetues, tërmete, stuhi, përmbytje, epidemi, apo ndonjë katastrofë tjetër natyrore. Pala që është e prekur nga forca madhore do të njoftojë menjëherë palën tjetër për pamundësinë për të përmbushur detyrimet e saj, për shkak të forcës madhore.

10.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Pala e parë duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e saj sipas marrëveshjes, në masën paraprakisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që pengohet nga Forca Madhore.

Neni 11
Dispozita të Fundit

11.1 Palët përgjigjen për respektimin dhe realizimin e kësaj marrëveshjeje.

11.2 Kjo marrëveshje përbën marrëveshjen e plotë mes palëve. Çdo shtesë apo ndryshim i kësaj marrëveshjeje bëhet vetëm me miratimin në formë të shkruar të të dyja palëve në marrëveshje.

11.3 Kjo marrëveshje hartohet në ***4 (katër) kopje,*** nga 2 (dy) kopje origjinale për secilën palë, të cilat, pasi bien dakord, e nënshkruajnë atë rregullisht.

PALA E PARË
Fondacioni "Mirenjohja"
Drejtori Ekzekutiv
Samet Shehu

PALA E DYTË
Bashkia Elbasan
Kryetari
Gledian Llatja
Personi i Autorizuar
Zv/Kryetari
Ervin Muço

1164
25.10.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 5074 Prot Elbasan më 27 /10/2021

VENDIM

Nr 98 datë 27 /10/2021.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin SHTATOR 2021

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 27.01.2021 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin SHTATOR 106 familje me fond 272.580 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr.Sh. K. Soc Komunit Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi

Drejtori Buxheti M. Beluli
Drejtori Financës A.Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

1165
25.10.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 5075/1 Prot Elbasan më 25/10/ 2021

VENDIM
Nr. 99 datë 25 /10/2021

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin SHTATOR 2021

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 27.01.2021 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike"

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike dhe pagese dyfishe nga fondet e kushtëzuara per muajin **SHTATOR 2021** gjithsej 211 familje me një fond prej 703.216 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi:
Dr. Sh. K. S Komunitar Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi

Drejtori Buxheti M. Beluli
Drejtori Finances A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

1166
25.10.2021

2

3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 507/1 **Prot.** **Elbasan, më:** 27 **.10.2021**

V E N D I M

Nr. 100 **Datë:** 27 **.10.2021**

"Mbi marrjen me qira të 2 (dy) mjeteve (rinovim kontrate) për plotësimin e nevojave të transportit të administratës dhe kryerjen e shërbimeve publike të Bashkisë Elbasan"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.10.2021, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, *"Mbi marrjen me qira të 2 (dy) mjeteve (rinovim kontrate) për plotësimin e nevojave të transportit të administratës dhe kryerjen e shërbimeve publike të Bashkisë Elbasan"*, bazuar në ligjin Nr. 139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*; ligjin Nr. 10160 datë 15.10.2009 *"Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë"*, i ndryshuar; ligjin Nr. 115/2014 *"Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"*; ligjin Nr. 7850 datë 29.07.1994 *"Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar;

V E N D O S I :

1. Miraton marrjen me qira (rinovim kontrate) nga Bashkia Elbasan për 2 (dy) mjete (autoveturë e markës Volkswagen Sharan dhe fadromë e markës Caterpilar) me afat 1 (një) vjeçar duke filluar nga data 06.11.2021 deri më 05.11.2022, për t'u përdorur për plotësimin e nevojave të transportit të Administratës dhe kryerjen e shërbimeve publike të Bashkisë.

2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës (sektori i pronave), Drejtoria Buxhetit dhe Drejtoria Financës .

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

Sektori Pronave : A. Pisha *R. Thanasi*
Drejtoria A. P. S.: *A. Suli*
Drejtoria Buxhetit: *M. Behluli*
Drejtoria Finances: *A. Merkja*
Drejtoria P.P.A.A.B.F.: *L. Dervishi*
Drejtoria P.Sh.O.: *D. Meta*
Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*
Zv/Kryetari: *I. Sina*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr.4567/2 **Prot.** **Elbasan, më:** 04 .11.2021.

KONTRATË QIRAJE

E lidhur sot, më datë ___/11/2021, ndërmjet:

- ***Subjekti "ERGI" sh.p.k., përfaqësuar nga administratori Z. Ergi Balla,*** regjistruar me çertifikatë regjistrimi Nipt K02727229P, me adresë: Autostrada Elbasan-Metalurgji, km 3, që mëposhtë do të quhet ***"Qiradhënësi"***;

- ***Bashkia Elbasan,*** person juridik, regjistruar me çertifikatë regjistrimi Nipt K52905207B, ***përfaqësuar nga kryetari i saj, Z. Gledian Llatja,*** që më poshtë do të quhet ***"Qiramarrësi"***;

I. Objekti i Kontratës

"Qiradhënësi" i jep me qira ***"Qiramarrësit"*** 2 (dy) mjete për t'i përdorur për plotësimin e nevojave të transportit të administratës dhe kryerjen e shërbimeve publike të Bashkisë Elbasan, si më poshtë:

1. Autoveturë të markës VOLKSWAGEN SHARAN, me ngjyrë gri, dhe numër shasie WVWZZZ7NZCV012674;

2. Fadromë të markës CATERPILAR, të tipit mjet ndërtimi nga 7.5 ton deri në 18 ton, në ngjyrë të verdhë, dhe numër shasie CAT0432EJBXE04123.

II. Baza Ligjore

1. Bazuar në ligjin Nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*;
2. Ligjin Nr. 7850 datë 29.07.1994 *"Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar;
3. Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 100 datë 25.10.2021 *"Mbi marrjen me qira të 2 (dy) mjeteve (rinovim kontrate) për plotësimin e nevojave të transportit të administratës dhe kryerjen e shërbimeve publike të Bashkisë Elbasan".*

III. Afati i Kontratës

Kjo kontratë lidhet me një afat 1 (një) vit, duke filluar nga data 06.11.2021 dhe mbaron më datë 05.11.2022.
Palët mund të merren vesh, për zgjatjen e afatit të kontratës, duke lajmëruar me shkrim 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të saj.

IV. Mënyra e Pagesës

"Qiramarrësi" i paguan ***"Qiradhënësit"*** tarifën e qirasë, prej 66.000 (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë/muaj (me T.V.SH) për autoveturën, dhe tarifën e qirasë, prej 158.000 (njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë/muaj (me TVSH) për fadromën, kundrejt dorëzimit të faturës.

Pagesa do të bëhet në llogarinë bankare me nr. llogarie 405010466, IBAN AL25205310500104 66CLPRCLALLA, pranë Bankës Kombëtare Tregtare (BKT), dega Elbasan, në emër të subjektit "ERGI" sh.p.k. me NIPT K02727229P, me administrator Z. Ergi Balla, brenda datës 28 të çdo muaji deri në përfundim të kësaj kontrate.

Kur mjetet nuk janë në gjendje pune për më shumë se 3 (tre) ditë, jo për faj të ***"Qiramarrësit"***, këto ditë do të zbriten nga vlera e qirasë.

V. Detyrimet e palëve

- ***"Qiradhënësi"*** i jep ***"Qiramarrësit"***, me qira, një mjet fadromë *(makineri ngarkuese - gërmuese, me katër goma, me specifikimet sipas dokumentacionit bashkëlidhur kësaj kontrate),* dhe një mjet autoveturë për t'a përdorur sipas nevojave të bashkisë;
- ***"Qiradhënësi"*** duhet të kryejë, me shpenzimet e veta, shërbimet periodike (ndërrim vaji, filtra, pjesë këmbimi etj.), brenda 24 orëve, nga lindja e nevojës për shërbime (mundësisht në ditë jozyrtare pune);
- ***"Qiradhënësi"*** kryen, me shpenzimet e veta, rinovimin e dokumentacionit, përcaktuar sipas Kodit Rrugor në fuqi, nëse përfundojnë gjatë kohës së kësaj kontrate (kryerja e këtij shërbimi të bëhet brenda 1 dite pune);
- ***"Qiradhënësi"*** kryen, me shpenzimet e veta, riparimet e defekteve, kur vërtetohet se defekti nuk ka ardhur nga përdorimi i keq i mjetit;
- ***"Qiradhënësi"*** duhet t'i dorëzojë mjetet (autoveturën dhe fadromën), objekt i kësaj kontrate, ***"Qiramarrësit"***, me nënshkrimin e saj nga palët, në gjendje të lirë, dhe të garantojë gëzimin e qetë të tij, gjatë kohëzgjatjes së qirasë;
- Janë në ngarkim të ***"Qiradhënësit"*** të gjitha detyrimet e taksave dhe tatimeve, që rëndojnë mbi këto mjete;
- ***"Qiramarrësi"*** merr përsipër furnizimin me lëndën djegëse të mjeteve;
- ***"Qiramarrësi"*** do të zhdëmtojë vlerën e plotë të dëmeve, të cilat vlerësohen që janë shkaktuar, nga përdorimi i mjetit, me dashje apo nga pakujdesia;
- ***"Qiramarrësi"*** do të paguajë vlerën e gjobave të vëna gjatë periudhës së qiramarrjes;
- ***"Qiramarrësi"*** nuk ka të drejtë të japë me nënqira, mjetet objekt të kësaj kontrate;

V. Zgjidhja e Kontratës

Kjo kontratë mund të zgjidhet, në mënyrë të njëanshme, nga palët para afatit, kur krijohen kushte të tilla që e bëjnë të pamundur vazhdimin e saj. Konkretisht:

- kur ***"Qiramarrësi"*** nuk paguan detyrimet mujore, për më shumë se 2 (dy) muaj rradhazi, nga afati i paracaktuar në kontratë;
- nëse, si pasojë e ndonjë akti ligjor, nënligjor, apo akt tjetër administrativ të organeve kompetente, ***"Qiramarrësi"*** do të ishte i detyruar të zgjidhte kontratën, duke njoftuar, me shkrim, ***"Qiradhënësin"*** 30 ditë përpara. Gjatë afatit të njoftimit ***"Qiradhënësi"*** do të përfitojë qiranë mujore të parashikuar;
- ***"Qiradhënësi"*** nuk plotëson apo respekton kushtet e parashikuara në kontratë.

VI. Të Përgjithshme

Mosmarrëveshjet e ndryshme, që mund të lindin kur palët janë në marrëdhënie kontraktuale, do të zgjidhen me mirëkuptim midis tyre. Në të kundërt kompetente, për zgjidhjen e tyre, do të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës.

Kjo kontratë hartohet në 6 (gjashtë) kopje origjinale, ku 1 (një) kopje e mban ***"Qiradhënësi"*** dhe 5 (pesë) të tjerat qëndrojnë në bashki *(Arkivë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Agjensia e Shrbimeve Publike, Drejtoria Aseteve dhe Strehimit dhe Këshilli Bashkiak).*

"Qiradhënësi"
"Ergi" sh.p.k
Administratori
Ergi Balla

"Qiramarrësi"
Bashkia Elbasan
KRYETARI
Gledian Llatja
Me urdhër e porosi
ZV/KRYETARI
Adi Qose

1166
25.10.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6071 **Prot.** **Elbasan, më:** 27 **.10.2021**

V E N D I M

Nr. 1100 **Datë:** 27 **.10.2021**

"Mbi marrjen me qira të 2 (dy) mjeteve (rinovim kontrate) për plotësimin e nevojave të transportit të administratës dhe kryerjen e shërbimeve publike të Bashkisë Elbasan"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.10.2021, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, *"Mbi marrjen me qira të 2 (dy) mjeteve (rinovim kontrate) për plotësimin e nevojave të transportit të administratës dhe kryerjen e shërbimeve publike të Bashkisë Elbasan"*, bazuar në ligjin Nr. 139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*; ligjin Nr. 10160 datë 15.10.2009 *"Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë"*, i ndryshuar; ligjin Nr. 115/2014 *"Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë";* ligjin Nr. 7850 datë 29.07.1994 *"Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar;

V E N D O S I :

1. Miraton marrjen me qira (rinovim kontrate) nga Bashkia Elbasan për 2 (dy) mjete (autoveturë e markës Volkswagen Sharan dhe fadromë e markës Caterpilar) me afat 1 (një) vjeçar duke filluar nga data 06.11.2021 deri më 05.11.2022, për t'u përdorur për plotësimin e nevojave të transportit të Administratës dhe kryerjen e shërbimeve publike të Bashkisë.

2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës (sektori i pronave), Drejtoria Buxhetit dhe Drejtoria Financës .

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1676/1 Prot.

Elbasan më 26.10.2021

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.100 datë 25.10.2021 "Mbi marrjen me qira të 2 (dy) mjeteve (rinovim kontrate) për plotësimin e nevojave të administratës dhe kryerjen e shërbimeve publike të Bashkisë Elbasan", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Spiro Maliqi

1167
25.10.2024

3

4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5076 **Prot.** **Datë** 25 **.10. 2021**

VENDIM

NR. 101 **DATË** 25 **. 10. 2021**

MBI

"Transferim fonde në buxhetin e vitit 2021",

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___ .10. 2021, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi "Transferim fonde në buxhetin e vitit 2021", bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", udhëzimin nr.4, datë 25.01.2021 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021" dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.168, datë 24.12.2020 mbi "Miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2021", i ndryshuar,

VENDOSI :

1. Transferimin e fondeve në buxhetin e vitit 2021, nga të ardhurat, si më poshtë :

Paksohet :
300,000 lekë, shpenzime programi 01110, artikulli 604, (transferta), njësia shpenzuese Bashkia;

Shtohet :
300,000 lekë, blerje materiale (për riparimin e parketit të pallatit të sportit "Tomorr Sinani"), programi 08130, artikulli 602, njësia shpenzuese Sport Klubi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Sport Klubi.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Klajd Gripshi

KRYETAR
Hektor Ciftja

Dr.Buxhetit : M.Beluli
Dr. Pergj.: L.Dervishi
Dr.Juridike: O.Delialli
Zv/kryetar : I.Sina

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr "Qemal Stafa",Tel. +355 54 400152,E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

1162
25.10.2024

4

B

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5072/1 **Prot.** **Elbasan më,** 25 **.10.2021**

VENDIM

Nr. 102 **datë:** 25 **.10.2021**

"Për miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Bashkisë Elbasan dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.10.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Operacionale ***""Për miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Bashkisë Elbasan dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave"***, mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjin nr.9154, date 06/11/2003 "Për Arkivat";

VENDOSI:

1. Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Bashkisë Elbasan dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave me objekt "Përpunimin tekniko - shkencor të dokumenteve të papërpunuara të fondeve dhe të fondkrijuesve të tjerë që e kanë mbyllur veprimtarinë e tyre, nga Bashkia Elbasan, si institucion trashëgues, të dorëzuara për ruajtje të përhershme pranë DPA-së" sipas lidhjes bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – BASHKIA ELBASAN

Konceptoi:

Pergjegjes sek.Prot.Arkives : *A. Talelli*

Drejtori Juridike: *O. Deliallisi*

Drejtori DPSHO: *B. Cabiri*

Zv/Kryetari: *E. Muco*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE

Nr. 7772/2 Prot, Datë 04.10.2021

BASHKIA ELBASAN

Nr. 5315 Prot, Datë 20.10.2021

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET
BASHKISË ELBASAN
DHE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE

Kjo akt-marrëveshje është lidhur sot më datë ____.____. **2021**, midis palëve të mëposhtme:

A. BASHKIA ELBASAN, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, këtu e në vijim "Bashkia".

B. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave Z. Ardit Bido, këtu e në vijim "DPA".

NENI 1
BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje hartohet dhe bazohet në:
1.Neni 42, pika 2 e nenit 46 të Ligjit Nr.9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat".
2.Pika 4 e nenit 24 e Normave Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.
3. Pika 1, 6 e nenit 9, neni 10, neni 42, neni 92 I LigjitNr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

NENI 2
OBJEKTI

Përpunimi tekniko shkencor i dokumentave të papërpunuara të fondeve dhe të fondkrijuesve të tjerë të këtij rrethi, që e kanë mbyllur veprimtarinë e tyre, nga Bashkia Elbasan, si institucion trashëgues, të dorëzuara për ruajtje të përhershme pranë DPA-së.

NENI 3
SASIA DHE GJENDJA E PËRPUNIMIT TEKNIKO-SHKENCOR

1.Sasia e dokumenteve i përket fondit të Bashkisë Elbasan, si institucion trashëgues, për të cilat nuk është kryer procesi i përpunimit tekniko-shkencor, si një detyrim që rrjedh nga aktet ligjore në fuqi.

2.Dokumentet që do të përpunohen i përkasin viteve para 1990.

NENI 4
ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E PALËVE

1. PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE:

1.1 Organizimi dhe ndjekja e punës për përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve në mjediset e vendruajtes së DPA, në Elbasan.
1.2 Punonjësit duhet të jenë me arsim të mesëm/lartë dhe me preferencë njohës të fushës arkivore.
1.3 Përgatitja profesionale e punonjësve që do të bëjnë përpunimin tekniko-shkencor dhe caktimi i një punonjësi të DPA që do të mbikqyrë procesin e përpunimit tekniko-shkencor të dokumenteve.

2. PËR BASHKINË ELBASAN:

2.1 Ushtrimi i të gjithë të drejtave të institucionit fondkrijues për shërbimin e dokumenteve, sipas ligjit "Për Arkivat" dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore për shfrytëzimin e dokumenteve.
2.2 Përcaktimi i numrit të punonjësve 10 (dhjetë), për një periudhë 5 (pesë) vjeçare dhe pagesa e tyre prej Bashkisë Elbasan.

NENI 5
HYRJA NË FUQI

1.Kjo akt marrëveshje hyn në fuqi menjëherë, me nënshkrimin e saj nga të gjitha palët.

NENI 6
AFATI

1.Afati i kësaj akt marrëveshje është 5 (pesë) vjet, me të drejtë rinovimi.

NENI 7
FORCA MADHORE

7.1 Forca madhore i perjashton Palët nga përgjegjësia për dështimin e pjesshëm apo të plotë në përmbushjen e detyrimeve të tyre përkatëse sipas kësaj akt marreveshje. Forca madhore do të thotë çdo ngjarje e paparashikuar dhe e pakapërcyeshme qe ndodh në mënyrë të pavarur nga vullneti i palëve, pas hyrjen në fuqi të kësaj akt marreveshje dhe e cila pengon pjesërisht ose në tërësi permbushjen e detyrimeve nga ana e Palëve nënshkruese.

7.2 Pala që ndodhet në kushtet e forcës madhore, detyrohet te njoftoje palën tjetër si per fillimin ashtu dhe për përfundimin e forcës madhore, brenda pesë ditëve; në mungese të një njoftimi të tille ajo nuk do të përfitojë efektet e forcës madhore.

NENI 8
DISPOZITA TË FUNDIT

8.1 Kjo akt marrëveshje përbën marrëveshjen e plotë të palëve. Marrëveshjet verbale dhe parashikimet e bëra gjatë negociatave për lidhjen e kësaj akt marrëveshje nuk përbëjnë kushte të kesaj akt marrëveshje. Çdo ndryshim i akt marrëveshjes do të jetë i vlefshem, vetëm nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të gjitha Palët.
8.2 Në rast mosrespektimi të marrëveshjes dhe moszgjidhjes me mirëkuptim, palët njohin si autoritet ankimimi në Gjykatë.
8.3 Palët kanë të drejtë që të rishikojnë vazhdimësinë e saj në përfundim të afatit.
8.4 Kjo aktmarrëveshje është hartuar në 2 (dy) kopje.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE
DREJTORI PËRGJITHSHËM
Ardit BIDO

BASHKIA ELBASAN
KRYETARI
Gledian LLATJA

1169

25.10.2024

(5)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5126/1 **Prot.** **Elbasan më,** 20.10.2021

VENDIM

Nr. 103 **datë:** 25.10.2021

"Për dhënien e pëlqimit për vendosjen e pllakës përkujtimore në shtëpinë e familjes Karanxha, në lagjen "Shën Koll",Elbasan"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.10.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit Parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportit *"Për dhënien e pëlqimit për vendosjen e pllakës përkujtimore në shtëpinë familjes Karanxha, në lagjen "Shën Koll", Elbasan"*, mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe në kërkesën e shoqatës kulturore "Arumunët e Shqipërisë", me propozim të Kryetarit të Bashkisë;

VENDOSI:

1. Të japë pëlqimin për vendosjen e pllakës përkujtimore në shtëpinë e familjes Karanxha me mbishkrimin *"La aesta casa ira scoala Romana 1899 - 1915"*, e përkthyer në shqip *"Në këtë shtëpi ishte shkolla rumune 1899 - 1915"*.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit Parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Konceptoi:

D.P.P.A.P.T.K.T.S. : *D. Kristo*

Drejtori Juridike: *O. Deliallisi*

Zv/Kryetari: *V. Lico*

1170
25.10.2021

6

3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5078/1 **Prot.** **Elbasan më** 25 **.10.2021**

VENDIM

Nr. 104 **datë:** 25 **.10.2021**

"Për përcaktimin e përfaqësuesve të Bashkisë Elbasan në bordet e institucioneve arsimore parauniversitare"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.10.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Arsimit dhe Edukimit *"Për përcaktimin e përfaqësuesve të Bashkisë Elbasan në bordet e institucioneve arsimore"*, mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjin nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" dhe në Udhëzimin nr.25, datë 25.07.2018 "Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor;

VENDOSI:

1. Miratimin e përfaqësuesve të Bashkisë Elbasan në bordet e institucioneve arsimore, parauniversitare, të cilët do të jenë Administratorët e Lagjeve të qytetit dhe Administratorët e Njësive Administrative, sipas juridiksionit territorial të tyre.
2. Ky përfaqësim është i vlefshëm për një periudhë 4 vjeçare nga data e miratimit të tij në Këshillin Bashkiak.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Elbasan.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Konceptoi:

Drejtoria P.A.E. : *E. Stafa*

Drejtori Juridike: *O. Deliallisi*

Zv/Kryetari: *V. Dico*

1172

25.10.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5127/1 **Prot.** **Elbasan më** 25.10.2021

VENDIM

Nr. 106 **datë** 25.10.2021

"Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Elbasanit At Josif Papamihalit"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.10.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit Parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportit (Sektori i Turizmit dhe i Trashëgimisë Kulturore) "*Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Elbasanit, At Josif Papamihalit"*, mbështetur në nenin 54 (gërma "m") të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), si dhe në nenin 15 (pika 1, gërma "a" dhe pika 2, gërma "b") të ligjit nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar);

VENDOSI:

1. Ti japë titullin "Qytetar Nderi" i Elbasani **At Josif Papamihalit**, me motivacionin:

   "Për shërbimin dhe sjelljen fisnike ndaj qytetit të tij, si dhe shembullin frymëzues të humanizmit e solidaritetit deri në martirizim".

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

Konceptoi:

DPPAPTKTS:	*D. Kristo*
Drejtoria Juridike:	*O. Deliallisi*
Zv/Kryetare:	*V. Lico*
Sekretari i Përgjithshëm:	*A. Bylykbashi*

1173 9

25.10.2024

9

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5121/1 Prot. Elbasan, më 25.10.2021

VENDIM

Nr. 107 dt. 25.10.2021

PËR DHËNIEN E FONDIT PYJOR NË PËRDORIM

"Për ndërtimin/rikonstruksionimin e linjës 110 kV Fibër-Librazhd në territorin e Bashkisë Elbasan".

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ____.____.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit, mbështetur në:

- Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",
- Ligjin nr 57/2020 datë 30.4.2020 "Për pyjet",
- Ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar,
- Ligjin nr. 8318, datë 1.4.1998 "Për dhënien me qira të tokës bujqësore, pyjore të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore", i ndryshuar (neni 13,16),
- VKM nr.433 dt.8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", i ndrysuar me VKM nr. 684 dt. 2.9.2020.
- VKM nr.1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", të ndryshuar,
- Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik",

V e n d o s i :

1. Të miratojë në parim dhënien në përdorim me qira, të fondit pyjor në pronësi të Bashkisë Elbasan, **për ndërtimin/rikonstruksionimin e linjës ekzistuese 110 kV Fibër-Librazhd,** e përjashtur nga konkurimi publik sipas udhëzimit nr.1 datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjthshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit.

3. Afati i dhënies në përdorim, sipas pikës 1 të këtij vendimi, do të jetë 1 (një) vit, ndërsa tarifat e përcaktuara në VKM nr.391 datë 21.6.2006 (i ndryshuar), përbëjnë vlerën e qirasë vjetore.

4. Ky vendim hynë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Heltor Çiftja

Konceptoi:

Specialisti i kadastrës: A. Muça

P/Sektorin e Admin_Menaxhimit: J. Bodurri

Drejtori i DSHPBVM: Sh. Çullhaj

Drejtoria Juridike: O. Deliallisi

Zv/ Kryetari: I. Sina

BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PYJORE, BUJQËSORE, VETERINARE DHE MJEDISORE

PËRMBLEDHËSE E PROPOZIMIT TË PAKËRKUARA
PËR DHËNIEN E FONDIT PYJOR NË PËRDORIM

Për ndërtimin/rikonstruksionimin e linjës 110 kV Fibër-Librazhd në territorin e Bashkisë Elbasan, Ekonomia pyjore "Labinot".

Nr.	Ngastra	Përdorimi territorit	Gjatësia lineare në përdorim, për ndërtimin e linjës së tensionit të lartë, (Km)			Rrugët lidhëse (Km)			Totali lekë
			Km	lekë/km/ vit	lekë	Km	lekë/km/ vit	lekë	
1	63a	Pyll (shkurre)	0.11	25 000	2750	-	-	-	2750
2	64a	Kullotë	0.05	25 000	1250	0.05	35 000	1750	3000
3	65a	Kullotë	0.33	25 000	8250	0.1	35 000	3500	11750
4	66a	Pyll (shkurre)	0.24	25 000	6000	0.05	35 000	1750	7750
5	67a	Pyll (shkurre)	0.011	25 000	275	-	-	-	275
6	68a	Pyll (shkurre)	0.48	25 000	12000	0.6	35 000	21000	33000
SHUMA:			**1.221**		**30 525**	**0.8**		**28 000**	**58 525**

SPECIALISTI I KADASTRËS
Astrit Muça

PËRGJEGJËSI SEKTORIT
Jakov Bodurri

D R E J T O R I
Shpëtim Çullhaj

1174
25.10.2021

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5213/1 **Prot.** **Datë** 25 **.10. 2021**

VENDIM

Nr. 108 **date 25. 10. 2021**

"MIRATIMIN NE PARIM TE DRAFT BUXHETIT TE KESHILLIT BASHKIAK PER VITIN 2022"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 25.10.2021, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 48, pika 1, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.22, date 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore",

VENDOSI

1. Të miratoje ne parim te draft Buxhetit te KB per vitin 2021.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë Keshilli Bashkiak.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Klajd Gripshi

KRYETAR
Hektor Çiftja

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr "Qemal Stafa",Tel. +355 54 400152,E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

1175 10 9

25.10.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5122/1 **Prot.** **Elbasan më** 25.10.2021

VENDIM

Nr. 109 **datë** 25.10.2021

"Për miratimin e formularit tip në procedimet administrative në sektorin e pyjeve, kullotave dhe gjuetisë"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.10.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe e Mjedisit, pranë Bashkisë Elbasan, mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjin 57/2020 "Për pyjet", ligjin 10279 datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative"

VENDOSI:

2. Të miratojë formularin tip që do të përdoret në procedimet për kundërvajtjet administrative në sektorin e pyjeve, kullotave dhe gjuetisë, sipas modelit bashkëngjitur këtij vendimi, deri në miratimin e modeleve nga Ministri përgjegjës për pyjet.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisit.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Konceptoi:

Specialisti i Menaxhimit: Q. Poka

P/Sektorin e Admin_Menaxhimit: J. Bodurri

Drejtori i DSHPBVM: Sh. Çullhaj

Drejtoria Juridike: O. Deliallisi

Zv/ Kryetari: I. Sina

BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PYJORE, BUJQËSORE, VETERINARISË DHE MJEDISIT

PROÇES - VERBAL Nr. ____
PËR VLERËSIMIN E DËMIT, GJOBËS NË FONDIN PYJOR/KULLOSOR DHE GJUETINË

I mbajtur sot me datë ____.____ 202__, nga _____
Inspektori i Polisisë Pyjore të Zonës Pyjore _____ Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinarisë dhe Mjedisit, Bashkia Elbasan. Gjatë kontrollit të ushtruar në fondin pyjor e kullosor në vendin e quajtur _____, ngastra pyjore nr._____, të ekonomisë pyjore _____, aksin rrugor _____në prani të Z .____
dhe të dëshmitarëve _____.

KONSTATOVA:

Shtetasi: _____ i biri _____, i datëlindjes _____, ID nr._____banues në _____, ka kryer shkeljen e dispozitave të ligjit nr. 57/2020 *"Për Pyjet"*, ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 *"Për Fondin Kullosor"* i ndryshuar, ligji nr.10253 datë 11.3.2010 për "Gjuetinë" i ndryshuar dhe konkretisht: (*Përshkruhet saktësisht çfarë është kryer dhe çfarë dëmi ka sjellë "lloji i shkeljes"):*

_____
_____
_____
_____

Në mbështetje të V.K.M nr. 391, datë 21.06.2006, ***"Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave "*** i ndryshuar, Lidhja **8**, pika nr. _____, nga shkelja e mësipërme është shkaktuar dëmi:

nr	**Përshkrimi i dëmit**	***Njësia matjes***	***Sasia***	***Vlera për njësi***	***Vlera totale e dëmit, lekë***
1					
2					
3					
4					
5					
6					
Shuma totale e vlerës së dëmit					

- Vlera e llogaritur e dëmit të shkaktuar është:_____(_____) lekë.
- Vlera e gjobës në bazë të ligjin nr. _____ , neni ___, pika ____, germa ____ është _____ lekë.
- Shuma totale e vlerës së dëmit + gjobën është: _____ (_____)lekë.

Në lidhje me shkeljen e kryer Z._____ *Shpjegon:*

_____
_____
_____

I proçeduari Dëshmitarë të pranishëm Inspektori i Policisë Pyjore, Bashkia Elbasan

_____ _____ _____
_____

Ky proçes-verbal u mbajt në katë kopje, prej të cilave një e mban i proceduari dhe tw tjerat dërgohen në Drejtorinë e Sherbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinarisë dhe Mjedisit, Bashkia Elbasan, me datë . ___.___.202_ për të shqyrtuar çeshtjen dhe i mori në dorëzim, Specialisti i Sektorit të Inspektimit dhe Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullotave .

Specialisti marrës në dorëzim
{_____}

LLOGARITJA E VOLUMIT

(për materialin drusor)

Lloji drusor: _____/_____

Klasa e Larësisë: _____/_____

Kateg. diamet (cm)	Nr.dru Lënd punimi	Nr.drur D. zjarri	Vëllimi për njësi (m3)					Vellimi total (m3)				
			Totali	Lëndë punimi			Dru zjarri	Lëndë punimi			Dru zjarri	Shuma
				E trashë	E mesme	E hollë		E trashë	E mesme	E hollë		
Shuma												

SKISA E PARCELËS

1248
18.12.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 5619/1 Prot

Elbasan më 18 /11/2021

VENDIM

Nr 110 datë 18 /11/2021.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin TETOR 2021

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 27.01.2021 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin TETOR 108 familje me fond 272.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr. Sh. K. S Komunitar Sh. Lika
Drejtori Juridik A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Ciftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

1250
18.11.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 5620/1 Prot

Elbasan më 18 /11/ 2021

VENDIM
Nr. 111 datë 18 /11/2021

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin TETOR 2021

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 2I të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 27.01.2021 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike"

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike dhe pagese dyfishe nga fondet e kushtëzuara per muajin **TETOR 2021** gjithsej 213 familje me një fond prej 700.296 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi:
Dr. Sh. K. S Komunitar Sh. Lika
Drejtori Juridik A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · BASHKIA ELBASAN

1257

18.11.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5641/1 **Prot.** **Elbasan, më** 18.11.2021

VENDIM

Nr. 112 **datë** 18.11.2021

"Për miratimin e Rishikimit të Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me Proçedurë të Thjeshtuar, Bashkia Elbasan"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 18.11.2021, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit "*Për miratimin e Rishikimit të Dokumentit të Planin të Përgjithshëm Vendor me Proçedurë të Thjeshtuar*", mbështetur në:

- ligjin nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore",
- ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar,
- VKM nr. 686, datë 22.11.2017, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar,
- VKM nr. 881, datë 14.12.2016, "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit",
- Udhëzim i AKPT nr.1, datë 22.02.2019, "Për hartimin bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e proçesit të rishikimit të dokumentave të Planeve të Përgjithshme Vendore me proçedurë të thjeshtuar",

VENDOSI:

1. Të miratojë rishikimin e Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me Proçedurë të Thjeshtuar, Bashkia Elbasan, me kushtin e përcaktuar për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis sipas Aktit të Përputhshmërisë lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për mbarëvajtjen e proçesit deri në miratimin dhe zbardhjen e PPV-së së rishikuar, sipas detyrimit ligjor.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Konceptoi:
Përgjegjësi i SUL: *S. Hyskja*
Përgjegjës *K. Qosja*
M. Avllazagaj

Pranoi:
Drejtori i DPTP: *A. Canaj*
Miratoi:
Drejtoria Juridike: *A. Hoxha*
Drejtori i DPShO: *D. Meta*
Konfirmoi:
Sekretari i Përgjithshëm: *A. Bylykbashi*
Zv/Kryetari: *I. Sina*

1252

18.11.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.5627 Prot

Elbasan, më 18.11.2021

VENDIM

Nr.113 datë 18.11.2021

"PËR
MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRVENDORE
PËR KRIJIMIN E NJË PERSONI JURIDIK TË PËRBASHKËT"

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.6(b), nenit 14, pika 3 e 5, nenit 23, pika 10, nenit 33, pika 1(d) dhe nenit 54, gërma (gj) të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, Këshilli i Bashkisë Elbasan, duke vlerësuar nevojën që nëpërmjet aktivitetit të ushtruar nga një person juridik i pavarur, i përbashkët me të gjitha njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore të qarkut Elbasan, të përmbushë funksionin dhe shërbimin vendor për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake, në kushtet kur nuk vlerësohet efiçente asnjë mënyrë tjetër për ushtrimin e këtij funksioni, në mbledhjen e tij të datës ____.11.2021, pasi mori në shqyrtim propozimin e Kryetarit të Bashkisë Elbasan,

VENDOSI

1. Të miratojë krijimin e një personi juridik të përbashkët, që do tu shërbejë të gjitha njësive bazë të vetëqeverisjes vendore të qarkut Elbasan për ushtrimin e funksionit të mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.

2. Të miratojë marrëveshjen ndërvendore midis shtatë bashkive të qarkut Elbasan për krijimin e një personi juridik të përbashkët në formën e një shoqërie tregtare.

Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes së ligjshmërisë nga Prefekti.

SEKRETARI
Klajdi Gripshi

KRYETAR
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Koncepton:
Drejtori i DPSHI: S. Mehmeti
Drejtori DPPAABF: L. Dervishi
Drejtori D.Juridike: A. Hoxha
Këshilltari ligjor: A. Spahiu
Miratoi:
Zv/kryetari: I. Sina

Bashkia Librazhd Nr. 6026

Bashkia Prrenjas Nr. 3112

Bashkia Peqin Nr. 1868

Bashkia Elbasan Nr. 5580. Prot

Bashkia Gramsh Nr. 4291 Prot.

Bashkia Cerrik Nr. 4656 prot

Bashkia Belsh Nr. 3576 prot

14.16.11.2021 10.11.2021

MARRËVESHJE NDËRVENDORE
PËR KRIJIMIN E NJË PERSONI JURIDIK TË PËRBASHKËT

Ne, Njësitë Bazë të Vetëqeverisjes Vendore të Qarkut Elbasan, si më poshtë:

- **Bashkia ELBASAN, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Elbasan, z.Gledian Llatja,**
- **Bashkia LIBRAZHD, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Librazhd, z.Kastriot Gurra,**
- **Bashkia PRRENJAS, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Prrenjas, z.Nuri Belba,**
- **Bashkia GRAMSH, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh, z.Klodian Taçe,**
- **Bashkia PEQIN, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Peqin, z.Lorenc Tosku,**
- **Bashkia CËRRIK, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Cërrik, z.Andis Salla,**
- **Bashkia BELSH, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Belsh, z.Arif Tafani,**

duke qënë plotësisht të përgjegjshëm për detyrimin e ushtrimit të funksionit vendor të trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake, të parashikuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 23, pika 10, si funksion i bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike,

duke konsideruar detyrimet që i ngarkon bashkive ligji nr.10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", si dhe VKM Nr.418, datë 27.5.2020 "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020–2035",

duke vlerësuar se nëpërmjet aktivitetit të ushtruar nga një person juridik i përbashkët ndërvendor mund të përmbushet me cilësi e në mënyrë efiçente funksioni vendor dhe shërbimi publik për trajtimin e mbetjeve, si dhe detyrimet ligjore që parashikon kuadri ligjor në fuqi,

duke gëzuar cilësinë e persouit juridik (publik) dhe të drejtën e krijimit të personave të tjerë juridikë, sipas parashikimit të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 1.6;

Sot, më datë 15.11.2021, në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 14, pika 8,

Vendosim si më poshtë vijon:

1. Të krijojmë një person juridik të përbashkët ndërvendor, me personalitet juridik të ndarë nga bashkitë që e krijojnë atë.

2. Personi juridik i përbashkët të jetë një shoqëri tregtare, në formën e një shoqërie aksionare, ku të gjitha Bashkitë themeluese të jenë pronare dhe të kenë të drejta administrimi.

3. Personit juridik të përbashkët i japim autoritet dhe kompetenca të ushtrojë veprimtari në këto fusha të mundshme:

a) Grumbullimi, rehabilitimi dhe përpunimi i mbetjeve të ndryshme, organike, të ngurta, të gjelbërta, etj. në territorin administrativ të të gjitha bashkive të Qarkut Elbasan;
b) Trajtimi i mbetjeve me djegie (incenerator);
c) Prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike;
d) Aktivitet të tjera të menaxhimit të mbetjeve që lejon ligji.

4. Kuotat e pronësisë dhe të drejtat e administrimit të sejcilës Bashki themeluese mbi personin juridik (shoqërinë) do të përcaktohen në raport me volumin e mbetjeve që ky person juridik i përbashkët do të trajtojë për çdo bashki, duke mbajtur në konsideratë faktin që aktualisht bashkia Elbasan prodhon më shumë se gjysmën e mbetjeve të të gjitha bashkive të qarkut Elbasan të marra së bashku.

5. Themelimi, emërtimi, organizimi, përbërja e organeve drejtuese dhe funksionimi i këtij personi juridik të përbashkët (shoqërisë), duke marrë në konsideratë si më sipër, do të bëhet sipas dispozitave të Aktit të Themelimit dhe Statutit që do të miratohen nga Bashkitë themeluese, në cilësinë e ortakëve të shoqërisë.

6. Personi juridik i përbashkët që do të krijohet do t'i nënshtrohet, si shoqëri tregtare, dispozitave të ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe ligjeve të tjera të lidhura me të, në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

7. Personi juridik i përbashkët do të regjistrohet si shoqëri tregtare në Regjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, sipas dispozitave të ligjit nr.9723 datë 03.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

8. Kjo marrëveshje ndërvendore midis shtatë bashkive të Qarkut Elbasan hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Këshilli i Bashkisë së sejcilës prej bashkive palë në këtë marrëveshje.

Njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore të qarkut Elbasan, palë në këtë marrëveshje:

BASHKIA ELBASAN
Përfaqësuar nga
KRYETARI
Gledian Llatja

BASHKIA LIBRAZHD
Përfaqësuar nga
KRYETARI
Kastriot Gurra

BASHKIA PRRENJAS
Përfaqësuar nga
KRYETARI
Nuri Belba

BASHKIA GRAMSH
Përfaqësuar nga
KRYETARI
Klodian Taçe

BASHKIA PEQIN
Përfaqësuar nga
KRYETARI
Lorenc Tosku

BASHKIA CËRRIK
Përfaqësuar nga
KRYETARI
Andis Salla

BASHKIA BELSH
Përfaqësuar nga
KRYETARI
Arif Tafani

1253

18.11.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

KËSHILLI BASHKIAK

Nr5628 Prot

Elbasan, më 18.11.2021

VENDIM

Nr.114 datë 18.11.2021

"PËR MIRATIMIN E THEMELIMIT TË SHOQËRISË TREGTARE TË PËRBASHKËT "ECO-ELB" SH.A

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.6(b), nenit 23, pika 10, nenit 33, pika 1(d) dhe nenit 54, pika (d) të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, të nenit 3, pika 1 dhe nenit 105 e vijues të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, të neneve 26, 28, 32 e 36 të Ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, Këshilli i Bashkisë Elbasan, si organi përfaqësues i personit juridik publik, Bashkia Elbasan, duke marrë në konsideratë faktin se Kontrata Koncesionare e formës "BOT", e lidhur midis Ministrisë së Mjedisit dhe shoqërisë "ALBTEK ENERGY" shpk, me objekt "Ndërtimin, Administrimin dhe Transferimin e Impiantit të Përpunimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Elbasan", përfundon në datën 16.12.2021, si dhe duke vlerësuar nevojën që nëpërmjet aktivitetit tregtar të ushtruar nga një shoqëri tregtare e përbashkët ndërvendore, të përmbushë në vazhdim funksionin vendor për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake, në kushtet kur nuk vlerësohet efiçente asnjë mënyrë tjetër për ushtrimin e këtij funksioni, në mbledhjen e tij të datës ___.11.2021, pasi mori në shqyrtim propozimin e Kryetarit të Bashkisë Elbasan,

VENDOSI

1. Të miratojë themelimin e shoqërisë tregtare të përbashkët me emërtimin "ECO-ELB" sh.a., në formën e një shoqërie aksionare me ofertë private.

2. Të miratojë Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë aksionare "ECO-ELB"sh.a, dokumente të cilat i bashkëngjiten këtij vendimit dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Autorizohet z.Gledian Llatja, Kryetar i Bashkisë Elbasan për të aplikuar për regjistrimin fillestar të shoqërisë aksionare "ECO-ELB" sh.a, sipas kërkesave të Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas 10 ditësh.

SEKRETARI

Klajdi Gripshi

KRYETAR

Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Konceptoi:
Drejtori i DPSHI: S. Mehmeti
Drejtori DPPAABF: L. Dervishi
Drejtori D.Juridike: A.Hoxha
Këshilltari ligjor: A. Spahiu
Miratoi:
Zv/kryetari: I. Sina

Bashkia Librazhd Nr.6026 dt.16.11.21

Bashkia Prrenjas Nr. 3112 16.11.2021

Bashkia Peqin Nr. 1868

Bashkia Elbasan Nr. 5580/2

Bashkia Gramsh Nr.4294 Prot.

Bashkia Cerrik Nr.4656/prot/2

Bashkia Belsh Nr. 3576/2 prot

AKT THEMELIMI
Për krijimin e shoqërisë tregtare
"ECO-ELB" sh.a.

Ne ortakët themelues, personat juridikë publikë si më poshtë:

Bashkia ELBASAN, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), me seli në Elbasan, me adresë: ***Lagjja "11 Nëntori", rruga "Qemal Stafa"***, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Elbasan, **z.Gledian Llatja,**

Bashkia LIBRAZHD, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), me seli në Librazhd, me adresë: ***Sheshi "Gjorg Golemi", Librazhd***, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Librazhd, **z.Kastriot Gurra,**

Bashkia PRRENJAS, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), me seli në Prrenjas, me adresë: ***Rruga "Skënderbeu", Godina: 15, Prrenjas***, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Prrenjas, **z.Nuri Belba,**

Bashkia GRAMSH, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), me seli në Gramsh, me adresë: ***Sheshi "Kamber Dermushi", Lagjia "Holta", Rruga "10 Korriku"*, Gramsh**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh, **z.Klodian Taçe,**

Bashkia PEQIN, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), me seli në Peqin, me adresë: ***Bulevardi "Mustafa Gjinishi", Peqin***, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Peqin, **z.Lorenc Tosku,**

Bashkia CËRRIK, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), me seli në Cërrik, me adresë: ***Lagjia Nr.2, Rruga "Bulevardi Gjimnazi 1962", Cërrik***, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Cërrik, **z.Andis Salla,**

Bashkia BELSH, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), me seli në Belsh, me adresë: ***Adresa: Rruga "Hasiz Dervishi", Belsh***, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Belsh, **z.Arif Tafani,**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe të ligjit nr.9723 datë 03.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar,

Vendosim si më poshtë vijon:

NENI 1
Forma juridike

1. Të themelojmë shoqërinë tregtare **"ECO-ELB" sh.a.** në formën e një shoqërie aksionare, me ofertë private.
2. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri **"ECO-ELB" sh.a.**, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2
Qëllimi i krijimit të shoqërisë

1. Qëllimi i krijimit të kësaj shoqërie është që nëpërmjet aktivitetit tregtar, sipas objektit të përcaktuar më poshtë, të përmbushë funksionin vendor dhe shërbimin publik për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake, si dhe të prodhojë e të shesë energji elektrike që gjenerohet nga procesi i trajtimit të mbetjeve, sikurse parashikohet nga kuadri ligjor e nënligjor në fuqi.
2. Veprimtaria e kësaj shoqërie do të jetë me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3
Emri, logoja dhe vula e shoqërisë

1. Shoqëria do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin **"ECO-ELB" sh.a.** Ajo do të ketë logon dhe vulën e saj.
2. Logoja do të përmbajë fjalë nga emri i shoqërisë.

NENI 4
Objekti i veprimtarisë

1. Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:
   a) Grumbullimi, rehabilitimi dhe përpunimi i mbetjeve të ndryshme, organike, të ngurta, të gjelbërta, etj., në territorin administrativ të të gjitha bashkive të Qarkut Elbasan;
   b) Trajtimi i mbetjeve me djegie (incenerator);
   c) Prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike;
   d) Aktivitete të tjera në fushën e përpunimit të mbetjeve, që lejon ligji, për interesat e shoqërisë dhe të komunitetit;
2. Shoqëria, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.
3. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj pas marrjes dhe në përputhje me licencat apo lejet përkatëse.

NENI 5
Selia e shoqërisë dhe afati i veprimtarisë

1. Selia e shoqërisë tregtare **"ECO-ELB" sh.a.** do të jetë në Elbasan, me adresë: **"Rruga "11 Nëntori 59, Elbasan".**
2. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj **për një afat kohor të pacaktuar**, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 6
Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 3.500.000 lekë (tre milion e pesëqind mijë) lekë.
2. Ai është i ndarë në 100 aksione të së njëjtës kategori me vlerë nominale prej 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë, për çdo aksion të shlyer për tërësinë e vlerës nominale të tyre. Aksionet janë të numërtuara nga 1 deri në 100 aksione.
3. Aksionarët themelues të shoqërisë **"ECO-ELB" sh.a.**, zotërojnë në pronësi aksionet si më poshtë:
   -Bashkia Elbasan, zotëron 52% të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 52 numër aksionesh, me vlerë 1.820.000 lekë (një milion e tetëqind e njëzetë mijë) lekë.
   -Bashkia Librazhd, zotëron 8% të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 8 numër aksionesh, me vlerë 280.000 lekë (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.
   -Bashkia Prrenjas, zotëron 8% të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 8 numër aksionesh, me vlerë 280.000 lekë (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.
   -Bashkia Gramsh, zotëron 8% të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 8 numër aksionesh, me vlerë 280.000 lekë (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.
   -Bashkia Peqin, zotëron 8% të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 8 numër aksionesh, me vlerë 280.000 lekë (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.
   -Bashkia Cërrik, zotëron 8% të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 8 numër aksionesh, me vlerë 280.000 lekë (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.
   -Bashkia Belsh, zotëron 8% të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 8 numër aksionesh, me vlerë 280.000 lekë (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

NENI 7
Përbërja e kapitalit të shoqërisë

1. Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para dhe/ose në natyrë i aksionarit themelues të kësaj shoqërie.
2. Kontributi në para do të jetë i përbërë nga shuma prej 3.500.000 lekë (tre milion e pesëqind mijë) lekë, që është edhe vlera minimale e kapitalit themeltar për shoqërinë, me ofertë private.
3. Një e katërta e vlerës nominale të aksioneve (kapitalit të shoqërisë), në shumën 875.000 (tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë është depozituar në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT), dega Elbasan, në llogarinë "Shoqëri në Formim e Sipër", në datën e nënshkrimit të këtij akti themelimi, nga Bashkia Elbasan. Pas regjistrimit, kjo shumë do të kalojë në

llogarinë e kësaj shoqërie, që do të çelet pranë BKT. Në llogarinë e shoqërisë çelet llogaria "Fondi themeltar i aksionarit", ku regjistrohet vlera e kapitalit të tij.

NENI 8
Organet drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

- Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve - organi më i lartë vendimarrës;
- Këshilli Mbikqyrës - organ i mbikqyrjes;
- Administratori - organ ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 9
Këshilli Mbikqyrës

1. Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 3 deri në 21 anëtarë, të cilët nuk mund të jenë njëkohësisht dhe administratorë të shoqërisë. Ata zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e votave të aksionarëve që marrin pjesë.
2. Aksionarët e shoqërisë kanë të drejtë të përzgjedhin secili nga 1 (një) anëtar në përbërjen e Këshillit Mbikqyrës.
3. Këshilli Mbikqyrës i parë i shoqërisë përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të cilët janë caktuar si më poshtë:
   - Z.Klejdi Maci i datëlindjes 7.3.1984 lindur e banues në Elbasan (Peqin), identifikuar me ID nr. I40307144H;
   - Z.Afrim Shtylla i datëlindjes 6.10.1984, lindur e banues në Elbasan (Gramsh), identifikuar me ID nr. I41006127D
   - Z.Maraglen Bali i datëlindjes 17.03.1988, lindur e banues në Belsh, identifikuar me ID nr. I80317012S;
   - Z.Andri Çata i datëlindjes 8.7.1986, lindur e banues në Elbasan (Librazhd), identifikuar me ID nr. I60708016P;
   - Z.Haxhi Sollakes i datëlindjes 15.12.1976, lindur e banues në Elbasan (Arenjas), identifikuar me ID nr. H6121;5156F
   - Z.Irland Sina i datëlindjes 14.12.1968, lindur e banues në Elbasan identifikuar me ID nr. G91214040G;
   - Z.Tomorr Zaimaj i datëlindjes 22.02.1958, lindur e banues në Cërrik, identifikuar me ID nr. F80222007B;
4. Kohëzgjatja e mandatit te anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës do të jetë 3 (tre) vjet. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen.

NENI 10
Administratori

1. Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një afat 3 (tre) vjeçar.
2. Administratori i parë i shoqërisë tregtare **"ECO-ELB" sh.a.** është z/znj. Anjola Memetaj i datëlindjes, me ID: 185923080R
   23.05.1988

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PEQIN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA CËRRIK

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBRAZHD

3. Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i saj, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 11
Eksperti kontabël

1. Shoqëria tregtare **"ECO-ELB" sh.a.**. do të ketë 1(një) ekspert kontabël të autorizuar.
2. Eksperti kontabël i autorizuar i shoqërisë është z. Armand Avdali datëlindjes 18.07.1977 identifikuar me ID nr. H7071800[illegible] i pajisur me liçensë nr. 298 .

NENI 12
Autorizimi për procedurat e themelimit

Ortakët themelues autorizojnë Kryetarin e Bashkisë Elbasan për të aplikuar për regjistrimin fillestar të shoqërisë aksionare **"ECO-ELB" sh.a**, sipas kërkesave të Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

NENI 13

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 14

Aksionarët themelues mund të vendosin, me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në shoqëri të tjera dhe mund të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, përveçse atij që mund të jetë konkurues me atë të shoqërisë tregtare **"ECO-ELB" sh.a.**.

NENI 15

Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen me mirëkuptim nga aksionarët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga gjykata kompetente sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Aksionarët e shoqërisë:

BASHKIA ELBASAN	**BASHKIA LIBRAZHD**	**BASHKIA PRRENJAS**
Përfaqësuar nga	*Përfaqësuar nga*	*Përfaqësuar nga*
KRYETARI	KRYETARI	KRYETARI
Gledian Llatja	**Kastriot Gurra**	**Nuri Belba**

BASHKIA GRAMSH	**BASHKIA PEQIN**	**BASHKIA CËRRIK**	**BASHKIA BELSH**
Përfaqësuar nga	*Përfaqësuar nga*	*Përfaqësuar nga*	*Përfaqësuar nga*
KRYETARI	KRYETARI	KRYETARI	KRYETARI
Klodian Taçe	**Lorenc Tosku**	**Andis Salla**	**Arif Tafani**

18.11.2021

Bashkia Librazhd Nr. 6026 | Bashkia Prrenjas Nr. 3/12 | Bashkia Peqin Nr. 1868 | Bashkia Elbasan Nr. 5560/Prot | Bashkia Gramsh Nr. 4293 Prot | Bashkia Cerrik Nr. 4656/prot | Bashkia Belsh Nr. 3576/1 prot

STATUTI
I
SHOQËRISË TREGTARE "ECO-ELB" sh.a.

Sot, më datë 18.11.2021, me cilësinë e aksionarëve themelues, personat juridikë publikë si më poshtë:

Bashkia ELBASAN, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), me seli në Elbasan, me adresë: ***Lagjja "11 Nëntori", rruga "Qemal Stafa"***, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Elbasan, **z.Gledian Llatja,**

Bashkia LIBRAZHD, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), me seli në Librazhd, me adresë: ***Sheshi "Gjorg Golemi", Librazhd***, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Librazhd, **z.Kastriot Gurra,**

Bashkia PRRENJAS, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), me seli në Prrenjas, me adresë: ***Rruga "Skënderbeu", Godina: 15, Prrenjas***, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Prrenjas, **z.Nuri Belba,**

Bashkia GRAMSH, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), me seli në Gramsh, me adresë: ***Sheshi "Kamber Dermushi", Lagjia "Holta", Rruga "10 Korriku"*, Gramsh**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh, **z.Klodian Taçe,**

Bashkia PEQIN, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), me seli në Peqin, me adresë: ***Bulevardi "Mustafa Gjinishi", Peqin***, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Peqin, **z.Lorenc Tosku,**

Bashkia CËRRIK, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), me seli në Cërrik, me adresë: ***Lagjia Nr.2, Rruga "Bulevardi Gjimnazi 1962", Cërrik***, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Cërrik, **z.Andis Salla,**

Bashkia BELSH, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), me seli në Belsh, me adresë: ***Adresa: Rruga "Haziz Dervishi", Belsh***, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Belsh, **z.Arif Tafani,**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe të ligjit nr.9723 datë 03.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar,

Vendosim si më poshtë vijon:

KAPITULLI I
FORMA LIGJORE, EMËRTIMI, SELIA E SHOQËRISË

NENI 1
Forma juridike

Në mbështetje të vullnetit të aksionarëve themelues, të shprehur në aktin e themelimit, si dhe në pajtim të plotë me dispozitat e ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, të ligjit nr.9723 datë 03.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, themelohet shoqëria tregtare **"ECO-ELB" sh.a.**, në formën e një shoqërie aksionare, me ofertë private, e cila do të funksionojë sipas dispozitave të Aktit të Themelimit dhe këtij Statuti.

NENI 2
Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë do të jetë shoqëria tregtare **"ECO-ELB" sh.a.**

NENI 3
Objekti i veprimtarisë

1. Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:
   a) Grumbullimi, rehabilitimi dhe përpunimi i mbetjeve të ndryshme, organike, të ngurta, të gjelbërta, etj., në territorin administrativ të të gjitha bashkive të Qarkut Elbasan;
   b) Trajtimi i mbetjeve me djegie (incenerator);
   c) Prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike;
   d) Aktivitete të tjera në fushën e përpunimit të mbetjeve, që lejon ligji, për interesat e shoqërisë dhe të komunitetit;
2. Shoqëria, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.
3. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj pas marrjes dhe në përputhje me liçencat apo lejet përkatëse.

NENI 4
Kohëzgjatja e veprimtarisë

1. Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e shoqërisë në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
2. Aksionari/ët e shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

KAPITULLI II
KAPITALI THEMELTAR, AKSIONET, NDRYSHIMET E KAPITALIT

NENI 5
Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 3.500.000 lekë (tre milion e pesëqind mijë) lekë.
2. Ai është i ndarë në 100 aksione të së njëjtës kategori me vlerë nominale prej 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë, për çdo aksion të shlyer për tërësinë e vlerës nominale të tyre. Aksionet janë të numërtuara nga 1 deri në 100 aksione.
3. Aksionarët themelues të shoqërisë **"ECO-ELB" sh.a.**, zotërojnë në pronësi aksionet si më poshtë:
   -Bashkia Elbasan, zotëron 52% të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 52 numër aksionesh, me vlerë 1.820.000 lekë (një milion e tetëqind e njëzetë mijë) lekë.
   -Bashkia Librazhd, zotëron 8% të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 8 numër aksionesh, me vlerë 280.000 lekë (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.
   -Bashkia Prrenjas, zotëron 8% të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 8 numër aksionesh, me vlerë 280.000 lekë (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.
   -Bashkia Gramsh, zotëron 8% të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 8 numër aksionesh, me vlerë 280.000 lekë (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.
   -Bashkia Peqin, zotëron 8% të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 8 numër aksionesh, me vlerë 280.000 lekë (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.
   -Bashkia Cërrik, zotëron 8% të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 8 numër aksionesh, me vlerë 280.000 lekë (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.
   -Bashkia Belsh, zotëron 8% të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 8 numër aksionesh, me vlerë 280.000 lekë (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

NENI 6
Regjistri i aksioneve

1. Pronësia e aksioneve vërtetohet nga regjistrimi i tyre në emër të pronarëve në regjistrin e mbajtur për këtë qëllim nga shoqëria, sipas mënyrës së parashikuar me ligj.
2. Me kërkesën e aksionarit, shoqëria lëshon një vërtetim të regjistrimit të aksioneve në pronësi te tij.
3. Administratori i shoqërisë është përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të aksioneve sipas ligjit.

NENI 7
Zmadhimi i kapitalit themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqërisë mund të zmadhohet sipas mënyrave dhe rregullave të parashikuara në nenet 168 - 180 të ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).
2. Me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 176 të ligjit të mësipërm, zmadhimi i kapitalit themeltar mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, e cila vendos me 3/4 (tre të katërtat) e votave të aksionarëve, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total

të aksioneve, me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, të cilët marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektonike.
3. Kapitali themeltar nuk mund të zmadhohet nëse nuk janë shlyer ende kontributet për aksionet e nënshkruara më parë.
4. Administratori është i detyruar të njoftojë për regjistrim, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, vendimin për zmadhimin e kapitalit.

NENI 8
Zvogëlimi i kapitalit themeltar

1. Zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërisë kryhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë dhe në pajtim me dispozitat e neneve 181 - 186 të ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).
2. Zvogëlimi i kapitalit themeltar mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, e cila vendos me 3/4 (tre të katërtat) e votave të aksionarëve, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total, personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike.
3. Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve.
4. Zvogëlimi i kapitalit themeltar nuk duhet të cënojë raportin e aksionarit para këtij zvogëlimi.
5. Kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën shumën minimale të kërkuar nga ligji.

NENI 9
Të drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet

1. Çdo aksion jep të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet vjetore të shoqërisë, të destinuara për shpërndarje dhe tepricën e aktivitetit të mbetur, në rastin e likujdimit, në përpjestim me aksionet që zotëron.
2. Pronësia mbi aksionet jep edhe të drejtën e votës dhe të përfaqësimit në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, në kushtet e përcaktuara në ligj dhe në Statut.
3. Çdo aksion i zakonshëm i jep zotëruesit të tij të drejta vote në raport proporcional me pjesën e kapitalit që përfaqëson aksioni.
4. Aksionarët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë ndaj të tretëve dhe për humbjen e saj deri në masën e shumës nominale të aksioneve që zotëron. Ndalohet kërkimi i fondeve të kësaj shume.
5. Kur aksionet u kalojnë aksionarëve të rinj, këta ruajnë të drejtat dhe detyrimet që vijnë nga aksionet. Pronësia e një aksioni përmban automatikisht të drejtën e aderimit në Statutin e shoqërisë dhe në vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.

KAPITULLI III
ORGANET E SHOQËRISË

SEKSIONI 1
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

NENI 10
Mbledhjet e Asamblesë dhe efektet detyruese të vendimeve

1. Të drejtat e aksionarëve, për çeshtjet e lidhura me veprimtaritë e funksionimit të shoqërisë, ushtrohen nëpërmjet Asamblesë së Përgjithshme.
2. Çdo Asamble, e mbledhur rregullisht, përfaqëson tërësinë e aksioneve të zotëruara nga aksionarët.

NENI 11
Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë

Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e shoqërisë, si më poshtë:

a) Përcaktimin e politikave tregtare;
b) Ndryshime në Statut;
c) Emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës;
d) Emërimin dhe shkarkimin e likujduesit dhe ekspertit kontabël të autorizuar;
e) Miratimin e skemës së shpërblimeve për anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, Administratorit, likujduesit dhe ekspertit kontabël të autorizuar;
f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore;
g) Shpërndarjen e fitimeve vjetore;
h) Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
i) Pjestimin e aksioneve dhe anullimin e tyre;
j) Ndryshime në të drejtat që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
k) Riorganizimi dhe prishja e shoqërisë;
l) Miratimin e rregullave proçeduriale të mbedhjeve të saj;
m) Çështje të tjera të parashikuara në ligj dhe Statut.

NENI 12
Organizimi i mbledhjeve të Asamblesë

1. Asambleja thirret nga Administratori, Këshilli Mbikqyrës ose aksionarët të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
2. Asambleja thirret të paktën një herë në vit.
3. Asambleja mblidhet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrje, si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë territorit, e cila tregohet në njoftimin përkatës.
4. Thirrja e Asamblesë bëhet me anë të njoftimit me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike, që i dërgohet aksionarëve së bashku me rendin e ditës, jo më vonë se 21 ditë përpara ditës së

parashikuar të mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë ditën, orën dhe vendin e mbledhjes, natyrën e Asamblesë dhe rendin e ditës.

5. Kur Asambleja e mbledhur nuk ka mundur të marrë vendim për shkak se nuk është siguruar kuorumi i kërkuar, mbledhja e dytë thirret jo më vonë se një muaj nga data e thirrjes së mbledhjes së parë në të njëjtat forma si e para.
6. Njoftimi ose letrat e thirrjes së mbledhjes së dytë rikujtojnë datën dhe rendin e ditës.

NENI 13
Rendi i ditës

1. Rendi i ditës së mbledhjes së Asamblesë, që njoftohet si mësipër, duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje. Nëse Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për ndryshimin e Statutit, teksti i ndyshimeve duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës.
2. Administratori duhet t'i përgjigjet me shkrim çdo kërkese me shkrim, për sqarim për rendin e ditës, dërguar nga aksionarët jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.
3. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas formaliteteve si mësipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë aksionarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsive.
4. Projektrezolutat dhe dokumentet shoqëruese duhet të mbërrijnë në selinë e shoqërisë të paktën 5 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë.

NENI 14
Evidenca e pjesëmarrjes, drejtimi i mbledhjes dhe proçesverbalet

1. Një aksionar mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një aksionar tjetër apo nga një person i tretë. Bashkia, në cilësinë e aksionarit, si person juridik publik, përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme nga zyrtari i ngarkuar me vendim nga Keshilli i Bashkisë.
2. Gjatë mbledhjes së Asamblesë përgatitet lista e aksionarëve të pranishëm dhe të përfaqësuesëve të tyre, ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me numrin e aksioneve, numrin e votave që këto aksione japin, vlerën nominale të aksioneve, si dhe llojin apo kategorinë e tyre, të zotëruara nga secili pjesëmarrës. Kjo listë nënshkruhet prej tyre.
3. Rregulloret përkatëse të mbledhjeve mund të parashikojnë se aksionarët që nuk janë të pranishëm kanë mundësinë e pjesëmarrjes në Asamble me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjete elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i aksionarëve.
4. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në proçesverbal.
5. Proçesverbali duhet të përmbajë të dhënat vijuese: datën e mbledhjes, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të proçesverbalit, rezultatet e votimit, vendimet e marra, qëndrimin e kryetarit për vendimarrjen, si dhe aksionarëve që janë shprehur kundër. Proçesverbalit i bashkëlidhen edhe lista e pjesëmarrësve dhe dokumentacioni i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme. Proçesverbali dhe lista e pjesëmarrësve duhet të nënshkruhen nga kryetari dhe nga mbajtësi i proçesverbalit.
6. Administratori është përgjegjës për ruajtjen e proçesverbaleve.
7. Jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, Administratori është i detyruar të publikojë kopje të proçesverbalit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme në faqen e internetit të shoqërisë, për t'u konsultuar vetëm nga ana e aksionarëve të shoqërisë.

NENI 15
Kuorumi

1. Për çështjet që vendosen me shumicë të zakonshme, Asambleja merr vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët që zotërojnë më shumë se 30% të aksioneve, me të drejtë vote.
2. Për çështje që kërkojnë shumicë të kualifikuar, Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse aksionarët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete të tjera elektronike.
3. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të kërkuar, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

NENI 16
Marrja e vendimeve

1. Asambleja e Përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve, që marrin pjesë në votim në lidhje me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërise.
2. Për çështjet e tjera Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicën e votave të aksionarëve që marrin pjesë.
3. Çdo aksion mbart të drejtën e një vote.

NENI 17
Mënyra e votimit

1. Asambleja e Përgjithshme merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës apo Administratorit.
2. Asambleja e Përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë kërkohet nga aksionarët që zotërojnë një numër aksionesh që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

NENI 18
Vënia në dispozicion, të aksionarit, e dokumenteve dhe informacioneve

1. Shoqëria mban dhe vë në dispozicion të aksionarit/ëve, në kushtet dhe në afatet e parashikuara nga ligji, raportet, dokumentet dhe llogaritë vjetore që shqyrton Asambleja.
2. Me përjashtim të inventarëve dhe të ndonjë dokumenti tjetër, të caktuar nga Asambleja, dokumentet, që duhet t'u vihen në dispozicion aksionarit/ëve, i dërgohen këtij bashkë me njoftim-thirrjen për mbledhje.

SEKSIONI 2
KËSHILLI MBIKQYRËS

NENI 19
Përbërja dhe emërimi

1. Këshilli Mbikqyrës kryen funksion mbikqyrës për të gjithë veprimtarinë e shoqërisë.
2. Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 3 deri në 21 anëtarë, të cilët nuk mund të jenë njëkohësisht dhe administratorë të shoqërisë. Ata zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e votave të aksionarëve që marrin pjesë.
3. Aksionarët e shoqërisë kanë të drejtë të përzgjedhin secili nga 1 (një) anëtar në përbërjen e Këshillit Mbikqyrës.
4. Anëtarët e parë të Këshillit Mbikqyrës do të jenë 7 (shtatë), si mëposhtë vijon, të cilët kanë pranuar detyrën:
   - Z. Klejdi Maci, i datëlindjes 07.03.1984, lindur e banues në Pegin, identifikuar me ID nr. I40307144H;
   - Z. Afrim Shtylla, i datëlindjes 06.10.1984, lindur e banues në Gramsh, identifikuar me ID nr. I41006127D;
   - Z. Maraglen Bali, i datëlindjes 17.03.1988, lindur e banues në Belsh, identifikuar me ID nr. I80317012S;
   - Z. Andri Çota, i datëlindjes 08.07.1986, lindur e banues në Librazhd, identifikuar me ID nr. I16070801GB
   - Z. Haxhi Gollaku, i datëlindjes 15.12.1976, lindur e banues në Prenjas, identifikuar me ID nr. H61215156F;
   - Z. Irland Sina i datëlindjes 14.12.1969, lindur e banues në Elbasan, identifikuar me ID nr. G91214040G;
   - Z. Tomorr Zaimaj i datëlindjes 22.02.1958, lindur e banues në Cërrik, identifikuar me ID nr. F80222007B;
5. Këshilli Mbikqyrës, nga përbërja e tij, ka një kryetar dhe një zëvendëskryetar, që ngarkohen me organizimin dhe zhvillimin e mbledhjeve të Këshillit. Ata ushtrojnë funksionet e tyre gjatë tërë periudhës së mandatit të dhënë.
6. Kryetar i Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë do të jetë z. Irland Sina i datëlindjes 14.12.1969 lindur e banues në Elbasan, identifikuar me ID nr. G91214040G

NENI 20
Mbledhjet dhe vendimet e Këshillit Mbikqyrës

1. Statuti ose Këshilli Mbikqyrës mund të përcaktojnë rregullore për proçedurën e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit, si dhe të marrjes së vendimeve. Vendimet e Këshillit për këto rregullore duhet të jenë unanime.
2. Zhvillimi i mbledhjeve të Këshillit regjistrohet në një proçesverbal, i cili duhet të nënshkruhet nga kryetari. Proçesverbali përmban vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, renditjen e ditës, një përshkrim për deshtjet e diskutuara dhe vendimet e marra.

Parregullsitë për mbajtjen e proçesverbalit nuk kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimeve të marra. Secili anëtar ka të drejtë të marrë një kopje të proçesverbalit.

3. Vendimet e Këshillit Mbikqyrës vlerësohen si të vlefshme nëse në proçesin e vendimarrjeve janë të pranishëm më shumë se 1/2 e anëtarëve. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe, kur për një çështje ka barazim votash, vota e kryetarit mbizotëron.
4. Vendimet e Këshillit Mbikqyrës mund të merren sipas përcaktimeve të statutit apo rregulloreve të Këshillit duke shprehur votën me shkresë, telefon apo me mjete të tjera të komunikimit elektronik, që bëjnë të mundur identifikimin e anëtarit.
5. Anëtari i Këshillit Mbikqyrës nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës, nëse Këshilli Mbikqyrës duhet të marrë vendim për:
   - vlerësimin e veprimtarisë së tij;
   - faljen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
   - ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
   - dhënien ose jo të përfitimeve të tjera.

NENI 21
Kohëzgjatja e funksioneve të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

1. Kohëzgjatja e anëtarëve të parë të Këshillit Mbikqyrës është 3 vjet, me të drejtë rizgjedhje.
2. Ata mund të shkarkohen nga detyra me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me shumicë të thjeshtë votash.

NENI 22
Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës, me shumicë të thjeshtë votash, mund t'i kërkojë gjykatës të shkarkojë një anëtar në rastet e shkeljes së detyrave të parashikuara në nenin 163 të ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).

NENI 23
Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës mund të përfitojnë pagë bazë e shpërblime shtesë, përfshirë këtu dhe pjesë nga fitimi i shoqërisë apo të drejta opsioni mbi aksionet e shoqërisë. Skema e këtyre shpërblimeve përgatitet nga Këshilli Mbikqyrës dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 24
Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Këshillit Mbikqyrës

1. Këshilli Mbikqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi:
   a) Të japë direktiva për Administratorin, për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
   b) Të kontrollojë dhe të mbikqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga Administratori;

c) Të përgatisë, me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme, marrjen e masave që janë kompetencë e kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë si dhe të zbatojë vendimet e Asamblesë;
d) Të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standartet e kontabilitetit;
e) Të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
f) Të shqyrtojë dhe të kontrolloj librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
g) Të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera teëraportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, kryhen me saktësi nga Administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikqyrës për t'iu paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit Mbikqyrës për miratim dhe një përshkrim për mbikqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
h) Të sigurojë se auditimi i librave dhe regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur dhe raporti i auditimit, drejtuar Asamblesë së Përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës. Raporti i Këshillit Mbikqyrës të përmendur në pikën g), duhet të përmbajë dhe mendimin për raportin e auditimit;
i) Të emërojë dhe të shkarkojë Administratorin, si dhe të përcaktojë kompetencat e tij;
j) Të përcaktojë shpërblimin e Administratorit;
k) Të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë me të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të çertifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huajve apo emetimit të obligacioneve apo instrumentave të tjera të borxhit;
l) Të vendosë krijimin e bashkëpunimeve afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;
m) Të miratojë kalimin e aksioneve me propozim të Administratorit të shoqërisë;
n) Të kryejë veprimet e tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;

2. Këshilli Mbikqyrës duhet të thërrasë menjëherë Asamblenë e Përgjithshme në rastet si më poshtë:
a) Kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton apo parashikohet se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50% të kapitalit ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrime që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim;
b) Kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara;
c) Kur brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, shoqëria propozon të blejnë pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë.

NENI 25
Personi juridik, anëtar i Këshillit Mbikqyrës

Një person juridik, që është aksionar i shoqërisë, nuk mund të jetë anëtar i Këshillit Mbikqyrës. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës janë individë (persona fizikë) të cilët duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga Administratori i shoqërisë.

SEKSIONI 3
ADMINISTRATORI

NENI 26

1. Administratori drejton e administron shoqërinë dhe merr vendime për mënyrën e vënies në zbatim të politikave tregtare.
2. Administratori i parë i përgjithshëm është z. Arjola Meneçi datëlindjes 23.09.1988 lindur e banues në Elbasan, identifikuar me ID nr. I85922080R

NENI 27
Emërimi dhe shkarkimi

1. Administratorë të shoqërisë mund të jenë një ose disa persona fizikë. Ata emërohen nga Këshilli Mbikqyrës për një afat të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 (tre) vjet. Ata mund të rizgjidhen.
2. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet si administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të jetë Kryetar i Këshillit Mbikqyrës të një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas.
3. Këshilli Mbikqyrës ka të drejtë të shkarkojë administratorët në çdo kohë.

NENI 28
Të drejtat dhe përgjegjësitë

1. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:
   a) Të kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
   b) Të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
   c) Të kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë;
   d) Të përgatisë dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilat ia paraqet Këshillit Mbikqyrës për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për tu paraqitur më pas për miratim nga Asambleja e Përgjithshme;
   e) Të krijoj një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
   f) Të kryej regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve ligjore;
   g) Të raportojë, përpara Këshillit Mbikqyrës, për zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;
   h) Të kryej detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

2. Administratori duhet të informojë menjëherë Kryetarin e Këshillit Mbikqyrës në rastet kur:
   a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton apo parashikohet se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50% të kapitalit ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim;
   b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% e aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara;
   c) brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozohet blerja nga një aksionar, e pasurisë që ka vlerë më të lartë se 5% e aseteve të shoqërisë.

NENI 29

Përfaqësimi i shoqërisë

1. Administratori përfaqëson shoqërinë në lidhje me të tretët.
2. Administratorët, të cilët kanë të drejtë të përfaqësojnë shoqërinë tregtare në mënyrë të përbashkët, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara.
3. Tagrat e përfaqësimit të administratorit/ëve dhe çdo ndryshim i tyre regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 30

Detyrime dhe përgjegjësi të përbashkëta të Këshillit Mbikqyrës dhe Administratorit

1. Administratorët dhe anëtarët e Këshillit Mbikqyrës detyrohen;
   a) Të kryejnë detyrat e tyre në mirëbesim e në interesin e shoqërisë;
   b) Të ushtrojnë kompetencat që u jep ligji dhe Statuti;
   c) Të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme çështjet për të cilat merret vendim;
   d) Të parandalojnë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit, të pranishme apo të mundshme të interesave personale me atë të shoqërisë;
   e) Të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm;
2. Ata përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Ata përgjigjen në mënyrë solidare për vërtetësinë e të gjitha pasqyrave financiare, të publikimeve të detyrueshme dhe informacioneve të tjera kryesore të veprimtarisë së shoqërisë.

NENI 31

Mbikqyrja e veçantë

Aksionarët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit bazë ose një përqindje më të vogël të parashikuar në Statut, apo kreditorët e shoqërisë, pretendimet e të cilëve ndaj saj janë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar, mund t'i kërkojnë Këshillit Mbikqyrës të kryejë mbikqyrje të veçantë për çështje të posaçme, sidomos kur merret në shqyrtim ligjshmëria e veprimeve të administratorëve.

KAPITULLI IV
EKSPERTËT KONTABËL

NENI 32
Emërimi dhe shpërblimi

3. Asambleja e Përgjithshme ka të drejtën për të caktuar një ose disa ekspertë kontabël të zgjedhur nga listat e Insitutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.
4. Në caktimin e ekspertëve mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtushmëritë e përcaktuara në rregullat e posaçme. Ekspertët kontabël caktohen për një kohë që i përgjigjet një ushtrimi financiar. Ata janë të ricaktueshëm.
5. Shpërblimi i ekspertëve kontabël të autorizuar caktohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe përballohet nga shoqëria.
6. Shoqëria tregtare **"ECO-ELB" sh.a.** do të ketë 1 (një) ekspert kontabël.

NENI 33
Detyrat dhe të drejtat

1. Detyrat dhe të drejtat e ekspertëve kontabël të autorizuar të shoqërisë janë ato të parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.
2. Asambleja e Përgjithshme mund t'u kërkojë ekspertëve kontabël të autorizuar kryerjen e kontrolleve apo verifikimeve të posaçme për çështje me interes të shoqërisë. Me marrjen e raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar, Asambleja miraton raportin dhe bilancin e shoqërisë. Raportet që ata përgatisin depozitohen në selinë e shoqërisë, në afatet e parashikuara nga ligji.

KAPITULLI V
LLOGARITË VJETORE, CAKTIMI I REZULTATIT

NENI 34
Viti financiar

1. Shoqëria përgatit, çdo vit financiar, llogaritë vjetore në pajtim me ligjin për kontabilitetin.
2. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

NENI 35
Caktimi i rezultateve

Rezultati i vitit financiar nxirret dhe caktohet në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe mbas dhënies së raportit përfundimtar nga ekspertët kontabël të autorizuar.

NENI 36
Fitimet dhe fondi rezervë

1. Fitimet, që rezultojnë nga bilanci ushtrimor, do të shpërndahen, sipas një vendimi përkatës të Asamblesë, ndërmjet aksionarëve pasi të jenë zbritur, nga kjo shumë, taksat dhe tatimet sipas ligjit, vlerat e humbjeve të pësuara gjatë vitit ushtrimor paraardhës si dhe 5% që destinohet për fondet e rezervës së domosdoshme, derisa kjo të ketë arritur nivelin maksimal prej 1/10 e kapitalit themeltar.
2. Aksionarët mund të vendosin sipas ligjit për një destinim të ndryshëm të fitimit të pashpërndarë. Me vendimin e miratimit të bilancit ushtrimor, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë t'i destinojë fitimet që i takojnë ortakëve në formë dividendi për zmadhim të kapitalit themeltar, investime ose mbartje, etj.

KAPITULLI VI
PRISHJA, LIKUJDIMI, KUNDËRSHTIMET

NENI 37
Prishja, likujdimi

1. Shoqëria aksionare prishet:
   a) Kur mbaron kohëzgjatja për të cilën është themeluar;
   b) Kur merr vendim Asambleja e Përgjithshme;
   c) Me hapjen e proçedurave të falimentimit;
   d) Kur nuk ka kryer veprimtari sportive për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit;
   e) Me vendim gjykate.
2. Shoqëria aksionare likujdohet në dy mënyra: likujdimi i zakonshëm dhe likujdimi i thjeshtëzuar.
   a) **Likujdimi i zakonshëm** kryhet nga likujduesit e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme. Në rast se Asambleja nuk merr vendim për caktimin e likujduesit ai zgjidhet nga gjykata.
   -Detyra e likujduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve.
   -Në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, nëse likujduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë sportive, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, atëherë detyrohen ta pezullojnë proçedurën e likujdimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e proçedurave të falimentit.
   -Likujduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë, në çastin e hapjes së likujdimit, dhe një bilanc përfundimtar, në çastin e mbylljes së këtyre proçedurave. Nëse proçedura e një likujdimi zgjat më shumë se një vit, likujduesi përgatit gjithashtu pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë.
   -Bilancet miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
   -Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likujduesi u shpërndan ortakëve apo aksionarëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ato kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur Statuti parashikon rradhë preferencë.

-Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likujduesi njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likujdimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

b) Për sa i përket **likujdimit të thjeshtëzuar**, ky mund të kryhet nëpërmjet një proçedure të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët apo aksionarët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjithë detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer dhe janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit.

-Administratori/ët njoftojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit vendimin për likujdimin e shoqërisë, nëpërmjet proçedurës së thjeshtëzuar; gjithashtu ata janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likujdimit të thjeshtë.

NENI 38
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likujdimit të saj, që lindin midis shoqërisë dhe Aksionierit ose midis vetë Aksionarëve, lidhur me veprimtarinë e shoqërisë, i nënshtrohen juridiksionit të gjykatës kompetente, në kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

KAPITULLI VII
DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 39

Nëpunësit, të zgjedhurit nga organet drejtuese të shoqërisë dhe personat që punojnë për llogari të saj, mbajnë përgjegjësi penale e civile, sipas ligjit përkatës, kur me dashje shkelin detyrat e ngarkuara dhe i shkaktojnë humbje shoqërisë.

NENI 40

1. Statuti hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Gjithçka që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar, dhe ligje të tjera të lidhura me të, në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në veçanti nga ligji nr.9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).

Aksionarët e shoqërisë

BASHKIA ELBASAN	**BASHKIA LIBRAZHD**	**BASHKIA PRRENJAS**
Përfaqësuar nga	*Përfaqësuar nga*	*Përfaqësuar nga*
KRYETARI	KRYETARI	KRYETARI
Gledian Llatja	**Kastriot Curra**	**Num Belba**

BASHKIA GRAMSH	**BASHKIA PEQIN**	**BASHKIA CËRRIK**	**BASHKIA BELSH**
Përfaqësuar nga	*Përfaqësuar nga*	*Përfaqësuar nga*	*Përfaqësuar nga*
KRYETARI	KRYETARI	KRYETARI	KRYETARI
Klodian Tace	**Lorenc Toska**	**Andis Salla**	**Arif Tafani**

1254
18.11.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.5629/Prot **Elbasan, më 18.11.2021**

VENDIM

Nr.115 datë 18.11.2021

"Për
Autorizim për përfaqësimin e Bashkisë Elbasan si Aksionar në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "ECO-ELB" SH.A

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 2 dhe nenit 54, pika "k" të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 140 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe nenit 14/1 të Statutit të Shoqërisë Tregtare të përbashkët "ECO-ELB" sh.a, Këshilli i Bashkisë Elbasan, si organi përfaqësues i personit juridik publik-Bashkia Elbasan, në cilësinë e aksionarit të shoqërisë "ECO-ELB" sh.a, në mbledhjen e tij të datës ___.11.2021, pasi mori në shqyrtim propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë Elbasan,

VENDOSI:

1. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Elbasan, z.Gledian Llatja, të përfaqësojë Bashkinë Elbasan si aksionar të shoqërisë "ECO-ELB" sh.a, në të gjitha mbledhjet që do të zhvillojë Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë "ECO-ELB" sh.a, gjatë gjithë periudhës së mandatit të Këshillit të Bashkisë Elbasan.

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas 10 ditësh.

SEKRETARI
Klajdi Gripshi

KRYETAR
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Konceptoi:
Drejtori i DPSHI: *S. Mehmeti*
Drejtori DPPAABF: *L. Dervishi*
Drejtori D.Juridike: *A. Hoxha*
Këshilltari ligjor: *A. Spahiu*
Miratoi:
Zv/kryetari: *I. Sina*

1348
16.12.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr.6031/1 **Prot.** **Elbasan më,**16.12.2021

VENDIM

Nr116 **Dt.** 14/12/**2021**

"PËR MBARIMIN PARA KOHE TË MANDATIT TË KËSHILLTARIT BASHKIAK

znj.Majlinda PERRIU"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 14/12/2021, në mbështetje të nenit 49, pika 4, shkronjat "b" dhe "c" dhe pika 5, të nenit 54 shkronja "j", dhe të nenit 55 pika 3 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Komisionit i Mandateve i Këshillit Bashkiak;

VENDOSI:

1. Deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të këshilltarit të Këshillit Bashkiak Elbasan, znj. Majlinda Perriu, përfaqësuese e subjektit politik Partia Socialiste, për arsye të doreheqjes nga mandati.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sekretari i Këshillit Bashkiak Elbasan.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI **Zv/KRYETARI**

Klajd GRIPSHI **Sokol SINANI**

Adresa:Bashkia Elbasan",Tel.+355 54 400152,E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

1350
16.12.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE ORGANIZATIVE
Drejtoria Administratës dhe Burimeve Njerëzore

Nr. 6032/1 Prot. Elbasan, më 16/12/2021

VENDIM

Nr.117 datë 14/12/2021

"Mbi mirtimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse të saj si dhe miratimin e nivelit të pagave për vitin 2022".

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ___/___/2021, pasi shqyrtoi materialin e përgatitur nga Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore "Mbi mirtimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse të saj si dhe miratimin e nivelit të pagave për vitin 2021", bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54 pika "dh", ligjin 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, nenin 113 të ligjit 44/2015 "Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e shqipërisë", i ndryshuar; nenin 5 të ligjit nr.10405 datë 24.03.2001 "Për kompetencat dhe përcaktimin e pagave dhe shpërblimeve", VKM nr.177, datë 8.03.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.165 datë 2.03.2016 të Këshillit të Ministrave 'Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të njësive të vetëqeverisjes vendore", si dhe VKB nr. 169, datë 24.12.2020 "Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe Institucioneve vartëse të saj si dhe miratimin e nivelit të pagave për vitin 2021". VKB nr. 102, datë 25.10.2021 „Për miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Bashkisë Elbasan dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave" si dhe Marrëveshjes nr.6224 prot., datë 21.12.2020 midis Shoqatës "La Luce dell Est" dhe Bashkisë Elbasan.

VENDOSI :

1. Të miratojë numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Elbasan dhe institucioneve vartëse të saj për vitin 2022 prej 1437 punonjësish, përfshirë numrin e punonjësve të funksioneve të deleguara dhe atyre specifike si (Sistemi Parauniversitar, Shërbimi Zjarrfikës, Gjendja Civile, dhe QKB), si dhe shtimit të 4 punonjësve pranë Qendrës Sociale Balashe për shkak të përfundimit të Marrëveshjes mes "La Luce dell Est" dhe Bashkisë Elbasan si dhe vazhdimit të ofrimit të shërbimit në strukturën e Shtëpisë së të Moshuarve pranë QSB. Pagat e tyre do financohen nga buxheti i Bashkisë.

Bazuar ne miratimin e VKB nr.102, datë 25.10.2021 "Për miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Bashkisë Elbasan dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave" do të shtohet me 10 punonjës përpunues tekniko shkencor të dokumentacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, pranë Sektorit të Arkivave Shtetërore Vendore Elbasan, Berat, Korçë. Pagat e tyre do financohen nga buxheti i Bashkisë.

Si dhe miratimin e tabelës së pagave për punonjësit e Bashkisë Elbasan për vitin 2022, sipas tabeleva bashkëngjitur;

2. Numri i Punonjësve me kohë të pjeshme për vitin 2022 është si më poshtë:
a) Qendra Kulturore e Fëmijëve 7 punonjës, 3 punonjës me 6 orë në javë dhe 4 punonjës me 4 orë në javë (350/lekë/orë);
b) Agjencia e Shërbimeve Publike, 20 punonjës sezonal ujitje me pagë bazë 30 000 lekë për periudhën mars-dhjetor 2022;
c) Agjencia e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore dhe Mjedisore 5 vrojtues-sinjalizues zjarri për një kohëzgjatje prej 100 ditësh për person, me pagë bazë minimale mujore në shkallë vendi dhe 6 punonjës me kohë të pjesshme (5 punëtor me pagë bazë minimale mujore në shkallë vendi + 1 arkëtare me pagë sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur);
d)) Qendra Ekonomike e Arsimit, 10 kaldaist me pagë bazë minimale mujore në shkallë vendi, si dhe 15 sanitare dhe 4 dezinfektues per nje periudhe 6 mujore nga momenti i lidhjes së kontratës. Pagat do të mbulohen nga fondi i pagave të parashikuara në Buxhetin e vitit 2022 për Qendrën Ekonomike të Arsimit.

3. Tabela e pagave të funksioneve të zgjedhur e të emëruar të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Elbasan, Institucioneve dhe Ndërmarrjeve Vartëse për vitin 2022 të jetë sipas Lidhjeve bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Janar 2022.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Administrata e Bashkisë dhe institucionet vartëse të saj.

6.Ky vendim hyn në fuqi pas 10 ditësh nga shpallja.

SEKRETARI **KRYETAR**

Klajd GRIPSHI **Sokol SINANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Konceptoi: DABNJ: L.Balliu
Dr Finances: A.Merkja
D.Juridike: A.Hoxha
D. Pergj: B.Cabiri
D.Pergj: L.Dervishi
Konfirmoi: Zv/kryetar: I.Sina

1	Administrata e Bashkisë	391
2	Njësitë Administrative	60
3	Agjensia e Shërbimeve Publike	282
4	Qendra Ekonomike e Arsimit	93
5	Qendra e Artit	40
6	Qendra Sociale Balashe	44
7	Qendra e Trashegimisë Kulturore	22
8	Njësia e Menaxhimit të Banesave Sociale	4
9	Klubi Shumësportësh	41
10	Drejtoria e Shërbimit MZSH-së	30
11	Arsimi	416
		1423

Lidhja Nr.1

Niveli i pagave per Funksionaret dhe Nepunesit Civile te Bashkise Elbasan

NR.	Pozicioni	Kategoria/Klasa	Paga grupit	Vjetersia ne %	Shtesa per pozicion
I	***Punonjes te sistemit me page grupi + shtese pozicioni***				
1	Kryetari i Bashkise				162 750
2	Zv/Kryetar i Bashkise				138 000
3	Sekretar i Keshillit Bashkiak	II B	1	2%	79 000
4	Sekretar i Pergjithshem	I B	1	2%	107 000
5	Drejtor i Pergjithshem	II A	1	2%	98 000
6	Kryeinspektor i Pergjithshem i Inspektoriateve dhe Policise Bashkiake	II A	1	2%	98 000
7	Shef Kabineti	II B	1	2%	77 000
8	Keshilltar	IIIA/1	1	2%	64 000
9	Pergjegjes(Koordinator) i Protokollit Zyrtar	II B	1	2%	77 000
10	Avokat i Qytetit	II A	1	2%	79 000
11	Koordinator i Sherbimit Urban	II A	1	2%	79 000
12	Administrator Lagjeje	II B	1	2%	79 000
13	Drejtor Drejtorie	II B	1	2%	79 000
14	Kryeinspektor i Inspektoriatit te Kontrollit dhe Mbrojtjes se Territorit	II B	1	2%	79 000
15	Pergjegjes Menaxherial/Koordinator	III A	1	2%	67 000
16	Koordinator i Konsultimit dhe Informimit Publik	III B	1 ose 2	2%	42 000
17	Pergjegjes i Gjendjes Civile	IV A	1	2%	49 000
18	Specialiste e Gjendjes Civile	IV B	1 ose 2 ose 3	2%	38 000
19	Pergjegjes Sektori I Investimeve	III A	1	2%	53 000
20	Pergjegjes, Sektori Buxhetit	III A	1	2%	69 900
21	Pergjegjes, Drejtoria Finances	III A	1	2%	67 000
22	Pergjegjes, Drejtoria e Detyrave te Projektimit	III A	1	2%	53 000
23	Pergjegjes Sektori Arkiv Protokoll	III A	1	2%	67 000
24	Pergjegjes Sektori /Pergjegjes Inspektoriati	IIIA/1	1	2%	44 000
25	Inspektor	IVA	1 ose 2 ose 3	2%	40 000
26	Specialiste e Keshillit Bashkiak	III B	1 ose 2	2%	61 000
27	Specialist Arkiv-Protokolli, Sektori Arkiv Protokoll	III B	1 ose 2	2%	*58 000*
28	Specialiste Kontabiliteti dhe Arketare	III B	1 ose 2	2%	61 000
29	Specialiste Kontabiliteti/Specialiste e Planifikimit te Buxhetit	III B	1 ose 2	2%	48 900
30	Ekonomiste MNZSH	III B	1 ose 2	2%	49 000

Specialist/Supervizor/Perpunues,Specialist Inventarizues/Inspektor zone etj	III B	1 ose 2	2%	42 000
Specialist/Punonjese keshillimi\programues kompjuterash/Instruktor/Punonjese shtypi	IVA	1 ose 2 ose 3	2%	41 000
Specialist QKB (QKR+QKL)	III B	1 ose 2	2%	42 000
Zedhenese Shtypi	III B	1 ose 2	2%	42 000
Arshiviste Medias	III B	1 ose 2	2%	42 000
Specialist i Medias	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	42 000
Specialist Ndihme Ekonomike ne Lagje	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	39 000
Agjent Tatimor	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	39 000
Specialist Magazine/Magaziner ne MNZSH	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	39 000
Specialist ne lagje/ Specialist zyra me nje ndalese/Punonjese Protokolli Gjendjes Civile	IV B	1 ose 2 ose 3	2%	36 000
Specialist Auditi	III B	1 ose 2 ose 3	2%	*58 000*
Sekretar i Kryetarit	IV B	1ose 2 ose 3	2%	38 000
Arketare	IV B	1 ose 2 ose 3	2%	36 000
Punonjes te sistemit me klasa	**Klasa**		**Shtesa per vjetersi**	**Paga baze**
Specialist te Gjendjes Civile ne Komune	XI		1%	37 000
Ndihmes Specialist (Punonjes)me arsim te mesem/ Perpunues/ Inspektor Zone/Topograf	IX		1%	36 000
Agjent Tatimor	IX		1%	30 000
Shofer	IV		1%	33 400
Punonjes Sherbimi	II		1%	31 600
Kasap/Kujdestar Thertore	II		1%	30 000
Ndihmes Specialist ne zyrat me nje ndalese	IX		1%	36 000
Fotograf	VI		1%	34 500
Magazinier/Arketare	V		1%	34 100
Punonjesit e Policise Bashkiake				**Paga**
Kryeinspektori I Policise Bashkiake				72 000
Inspektor I Policise Bashkiake				53 000
Punonjes I Policise Bashkiake				47 000
Administratoret e Njesive Administrative				**Paga**
Administrator (Njesia Administrative Shirgjan 5 000-20 000 banore)				83 000
Administrator (Njesia Administrative Gjergjan 5 000-20 000 banore)				83 000
Administrator (Njesia Administrative Zavaline me pak se 5 000 banore)				59 000
Administrator (Njesia Administrative Shushice 5 000-20 000 banore)				83 000
Administrator (Njesia Administrative Gjinar 5 000- 20 000 banore)				83 000

Administrator (Njesia Administrative Paper 5 000- 20 000 banore)				83 000
Administrator (Njesia Administrative Bradashesh 5 000- 20 000 banore)				83 000
Administrator (Njesia Administrative Funar me pak se 5 000 banore)				59 000
Administrator (Njesia Administrative Tregan me pak se 5 000 banore)				59 000
Administrator (Njesia Administrative Labinot- Mal 5 000- 20 000 banore)				83 000
Administrator (Njesia Administrative Labinot- Fushe 5 000- 20 000 banore)				83 000
Administrator (Njesia Administrative Gracen me pak se 5 000 banore)				59 000

1. Pagat e punonjesve te Gjendjes Civile ne Bashki dhe Njesi Administrative te jete sipas VKM nr.177 date 8.03.2017 i ndryshuar

2. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.1 per kategorinë I, të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

3. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.1 per kategorinë II, të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë të klasës së I.

Paga baze e Klases se I eshte 30 000 leke

Lidhja Nr.2

Niveli i pagave per Qendren Ekonomike te Arsimit

NR.	Emertimi	Kategoria/Klasa	Paga grupit	Vjetersia ne %	Shtesa per pozicion
I	***Punonjes te sistemit me page grupi + shtese pozicioni***				
1	Drejtor	II/B	1	2%	77 000
2	Zv.Drejtor I konvikteve				51 150
3	Punonjes edukativ, Sociolog				36 850
4	Pergjegjes Finance	III A/1	1	2%	50 000
5	Pergjegjes Sektori	III A/1	1	2%	50 000
6	Pergjegjes Sektori Ndihmes	III A/1	1	2%	35 000
7	Pergjegjese Çerdhe	III A/1	1	2%	35 000
8	Pergjegjes Administrativ ne Konvikt	III A/1	1	2%	39 000
9	Kujdestare	IV/A	1 ose 2 ose 3	2%	32 000
10	Specialiste Protokoll/Arkiv	IV/A	1 ose 2 ose 3	2%	34 000
11	Specialist, Inventarizues	IV/A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
12	Ekonomiste	IV/A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
13	Infermiere	IV/A	1 ose 2 ose 3	2%	34 000
II	**Punonjes te sistemit me klasa**	**Klasa**		**Shtesa per vjetersi**	**Paga baze**
1	Ndihmës Specialist/Specialist me arsim te mesem	VI		1%	33 000
2	Kujdestare, Pergjegjes sektori	IX		1%	33 000
3	Magazinier	IV		1%	32 000
4	Shofer	IV		1%	30 000
5	Shofer per personat me aftesi ndryshe	IV		1%	30 000
6	Punetor Mirembajtjeje/Marangoz etj	II		1%	30 000
7	Pastruese	I		1%	30 000

8	Dezinfektues	II		1%	32 000
9	Guzhiniere	VI		1%	31 000
10	Nd/kuzhinier,pjatalarese	III		1%	30 000
11	Rrobalarese, magaziniere	IV		1%	30 000
12	Rrobaqepes	IV		1%	30 000

VKM nr.60,date 13.02.2019, shtesa për pozicion të jetë sipas nivelit te diplomës

2. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.2 per kategorinë I, të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupi

3. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidbjen Nr.2 per kategorinë II, të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë t

Paga baze e klases se I eshte 30 000 leke

Lidhja Nr.3

Niveli i pagave per Agjensise e Sherbimeve Publike

NR.	Emertimi	Kategoria/Klasa	Paga grupit	Vjetersia ne %	Shtesa per pozicion
I	***Punonjes te sistemit me page grupi + shtese pozicioni***				
1	Drejtor I Pergjithshem	II A	1	2%	98 000
2	Drejtor Drejtorie	II B	1	2%	77 000
3	Pergjegjes Sektori	III A/1	1	2%	44 000
4	Sekretare	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	42 000
5	Specialist	IV/A	1ose 2 ose 3	2%	42 000
6	Specialist Magazine	IV/A	1ose 2 ose 3	2%	35 000
II	**Punonjes te sistemit me klasa**	**Klasa**		**Shtesa per vjetersi**	**Paga baze**
1	Kryetar Dege per sektorin e varrezave me arsim te mesem	IX		1%	36 000
2	Magazinier	V		1%	34 100
3	Teknike te mesem te specialitetve te ndryshme	VI		1%	34 500
4	Shofer / Manovrator	XIV		1%	39 800
5	Punetor mirembajtjeje te profesioneve te ndryshme	IV		1%	33 400
6	Pastruese	I		1%	30 000
7	Punonjes Sherbimi	II		1%	31 600
8	Punonjes Sherbimi Varrezash	II		1%	31 600

1. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.3 per kategorinë I, të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

2. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.3 per kategorinë II, të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë të klasës së I

Paga baze e klases se I eshte 30 000 leke

Lidhja Nr.4

Niveli i pagave per Klubin Shumesportesh

NR.	Emertimi	Kategoria/Klasa	Paga grupit	Vjetersia ne %	Shtesa per pozicion
I	***Punonjes te sistemit me page grupi + shtese pozicioni***				
1	Drejtor	II B	1	2%	77 000
2	Përgjegjës Finance	III A/1	1	2%	37 000
3	Specialist finance	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	35 000
4	Specialist	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
5	Instruktor/ Inspektor	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
6	Koordinator i shoqatave sportive	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
7	Llogarita-Arkëtar	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
8	Magazinier	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
8	Infermier, Fizioterapist	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
II	**Punonjes te sistemit me klasa**	**Klasa**		**Shtesa per vjetersi**	**Paga baze**
1	Përgjegjës Sektori me arsim të mesëm	XI		1%	37 000
2	Ndihmës Specialist	VI		1%	34 500
3	Punëtor Mirëmbajtje/ Hidraulik/ Elektricist	IV		1%	33 400
4	Shofer me mjet mbi 2.5 ton	VIII		1%	35 400
5	Llogaritar-Arkëtar	IX		1%	32 000
6	Magazinier	V		1%	34 100

1. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.4 per kategorinë I, të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

2. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.4 per kategorinë II, të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë të klasës së I.

Paga baze e klases se I eshte 30 000 leke

Lidhja Nr.5

Niveli i pagave per Qendren e Artit

NR.	Emertimi	Kategoria/Klasa	Paga grupit	Vjetersia ne %	Shtesa per pozicion
I	***Punonjes te sistemit me page grupi + shtese pozicioni***				
1	Drejtor	II B	1	2%	77 000
2	Pergjegjes Finance	III A/1	1	2%	42 000
3	Pergjegjes i Galerise se Arteve	III A/1	1	2%	31 000
4	Specialist	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	37 000
5	Menaxher	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	37 000
6	Specialiste Finance/Protokolliste	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	37 000
7	Regjisor I Teatrit te Kukullave	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	37 000
8	Pergjegjes dhe Inspektor per skenen	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	33 000
9	Dirigjent	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	32 000
10	Koreograf	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
11	Specialist Folku	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
12	Udheheqes Artistik	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	37 000
13	Kompozitor(Orkestrues)	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	37 000
14	Asistent Inspektor Salle	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
15	Skenograf	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	32 000
16	Aktore	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
17	Kengetar	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
18	Instrumentist	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
II	**Punonjes te sistemit me klasa**	**Klasa**		**Shtesa per vjetersi**	**Paga baze**

1	Teknik Ndricimi, Fonist , Instrumentist, Kengetar, Aktore	VI		1%	34 000
2	Magazinier/Garderobe	V		1%	32 000
3	Marangoz,Punetor Skene	IV		1%	30 000
5	Pastruese	I		1%	30 000

1. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.5 per kategorinë I, të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

2. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.5 per kategorinë II, të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë të klasës së I.

Paga baze e klases se I eshte 30 000 leke

Lidhja Nr.6

Niveli i pagave per Qendren e Trashegimise Kulturore

NR.	Emertimi	Kategoria/Klasa	Paga grupit	Vjetersia ne %	Shtesa per pozicion
I	***Punonjes te sistemit me pagw grupi + shtese pozicioni***				
1	Drejtor I Qendres se Trashgimise Kulturore	II A	1	2%	77 000
2	Drejtor I Bibliotekes	II B	1	2%	61 000
3	Drejtor I Muzeut	II B	1	2%	61 000
4	Pergjegjes Finance	III A/1	1	2%	50 000
5	Biblotekare	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
6	Klasifikatore	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	32 000
7	Specialiste	III B	1 ose 2 ose 3	2%	42 000
II	**Punonjes te sistemit me klasa**	**Klasa**		**Shtesa per vjetersi**	**Paga baze**
1	Dizenjator/ Magazinier	VII		1%	35 000
2	Biblotekare	VIII		1%	34 000
3	Libralidhese	IV		1%	32 000
4	Pastruese	I		1%	30 000

1. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.6 per kategorinë I, të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

2. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.6 per kategorinë II, të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë të klasës së I.

Paga baze e klases se I eshte 30 000 leke

Lidhja Nr.7

Niveli i pagave per Qendren Sociale Balashe

NR.	Emertimi	Kategoria/Klasa	Paga grupit	Vjetersia ne %	Shtesa per pozicion
I	***Punonjes te sistemit me page grupi + shtese pozicioni***				
1	Drejtor	II B	1	2%	79 000
2	Pergjegjes Finance	III A/1	1	2%	36 000
3	Pergjegjes I qendres Rome	III A/1	1	2%	34 000
4	Specialist(Psikolog, Punonjes Social, Instruktor, Infermiere, Fizioterapist etj	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
5	Specialist Magazine	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
II	**Punonjes te sistemit me klasa**	**Klasa**		**Shtesa per vjetersi**	**Paga baze**
1	Specialist me arsim te mesem, Asistente Shtepiake, Kujdestar etj	VI		1%	33 000
2	Guzhiniere	VI		1%	32 000
3	Nd/kuzhiniere	III		1%	30 000
4	Pastruese	I		1%	30 000
5	Shofer	IV		1%	30 000
6	Punetor Mirembajtje	IV		1%	30 000
7	Magazinier	IV		1%	32 000
8	Lavanteri	II		1%	30 000

1. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.7 per kategorinë I, të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

2. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.7 per kategorinë II, të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë të klasës së I.

Paga baze e klases se I eshte 30 000 leke

Lidhja Nr.8

Niveli I Pagave per punonjesit e Menaxhimi te Banesave Sociale

NR.	Emertimi	Kategoria	Paga grupit	Vjetersia ne %	Shtesa per pozicion
I	***Punonjes te sistemit me page grupi + shtese pozicioni***				
1	Menaxher	III A/1	1	2%	52 000
2	Specialist	IV/A	1 ose 2 ose 3	2%	39 000
3	Kujdestar	IV/A	1 ose 2 ose 3	2%	34 000
II	**Punonjes te sistemit me klasa**	**Klasa**		**Shtesa per vjetersi**	**Paga baze**
3	Punetor Mirembajtje	IV/A	1 ose 2 ose 3	1%	30 000

1. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.9 per kategorinë I, të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

1351
16.12.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6030/1 **Prot.** **Elbasan, më:** 16.12.2021.

V E N D I M

Nr. 118 **datë** 14/12/2021.

"Mbi miratimin e listës emërore të familjeve që do të përfitojnë subvencionim qiraje, për vitin 2022, në qytetin e Elbasanit"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___/___/2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Aseteve dhe Strehimit (Sektori i Strehimit), mbështetur në ligjin 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore";* ligjin nr. 22/2018 *"Për strehim social";* V.K.M. nr. 459 datë 03.07.2019 *"Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyren e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehim";* V.K.M. nr. 384 datë 12.06.2019 *"Për përcaktimin e dokumentacionit, për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afatëve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore";*

V E N D O S I:

1. Miraton *"Listën emërore të familjeve që do të përfitojnë subvencionim qiraje, për vitin 2022, në qytetin e Elbasanit",* sipas listës bashkëlidhur.
1. Miraton në parim, masën e subvencionimit të qirasë me vlerë totale prej ***22.500.916.20 lekë*** për periudhën (Janar-Dhjetor) viti 2022, për t'u financuar nga në masën ***70%*** nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vlerën ***15,750,641.34 lekë*** dhe në masën ***30%*** nga Bashkia Elbasan në vlerën ***6,750,274.86 lekë.***
2. Paraqitjen e listës emërore të familjeve përfituese, bashkëlidhur këtij vendimi, për miratim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
3. Dhënia e subvencionimit do të bëhet për cdo rast pas verifikimit të plotësimit të kritereve ligjorë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Aseteve dhe Strehimit dhe Drejtoria e Buxhet-Financës
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd GRIPSHI

Zv/KRYETARI
Sokol SINANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Konceptoi: A. Beqiri E. Ibërshimi
Dr.A.S.: A. Suli
Dr.B.F.: A. Merkja
Dr. P.P.A.A.B.F.: L. Dervishi
Dr. Juridike: A. Hoxha
Zv/Kryetar: I. Sina

Lista e kerkesave te aplikuesve të cilët kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë ligjorë

Shtojca A

Nr.	Emër, Atësia, Mbiemër	Përbërja familjare	Struktura e apartamentit	Sipërfaqja e apartamentit	Qiraja mes e apartamentit në treg	Të ardhurat familjare mujore	Kategoria (sipas pikës 45, e nenit 2 të ligjit 22/2018)	Kategoria (sipas pikës 3, e nenit 34 të ligjit 22/2018)	Aftësia përballuese sipas nenit 3 të ligjit	Qiraja e përballueshme (g x i)	Subvencioni (f-j)	Subvencioni nëmuaj qe mbulohet nga bashkia	Shuma qe kerkohet nga buxheti	Subvencioni për 12 muaj
a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l	ll	m	n
1	LUAN TAJAR XHAJA	5 PERSONA	3+1	50	15,000.00	-	"ç"	Person me aftësi të kufizuara	0%	0	15,000.00	4,500.00	10,500.00	180,000.00
2	SHKELQIM LUFTAR LUSHJA	4 PERSONA	2+1	50	12,000.00	-	"ç"	Familje e kom.egjiiptian	0%	0	12,000.00	3,600.00	8,400.00	144,000.00
3	SHPETIM RAMAZAN KUMBULLA	4 PERSONA	2+1	84.8	12,000.00	-	"ç"	Familje e kom.egjiiptian	0%	0	12,000.00	3,600.00	8,400.00	144,000.00
4	LEONARD LEFTER MAXHARI	3 PERSONA	1+1	20	10,000.00	-	"ç"	Familje e kom.egjiiptian	0%	0	10,000.00	3,000.00	7,000.00	120,000.00
5	SOKOL TOMORR ULQINAKU	4 PERSONA	2+1	75	12,000.00	-	"ç"	Familje e kom.egjiptian	0%	0	12,000.00	3,600.00	8,400.00	144,000.00
6	ARDJAN SALI DUKA	3 PERSONA	1+1	91	10,000.00	-	"ç"	Person me aftësi të kufizuara	0%	0	10,000.00	3,000.00	7,000.00	120,000.00
7	LEONORE ZEF CFARKU	2 PERSONA	1+1	68	10,000.00	-	"ç"	Person me aftësi të kufizuara	0%	0	10,000.00	3,000.00	7,000.00	120,000.00
8	SELIM MUSTAFA LALOSHI	2 PERSONA	1+1	50	10,000.00	23,190.00	"c"	PENSIONIST	15%	3478.5	6,521.50	1,956.45	4,565.05	78,258.00
9	IRMA RAMAZAN TOMORRICA	2 PERSONA	1+1	53	10,000.00	-	"ç"	Person me aftësi të kufizuara	0%	0	10,000.00	3,000.00	7,000.00	120,000.00
10	SAIMIR MUSTAFA BALIJA	4 PERSONA	2+1	50	12,000.00	26,640.00	"c"	Familje e kom.egjiiptian	15%	3996	8,004.00	2,401.20	5,602.80	96,048.00
11	SAMI SELMAN LUPI	6 PERSONA	3+1	52	15,000.00	-	"ç"	Familje e kom.egjiiptian	0%	0	15,000.00	4,500.00	10,500.00	180,000.00
12	MARIAN BASHKIM BERATI	6 PERSONA	3+1	68	15,000.00	26,640.00	"c"	Familje e kom. Egjiptian	15%	3996	11,004.00	3,301.20	7,702.80	132,048.00
13	GEZIM FIQIRI MEJDANI	5 PERSONA	3+1	90	15,000.00		"ç"	Person me aftësi të kufizuara	0%	0	15,000.00	4,500.00	10,500.00	180,000.00
14	ANTONJO QAZIM SULA	4 PERSONA	2+1	114	12,000.00	-	"ç"	Familje me ndihme ekonomike	0%	0	12,000.00	3,600.00	8,400.00	144,000.00
15	SAIMIR HAZIS PLLUMBI	3 PERSONA	1+1	63	10,000.00	-	"ç"	Familje e kom.egjiiptian	0%	0	10,000.00	3,000.00	7,000.00	120,000.00
16	ADRIAN HYQMET ZHUGLI	1 PERSON	1+1	188.8	10,000.00	-	"ç"	Familje me ndihme ekonomike	0%	0	10,000.00	3,000.00	7,000.00	120,000.00
17	ADRIAN SAJMIR GOGUJA	5 PERSONA	3+1	44.64	15,000.00	26,640.00	"c"	Familje e kom.egjiiptian	15%	3996	11,004.00	3,301.20	7,702.80	132,048.00
18	ADRIANO VLADIMIR KRUJA	4 PERSONA	2+1	47	12,000.00	-	"ç"	Familje e kom.egjiptian	0%	0	12,000.00	3,600.00	8,400.00	144,000.00
19	AGIM FERIT BAMI	3 PERSONA	1+1	119.8	10,000.00	-	"ç"	Familje e kom.egjiiptian	0%	0	10,000.00	3,000.00	7,000.00	120,000.00
20	AGIM TAJAR BERATI	4 PERSONA	2+1	48.2	12,000.00	-	"ç"	Familje e kom.egjiptian	0%	0	12,000.00	3,600.00	8,400.00	144,000.00
21	AHMET ZENEL KURTI	2 PERSONA	1+1	33.74	10,000.00	14,265.00	"c"	Familje e kom.egjiptian + PAK	15%	2139.75	7,860.25	2,358.08	5,502.18	94,323.00
22	AJAKS BUJAR IZET	2 PERSONA	1+1	32	10,000.00	-	"ç"	Familje e kom.rom	0%	0	10,000.00	3,000.00	7,000.00	120,000.00
23	ALBERT QAMIL SERICA	2 PERSONA	1+1	35.91	10,000.00	-	"ç"	Familje e kom.egjiiptian	0%	0	10,000.00	3,000.00	7,000.00	120,000.00
24	ALMA FATMIR XHIKA	2 PERSONA	1+1	53	10,000.00	26,640.00	"c"	Prindër i vetëm, që ka në ngarkim fëmijë	15%	3996	6,004.00	1,801.20	4,202.80	72,048.00
25	ANISA FETI MEHALLA	2 PERSONA	1+1	77.18	10,000.00	-	"ç"	rindër i vetëm, që ka në ngarkim fëmi	0%	0	10,000.00	3,000.00	7,000.00	120,000.00
26	ARBEN HASAN JAKODINA	3 PERSONA	1+1	50	10,000.00	-	"ç"	Familje me ndihme ekonomike	0%	0	10,000.00	3,000.00	7,000.00	120,000.00

27	ARBEN XHAFERR HANKJA	4 PERSONA	2+1	45.88	12,000.00	26,640.00	"c"	Familje e kom.egjiiptian	15%	3996	8,004.00	2,401.20	5,602.80	96,048.00
28	ARDIAN BAKI ZENA	2 PERSONA	1+1	69.5	10,000.00	-	"ç"	Familje e kom.egjiiptian	0%	0	10,000.00	3,000.00	7,000.00	120,000.00
29	ARMAND JEMIN DUBALI	3 PERSONA	1+1	54	10,000.00	26,640.00	"c"	Familje e kom.egjiiptian	15%	3996	6,004.00	1,801.20	4,202.80	72,048.00
30	AZBI SELIM SALIAJ	2 PERSONA	1+1	56	10,000.00	39,691.00	"c"	PENSIONIST	20%	7938.2	2,061.80	618.54	1,443.26	24,741.60
31	BESNIK JONUS PEQINI	4 PERSONA	2+1	62.6	12,000.00	-	"ç"	Familje e kom.egjiptian	0%	0	12,000.00	3,600.00	8,400.00	144,000.00
32	BESNIK RYZHDI MECJA	3 PERSONA	1+1	51.45	10,000.00	-	"ç"	Person me aftësi të kufizuara	15%	0	10,000.00	3,000.00	7,000.00	120,000.00
33	BESNIK SBARI DEMIRI	2 PERSONA	1+1	45	10,000.00	-	"ç"	Person me aftësi të kufizuara	0%	0	10,000.00	3,000.00	7,000.00	120,000.00
ç.Personat që aplikojnë për t'u pajisur me leje për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, përjashtohen nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë duke paraqitur dokumentacionin përkatës sipas VKM nr. 145, datë 13.02.2020 është 0% taksa e ndikimit në infrastrukturë.

KREU VII
TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

Neni 23
Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël

Sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, çdo biznes i cili realizon gjatë vitit një qarkullim më të vogël ose të barabartë me

8,000,000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Neni 24
Baza dhe niveli i detyrimit

1. Kështet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5-së (pesë) deri në 8-të (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë.

2. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, paraqitet si më poshtë vijon:

a. niveli i tatimit për subjektet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me qarkullim vjetor nga 0 deri në 5-së milionë lekë, është 0 (zero) lekë.

b. shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për subjektet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, me qarkullim nga 5-së deri në 8-të milionë lekë, është 5 % mbi fitimin e tatueshëm.

Neni 25
Mënyra e pagesës

Tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e Administratës Tatimore .

Neni 26
Struktura për vjeljen e taksës

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogarinë e buxhetit të Bashkisë Elbasan të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

2. Administrata Tatimore Qendrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të Bashkisë Elbasan, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet. Dhe për shërbimin që kryen merr një komision, i cili është në masën 1% dhe derdhet në llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan.

KREU VIII

TAKSË PËR OBJEKTET NË PROCES LEGALIZIMI

Neni 27
Taksë për objektet në proces legalizimi

Në rastet kur një subjekt aplikon për legalizimin të më tepër se 1 objekti taksa që aplikohet është:

a. Për struktura banimi, 3 % e ndikimit në infrastrukturë.
b. Për struktura me funksione shërbimi dhe njësi, 3 % e ndikimit në infrastrukturë
c. Për struktura për qëllime publike si: shkolla, kopshte, spitale etj., (private ose publike), 2 % e ndikimit në infrastrukturë.

Neni 28
Struktura për vjeljen e taksës

1. Për ndërtesat të cilat janë në proçes legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.5% e vlerës së investimit.
2. Dokumentacioni i kërkuar do të jetë ai i parashikuar nga drejtoria përkatëse, i cili përfshin kopje të njehësuar të vetëdeklarimit, planvendosje të objektit, si dhe planimetritë me sipërfaqjet përkatëse.
3. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

KREU IX
GARANCIA PËR HEQJEN E INERTEVE

Neni 29
Struktura për vjeljen e taksës

1. Në mbështetje të pikës 10, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", subjekti fizik/juridik, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogari të Bashkisë Elbasan ose kontratë sigurimi, e cila nuk do të jetë më e vogël se 4% e vlerës së strukturës së objektit.

2. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

KREU X
TAKSA E FJETJES NE HOTEL

Neni 30
Baza dhe niveli i detyrimit

1. Me "hotel" kuptohet çdo veprimtari që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet: hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar si dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

2. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel.

3. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

4. Subjektet janë të detyruar të bëjnë vetëdeklarimin e numrit të netëve të qëndrimit në hotel shoqëruar me dokumentaciomin justifikues për muajin paraardhës. Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës. Subjekti detyrohet të paraqitet para datës 5 të muajit për tërheqjen e faturës për arkëtim.

5. Për subjektet "Hotele me 4 dhe 5 yje" që ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin e Elbasanit, niveli i taksës për çdo fjetje është 175 lekë për person, ndërsa për ato që ushtojnë aktivitetin e tyre në Njësitë Administrative jashtë qytetit të Bashkisë Elbasan, vlera që duhet të paguhet është 105 lekë për natë fjetje për person.

6. Subjektet "Hotel nën 4 yje", motel, hostel, bujtinë, si dhe çdo njësi tjetër akomoduese të ngjashme me to, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Bashkinë e Elbasanit, niveli i taksës është 70 lekë për person. Në rastet kur subjektet nuk mbajnë regjistër të klientëve që akomodohen në hotel, administratës tatimore i lind e drejta të bëjë vlerësimin.

Neni 31
Struktura për vjeljen e taksës

1. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave.
2. Në rastin e pikës 6 të nenit 30, afati për pagesën e kësaj takse është data **31.07.2022**.
3. Për subjektet me aktivitet "hoteleri" në territorin e njësisë administrative Tregan, afati për pagesën e kësaj takse është data **31.10.2022**.
4. Për mospagesë në afatin e caktuar aplikohet kamatëvonesë në masën 1.8% çdo muaj, deri në 12 muaj mbi detyrimin si dhe ndërprerje të aktivitetit nga struktura përkatëse.

KREU XI
TAKSA E TABELËS

Neni 32
Fusha e zbatimit dhe kategorizimet

Taksa e tabelës zbatohet për të gjitha subjektet, të cilat vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

1. Për qëllime të zbatimit të këtij vendimi, tabelat kategorizohen në:
   a. **Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo,** vendosen brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logoja dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një tabele identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë.
   b. **Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit,** kanë formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.
   c. **Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme,** e vendosur në pamje ballore ose joballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si: tarraca, lozha, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, për të tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.
   d. **Tabelë në funksion të ekspozimeve të udryshme të hapura**, tabela që përdoren për panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.

2. Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga shkronja të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si: mur, fasadë e jashtme e çdo lloji, shtyllë, kolonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë e shkruar, e stampuar apo e pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi një sipërfaqe ekzistuese, si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zënë të gjitha shkronjat, figurat, logot dhe simbolet që formojnë tabelën.



Neni 33
Niveli i taksës

Nivelet e taksës së tabelës, sipas kategorizimeve të përcaktuara në nenin 34, jepen në **Aneksin nr. 3**, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Neni 34
Struktura për vjeljen e taksës

1. Detyrimi për taksën e vendosjes së tabelës referuar kategorive 1 dhe2 është vjetor. Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.
2. Për kategoritë 1 dhe 2 për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet 31.07.2022 te vitit fiskal Për subjektet që duan të identifikohen me tabelë të re pas **31.07.2022**, detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë për periudhën nga I deklarimit.
3. Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet që nga muaji pasardhës që subjekti regjistrohet pranë QKB dhe taksa paguhet menjëherë. Taksa e tabelës për qëllime identifikimi paguhet për çdo njësi ku subjekti zhvillon aktivitetim, nga muaji pasardhës që regjistrohet pranë QKB.
4. Në rastin e më shumë se një tabele, pavarësisht nga vendndodhja, vetëm njëra do të konsiderohet si tabelë me qëllime identifikuese, ndërsa tabelat e tjera do të konsiderohen si tabela me qëllime reklamuese.
5. Për kategorinë 1c për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet **31.07.2022**. Për subjektet e reja detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë sipas periudhës së përcaktuar në kontratën e nënshkruar me strukturat përkatëse të bashkisë Elbasan.
6. Për kategorinë 1d detyrimi llogaritet sipas ditëve të përcaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të bashkisë Elbasan dhe paguhet menjëherë.
7. Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe shkronja, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produkteve apo shërbimeve që furnizohen nga vetë njësia, ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori tabele. Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi
8. Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një tabele identifikuese, përveç atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo në njësinë apo territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet më pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij. Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori tabele.
9. Institucionet e varësisë së Bashkisë Elbasan përjashtohen nga taksa për vendosjen e tabelës.
10. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj është Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

PJESA E POSAÇME

TARIFAT VENDORE

Neni 35
Llojet e tarifave

Bashkia Elbasan aplikon tarifat vendore si më poshtë:

a. Tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit
b. Tarifat e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, shërbimit në tregje dhe zgjatjeve të orarit;
c. Tarifa për zënien e hapësirave publike;
d. Tarifa për dhënie licence për tregtim karburanti e lëndë djegëse;
e. Tarifa të shërbimit adminitrativ të Bashkisë Elbasan;
f. Tarifë për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime;
g. Tarifa të institucioneve të varësisë.

KREU XII
TARIFA PËR MBROJTJEN DHE PËRMIRËSIMIN E MJEDISIT

Neni 36
Kategoritë e subjekteve

1. Ngarkohen me detyrimin për pagesën e tarifës për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit:

a. Subjektet VIP që ushtrojnë aktivitet prodhim metalesh nga skrapi ose minerali, shkrirje e substancave minerale, përpunimi naftës dhe nënprodukteve të saj, prodhimi I çimentos, që ndikojnë në mjedis, në vlerën 3,360,000 lekë/ vit.

b. Subjektet VIP që ushtrojnë aktivitet të tillë si: trajtimi I mbetjeve plastike dhe nënprodukteve, industria e peshkut dhe nënprodukteve, grumbullimi dhe asgjesimi I mbetjeve metalike, prodhim polisteroli, apo aktivitete të tjera, që ndikojnë në mjedis, në vlerën 448,000 lekë/ vit.

c. Subjektet persona juridik që ushtrojnë aktivitet të tillë si: karrire guri (gurore), shfrytëzim të argjilave, shfrytëzim të lumenjve, që ndikojnë në mjedis, në vlerën 336,000 lekë/ vit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

d. Subjektet persona juridik që ushtrojnë aktivitet të tillë si: industria e gomës dhe nënprodukteve të saj, prodhimi I polisterolit, 23mir23a23c të tjera, që ndikojnë në mjedis, në vlerën 224,000 lekë/ vit.

e. Subjektet persona juridik që ushtrojnë aktivitet të tillë si: trajtimi I mbetjeve plastike dhe nënprodukteve, grumbullimi dhe asgjësimi I mbetjeve metalike, furrë buke, përpunimi I peshkut/mishit dhe nënprodukteve, që ndikojnë në mjedis, në vlerën 25,000 lekë/ vit.

f. Subjektet persona fizik që ushtrojnë aktivitet të tillë si: trajtimi I mbetjeve plastike dhe nënprodukteve, grumbullimi dhe asgjësimi I mbetjeve metalike, furrë buke, përpunimi I peshkut/mishit dhe nënprodukteve, që ndikojnë në mjedis, në vlerën 8,000 lekë/ vit.

2. Lista me subjektet që duhen ngarkuar me këtë tarifë vendoset në dispozion të DTTVMA[3], nga Inspektoriati I Mjedisit para 23mir23 15.02.2022 dhe rast pas rasti për subjktet e reja.

3. Afati I pagesës së detyrimit është data **31.07.2022**.

KREU XII
TARIFAT E PASTRIMIT, GJELBËRIMIT, NDRIÇIMIT, SHËRBIMIT NË TREGJE DHE ZGJATJEVE TË ORARIT

Neni 37
Fusha e zbatimit, kategorizimet dhe mënyra e pagesës

1. Këto tarifa aplikohen për subjektet persona fizik/ juridik, vendas apo të huaj, ambulantët dhe familjarët, që ushtrojnë aktivitet ekonomik ose banojnë në territorin e Bashkisë Elbasan.
2. Kategorizimet e subjekteve jepen në Aneksin nr. 4 që I bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Të gjithë subjektet që tregtojnë tek tregu industrial (lagjja "Shënkoll"), tregu I fruta perime (Namazjaja dhe markata tek ish Zyra e Punës), tek fusha e vjetër e sportit, lagjja "Luigj Gurakuqi" (tek rruga "Mustafa Sahatçi") trajtohen si ambulantë.
4. Subjektet që tregtojnë në tregjet e Njësive Administrative Tregan, Gjinar, Funar, Shmil, Zavalinë, Papër, si dhe në tregun e bagëtive në Mengël, I nënshtrohen tarifës së shërbimit në tregje.
5. Ambulantët menaxhohen nga Sektori I Terrenit, Tregut dhe Menaxhimit të Parkimit. Në fillim të vitit realizohet inventarizimi I subjekteve që marrin në përdorim banakët dhe më pas

[3] Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave.

lidhen kontratat. Në vazhdimësi, ndryshimet në kontrata depozitohen në Drejtorinë e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, jo më vonë se 5 ditë nga 24mir24a I ndryshimit të kontratës.

6. Detyrimi për tarifat e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore është vjetor.
7. Për kategorinë "Familjare" detyrimi paguhet në 12 këste mujore. Ky detyrim do të evidentohet në faturën e konsumit të ujit. Likuidimi I kësaj pagese do të kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit.
8. Për kategorinë "Familjare" detyrimi llogaritet dhe paguhet për familje. Për të llogaritur detyrimin për tarifën, kjo kategori duhet të paraqesë pranë agjentit tatimor përkatës çertifikatën e gjëndjes familjare të lëshuar nga zyra e Gjendjes Civile.
9. Për kategoritë e tjera afati për pagesën e tarifave të parashikuara në pikat 1, 2, 3, 5 germat b dhe c, dhe 7 është data **31.07.2022.** Për tarifat e mbetura pagesa ekzekutohet në momentin e marrjes së aprovimit.
10. Për subjektet e regjistruara rishtaz detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent I regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

11. Për pikën 5/c (lokale dasmash) lista me subjektet që ngarkohen me këtë tarifë vendoset në dispozion të DTTVMA, nga Inspektoriati i Mjedisit para datë **31.01.2022** dhe rast pas rasti për subjektet e reja.
12. Për mospagesë në afatin e caktuar aplikohet kamatëvonesë në masën 1.8% çdo muaj (deri në 12 muaj). Përjashtohen nga kamatëvonesa tarifat e pikës 4, 5 dhe 7.
13. Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar taksën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer, përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.
14. Për subjektet e reja që nisin veprimtarinë pas datë 31.07.2022, afati për pagesën e tarifave është **data 25 e muajit pasardhës nga momenti regjistrimit.**

Neni 38
Niveli I tarifave

Nivelet e tarifave të pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, shërbimit në tregje dhe zgjatjeve të orarit, sipas kategorizimeve të përcaktuara në nenin 34, jepen në **Aneksin nr. 4**, që I bashkëlidhet këtij vendimi.

Neni 39
Lehtësira dhe përjashtime

1. Familjet me ndihmë ekonomike paguajne 50% te tarifes së pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit dhe tarifa për mirëmbajtjen e infrastruktures në njësitë administrative (aty ku aplikohet kjo tarifë referuar aneksit 4).

2. Familjet që figurojnë me banim në territorin e Bashkisë Elbasan, por që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë përjashtohen nga tarifa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit dhe tarifa për mirëmbajtjen e infrastrukture në Njësitë Administrative aty ku aplikohet kjo tarifë.
3. Personat me aftësi të kufizuar, invalidë, tetraplegjikë dhe paraplegjikë, të verbër, kur janë kryefamiljarë dhe nuk kanë persona të tjerë madhor në familje, me përjashtim të bashkëshortit/bashkëshortes, përjashtohen nga tarifat e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit dhe tarifa për mirëmbajtjen e infrastruktures në Njësitë Administrative (aty ku aplikohet kjo tarifë).
4. Institucionet e varësisë së Bashkisë Elbasan përjashtohen nga tarifat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit.
5. Tarifat e ambulantëve në tregjet e miratuara janë 0 lekë (tarifa e pastrimit, e ndriçimit, e gjelbërimit).

❖ Dokumentacioni që dorëzohet për të përfituar nga përjashtimi

Kategoritë e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, për të përfituar këtë përjashtim, duhet të dorëzojnë pranë zyrave të Njësive Administrative dhe Lagjjeve të Bashkisë Elbasan sipas rastit dokumentet si vijon:

- ✓ Dokumentin që vërteton kushtin që sipas çertifikatës familjare janë kryefamiljarë dhe pa persona të tjerë madhorë përveç bashkëshortit ose bashkëshortes, si dhe personave të tjerë madhorë të paaftë për punë (invalidë ose fëmijë nën 25 vjeç që ndjekin studimet).
- ✓ Librezën e invalidit, librezën e pensionit, vërtetimin e KMCAP, vërtetimin nga Njësia Administrative/lagjjet për përfituesit e ndihmës ekonomike.
- ✓ Dokumentin që vërteton kushtin që familja ka jetuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 40
Struktura për vjeljen e tarifave dhe afati e pagesws

Strukturat e caktuara për vjeljen e këtyre tarifave janë:

a. Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, për subjektet persona fizik/ juridik, vendas apo të huaj, ambulantët, që ushtrojnë aktivitet ekonomik në territorin e Bashkisë Elbasan.
b. Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" në cilësinë e agjentit tatimor dhe Drejtoria e Koordinimit me Njësitë Administrative dhe Lagjjet për familjet që banojnë në territorin e Bashkisë Elbasan.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

KREU XIII

TARIFA PËR ZËNIEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE

Neni 41
Baza dhe niveli I tarifës

1. Baza e tarifës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në metra katror, e cila kërkohet të shfrytëzohet nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi.
2. Niveli I tarifës sipas kategorive dhe nënkategorive është sipas aneksit nr. 5, bashkëlidhur këtij vendimi. "Zona A", zona "B" dhe zona "C", për efekt tatimor janë zonat sipas hartës bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Detyrimi I tarifës për llogaritet si shumëzim I bazës (sipërfaqes) me nivelet treguese të saj. Kjo tarifë paguhet sipas kushteve të përcaktuara DPZHT [4] në zbatim të Rregulloris Arkitektonike e qytetit të Elbasanit miratuar nga Kryetari I Bashkisë me vendim nr.143, datë 03.03.2020 dhe përllogaritjes së detyrimit nga D.T.T.V.M.A.
4. Pagesa e kësaj tarife bëhet në momentin e nënshkrimit të kontratës.
5. Subjekte të cilët kryejnë aktivitet në shëshet publike përjashtohen nga tarifat e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të tabelës së mësipërme pas lidhjes së marrëveshjes me Bashkinë Elbasan.

Neni 42
Struktura për mbledhjen e tarifës së hapësirës publike

Strukturat e caktuara për vjeljen e kësaj tarife janë Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave dhe Njësitë Administrative.

KREU XV
TARIFAT E TRANSPORTIT

Neni 43
Tarifat vendore të transportit

1. Niveli I tarifave vendore të transportit sipas kategorive dhe nënkategorive është sipas **Aneksit nr. 6,** bashkëlidhur këtij vendimi.

[4] Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit

2. Struktura e caktuar për vjeljen e këtyre tarifave është Drejtoria e Shërbimit të Territorit Urban, Sektori i Transportit, në Bashkinë Elbasan.

Neni 44
Tarifa për liçensa/autorizime/çertifikata

1. Niveli I tarifave vendore të transportit sipas kategorive dhe nënkategorive është sipas **Aneksit nr. 7**, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për dublikatë me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmërie, paguhet 30% e vlerës së plotë të tarifës.
3. Struktura e caktuar për vjeljen e këtyre tarifave është Drejtoria e Shërbimit të Territorit Urban, Sektori I Transportit, në Bashkinë Elbasan.

Neni 45
Tarifa për dhënie 27mir27a27 për tregtimin e naftës bruto, gazit dhe nënprodukteve të tyre

1. Pagesa për dhënien dhe përtëritjen e liçensave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 1 000 000 (një milionë) lekë.
2. Pagesa për dhënien dhe përtëritjen e liçensave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 100 000 (njëqind mijë) lekë.
3. Pagesa për dhënien dhe përtëritjen e autorizimit për hyrje – dalje në rrugë për stacionin e karburantit, është 2 000 (dymijë) lekë.
4. Vlera e pagesës sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni është për një periudhe deri ne pesë vjeçare, ndërsa për pikën 3 është i përhershëm.
5. Struktura e caktuar për vjeljen e këtyre tarifave është Drejtoria e Shërbimit të Territorit Urban, Sektori I Transportit, në Bashkinë Elbasan, dhe drejtoria e taksave (Aneksi 7).

KREU XVI
TARIFAT VENDORE PËR UJITJEN DHE MIRËMBAJTJEN E RRJETIT KULLUES E UJITËS

Neni 46
Baza dhe niveli I tarifës

1. Kategoritë e tarifave janë:

   a. Tarifë mirëmbajtje të sistemit të kullimit në vlerën 130 lekë/ dynym.
   b. Tarifë mirëmbajtje të sistemit të ujitjes në vlerën 130 lekë/ dynym.
   c. Tarifë ujitje me kanal të hapur, rrjedhje e lire në vlerën 200 lekë/ dynym.
   d. Tarifë ujitje me sistem të mbyllur tubacioni në vlerën 50 lekë/ dynym.

e. Tarifë ujitje me pompat private kur merr ujë nga kanali ujitës I fshatit në vlerën 100 lekë/ dynym.

2. Këto tarifa aplikohen në Njësitë Administrative.

Neni 47
Struktura për mbledhjen e tarifës së hapësirës publike

Strukturat e caktuara për vjeljen e kësaj Tarife janë:

1. Drejtoria e Koordinimit me Njësitë Administrative, Njësitë Administrative dhe Lagjjet në bashkëpunim me strukturat e Agjencia e Shërbimeve Publike.
2. Në ato fshatra ku Bashkia Elbasan nuk kryen shërbimin tarifa është 0 lekë. Mungesa e shërbimit vërtetohet me anë të një vërtetimi nga Agjencia e Shërbimeve Publike.

KREU XVII

TARIFAT E DREJTORISË SË PËRGJITHËSHME E SHËRBIMEVE OPERACIONALE

Neni 48
Baza dhe niveli I tarifës

1. Kategoritë e tarifave janë:
- **a.** Tarifë aplikimi për çertifikatë përdorimi.
- **b.** Tarifë e hartimit të PDV për sipërfaqjen e pronës (gjatë lejes së ndërtimit).
- **c.** Tarifë aplikimi për leje zhvillimi.
- **d.** Tarifë aplikimi për leje ndërtimi.
- **e.** Tarifë aplikimi për deklarata paraprake të kryerjes së punimeve.
- **f.** Tarifë për çertifikim rilievi.
- **g.** Tarifë plan rilevimi.
- **h.** Tarifë fasade.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

i. Tarifë për dhënie dokumenta nga arkiva DPTP-së.
j. Tarifa kantieri brenda pronës.
k. Tarifë për depozitimin e mbetjeve të ngurta

2. Niveli I tarifave vendore të DPZHT-së sipas kategorive dhe nënkategorive është sipas aneksit nr. 8, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Faturat e lëshuara brënda vitit buxhetor për tarifat për aplikimet për deklaratë paraprake për punime në sistemin e-leje është e vlefshme deri në 3 aplikime kur dy aplikimet e para janë refuzuar për mungesë dokumentacioni ose gabime materiale në shkresat e ngarkuara. Faturat e lëshuara brënda vitit buxhetor për tarifat për aplikimet për leje zhvillimi ose ndërtimi në sistemin e-leje është e vlefshme deri në 2 aplikime kur aplikimi I parë është refuzuar për mungesë dokumentacioni ose gabime materiale në shkresat e ngarkuara

Neni 49

Struktura për mbledhjen e tarifave Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Operacionale

1. Struktura e caktuar për vjeljen e këtyre tarifave sipas Aneksit 8 është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Azhornimit Topografik në Bashkinë Elbasan.
2. Për pikën k. të nenit 48 të këtij vendimi, për tarifën e depozitimin të mbetjeve të ngurta në zbatim të V.K.B-së nr.67, datë 23.05.2019 "*Mbi miratimin e tarifës që duhet të paguajnë subjektet dhe individët, për depozitimin e mbetjeve të ngurta*" përgjegjëse për vjeljen e saj do të jetë Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, D.T.T.V.M.A, Drejtoria e Prokurimeve Publike dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit i Bashkisë Elbasan dhe Inspektoriati i Mjedisit si më poshtë:

   a. Për aplikimet për leje ndërtimi tarifa për depozitimin e mbetjeve të ngurta do të përllogaritet me vlerën 250 lekë / m^3 sipas zërave të preventivit të ngarkuar në sistemin e-leje përpara miratimit të lejes në fazën e përllogaritjes së taksave dhe tarifave. Drejtoria përgjegjëse për vjeljen e saj do jetë D.P.Zh.T
   b. Për aplikimet për deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve me miratimin e saj do të faturohet nga D.P.Zh.T edhe tarifa për depozitimin e mbetjeve të ngurta me vlerë fikse 5000 lekë për subjektet zhvilluese të cilët janë të detyruar që të paguajnë me marrjen e njoftimit të miratimit të deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve. Një kopje e mandate të pagesës do të dorëzohet nga zhvilluesi pranë IMT-së Elbasan brënda 7 ditëve kalendarike nga njoftimi i miratimit të deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve . Nëse nuk është paguar brënda afatit të përcaktuar në këtë vendim është Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Elbasan përgjegjës për kontrollin dhe vjeljen e kësaj tarife.
   c. Për vetdeklarimet sipas formularit të Bashkisë Elbasan, për punimet e parashikuara në nenin 6 të VKM-së nr.408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" e ndryshuar, vetdeklaruesit do të pajisen me formularin përkatës vetëm pasi të dorëzojnë pranë Rajonit ose Njësisë Administrative të Bashkisë Elbasan tarifën për depozitimin e mbetjeve të ngurta me vlerën 3000 lekë

sipas faturës të lëshuar sipas rasteve të parashikuara:

1. Sipas faturës të lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku do kryhen punimet vetëm pas pagesës të mandatit së tarifës për depozitimin e mbetjeve të ngurta nga subjekti vetdeklarues në filialet e Postës Shqiptare dega Elbasan ose një Bankë të nivelit të Dytë.

2. faturës të lëshuar nga D.T.T.V.M.A për punimet që propozohen të kryhen në Rajonet e Bashkisë Elbasan përkatëse vetëm pas pagesës dhe dorëzimit të mandatit të tarifës për depozitimin e mbetjeve të ngurta nga subjekti vetdeklarues në filialet e Postës Shqiptare dega Elbasan ose një Bankë të nivelit të Dytë.

d. Për ndërtimit ose veprave civile inxhinierike publike të Bashkisë Elbasan të realizuara me procedurat e prokurimit, Drejtoria e Prokurimeve Publike, para lidhjes së Kontratës Publike për Punë do të njoftojë operatorin fitues për pagesën e tarifës për depozitimin e mbetjeve të ngurta dhe D.T.T.V.M.A për përllogaritje e saj, në zbatim të këtij vendimi. Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes se të Ardhurave, Bashkia Elbasan do të llogarisë këtë tarifë me vlerën 250 lekë / m^3 sipas zërave të preventivit të operatorit ekonomik të shpallur fitues e cila do të paguhet brënda 5 ditëve kalenderikë nga njoftimi për lidhjen e kontratë kontrata publike me operatorin ekonomik.
e. Subjekte të tjera (fizike ose juridike) që gjenerojnë mbetje inerte si pasojë e objektit të veprimtarisë që ushtrojnë janë të detyruar të bëjnë vetdeklarimin mbi sasinë e mbetjeve inerte të gjeneruara dhe të pajisen me faturën për pagesën e tarifës së mbetjeve inerte pranë Drejtorisë së Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, Bashkia Elbasan. Inspektoriati i Mjedisit Elbasan ka detyrë monitorimin dhe kontrollin e vjeljes së kësaj tarife.
f. Në çdo rast pagesa e tarifës për depozitimin e mbetjeve të ngurta nuk heq detyrimin e zhvilluesit ose operatorit ekonomik që mbetjet ndërtimore, ti depozitojë në jug të fshatit Vidhas, Njësia Adminitrative Papër, në truall shtet, me nr. pasurie 52/26 me kapacitet maksimal 1.000.000 ton/vit nën juridiksionin e Bashkisë Elbasan në zbatim të V.K.B-së Nr.66, datë 23.5.2019.

Përfaqësuesi të subjekteve fizik/juridik apo individi do të paraqesë mandatin e pagesës së kryer për tarifën e mbetjeve të ngurta në momentin e depozitimit të mbetjeve të ngurta në vendin e përcaktuar.

KREU XVIII
TARIFA TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË

Neni 50
Tarifa për Qendrën e Artit

Qendra e Artit, aplikon këto tarifa:

a. Për përdorimin e sallës së teatrit "Skampa" për qëllime artistike, është 15,000 lekë/ ditë.
b. Për përdorimin e sallës së teatrit "Skampa" për qëllime artistike dhe bamiresie per te cilat nuk shiten bileta nga subjekti organizatore është 10 000 leke/ditë.

c. Për përdorimin e sallës së teatrit "Skampa" për qëllime jo artistike, është 15,000 lekë/ orë.
d. Për përdorimin e sallës së teatrit të kukullave 5,000 lekë/ ditë.
e. Për shfaqje në teatër muzike varion 200 deri në 1,000 lekë/ bileta. Për studentët, invalidët dhe pensionistët kjo tarifë është sa 50 % e vlerës.
f. Për shfaqje në teatrin kukullave është 100 lekë/ bileta.
g. Për foni dhe ndriçim është 15, 000 deri në 50,000 lekë/ aktivitet.

Neni 51
Tarifa për Qendrën e Trashëgimisë Kulturore

Qendra e Trashëgimisë Kulturore, aplikon këto tarifa:

a. Për hyrje në vende muzeale për të rritur është 200 lekë/ bileta.
b. Për hyrje në vende muzeale për nxënës dhe studentë është 50 lekë/ bileta.
c. Për dhënie me qira të kostumeve tradicionale është 1,000 lekë/ kostum/ ditë.

Neni 52
Tarifa për Klubin Shumësportësh

Klubi Shumësportësh, aplikon këto tarifa:

1. Për përdorim salle të pallatit të sportit
   a. Ndeshje 10 000 lek/ora
   b. Stervitje 4 000 lek /ora
   c. Bamiresi 0 lek/ora
   d. Panair, koncerte, takime elektorale etj. 100 000 lekë

2. Për përdorim e komleksit sportive "Shefqet Lamcja"
   a. Ndeshje 5000 leke
   b. Stervitje 3000 leke

Neni 53
Tarifa për Qendrën e Ekonomike të Arsimit

Qendra Ekonomike e Arsimit, aplikon këto tarifa:

a. Për ushqim në çerdhe është 160 lekë/ ditë.
b. Për ushqim në kopësht është 160 lekë/ ditë.



Neni 54
Struktura për mbledhjen e tarifave të institucioneve të varësisë

1. Struktura të caktuara për mbledhjen e tarifave të institucioneve të varësisë janë përkatësisht:

a. Qendra e Artit për tarifat e nenit 50,
b. Qendra e Trashëgimisë Kulturore për tarifat e nenit 51,
c. Klubi Shumësportësh për tarifat e nenit 52,
d. Qendra Ekonomike e Arsimit për tarifat e nenit 53.

2.Tarifat e parashikuara në nenet 50/d, 50/f, 52/a dhe 52/b miratohen nga bordi artistik.

KREU XIX

TARIFA E SHËRBIMIT FUNERAL

Neni 55
Baza, niveli I tarifës dhe struktuara e ngarkuar për vjeljen e detyrimit

1. Tarifat e shërbimit funeral përcaktohen në **Aneksin nr. 10**, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Agjencia e Shërbimeve Publike.

KREU XX

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

TARIFAT VENDORE PËR SHFRYTËZIMIN E TRUALLIT PUBLIK PËR TUBACIONET, KABLLOT TELEFONIKE DHE FIBRËN OPTIKE

Neni 56
Kategoritë për shfrytëzim të truallit publik për tubacione të ujrave të bardha e të zeza, kabllot telefonike, fiber optike (nëntokësor dhe ajror)

1. Tarifë për shfrytëzim të truallit publik për tubacioneve të ujrave të bardha e të zeza për:

   a. tubacion uji i pijshëm, diametri > 200÷600 mm është 20 lekë/ml/vit,
   b. tubacion uji i pijshëm, diametri > 80÷200 mm është 10 lekë/ml/vit,
   c. tubacion uji i pijshëm, diametri diametri ÷ 80 mm është 5 lekë/ml/vit,
   d. tubacion i ujrave të zeza, diametri < 200 mm është 2 lekë/ml/vit,
   e. tubacion i ujrave të zeza, diametri > 200÷600 mm është 3 lekë/ml/vit,
   f. tubacion i ujrave të zeza, diametri > 600 mm është 5 lekë/ml/vit.

2. Tarifë për shfrytëzim të truallit publik për kabllot telefonike, fiber optike (nëntokësor dhe ajror) është 5 lekë/ml/vit.

3. Tarifa për prishje asfalti nga Ndërmarrja "Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a.", Ndërmarrja [redacted][5] Ndërmarrja Elektrike dhe qytetarët, do të jetë sipas preventivit të depozituar pranë Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Projekteve.

4. Për rrjetet kabllore telefonike, ndërlidhëse apo të shërbimit informatik, tarifat vendore vendosen vetëm në rastin kur subjektet përdorin rrjetet infrastrukturore, si: tubacione, kanale etj., të cilat janë ndërtuar dhe janë në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe për përdorimin e hapsirës publike.

5. Strukturat e caktuara për vjeljen e këtyre tarifave janë:

   a. Drejtoria e Shërbimit të Territorit Urban,
   b. Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes se të Ardhurave.

KREU XXI
TARIFAT VENDORE PËR PYJET DHE KULLOTAT

Neni 57
Kategoritë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · BASHKIA ELBASAN

1. Tarifa për shërbimet profesionale që kryhen në fondin pyjor privat është 500 lekë/ shërbim.
2. Tarifa për shitjen e vërtetimit të transportit, për lëvizjen e produkteve drusore dhe jodrusore pyjore është 200 lekë/ 34mir.
3. Tarifa për vërtetim është 200 lekë/ 34mir.
4. Tarifë për prerje druri për nevoja familjare në pyjet vendore të miratuara në Njësitë Administrative është 500 lekë/ m^3. Për të gjithë tarifat e tjetra që aplikohen në sektorin pyjeve dhe të kullotave do të zbatohen tarifat sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarfave në sektorin e pyjeve dhe kullotave" ndryshuar me Vendimin ë Këshillit të Ministrave nr. 1064, datë 22.12.2010 'Për disa ndryshime në vendimin e nr. 391, datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarfave në sektorin e pyjeve dhe kullotave" si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 438, datë 08.06.2016 "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jo pyjore".

Neni 58
Struktura për mbledhjen e tarifave vendore për pyjet dhe kullotat

Strukturat e caktuara për mbledhjen e këtyre tarifave janë:

a. Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisit (Sektori i Pyjeve dhe Kullotave), për tarifat e pikave 1,2,3.
b. Njësitë Administrative dhe Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisit (Sektori i Pyjeve dhe Kullotave) për pikën 4.

KREU XXII
TARIFAT VENDORE PËR SEKTORIN E BUJQËSISË

Neni 59
Kategoritë

1. Tarifë për vërtetim toke në pronësi ose në përdorim dhe kategoria e saj është 100 lekë/copë.
2. Tarifë për ushtrim aktiviteti bujqësor e blegtoral është 100 lekë/copë.
3. Tarifë për kërkesë për ndryshim të bonitetit të tokave është 100 lekë/copë.
4. Tarifë për kërkesë për aplikim për subvencione bujqësore e blektorale është 100 lekë/copë.
5. Tarifa për përdorimin e kullotave dhe livadheve për kullotje do të jetë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 632, datë 11.06.2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje", me ndryshimet që mund të pësojë ky vendim.

Neni 60
Struktura për mbledhjen e tarifave vendore për sektorin e bujqësisë

Strukturat e caktuara për mbledhjen e këtyre tarifave janë:

3. Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisit (Sektori i Bujqësisë)
4. Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan.

KREU XXIII
TARIFAT E SHËRBIMEVE TË SMZSH

Neni 61
Baza, niveli I tarifës dhe struktuara e ngarkuar për vjeljen e detyrimit

1. Tarifat e shërbimeve që kryhen nga struktura e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin përcaktohen në aneksin nr. 11, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (M.Z.SH.) rregullohet nga ligji nr. 152/2015 "Për Shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".

3. Tarifat në lidhje me shërbimet e MZSH-së përcaktohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 27.06.2002 "Për tarifat e shërbimeve që kryen Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 707, datë 12.10.2016 "Për tarifën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, të ofruar nga bashkitë e pajisura me stacione të këtij shërbimi, në territorin e bashkive që nuk kanë stacione të shërbimit të MZSH-së", si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 9.11.2016 "Për mënyrën dhe kriteret e llogaritjes së shpenzimeve për shuarjen e zjarreve në objektet e siguruara nga zjarri dhe administrimin e përdorimin e të ardhurave, për llogari të shërbimit vendor MZSH-së".
5. Struktura e caktuar për vjeljen e këtyre tarifave është Drejtoria Vendore e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, pranë Bashkisë Elbasan.

KREU XXIV
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 62
Strukturat e ngarkuara për zbatimin e këtij vendimi

1. Ngarkohet Kryetari I Bashkisë Elbasan të miratojë aktet e nevojshme dhe të lidhë marrëveshjet sipas parashikimeve të këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet administrate e Bashkise Elbasan.

Neni 63
Shfuqizime

1. Vendimi nr. 164, 36mir 27.11.2020 I Këshillit Bashkiak "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinw Elbasan", I ndryshuar, shfuqizohet.
2. Çdo vendim apo parashikim tjetër që bie ndesh me këtë vendim, shfuqizohet.

Aneksi nr. 1

Nr.	Kategoritë e tokës bujqësore	lekë /ha/vit.
1.	Klasa I	4,200
2.	Klasa II	3,500
3.	Klasa III	2,800
4.	Klasa IV	2,300
5.	Klasa V	1,900
6.	Klasa VI	1,600
7.	Klasa VII	1,400

Aneksi nr. 2

Nr.	Kategoritë e ndërtesave	Niveli tregues I taksës (Qyteti Elbasan) lekë/m^2	Njesitë Administrative lekë/m^2
1.	Ndërtesa banimi.	300	100
2.	Ndërtesa për tregti e shërbime.	700	300
3.	Ndërtesa të tjera.	500	200

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · BASHKIA ELBASAN

Aneksi nr. 3

	Kategoritë	Njësia matëse	Niveli I taksës Qyteti	Niveli I taksës Njësitë administrative
I	**Taksë tabele për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, 37mir37a territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet 37mir dhe/ose aktiviteti I biznesit).**			
A	**deri në 2 m²**	lekë/ m² /vit	0	0
b	**mbi 2 m² deri 10 m²**			
	e thjeshtë (pa ndriçim).	Lekë/ m² /vit	10,000	10,000
	me ndriçim të thjeshtë.	Lekë/ m² /vit	15,000	15,000
	elektronike.	Lekë/ m² /vit	20,000	20,000
c	**mbi 10 m² deri 20 m²**			
	e thjeshtë (pa ndriçim).	Lekë/ m² /vit	8,500	8,500
	me ndriçim të thjeshtë.	Lekë/ m² /vit	12,750	12,750
	elektronike.	Lekë/ m²/vit	17,000	17,000
ç	**mbi 20 m² deri 40 m²**			
	e thjeshtë (pa ndriçim).	Lekë/ m² /vit	5,500	5,500
	me ndriçim të thjeshtë.	Lekë/ m² /vit	8,250	8,250
	elektronike.	Lekë/ m²/vit	11,000	11,000
d	**mbi 40 m²**			
	e thjeshtë (pa ndriçim).	Lekë/ m² /vit	4,000	4,000
	me ndriçim të thjeshtë.	Lekë/ m² /vit	6,000	6,000
	elektronike.	Lekë/ m² /vit	8,000	8,000
II	**Taksë tabele për qëllime identifikimi jasbtë territorit, ku zhvillobet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim.**			
	Tabela identifikuese.	Lekë/ m² /vit	120	120
III	**Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme, e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m²**			
	e thjeshtë (me/pa ndriçim).	Lekë/ m² /vit	22,500	22,500
	elektronike.	Lekë/ m² /vit	45,000	45,000
IV	**Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.**			

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

	Të të gjitha llojeve dhe përmasave.	Lekë/ m^2 /ditë	1,000	1,000

Aneksi 4

Nr.	Lloji i tarifës	Njësia	Niveli i tarifës
1.	**Tarifë pastrimi:**		
a	Familje.	Lekë / vit	1,375
b	Biznesi i vogël (pa TVSH).	Lekë / vit	8,800
c	Biznesi i vogël (me TVSH).	Lekë / vit	18,750
ç	Biznes i vogel Transport udhetaresh me taksi, 8+1 dhe transport mallrash me kapacitet deri 3.5 ton.	Lekë / vit	15,000
d	Biznes i vogel transport mallrash me kapacitet mbi 3.5 ton	Lekë / vit	25,000
dh	Restorant – biznes I vogël.	Lekë / vit	25,000
e	Restorant – biznes I madh.	Lekë / vit	50,000
ë	Biznesi i madh (tregti, shërbim dhe transport)	Lekë / vit	50,000
f	Biznesi i madh (njësi prodhimi).	Lekë / vit	68,750
g	Biznes i madh Firmë ndërtimi (pas lejes së përdorimit).	Lekë / vit	50,000
gj	Biznes i madh Firmë ndërtimi.	Lekë / vit	75,000
h	Biznes VIP per çdo vendodhje	Lekë / vit	80,000
i	Institucione shtetërore.	Lekë / vit	37,500
j	OJF	Lekë / vit	3,750
2.	**Tarifa e gjelbërimit:**		
a	Familje në qytet.	Lekë / vit	625
b	Biznesi i vogël (pa TVSH)	Lekë / vit	1,250
c	Biznesi i vogël (me TVSH).	Lekë / vit	1,800
ç	Biznes i vogel Transport udhetaresh me taksi, 8+1 dhe transport mallrash me kapacitet deri 3.5 ton.	Lekë / vit	1,800

d	Biznes i vogel transport mallrash me kapacitet mbi 3.5 ton	Lekë / vit	1,800
dh	Restorant – biznes I vogël.	Lekë / vit	1,250
e	Restorant – biznes I madh.	Lekë / vit	7,500
ë	Biznesi i madh (tregti, shërbim dhe transport)	Lekë / vit	7,500
f	Biznesi i madh (njësi prodhimi).	Lekë / vit	7,500
g	Biznes i madh Firmë ndërtimi.	Lekë / vit	7,500
gj	Biznes VIP per çdo vendodhje	Lekë / vit	50,000
i	Institucione shtetërore.	Lekë / vit	7,500
j	OJF	Lekë / vit	1,250
3.	**Tarifa e ndriçimit:**		
a	Familje	lekë / vit	1,500
b	Biznesi i vogël (pa TVSH)	lekë / vit	1,500
c	Biznesi i vogël (me TVSH).	Lekë / vit	1,800
ç	Biznes i vogel Transport udhetaresh me taksi, 8+1 dhe transport mallrash me kapacitet deri 3.5 ton.	lekë / vit	1,800
d	Biznes i vogel transport mallrash me kapacitet mbi 3.5 ton	lekë / vit	1,800
dh	Restorant – biznes i vogël.	lekë / vit	1,800
e	Restorant – biznes i madh.	lekë / vit	9,000
ë	Biznesi I madh (tregti, shërbim dhe transport)	lekë / vit	9,000
f	Biznesi i madh (njësi prodhimi).	lekë / vit	9,000
g	Biznes i madh Firmë ndërtimi.		9,000
gj	Institucione.	Lekë / vit	7,500
h	Biznesi VIP per çdo vendodhje	lekë / vit	50,000
j	OJF	lekë / vit	1,500
4.	**Tarifë shërbimi në tregje:**		
a	Bagëti e imët në tregje publike.	lekë / krerë	50
b	Bagëti e trashë në tregje publike.	lekë / krerë	100
c	Fruta - perime në merkato dhe në tregjet e Njësive	lekë / 1.3 m^2 / ditë	50

	Administrative.		
ç	Fruta - perime në rrugë.	lekë / 1.3 m^2 / ditë	100
d	Artikuj industrialë në rrugë.	lekë / 1.3 m^2 / ditë	100
dh	Autorizim për shitje fruta- perime në rrugë.	lekë / 1.3 m^2 /muaj	2,500
5.	**Tarifë për zgjatje orari:**		
a	"Non-Stop" për një natë.	lekë /ditë	10,000
b	Deri në orën 24^{00}.	lekë / vit	20,000
c	"Non-Stop", stacionet e karburanteve, lokale dasmash, etj.	lekë / vit	35,000
6.	**Tarifë për vërtetim**	lekë/vërtetim	100
7.	**Tarifë për mirëmbajtjen e infrastrukturës në njësitë administrative**	lekë / vit	500

Aneksi 5

Nr.	Lloji i Tarifës	Niveli tregues
1.	Tarifa për zënien e hapësirës publike për tregti brenda Zonës A.	360 lekë m^2/ muaj
2.	Tarifa për zënien e hapësirës publike për tregti brenda Zonës B.	220 lekë m^2/ muaj
3.	Tarifa për zënien e hapësirës publike për tregti brenda Zonës C.	100 lekë m^2/ muaj
4	Tarifa për zënien e hapësirës publike për tregti në Njësitë Administrative	50 lekë m^2/ muaj
5.	Për personat dhe shoqëritë që shesin automjete në hapësirë publike (1 automjet x 5m^2 x 100 lekë).	500 lekë/automjet/ditë
6.	Tarifë për zënien e hapësirës publike gjatë ndërtimit për objekt mbi 4 kate.	150.000 lekë/vit
7.	Tarifë për zënien e hapësirës publike gjatë ndërtimit për objekt nën 4 kate.	100.000 lekë/vit
8	Tarifë kantieri/ ndërtim çatie, muri rrethues apo shkallë	5,000 lekë/ vit
9.	Tarifë për instalimin e "strukturave për nevoja të çastit dhe të	100 lekë/m^2/muaj

	përkohshme"	
10	Tarifë për instalimin e "strukturave për nevoja të çastit dhe të përkohshme" në Njësitë Adıninistrative	50 lekë/m^2/muaj
11	Tarifë për zënien e hapësirës publike për kampingje, ngritje tendash, për trajlera, rulotë dhe mjetet të tjera me përdorim të përkohshëm.	100 lekë/automjet/ditë

Aneksi nr. 6

1	**Tarifë Parkimi**				
1-1	Tarifë orare parkimi.		lekë /ora		50
1-2	Tarifë vjetore parkimi.				
1-2a	Taksi 4+1.		lekë /vit		5,000
1-2b	Taksi 8+1.		lekë /vit		5,000
1-2c	Autovetura familjare.		lekë /vit		1,500
1-2d	Automjet transport i përzier deri 3.5 ton.		lekë /vit		2,500
1-2e	Kamion transport malli 3.5 deri 8 ton.		lekë /vit		4,000
1-2f	Kamion transport malli 8 deri 14 ton.		lekë /vit		5,500
1-2g	Kamion transport malli mbi 14 ton.		lekë /vit		6,500
1-2h	Autobus.		lekë /vit		9,000
1-3	Parkim i rezervuar në rrugë dhe sheshe për subjektet e liçensuara.				
	paketa/abonim	orari 07:00 deri më 23:00	ditë/vit	lekë/ditë	tarifa/lekë
	Kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel).		365	200	73,000
1-3 a	Tarifë rivendosje tabele parkim i rezervuar	lekë/ rivendosje			3,000
2	**Karroatreci**		lekë/ngarkesë		3,000
3	**Tarifë embleme për taksi**		lekë/mjet		500
4	**Leje qarkullimi në qytet për mjetet e rënda**				
4.1a	Leje ditore për mjetet me kapacitet 3.5 deri 8 ton.		lekë/ditë		100
4.2a	Leje ditore për mjetet me kapacitet 8 deri 14 ton.		lekë/ditë		200
4.3a	Leje ditore për mjetet me kapacitet mbi 14 ton.		lekë/ditë		300
4.1b	Leje 3 mujore për mjetet me kapacitet 3.5 deri 8 ton.		lekë/ 3 muaj		4,500
4.2b	Leje 3 mujore për mjetet me kapacitet 8 deri 14 ton.		lekë/ 3 muaj		6,000
4.3b	Leje 3 mujore për mjetet me kapacitet mbi 14 ton.		lekë/ 3 muaj		7,500

4.1c	Leje vjetore për mjetet me kapacitet 3.5 deri 8 ton.	lekë/ vjet	10,000
4.2c	Leje vjetore për mjetet me kapacitet 8 deri 14 ton.	lekë/ vit	15,000
4.3c	Leje vjetore për mjetet me kapacitet mbi 14 ton.	lekë/ vit	20,000
4.1d	Leje vjetore per mjetet me kapacitet deri ne 3.5 ton (ATP)	lekë/vit	5,000
5	Leje qyteti për karrocat.	lekë/vit	2,000

Aneksi nr. 7

Nr	Emërtimi	Njësia	Tarifa në lekë	Afati
A	**Transport udhëtaresh**			
1	Licensë për kryerjen e shërbimeve të rregullta qytetës të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit.	për linjë	80,000	10 vjeçar
1.a	Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve të rregullta qytetës.	për mjet	7,500	5 vjeçar
2	Licensë për kryerjen e shërbimeve të rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit.	për linjë	40,000	10 vjeçar
2.a	Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve të rregullta rrethqytetëse.	për mjet	7,500	5 vjeçar
3	Licensë për kryerjen e Shërbimevetë rregullta të specializuara, të udhëtarëve.	për linjë	20,000	5 vjeçar
3.a	Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve të rregullta specializuara, të udhëtarëve.	për mjet	7,500	5 vjeçar
4	Licensë për kryerjen e shërbimeve vajtje-ardhje (lavjerrës) të udhëtarëve.	për linjë	20,000	5 vjeçar
Nëpërmjet këtij plani krijohen rrugët e komunikimit dhe të shkëmbimit të informacionit të duhur, forcimi i vendimmarrjes dhe, nëpërmjet bashkërendimit, arrihet forcimi i kapaciteteve të përgjigjes në të gjitha fazat e ciklit të emergjencave civile. PVEC-ja, në thelb, është mjet bashkërendimi, i cili, nëse përdoret në mënyrë korrekte:

1. Do të shpëtojë jetë njerëzore dhe pasuri.
2. Do të rrisë ndikimin e kapaciteteve ekzistuese.
3. Do të sigurojë mjetet për kërkimin e burimeve dhe të ndihmës shtesë.

Në planin afatgjatë, qëllimi kryesor është ai i parandalimit e lehtësimit dhe PVEC-ja është rruga e nevojshme për t'u ndjekur në arritjen e këtij qëllimi. Sjellja së bashku që në kohë të qetë e të gjithë protagonistëve me synimin, krijimin e një tabloje dhe klime bashkëpunimi është mjaft e rëndësishme.
Kjo krijon mundësinë për dhënie përparësi çështjeve të veçanta dhe zgjidhjen e tyre në vijimësi në kohë dhe kushte për trajtimin e bashkërenduar, i cili është i nevojshëm për të kërkuar ndihmën kombëtare dhe ndërkombëtare shtesë.

- Të gjithë objektivat në PPECB do të jenë koherentë me objektivat e përgjithshëm.
- Plani reflekton ligjet dhe vendimet ekzistuese, të cilat, në këmbim, do ta forcojnë atë.
- Plani përfshin të dhëna, informacion nga të gjitha institucionet në mënyrë të përshtatshme..
- Bashkëpunimi dhe bashkërendimi përbëjnë bazën dhe elementet të cilat prekin planin në tërësi, për të rritur në maksimum ndikimin e të gjitha burimeve të disponueshme si dhe sigurimin e konsensusit.
- Qartësia e përgjegjësive, funksionet dhe detyrat themelore, si përgjegjësi dhe si vendimmarrje paraprake janë përfshirë në këtë plan.
- Plani inkurajon iniciativa dhe nuk shndërrohet në instrument ndalues për strukturat dhe njerëzit që duhet të veprojnë.
- Plani nuk është përfundimtar, por do të ketë përmirësime të vazhdueshme, në përputhje me ndryshimin e faktorëve të brendëshëm dhe të jashtëm.

Bashkia e Elbasanit është më e madhja në Qarkun e Elbasanit dhe ka një probabilitet relativisht të lartë të goditjes nga fatkeqësitë natyrore. Ajo renditet ndër bashkitë me risk të lartë ekonomik ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh.
Rreziqet nga fatkeqësitë natyrore për Bashkin e Elbasanit janë: gjeologjike (tërmete, rrëshqitje dheu, shkëmbinjsh); hidrometeorologjike (përmbytje, shira të rrëmbyer, thatësira, stuhi bore, orteqe apo bllokim nga bora, stuhi ere); bio-fizike (zjarre në pyje) ndërsa ato të shkaktuara nga njeriu konsistojnë në: shpërthim digash, përmbytje e fatkeqësi teknologjike.
Ai ndeshet gjithashtu me një numër problemesh mjedisore, të cilave u shtohet ekzistenca ende e zonave me rrezik të lartë për shkak të ndotjes (hot-spote).
Elbasani karakterizohet nga shkallë e lartë sizmiciteti. Nga statistikat ai ka pësuar po thuajse mesatarisht çdo vit një tërmet me magnitudë ≥ 6.5. Një pjese e teritorit të këtij Bashkie konsiderohet "e paqëndrueshme", objekt i rrëshqitjes së dherave.
Sistemi lumor në Bashkie e Elbasan paraqet riskun më të madh për përmbytjet. Ato ndodhin zakonisht gjatë periudhës nëntor-mars, në të cilën në Shqipëri bie rreth 80-85% sasisë vjetore të shirave.
Emergjencat Civile përbëjnë situata serioze, të papritur dhe zakonisht të rrezikshme (kryesisht vijnë nga fatkeqësitë dhe nënkuptojnë dukuritë e shkaktuar nga fuqitë e pakontrolluara natyrore dhe nga fuqi të tjera,) që rrezikojnë jetën apo shëndetin e njerëzve, të shtazëve si dhe pasurinë, shkaktojnë dëme në trashëgiminë e kulturës dhe të natyrës, si dhe në mjedis në atë masë që për kontroll dhe për mbizotërim është e nevojshme të përdoren masat, forcat dhe mjetet e posaçme.
Plani i Pergatitjes dhe Reagimit ndaj Emergjencave dhe Krizave për Bashkinë Elbasan është hartuar për të qenë një burim praktik dhe i përdorshëm për të gjitha fazat e ciklit të cdo ngjarje që përbën emergjencat e mundëshme, duke filluar nga parapërgatitja, përgjigja dhe duke vazhduar me fazën e rikthimit në gjendjen normale dhe lehtësimin e pasojave.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

QËLLIMI

Plani i Përgatitjes dhe Reagimit Ndaj Emergjencave dhe Krizave për Bashkin e Elbasanit është dokument rëndësishëm i hartuar në mbështetje të ligjit nr. 45/2019 " Për mbrojtjen civile" dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë lidhje të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë me emergjencat civile.
Ai synon:
Në parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga cdo dëmtim që prek popullatën, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga katastrofat natyrore.
Sigurimin e kushteve për institucionet shtetërore, publike dhe private në veprimtarinë ekonomike për popullatën për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës në një situatë emergjence me humbje sa më të vogla.
Garantimin e përdorimit të të gjitha burimeve të mundëshme që ndodhen në teritorin e Bashkisë Elbasan me qëllim sigurimin e rendit publik, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë lokalizimin e zonës (sektorit) në të cilën ka ndodhur emergjenca dhe lehtësimin e pasojave.

2. BAZA LIGJORE

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenet 170 e 174 adreson çështjet e emergjencave dhe fatkeqësive, aktet që nxirren dhe masat që merren në raste të tilla.
Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", Plani Kombëtar i Emergjencave Civile, miratuar me VKM. Nr. 835, datë 03.12.2004, Ligji Nr. 139/2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"*, VKM Nr. 329, datë 16.05.2012, *"Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"*, si dhe një numër ligjesh dhe vendimesh qeverie të tjera që adresojnë aspekte të veçanta të Reduktimit të Rrezikut të Fatkeqësive (RRF) dhe Mbrojtjes Civile (MC), "Kriteret për deklarimin e gjendjes së emergjencës", "Mbrojtja dhe shpëtimi nga zjarri", "Pjesëmarrja e qytetarëve në mbrojtjen civile" etj.
Ligji Nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile".
Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
Ligji Nr. 7978 datë 26.07.1995 "Për Forcat e Armatosura të Republikës se Shqiperisë".
Ligji Nr. 152/2015 datë 21.12.2015 "Për Shërbimin e Mbrotjes nga Zjarri dhe Shpetimin".
Ligji Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".
Ligji Nr. 107//2014 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit".
Ligji Nr. 73/2015 datë 09.07.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit".
VKM Nr. 893, datë 4.11.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit".
Ligji Nr. 183/2014 datë 4.11.2014 "për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, "Për inspektimin e ndërtimit", të ndryshuar.
Ligji nr. 8405 datë 17.09.1998 "Per Urbanistikën".
Ligji nr.7664 datë 21.01.1993 "Per Mbrojtjen e Mjedisit" dhe shtesa nr. 8364 date 02.07.1998.
Ligji nr. 8408 datë 25.09.1998 "Per Policine e Ndertimit".
Vendimi nr. 155 datë 01.04.1999 "Për mënyren e organizimit dhe lajmërimit te popullatës në rast të kushtrimit ajror".
VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".
VKM Nr. 206 datë 26.03.1998 "Per kriteret per pjesmarrjen e Shtetit ne perballimin e demeve ne raste fatkeqsish".

VKM Nr. 655 date 18.12.2002 "Për ngritjen dhe funksionimin e structures se sistemit kombëtar te Planifikimit dhe te Perballimit te Emergjencave Civile".
VKM Nr. 664 date 18.12.2002 "Per kriteret dhe procedurat e shpalljes se Emergjences Civile".
VKM Nr. 654 date 18.12.2002 "Per percaktimin e tarifave per perdorim te perkohshem nga organet shteterore, ne situate emergjente, te cdo mjeti privat".
VKM Nr. 531 date 01.08.2003 "Per organizimin, funksionimin, detyrat dhe pergjegjesite e sherbimit te Emergjencave Civile".
VKM Nr. 533 date 01.08.2003 "Për pjesmarrjen e shtetasve ne parandalimin dhe perballimin e Emergjencave Civile".
VKM Nr. 965, datë 02.12.2015 "Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e emergjencave civile dhe krizave".

2.1 LIDHJA ME PLANET E TJERA

PVEC-ja është dokument harmonizues, gjithëpërfshirës, i cili mbledh së bashku të gjitha institucionet që operojnë në territorin e Bashkisë si dhe strukturat kombëtare dhe ndërkombëtare në përgjigjen ndaj emergjencave civile.
Drejtoritë, strukturat lokale dhe institucione të ndryshme kanë hartuar dhe do të hartojnë planet e tyre të emergjencave civile. Planet specifike sektoriale kanë vlerë të veçantë dhe PVEC-ja nuk i zëvendëson ato, por i harmonizon dhe i sjell ato së bashku në një frymë bashkërendimi.
PPKECKB -ja është hartuar përmes konsultimeve dhe shkëmbimit të informacioneve me institucione të ndryshme, si rrjedhim, përfshin idetë dhe procedurat e planeve specifike, duke i lidhur ato me përgjigjen e planifikuar të institucioneve, të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën.
PPKECKB në Bashki, nuk i përjashton dhe as i zëvendëson planet e ministrive të linjës, Strukturave Rajonale të Qarkut, subjekteve të rëndësishme ekonomike shtetërore dhe joshtetërore, përkundrazi, i përfshin ato duke mos rënë ndesh, i stimulon dhe i mbështet ato.

2.2 NOCIONET BAZË

Emergjencë Civile: kuptohet një situatë e shkaktuar nga faktorë të ndryshëm natyrore, ekologjike, industrial, social, veprimtari terroriste, veprimtari ushtarake (në gjëndje lufte), të cilët sjellin dëme të menjëhershme, të rënda me pasoja për jetën dhe shëndetin e popullatës, të gjësë së gjallë, pasurisë kombëtare, pasurisë natyrore dhe mjedisin.
Emergjencë Civile Kombetare: kuptohet një situatë kritike urgjente e një natyre të përkohëshme që dëmton seriozisht jetën, shëndetin dhe sigurinë e shtetasve të Republikes së Shqipërisë, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, në një masë e natyrë të tillë që kalon mundësinë ose autoritetin e organeve të qeverisjes vendore për të përballuar atë ose kërcënon seriozisht mundësinë e Qeverisë së Republikes së Shqipërisë për të ruajtur sovranitetin, sigurinë dhe integritetin territorial të vendit.
Fatkeqësi natyrore: kuptohen tërmetet, përmbytjet, thatësirat atmosferike të tejzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, orteqet, erërat e forta, zjarret në pyje dhe në mjediset e banuara, sëmundjet infektive masive, pasojat e të cilave prekin popullatën, gjënë e gjallë, pronën, mjedisin, si dhe ngjarje të tjera të shkaktuara nga dukuri natyrore.
Fatkeqësi te tjera: kuptohen aksidentet rrugore, hekurudhore, detare, lumore, liqenore, ajrore, si dhe zjarret, shpërthimet, rrëzimet e digave, aksidentet bërthamore, ekologjike ose industriale dhe çdo lloj tjetër aksidenti të shkaktuar nga veprimtaria njerëzore, nga luftrat si dhe forma të tjera të ngjashme me to.
Fatkeqësi: kuptohet një ngjarje, pasojat e së cilës janë shkaktuar nga forca natyrore të pakontrolluara ose nga arsyet e tjera të parashikuara në ligjin "Për Mbrojtjen Civile", të cilat kërcënojnë ose dëmtojnë jetën dhe shëndetin e popullatës, të gjësë së gjallë, pasurinë, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin në një nivel

të tillë që kërkon marrjen e masave të veçanta dhe përdorimin e burimeve njerëzore e materiale teknike në shkallë Bashkie.

Masa mbrojtëse: kuptohen masat organizative, teknike dhe çdo masë tjeter për mbrojtjen e menjëherëshme individuale dhe kolektive të njerëzve, gjësë së gjallë, pasurisë, institucioneve, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, kundër pasojave të fatkeqsive natyrore ose të fatkeqsive të tjera. Të tilla janë masat që marrin komisionet e ngritura në shkallë Bashkie, Njësie Administrative si dhe komisionet e ngritura në çdo administratë shtetërore, për të menaxhuar llojet e emergjencave të mësipërme.

Operacione ndërhyrjeje: kuptohen veprimet e forcave dhe të mjeteve për shpëtimin e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë dhe të vlerave materiale (pronës) në një territor të prekur nga fatkeqsia si dhe sigurimi i kushteve për jetesë të popullatës së prekur. Të tilla janë planet operacionale që ndërmerren nga strukturat e ushtrisë, policisë, forcave speciale, SHMNZSH, OJF-të dhe institucionet e tjera shtetërore mbi bazën e detyrave të deleguara nga Prefektura drejtuesve të pushtetit lokal sipas ngjarjeve, dhe mbi bazën e kompetencave që parashikon ligji " Për Mbrojtjen Civile".

Parandalimi: kuptohet një kuadër masash që merren para ndodhjes së një ngjarjeje për shmangien ose për zvogëlimin e dëmeve që mund të vijnë nga ngjarja. Të tilla janë programet e planizuara të komisioneve përkatëse, komisionet ose grupet e studimeve të cilët programojnë masat konkrete për parandalimin e një ngjarjeje që mund të ndodhë.

Parashikimi: kuptohen veprimtaritë që kryhen për studimin dhe përcaktimin e shkaqeve të emergjencave, për përcaktimin e zonave, teritoreve dhe objekteve nga rreziqet e njejta. Të tilla janë grupet e specialisteve. inxhinierë e teknikë të fushave të ndryshme, që veprojnë në kuadrin e komisioneve, parapërgatisin studime ku parashikojnë shkaqet e fryrjes së lumenjve, përrenjve dhe daljes nga shtrati i tyre, shkarjet e dherave, etj.

Planizim i përballimit të emergjencave civile: kuptohet përgatitja e autoriteteve publike, e institucioneve dhe e organeve të qeverisjes vendore e qëndrore, e personave juridike, publike ose private, e organizatave publike dhe e populatës për një emergjence civile, si dhe për rastet e një fatkeqsie natyrore, duke përcaktuar marrjen e masave për parandalimin dhe për riaftësimin e gjendjes së shkaktuar nga veprimi i rrethanave emergjente, të tilla si:

Masat që merr komisioni i Bashkisë, planet e masave dhe programet e masave të hartuara në fillim të vitit në bashkëveprim me strukturat e ushtrisë, policisë, forcat speciale, personat juridikë e fizikë, institucionet shtetërore dhe private, OJF-të vendase dhe të huaja, që ushtrojnë aktivitet nën juridiksionin e tyre. Stërvitje të planizuara ku të parashikohen situata konkrete, si dhe të koordinohen veprimet e strukturave për menaxhimin, përballimin dhe planizimin e situatave emergjente.

Riaftësimi: kuptohen masat dhe veprimet që kryhen për rikthimin e gjëndjes në mëparshme në rajonin (teritorin) e prekur nga fatkeqsia. Të tilla janë masat e marra nga çdo komision lokal ose institucion, me të gjitha resurset që ka në juridiksionin e tij, për të rikthyer në gjëndjen e mëparshme territore si fusha e aviacionit apo objekteve social-kulturore, që janë përdorur për strehimin e refugjatëve, të sipërfaqes së tokave, objekteve apo shtëpive që kanë qenë të përmbytura dhe rikthimin e popullsisë në qendrat e banuara.

Rrezik: kuptohet një gjendje serioze, reale dhe e menjëherëshme që rrezikon jetën e njerëzve, të gjësë së gjallë, dëmtimin e pronës publike dhe private, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, e cila mund të shkaktohet nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësi të tjera.

Shërbim të emergjencave civile: kuptohet shërbimi i bashkërenduar i Policisë së Shtetit dhe i të gjitha policive të tjera, ushtrisë, forcave speciale, Shërbimit të Mbrojtjes nga zjarri dhe Shpëtimit dhe i Urgjencës Mjeksore. Të tilla janë masat e marra dhe të planizuara më parë në forca dhe mjete nga strukturat e ushtrisë, policisë shëndetsisë dhe institucioneve të tjera, për ti shërbyer komunitetit në kuadrin e menaxhimit të situatave emergjente që mund të ndodhin në territorin Bashkisë.

Vlerësimi i rrezikut: kuptohet analiza cilësore dhe sasiore e natyrës dhe e rrethanave të tjera për ngjarjet e pritshme nga fatkeqsitë natyrore ose nga fatkeqsi të tjera, mbi bazën e të dhënave empirike (historike) të viteve të mëparshme. Të tilla janë planet dhe preventivat e hartuara, të studiuara dhe të planifikuara

nga grupe specialistësh e financierësh, ku parashikohet saktë numri i forcave, i mjeteve dhe vlerësimi në vlerë monetare që duhet të kërkohet për ti vënë në dispozicion Bashkisë për të përballuar situatën emergjente që mund të krijohet, me fonde të akorduara nga Qeveria dhe nga buxhetet e Bashkisë mbi bazën e propozimeve të bëra nga ky grup specialistësh. Për këtë kërkohet që të bëhen studime paraprake, duke analizuar situatat që kanë ndodhur, duke parashikuar situatat që mund të ndodhin dhe mbi bazën e tyre duhen përllogaritur shpenzimet përkatëse të planifikuara.

3. ANALIZA E PËRGJITHSHME E SITUATËS DHE PËRSHKRIMI I GJENDJES

3.1. NDARJA ADMINISTRATIVE.

Bashkia e Elbasanit është një nga 7 bashkitë e Qarkut të Elbasanit, ka një sipërfaqje prej 872.03 **km²** dhe ka një popullsi prej 214.361 banorë. Në qëndër të Bashkisë së Elbasanit ndodhet qyteti i Elbasanit. Bashkia e Elbasanit kufizohet:

- në veri me Qarkun e Tiranës
- në lindje me Bashkinë e Librazhdit
- në jug me Bashkinë e Gramshit
- në perëndim me Bashkinë e Cerrikut e të Peqinit

Në përberjen administrative Bashkia e Elbasanit ka **6 Lagje në qytet, 12 Njësi Administrative me 116 fshatra.**

Ndarja Administrative

Lagjet/ Njësitë Administrative	Banorë	Qëndra Kryesore	Lagjja ose Fshatrat
Lagjja Nr. 1	23238	L. Luigj Gurakuqi	Kongresi i Elbasanit, Luigj Gurakuqi, Beqir Dardha, Emin Matraxhiu
Lagjja Nr. 2	23261	L. Brig. 17 Sulmuese	Qemal Stafa, Brigada 17 Sulmuese, Çlirimi, Sul Papri, Shënkoll
Lagjja Nr. 3	28043	L. 28 Nëntori	Skëndërbej, Dyli Haxhire, 28 Nëntori, Syrja Dylgjeri
Lagjja Nr. 4	22180	L. Aqif Pasha	Vullnetari, Partizani, Aqif Pasha, Kala, Visarion Xhuvani
Lagjja Nr. 5	13721	L. 11 Nëntori	11 Nentori, Haxhias
Lagjja Nr. 6	21306	L. 5 Maj	5 Maj
Lagjet Total	**131749**		
Gracen	2340	Gracen	9
Papër	9444	Papër	13
Bradashesh	13732	Bradashesh	17
Gjergjan	8136	Gjergjan	7
Shirgjan	10896	Shirgjan	7
Tregan	4602	Tregan	12
Zavalinë	1422	Zavalinë	6
Gjinar	4892	Gjinar	11
Shushicë	11667	Shushice	9
Labinot Fushë	7040	Labinot Fushë	6

Labinot Mal	5617	Qafë	10
Funar	2824	Branesh	9
Njësitë Administrative	**82612**		
Bashkia Elbasan	**214361**		

Bashkia e Elbasanit ka në përbërje te saj 6 Lagje në qytet dhe 12 Njësi Administrative në zonat rurale që janë: Bradashesh, Gracen, Funar, Gjinar, Zavalinë, Gjergjan, Labinot Mal, Labinot Fushë, Papër, Shirgjan, Shushicë e Tregan të cilat në total kanë 116 fshatra.

Më poshtë po paraqesim hartën e Bashkisë Elbasan me ndarjen në Njësi Administrative.



3.2 SHTRIRJA GJEOGRAFIKE, RELIEVI, KLIMA, HIDROLOGJIA NË BASHKINË E ELBASANIT

Bashkia e Elbasanit është një nga 7 bashkitë e Qarkut të Elbasanit dhe ka një sipërfaqje prej 872.03 km², ka një popullsi prej 214361 banorë. Në qendër të Bashkisë së Elbasanit ndodhet qyteti i Elbasanit. Bashkia është e dominuar nga lugina e Shkumbinit e cila e pështkon nga lindja në perëndim.
Shtrihet në fushën me të njejtin emër, në krahun e djathtë të rrjedhës së mesme të lumit "Shkumbin" në lartësinë 120m mbi nivelin e detit. Është terren fushor, kodrinor dhe pjesërisht malor.

Lartësia mesatare është **440 m**. Maja më e lartë është mali i Jeronishtit (**1883 m**). Malet ndodhen në verilindje, lindje dhe juglindje (si Labinot dhe Shpati). Kodrat ndodhen në veriperëndim, perëndim dhe jug, si kodrat e Krabës dhe Llixhës. Fushat ndodhen në pjesën qëndrore, si fusha e Elbasanit.
Relievi është kryesisht malor ku **38%** të tij e zënë malet **28%** fushat dhe **34%** kodrat. Bashkia e Elbasanit përshkohet nga lumi Shkumbin dhe përrejtë e Zaranikës, Manazderes, Kushës, Shushicës, etj.
Gjithashtu është lehtësisht i arritshëm nga të gjithë qytetet. Elbasani është 34 km larg nga Tirana, 81 km larg nga Durresi, 124 km larg nga Saranda dhe 88 km nga Pogradeci.
Klima e Bashkisë së Elbasanit karakterizohet nga një klimë mesdhetare, me dimër të butë dhe verë të nxehtë. Reshjet bien kryesisht në stinën e dimrit dhe të vjeshtës me një mesatare prej **1490 mm** në vit. Temperatura mesatare vjetore është 15.4°C.
Klima e përshtatshme favorizon një botë bimore dhe shtazore të pasur. Kultivohen shumë bimë mjeksore dhe etero-vajore si rozmarinë, dëllenjë, sherebel etj.
Pyjet zënë një sipërfaqe të konsiderueshme, sidomos pyjet e ulëta dhe shkurret. Në gjithë territorin rriten kafshë të buta e të egra. Nga kafshët e buta që mbarështohen janë gjedhë, dhen, kuaj, shpendë. Tepër e zhvilluar është rritja e bletëve, e përhapur në zona të veçanta. Nga kafshët e egra janë dhelpra, ujku, kunadhja, macja e egër, nuselalja, ketri, lepuri i egër, etj. Në liqene e lumenj rritet qefulli, mustaku, etj.
Prerjet e pyjeve pa kriter, ndotja e ajritdhe ujit janë faktorë që kanë ndikuar negativisht në zhvillimin e florës dhe faunës.
Gjatë viteve në vazhdim priten ndryshime të klimë kjo do të sjellë:

- Rritja e temperaturave
- Ulja e sasisë së reshjeve,
- Shtimi i fenomeneve ekstreme të motit

Rritja e temparaturave më të ndjeshme në sesonin e verës si dhe ulje të sasive mesatare vjetore të reshjeve.
Ulja e sasisë së reshjeve do të sjellë do të sjellë pakësimin e sasisë së ujit në rezervuarë ujë i cili shërben për vaditje.
Shtimi i fenomeneve ekstreme të motit do të vërehet me shtimin e ditëve të nxehta me temperatuarë mbi 35°C si dhe me reshje intensive të shiut që shkaktojnë përmbytje ose rrëshqitje të tokës. Ndryshimi i klimës dhe rritja e temperaturës kanë ndikim të drejtëpërdrejtë në uljen e prodhimit, shtimin e dëmtuesve në bujqësi dhe pyje (insekteve, parazitëve) etj.
Hidrologjia. Arteri kryesor hidrografik i Bashkisë është lumi "Shkumbin" me një gjatësi prej 39 km që rrjedh nga juglindja drejt perëndimit duke e ndarë Bashkinë e Elbasanit në dy pjesë afërsisht të barabarta. Ujërat sipërfaqësore zënë një sipërfaqe prej 22.7 km². Trupi ujor kryesor është Lumi Shkumbin. Gjatë rrugës merr shumë perrenj si: Gostima, Shushica, Zaranika, Kusha, Manazderja, etj.
Përmbytjet nga rrjedhat e lumenjve do të jenë një problem serioz dhe me i shpeshtë në dekadat e ardhshme. Shirat e rrëmbyeshme që sjellin vërshimin maksimal të lumenjve në kohë të shkurtër parashikohet të jenë problemi kryesor i përmbytjeve në pjesën fushore për këtë arsye duhet të merren masat në ndërtimin, përforcimin e pritave lumore dhe të pritave anësore (skarpatet e lumejve).
Në pasuritë hidrografike të Bashkisë së Elbasanit hyjnë edhe rezervuarët.
Në tabelën e mëposhtme po paraqesim rezervuarët që ndodhen në Bashkinë e Elbasanit dhe karakteristikat përkatëse për secilin prej tyre.

Nr	Emëri i rezervuarit dhe digës	Regjistruar ICOLD/ viti ndërt	Treguesit e digës			Vëll i rezervuar		Vendi ku ndodhet diga	
			Lartësia H--m	Gjatësia L-m	Vëllimi 1000m³	Projekt 1000 m³	Fakt 1000 m³	Fshati	Bashkia Nj.Adm.
1	Balëz					120		Balëz	Bradashesh
2	Funar aksi 1/1	1968	10	218		360		Funar	Funar
3	Funar aksi 2/2	po/1990	33	217	298	1150		Funar	"
4	Funar aksi 3/3	po/1988	30	219	316	2600		Funar	"

5	Funar aksi 4/4	po/1987	26	185	255	1400		Funar	"
6	Gracen					30		Gracen	Gracen
7	Griqan					45		Griqan	L.Mal
8	Kollogjesh	1976	12	176		184	160	Kollogjesh	Funar
9	Kryezjarr	1964	6	110		120	80	Kryezjarr	Shirgjan
10	Lukaxhi					65		Lukaxhi	L.Mal
11	Mlizë	1973	6.3	185		200	70	Mlizë	Shushicë
12	Mamël	1980	10	110		120	100	Mamël	Gracen
13	Mollogjesh	1977	9	45		51	31	Mollogjesh	Funar
14	Nezhan	1975	7.5	80		60	20	Nezhan	Zavalinë
15	Plangaricë	1980	11	150		150	130	Plangaricë	Gracen
16	Prapanikë	1966	5	70		40	20	Prapanikë	L.Mal
17	Valesh					80		Valesh	Gjinar
18	Petresh					140	0	Petresh	Bradashesh
19	Qerret	po/1977	19	167	68	80		Qerret	L.Mal
20	Tregan	po/1983	35	200	300	2800		Tregan	Tregan
21	Trëbac	1975	8.3	200		40	30	Tërbaç	Gracen

Bashkia Elbasan ka një popullsi prej **214.361** banorë. Shtrihet në qendër të Shqipërisë dhe kufizohet: në veriperëndim me Qarkun e Tiranës, në verilindje dhe lindje me Bashkinë e Librazhdit, në juglindje me Bashkinë e Gramshit, në jug me Bashkinë e Cerrikut dhe në perëndim me Bashkitë e Cerrikut dhe Peqinit. Në qendër të baskisë së Elbasanit shtrihet fusha me të njëjtin emër, e lokalizuar në krahun e djathtë e të majtë të rrjedhës së lumit Shkumbin në lartësinë 120 m. Është terren fushor dhe pjesërisht kodrinor-malor. Lartësia mesatare është 440 m. Maja më e lartë është mali i Jeronishtit (1883m). Malet ndodhen në verilindje, lindje dhe juglindje. Kodrat ndodhen në veriperëndim, perëndim dhe jugperëndim. Fushat ndodhen në pjesën qëndrore, si fusha e Elbasanit.
Zona malore zë 21% të sipërfaqes, zona kodrinore 35 % dhe fusha 44 % të saj.
Bashkia karakterizohet nga një klimë mesdhetare, me dimër të butë me reshje dhe verë të nxehtë. Temperatura mesatare vjetore është 15.4°C. Sasia mesatare e reshjeve arrin në 1160 mm, maksimumi 1500 mm.
Ka burime natyrore nëntoksore dhe mbitokësore të shfrytëzuara pjesërisht.

3.3 SITUATA DEMOGRAFIKE

Sipas të dhënave zyrtare të RGJC, në 31.12.2020 në Bashkinë e Elbasanit janë të regjistruar **214.361** banorë. Zonat urbane kanë dendësi më të lartë (si qyteti i Elbasanit (3,548 banorë/km²), me përqëndrim të ngjashëm me atë të raportuar nga Censusi 2011, pra 60 % në Elbasan.
Dendësia mesatare e popullsisë për Bashkinë Elbasan është 245 banorë/km² ndër të cilat 16677.1 banorë/km² që është dendësia mesatare e popullsisë për njësitë administrative.

Nr. Popullsisë së Bashkisë Elbasan sipas *Regjistrit të Gjendjes Civile 2020*, dhe Censusit 2011, i ndarë sipas Njësive Administrative dhe lagjeve.

Nr	**Bashkia Elbasan**	Nr. Popullsisë sipas Regj. Gj. Civile **2020**	Nr. Familjeve sipas Regj.Gj. Civile **2020**	Nr Popullsisë sipas Censusit **2011**
	Bashkia Elbasan	**214361**	**70194**	**141714**
1.	Lagjja 1	23238	7916	
2.	Lagjja 2	23261	7965	

3.	Lagjja 3	28043	9363	
4.	Lagjja 4	22180	7780	
5.	Lagjja 5	13721	4490	
6.	Lagjja 6	21306	7351	
Qyteti (Total)		**131749**	**44865**	**78703**
	Njësitë administrative			
1.	Bradashesh	13732	3990	10700
2.	Gracen	2340	699	2192
3.	Funar	2824	1044	2122
4.	Gjinar	4892	1622	3478
5.	Zavalinë	1422	616	1622
6.	Gjergjan	8136	2455	5126
7.	Labinot Mal	5617	1777	5291
8.	Labinot Fushë	7040	2175	7058
9.	Papër	9444	2826	6348
10.	Shirgjan	10896	3298	7307
11.	Shushicë	11667	3438	8731
12.	Tregan	4602	1389	3036
Njësitë Administrative (Total)		**82612**	**25329**	**63011**

Bashkia Elbasan përsa i përket popullsisë, ka peshën kryesore në qark. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, rreth 47.4 % e popullsisë së qarkut banon në Bashkinë e Elbasanit.
45 % e popullsisë banon në qytet dhe 55 % në zonën rurale. Lëvizja demografike në këtë bashki tregon për rritje të popullsisë urbane me ritme të ngadalta.

3.4 ZHVILLIMI EKONOMIK DHE TURIZMI

Indikatorë të rëndësishëm makroekonomik që tregojnë nivelin e zhvillimit të bashkisë janë niveli i papunësisë, numri i ndërmarrjeve aktive që ndodhen në teritorin e bashkisë, forca e punës si dhe numri i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike.
Nëse do të ndalonim tek këto tregues për bashkine e Elbasanit, do na rezultoni këto të dhëna:
Nr. i bizneseve që operojnë në bashkinë e Elbasanit është afërsisht 6345 biznese.
Në përqindje, themi se 24.3% e bizneseve janë vendosur në njësitë administrative të kësaj bashkie.
Kjo bashki renditet e pesta për sa i përket numrit të ndërmarrjeve aktive ekonomike në vend, pas bashkisë së Tiranës, Durrësit, Fierit dhe Vlorës.

Nr. i bizneseve në Bashkinë Elbasan

Nr. i bizneseve në Bashkinë Elbasan	Njësitë Administrative	Qyteti	Total
	1545	4800	6345

Tregues të rëndësishëm ekonomik për zhvillimin e bashkisë janë papunësia dhe ndihma ekonomike që marrin familjet.
Numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike në bashkinë Elbasan, sipas të dhënave të Drejtorisë së Koordinimit të Njësive Administrative dhe Statistikat, për vitin 2020 është 4836 familje.
Të papunë në qytetin e Elbasanit janë rreth 6000 persona.
Sipas sektorëve, numri më i lartë i të punësuarve është në sektorin privat.
Kështu në bashkinë Elbasan, në vitin 2021, sektori privat kontribuoi me 80.1% të të punësuarve, ndërsa në nivel vendi sektori privat kontribuon me 83.5% të numrit të punësuarve.
Është e rëndësishme për të bërë një dallim ndaj bashkive përsa i përket treguesve të rritjes ekonomike të prodhimit të përgjithshëm bruto dhe të ardhurave për frymë.
Këto tregues ekonomik përbëjnë një diferencim të caktuar nga ana sociale dhe ekonomike.
Sektorët më të rëndësishëm janë: industria, bujqësia, tregtia, restorantet, transporti, komunikimi, hoteleria.
Eksportet përbëjnë një pjesë të rëndësishme të PBA të bashkisë, tw cilat pwrbwhen nga eksporti i çelikut, çimentos, kromit, prodhimeve tw konservuara tw detit, konstruksione metalike dhe druri si edhe prodhimeve artizanale dhe konfeksioneve.
Ka shumë kompani të huaja, kryesisht nga Turqia (Kurum International, Turka Kurum, Kurum Gaz) në sektorin e industrisë dhe minierave gurore, nga Libani (fabrika e cimentos Elbasan), delmon grup me kapital francez si pjesë këmbimi për makinat.
Ka 4800 ndërmarrje aktive jo-bujqësore (në përgjithësi ndërmarrjet e vogla) që gjenden kryesisht në qytetin e Elbasanit, në zonën industriale të Bradasheshit dhe njësitë administrative. Dominojnë vendndodhjet si materialet e ndërtimit në bashkinw Elbasan, hoteleria ne zonen e llixhave etj.
Bashkia Elbasan ka resurse turitike qe i japin zhvillim ekonomik si qendra muzeale e qytetit, Llixhat e Elbasanit, fshati turistik Gjinar dhe Shushica (Bysheku), zona turistike e Funarit.
Dominojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
Ndërmarrjet aktive jo-bujqësore ndodhen në qytetin e Elbasanit dhe në 12 njesitë administrative.
Zona industriale e Bradasheshit mbetet zonë ekonomike me shumë rëndësi për bashkinë ku ka kushte ideale për zhvillimin dhe zgjerimin e aktiviteteve industriale dhe tregtare pasi bizneset aty i kanë të gjitha kushtet dhe lehtësitë e nevoshme si ujë, energji elektrike, ndërtesa e troje shtetërore dhe këtu ka ende shumë rezerva për shtimin dhe rigjenerimin të bizneseve e për t'u bërë më tërheqëse për investitorë të mundshëm.
Qyteti i Elbasanit ka resurse turistike që i japin zhvillim ekonomik si qëndra muzeale, kalaja, fshati turistik Gjinar, Shushica (Bysheku), Llixhat e Treganit, zona turistike e Funarit.

Resurset e tjera turistike që ka në bashkinë Elbasan janë:

1. Frashëri i Polis Valë	Njësia Administrative Shushucë
2. Pylli aluvial i Shushicës	Njësia Administrative Shushucë
3. Shpella e Letanit	Njësia Administrative Bradashesh
4. Shpella e Gracenit	Njësia Administrative Gracen
5. Burimi i Llixhës së Hibrait	Njësia Administrative Tregan
6. Dushku i Lleshanit	Njësia Administrative Gjinar
7. Mështekna e Zavalinës	Njësia Administrative Zavalinë
8. Pisha e Fushë Kuqes Gjinar	Njësia Administrative Gjinar
9. Dushku i Kishës Gjinar	Njësia Administrative Gjinar
10. Lisat e Pashtreshit	Njësia Administrative Gjinar
11. Mani i Zi i Joronishtit	Njësia Administrative Zavalinë
12. Rrepet e Byshekut	Njësia Administrative Shushucë
13. Robulli i Zeleshnjës	Njësia Administrative Zavalinë

14.Rapi i Bezistanit	Qytet Elbasan
15.Rrapi i Gurrës së Labinotit	Njësia Administrative Labinot Mal
16.Ulliri i Qejfit	Qytet Elbasan
17.Rrapi i Llixhës	Njësia Administrative Tregan
18.Liqeni i Treganit	Njësia Administrative Tregan
19.Rrapi i Vojvodës	Qytet Elbasan

Lista e monumenteve të kulturës në Bashkinë e Elbasanit

Nr	Monumenti	Bashkia	Nj. Administr.	Kategoria
1.	Kalaja e Elbasanit	Elbasan		I-rë
2.	Kalaja e Gurit		Gjinar	I-rë
3.	Kalaja e Menglit		Labinot-Fushë	I-rë
4.	Kalaja e Valeshit		Gjinar	I-rë
5.	Kalaja e Bodinit		Gracen	I-rë
6.	Kalaja në Llixhat e Elbasanit		Gjinar	I-rë
7.	Kalaja në Shkëmbin Mbret		Labinot–Fushë	I-rë
8.	Kalaja në vendin e quajtur Kulla e Gracenit		Gracen	I-rë
9.	Kalaja në vëndin e quajtur Shkëmbi Skënderbeut		Bradashesh	I-rë
10.	Kalaja në majën e Shën Mërisë		Funar	I-rë
11.	Gjurmë të Kalasë Mesjetare pranë Pallatit Sportit	Elbasan		I-rë
12.	Kalaja e Kabashit		Zavalinë	I-rë
13.	Kulla e sahatit në muret e Kalase së Elbasanit	Elbasan		I-rë
14.	Ura antike		Gjergjan	I-rë
15.	Kembet e urës antike në Topçias	Elbasan		I-rë
16.	Ura mbi përroin e Gurrës		Labinot	I-rë
17.	Gërmadhat antike (stacioni rrugor AD)	Elbasan		I-rë
18.	Pusi që lahet vetë dhe rrapi pranë tij	Elbasan		I-rë
19.	Bezistani i qytetit Shatërvani, rrapi dhe një pjesë e kalldrëmit	Elbasan		I-rë
20.	Kisha e Shën Gjon Vladimirit		Bradashesh	I-rë
21.	Kisha e Shën Premtes		Gjinar	I-rë
22.	Kisha e Shën Kollit		Shelcan	I-rë
23.	Kisha e Shën Mërisë në Kala	Elbasan		I-rë
24.	Rrënojat e Kishës		Funar	I-rë
25.	Rrënojat e Kishës		Gracen	I-rë
26.	Rrënojat e Kishës së Ungjillizimit		Shirgjan	I-rë
27.	Bazillika në Kodër të Tepes	Elbasan		I-rë
28.	Xhamia Mbret	Elbasan		I-rë
29.	Xhamia e Nazireshës	Elbasan		I-rë
30.	Namasgjaja	Elbasan		I-rë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

31.	Hamami i pazarit	Elbasan		I-rë
32.	Hamami i vjetër në lagjen Kala	Elbasan		I-rë
33.	Banesa e Qemal Stafës	Elbasan		I-rë
34.	Shkolla "Kostandin Kristoforidhi" dhe Varri pranë saj	Elbasan		I-rë
35.	Burgu dhe qelite e tij	Elbasan		I-rë
36.	Shtepia muze e "Kostandin Kristoforidhit"	Elbasan		I-rë
37.	Banesa e Staf Papanikoll Papajanit Lagja "Kala"	Elbasan		I-rë
38.	Banesa Sul Shahinit	Elbasan		I-rë
39.	Banesa e Hajdar Sejdinit	Elbasan		I-rë
40.	Banesa e Hajrie Skiles	Elbasan		I-rë
41.	Banesa e Ikbale Bumçit	Elbasan		I-rë
42.	Banesa e Tasim Qitjes	Elbasan		I-rë
43.	Banesa Vellezërve Kopili	Elbasan		I-rë
44.	Banesa e Refie Mallahollit	Elbasan		I-rë
45.	Banesa e Elena Papajanit	Elbasan		I-rë
46.	Banesa e Jorgji (Josif Lef) Kushtës		Zavalinë	I-rë
47.	Banesa e Pali Thoma Joncit		Gjinar	I-rë
48.	Banesa e Kostë dhe Naum Ziut		Zavalinë	I-rë
49.	Banesa e Toli Dedes Elbasan		Zavalinë	I-rë
50.	Banesa e Ramadan Bodurit		Tregan	I-rë
51.	Qendra historike e qytetit Elbasan	Elbasan		I-rë
52.	B.K.T "Rr."Qemal Baholli"	Elbasan		II-të
53.	Ish Muzeu i Luftës, Rr" J.Kilica"	Elbasan		II-të
54.	Ndërtesë 2 kat, Rr."P. Xhuvani" nr.48	Elbasan		II-të
55.	Ndërtesë 2 kat, Rr."P.Xhuvani" 38	Elbasan		II-të
56.	Ndërtese 2 kat. Rr. "Rinia" kryqezimi me Rrugën e degës	Elbasan		II-të
57.	Ndërtesë 2kat. Rr. "Rinia", ngjitur me murin e Kalasë	Elbasan		II-të
58.	Ndërtesa 2 kat. Rr. "Rinia", internet dhe bingo	Elbasan		II-të
59.	Ndërtesë 2 kat, Rr. "Rinia"	Elbasan		II-të
60.	Ndërtesë 2 kat. Rr. "Rinia", Hotel "Guri"	Elbasan		II-të
61.	Ndërtesë 2 kat. Rr. "Rinia", Selia e PD	Elbasan		II-të

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

62.	Ndërtesë 2 kat. Rr. "Rinia", parfumeri Eri	Elbasan		II-të
63.	Ndërtesë 2 kat. Rr. "Rinia"	Elbasan		II-të
64.	Ndërtesë 2 kat. Lagja "L. Shënkoll"	Elbasan		II-të
65.	Ndërtesë 2 kat. Lagja "L. Sokoli", Kisha Ringjallja	Elbasan		II-të
66.	Ndërt. 2 kat, Lagja "L.Shënkoll" Nr. 1	Elbasan		II-të
67.	Ndërt 2 kat, Rr. "Fetah Ekmeciu" përballë laboratorit	Elbasan		II-të
68.	Ish Shkolla " Ptoleme Xhuvani" Rr. "Sul Misiri"	Elbasani		II-të
69.	Ndërtesë 2 kat, Rr."Sul Misiri", pas ndërtesë nr. 12.	Elbasan		II-të
70.	Ndërtesë 2 kat, Rr " Sul Misiri", Nr.6	Elbasan		II-të
71.	Ndërtesë 2 kat, Rr. "Sul Misiri", nr.1	Elbasan		II-të
72.	Muzeu	Elbasan		II-të
73.	Ndërtesë 2 kat, Rr."Q Baholli", afer Biblotekes publike	Elbasan		II-të
74.	Bibloteka publike, Rr. "Q Baholli "	Elbasan		II-të
75.	Ndërtesë 2 kat, Rr."Labinoti"	Elbasan		II-të
76.	Rruga"Rinia" duke filluar nga Kryqëzimi me L"Shënkoll"	Elbasan		II-të
77.	Teatri "Skampa", Kryqëzimi i Rrugës Rinia	Elbasan		II-të
78.	Dhoma me tavan dekorativ në kopështin e fëmijëve	Elbasan		I-rë
79.	Banesa Qefsere, Shefqet e Sabrie Duhanxhiu	Elbasan		I-rë
80.	Banesa e Nabise Idrizit		Labinot-Mal	I-rë
81.	Shtëpia e Konferencës së Labinotit		Labinot	I-rë

Bashkia e Elbasanit ka një potencial të fuqishëm turistik. Ajo posedon shumë objekte turistike si monumente kulturore, kështjella, kulla e sahatit në Elbasan, objekte kulti, mozaikë, etj
Zonat e caktuara me prioritet turistik janë si më poshtë:
Zona turistike e Gjinarit (900 hektarë) e përshtatshme për turizëm malor, ski, etj. dhe në veçanti mali Bukanikut.
Zona kurative e Llixhave (52.7 hektarë) të përshtatshme për turizëm kurativ.
Në Byshek është burimi dhe shkëmbi gëlqeror, të përshtatshëm për rikreacion, turizëm të natyrës dhe historik.
Rezervuarët në Funar dhe vegjetacioni përreth, të përshtatshme për turizmin rikreativ até të natyrës, etj.

Për më tepër në Bashkinë e Elbasanit ka një pasuri të madhe etnofolku dhe organizon rregullisht evente publike të tilla si (dite vere, ditë olimpike etj).

Tërheqjet turistike

- Dita e Verës në qytetin e Elbasanit
- Qëndra termale kurative, Llixhë. Këtu përfshihet zona qëndrore dhe burimet e Llixhave të Hidrajt, me sipërfaqe të përgjithshme 527 ha.
- Kalatë e Bashkisë së Elbasanit:
  - Kalaja e qytetit të Elbasanit
  - Shkëmbi i Shëmllijut (Shën Ilia). Njësia Administrative Bradashesh.

  Qytezë ilire e shek. III (para lindjes së Krishtit). Ka gjurmë të mureve rrethuese.

  Kala të pa aksesueshme (aktualisht nuk ka rrugë që të çojnë tek këto kala).
- Dita Olimpike e Gjinarit
- Monumente kulture të Bashkisë së Elbasan, të tilla si:

- Gërmadhat antike (stacioni rrugor Ad-Quintum), fshati Bradashesh, Njësia Administrative Bradashesh.
- Ura mbi Përroin e Gurës së Labinotit, fshati Labinot, Njësia Administrative Labinot-Fush.
- Kisha e Shën Gjon Vladimirit, fshati Shijon, Njësia Administrative Bradashesh.
- Kisha e Shën Kollit, fshati Shelcan, Njësia Administrative Shiushicë.
- Kisha e Shën Nikollës, fshati Shelcan, Njësia Administrative Shiushicë.
- Kisha e Shën Mërise në Kalanë e Elbasanit.
- Xhamia Mbret në lagjen Kala, Qyteti Elbasan.

- Etno – folk (kostumet)

Muze - Muzeu Etnografik, Muzeu Shkollës Normale (Pedagogjike), Muzeu i shkollës "Naim Frashëri". Të gjithë këto muze ndodhen në qytetin e Elbasanit.

Gastronomia (ushqim tradicional).

- Zona pyjore e malit të Bukanikut dhe e Gjinarit, Njësia Administrative Gjinar me sipërfaqe 920 ha (turizëm masiv e rezidencial, malor, kurativ, agroturizëm dhe ekoturizëm). Ndodhet 22 km larg nga qyteti i Elbasanit.
- Rruga Egnatia.
- Byshek (Fshati Shushicë, Komuna Shushicë, Njësia Administrative Shiushicë, 6 km para se të arrish në qëndër të fshatit në të majtë të lumit Shkumbin. Përfaqëson një grup drurësh gëlqerorë dhe disa rrapa me siperfaqe 0.4 ha me moshë 500-600 vjeçare. Pranë tyre ka burime me ujë.
- Biodiversiteti i zonave. Përmendim zonën që fillon nga Përroi i Qershisë (fshati Fush Buall, Njësia Administrative Shiushicë) deri tek Rrobujt e Zeleshnjës (Mali Bukanikut, Njësia Administrative Gjinar). Ka të bëjë me një shumëllojshmëri bimore dhe shtazore të vendosura në një zonë të caktuar, që mund ta quajmë edhe "Shqiperia apo Europa ne miniature".

Vlera historike (nga Kombinati Metalurgjik, Njësia Administrative Bradashesh.)

- Ujrat e ftohta me veti kuruese Rrobujt e Zeleshnjës (Mali Bukanikut, Njësia Administrative Gjinar),

kanë të bëjnë me: Grumbuj drurësh të vendosur në një areal me poshtë se zakonisht, ku në vend të një trungu të vetëm ka tre trungje të vendosur bashkë (atraksion shkencor dhe turistik), i vetmi në Europë.

- Dita Shën Vladimirit (4 Qershor, Shijon).

Zona me përparësi për zhvillimin e turizmit:

• Qafë Bush (Bashkia Elbasan) me sipërfaqe pyjore 512 ha.

Monumente Natyrore (Zona të mbrojtura të kategorise III), ku përfshihen 30 gjeomonumente të shpërndara në të katër anët e Bashkisë Elbasan dhe një numër i madh biomonumente.

Marketing turistik dhe promocion

Panairi tradicional "Dita e Verës"

Konferenca Ndërkombëtare e Ditës së Verës (e përvitshme), e cila promovon turizmin e qëndrueshëm dhe zhvillimin lokal.
Konkretisht promovon:
• Turizmin ekologjik, kulturor, historik e sportiv.
• Antropologjinë e turizmit (sjellja në vlera të sotme e vlerave të shkuara).
• Enogastronominë (gastronomia tipike).
• Zhvillimi i sektorit të tretë, sektori mbështetës i turizmit të qëndrueshëm (sektori shërbimeve, agroindustria, higjena dhe siguria).
• Të rejat e fundit ndërkombëtare në fushën e turizmit të qëndrueshëm.
Faqe interneti të bashkive. Bashkia Elbasan (www.elbasani.gov.al).
Guida për Elbasanin.
Botimet, të tilla si:
• "Rivitalizimi i qendrës historike të Elbasanit" (botim i Universitetit të Pizës në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan dhe Universitetin "A.Xhuvani").
• "Enciklopedia e Elbasanit", Fletëpalosje të ndryshme,
Libra për Ditën e Verës.
• "Dita e Verës"(Ritual) – Thanas Meksi.
• "Mjeshtri i Këngës Popullore, (Isuf Myzyri)"- Thanas Meksi.
• "Këngë Popullore të Elbasanit"-Gëzim Selita, Demir Bebeti.
• Dokumentar artistik "Mirësevjen, o Dita e Verës" realizuar nga Shoqata "Elba Folku".
• Aktiviteti "Miqtë e Malit" (Dita Olimpike e Gjinarit).
Promovimi i prodhimeve bio në zonën turistike të liqeneve të Funarit 20 Maj të çdo viti.
Promovimi i qershisë në fshatin Godolesh të Njësisë Administrative 05 Qeshor të çdo viti.
Një traditë disa vjeçare që organizohet në qendrën turistike të Gjinarit. Në këtë aktivitet promovohen vlerat turistike të zonës (natyrore, prodhimet tradicionale të zonës) si edhe organizohen aktivitete rinore që shërbejnë në të njëjtën kohë edhe për promovimin e këtyre vlerave të zonës.
Eksporte të prodhimeve bio (eksport të vajit të ullirit, bimë mjekësore, lule të thata që përdoren për dekorim) etj.
Gazetat lokale Bashkia Elbasan
Media Vizive (tv lokale) dhe radio lokale. Përmendim këtu: Tv Skampa, BEST Channel, Radio Egnatia, Radio Klea, Radio Alsion.

3.5 BURIMET NATYRORE, INDUSTRIA

Rajoni ka gjithashtu minerale jo-metalore të cilat përbëjnë një pasuri të çmuar.
Gurët dekorative janë të vendosur kryesisht në malësinë e Shpatit.

INDUSTRIA
Degët kryesorë të zhvillimit të industrisë në Bashkin e Elbasanit janë:

- **Industria e rëndë dhe e ndërtimit**
- **Industria e lehtë dhe ushqimore**
- **Industria përpunuese**

Industria e rëndë dhe e ndërtimit është e përqëndruar kryesisht në qytetin e Elbasanit, në zonën industriale të Bradasheshit.
Në këtë zonë ndodhen:

- Uzina "Kurum International" e themeluar në vitin 1998 nga një firmë turke, e cila përbëhet nga: Uzina e çelikut (furrat elektrike) dhe Petëzimi.
- Kurum gëlqere, fabrike e ish kombinatit metalurgjik për prodhimin e gëlqeres e dhënë me kontratë koncensionere shoqërisë: "Turka Kurum" në vitin 1999.
- Kurum Gaz, fabrikë e ish kombinatit metalurgjik që prodhon gaz.

- Reparti i remontit elektrik, i privatizuar nga firma 2K Grup. Është një repart i fuqishëm për kryerjen e riparimeve, remonteve të mesme e kapitale të makinave elektrike rrotulluese, transformatorëve etj.
- Uzina e Ferro-Kromit vënë në punë në vitin 1998, e cila realizon shkrirjen e mineralit të kromit nëpërmjet tre furrave elektrike me hark të mbyllur.
- Uzina e karbonit, e cila prodhon masë karbonike. Tani është e privatizuar.
- Alba – Red, që prodhon polesterol, kmuf, asfalto-beton etj.
- Fabrik e përpunimit të naftës.

Në Elbasan ka një zhvillim te madh industria e materialeve të ndërtimit, ku krahas prodhimit të hekurit ekziston dhe fabrika e çimentos (Elbasan Cement Factory), fabrika tullave, gurit gëlqeror të Letanit dhe shumë biznese në fushën e ndërtimit.

Në Elbasan ka shumë punishte për prodhimin e mobiljeve.

Industria e lehtë dhe ushqimore përfaqësohet nga disa fabrika egzistuese si:

- Fabrika e bukës dhe shumë minifurra për prodhimin e llojeve të ndryshme të bukës.
- Janë ndërtuar dhe kanë filluar punë me teknologji bashkëkohore edhe shumë fabrika mielli si "Skraqi", "Sulove", "Klajdi", "Farina", "Erina".
- Fabrika e përpunimit të peshkut "Rozafa" në fshatin Labinot Fushë në ish Rezervat e Shtetit.

Në industrinë përpunuese mund të përmendim edhe një numër të madh firmash të vogla si bloje mielli, furra elektrike, sallameri, firma për prodhimin e pijeve freskuese dhe alkoolike, baxho për përpunimin e qumështit dhe nënprodukteve të tij, etj.

Në qytet ka disa dyqane shërbimi si hekur punues, teneqe dhe bakër punues, zdrukthtari ku prodhohen mobilje të ndryshme.

3.6 FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM

PËRDORIMI I UJIT

Bashkia e Elbasanit ka artierje kryesore hidrike Lumin Shkumbin me degëzimet e tij. Rëndësi të veçantë ne rezervën hidrike përbëjnë, siç u tha më lart edhe rezervuaret që janë shpërndarë pothuajse në të gjitha Njësitë Administrative.

Burimi kryesor i furnizimit me ujë të pishjshëm i popullatës së Bashkisë janë ujrat nëntokësore. Duhet theksuar se Elbasani është mjaft i pasur me këto burime, të cilat nuk shfrytëzohen tërësisht. Ujërat sipërfaqësore përdoren kryesisht për vaditjen e tokave bujqësore. Përdorimi i ujit për nevoja industriale është reduktuar ndjeshëm si pasojë e mbylljes së një pjesë të mirë të uzinave (veçanerisht në ish KME) që kërkonin një produkt të tillë.

Nga të dhënat, mund të themi se cilësia e ujit në lumin Shkumbin është relativisht e mirë, kjo edhe si pasojë e reduktimit të aktiviteteve industriale. Në këtë lumë përmbajtja e fosforit është brenda normave të lejuara të Bashkimit Europian.

SISTEMI I FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM

Bashkia Elbasan siguron furnizimin e popullatës me ujë për konsum publik nga Akuiferi publik, nga Akuiferi i Elbasanit, ku UKE shfrytëzon burimet nëntokësore në pellgun e ujëmbledhësit të Mengëlit me kapacitet 200-300 litra/sek, Krastës së Vogël me kapacitet 200-300 litra/sek dhe Frigoriferit me kapacitet 300-400 litra/sek, zona të cilat shtrihen në jug-lindje të Elbasanit. Sistemi i furnizimit me ujë

ka 29 stacione pompimi në Bashkinë Elbasan. Sistemi i pompave është i ndërlikuar i përbërë nga pompa horizonale e vertikale dhe zhytëse, në përshtatje me thellësinë dhe pozicionimin e pellgut ujëmbajtës që shfrytëzojnë. Nga këto stacione pompimi, vetëm 29 janë aktualisht në gjëndje pune të mirë pasi janë instaluar kohët e fundit ose janë rehabilituar. Kapaciteti i përgjithshëm i këtyre pompave vlerësohet të jetë 1,150 l/sek, ndërkohë që kapaciteti i pellgut është 1,153 l/sek. Ndërmarja ujësjellësit çdo 24 orë furnizon konsumatorët me 35 mijë m3 ujë të pishëm. Zona e ujësjellësit të qytetit administron furnizimin me ujë të pijshëm edhe për Njësitë Administrative Bradashesh, Shushicë, Gjergjan (fshati Gjonme), Labinot Fushë, Papër, Tregan, Gjinar.

Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve në Bashkinë Elbasan



3.7 FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE

Furnizimi me energji elektrike sigurohet nga OSHEE (dega Elbasan).
Në juridiksionin e kësaj drejtorie janë:

- Agjensia e Elbasanit ku funksionojnë nënstacione të tensionit 400, 220, 110 dhe 35 kë, konkretisht:

Në Elbasan – 10 nënstacione

- N/stacioni Fushë Mbret 400, 220, 30 kë.
- N/stacioni Bradashesh 220, 110, 35 kë.
- N/stacioni tek Spitali Psihiatrik 110,20,6 kë.
- N/stacioni K. Drurit 35,6 kë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

- N/stacioni Nr.2 FEE (ish KME) 110,10 kë.
- N/stacioni FEE Nr.3 (ish KME) 110,6 kë.
- N/stacioni Nr.1 FEE (ish KME) 35,10 kë.
- N/stacioni Nr.4 (N/st. Tulla) 35,10 kë.
- N/stacioni Nr.5 Vidhas-Papër 110/6 kë, 35/6 kë.
- N/stacioni Mjekës 35/6 kë.
- N/stacioni Kusarth 110/20 kë.

Në rast emergjence qyteti i Elbasanit ka të instaluar sistemin unazor 20 kw të furnizimit me energji elektrike.

3.8 GJENDJA E INFRASTRUKTURËS

Rrjeti rrugor në qarkun e Elbasanit është i ndarë në rrjetin rrugor nacional dhe rural.

Rrjeti rrugor i rrugeve nacionale që administrohet nga Autoriteti Rrugor Kombëtar, Rajoni Qëndror Rrugor Tiranë, për Bashkinë e Elbasanit paraqitet në tabelën e mëposhtme:
Nisur nga pozicioni gjeografik, akset rrugore që përshkojnë Bashkinë e Elbasanit kanë një rëndësi të madhe jo vetem për Bashkinë por edhe në nivel kombëtar. Disa nga këto akse janë pjesë përbërëse e koridorit 8-të.

Rrjeti i rrugëve rurale në Bashkinë e Elbasanit është në monitorim të vazhdueshëm nga Bashkia.

Inventari i rrugëve rurale të Bashkisë Elbasan

	Inventari i rrugëve	Njësia matëse	Bradashesh	Shushicë	Shirgjan	Papër	Gjerjgjan	Labinot Fushë	Labinot Mal	Gjinar	Tregan	Funar	Gracen	Zavalinë	Totali
1.	**Rrugë rurale**	km	7	5	0	0	0	4.5	55	19	0	20	0	13	**123.1**
a)	**me asfalt**	km	7	5	0	0	0	4.5	11	0	0	15	0	0	**42.5**
b)	**pa asfalt**	km	0	0	0	0	0	0	44	19	0	5	0	13	**80.6**
2.	**Rrugë komunale**	km	85	185	38	82	45	22	0	37	143	48	42	29	**756.4**
3.	**Me zhavor**	km	30	71	18	68	23	15	44	133	35	27	34	21	**519.2**
4.	**Nga këto shtruar me asfalt**	km	55	2	10	4	8	4	11	0	2	12	6	0	**114**
5.	**Të pa shtruara**	km	0	96	0	10	14	3.2	44	10	0	9	2	8	**196.2**
6.	**Rrugë arash**	km	15	16	39	24	13	7	0	8	10	5	5	40	**182**

Rrjeti rrugor si dhe firmat kontraktuese për mirëmbajtjen e këtyre segmenteve rrugore, inspektorët e MFSH që ndjekin këto punime si dhe kontaktet.

Nr.	Segmentet rrugore	Gjatësia në km	Kontraktori / Nënkontraktori	Inspektori
K-3	Qafë Krrabë (Km 29) – rot. re Shijon, rot. re Shijon – Ura e Zaranikës, K/Km	23.75	``ALKO IMPEX`` Arbër Abazi: 0692048888	Besnik Poci 0692532233
K-7	K/Shirgjan (K/Rr.Nr.70) – Llixha, Llixha – Kaçivel (k. Gramsh), K/Llixhë – Mjekës (Uzinë), Elbasan – Gjinar, k/Drizë (k/rr. 59) – Kaçivel (K/Elbasan),	88.95	``ALKO IMPEX`` Arbër Abazi: 0692048888	Bashkim Kurtina 0699376121
	Aksi rrugor Nacional Rrogozhinë-Peqin-Elbasan-Unaza Jugore e qytetit-Librazhd-Qafë Thanë	47.3	``2 T``SHPK Ilir Kokona:	Ismail Ruci 0694799399

3.9 BUJQËSIA DHE PYJET

Elbasani ka një klimë mjaft të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë.
Sipërfaqja bujqësore është 15132 ha, nga të cilat janë tokë arash 11111 ha, me tokë pemtari në total 4071 ha të cilat përfshijnë ullishtë, agrume, vreshta.
Në Bashkinë e Elbasanit, veçantërisht gjatë 10 vjeçarit të fundit, ka një zhvillim mjaft të madh të blegtorisë në të cilën mbarështrohen 2958 krerë gjedhë, 28805 krerë të leshta, 34119 krerë të dhirta, 698 derra dhe 181000 krerë shpendë.
Shteti ka dhënë subvencione me qëllim stimulimin e mbjelljes së rrënjëve të ullirit dhe pemëve frutore. Është rritur edhe prodhimi bujqësor në aspekte të tjera.
Në Bashkinë e Elbasanit janë në eficiencë 210 traktorë me rrota dhe 242 minitraktore, etj.
Elbasani është bashki me pasuri të konsiderushme pyjore. Pyjet zënë një sipërfaqe prej 24795 ha, ndërsa livadhet dhe kullotat 3863 ha. Në hartën e mëposhtme paraqitet pozicioni i tokës bujqësore, territorit urban, rrjeti infrastrukturës, rrjeti hidrologjik dhe natyror (pyje, kullota e të pafrtytshme).



Pasuri e madhe për Elbasanin është edhe mbledhja e prodhimi i bimëve medicinale të kultivuara dhe të grumbulluara në pyje.

TREGUESIT E BUJQËSISË PARAQITEN NË TABELËN E MËPOSHTME:

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Elbasan
1	Sip. bujq. gjithësej	Ha	15131
2	Sip. E mbjellë	Ha	9035
3	Tokë arash	Ha	11111
4	Tokë pemtari	Ha	4071
5	Koefic. shfrytzimit	%	66
6	Pyje gjithsej	Ha	24795
7	Kullota + Livadhe	Ha	3863
8	Gjedhë gjithsej	Nr	10278
9	Të leshta	Nr	28805
10	Të dhirta	Nr	34119
11	Derra	Nr	698
12	Njëthundrake	Nr	2958
13	Shpendë	Nr	181000
14	Prodhim drithra	Ton	2463
15	Prodhim perime	kv	127416
16	Prodhim patate	kv	56665
17	Prodhim fasule	kv	5661

18	Prodhime foragjere	kv	1604500
19	Prodhim fruta	kv	78122
20	Prodhim ullinj	kv	43860
21	Prodhim agrume	kv	4990
22	Prodhim duhani	kv	5000
23	Prodhim arrash	kv	2065
24	Prodhim mjaltë	kv	10000
25	Prodhim qumështi	kv	164308
26	Prodhim mishi	kv	25683
27	Prodhim vezë	000/k	9920
28	Traktorë	Nr	210
29	Minitraktorë	Nr	242

Për administrimin e pyjeve në Bashkinë Elbasan fuksionon Drejtoria e Shërbimeve të Pyjeve, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Përveç saj në territorin e bashkisë funksionojnë edhe Inspektoriati Shtetëror i Pyjeve, Mjedisit dhe Ujërave si dhe Administrata e Zonave të Mbrojtura.

3.10 SHËNDETËSIA

DREJTORITË E SHËNDETIT PUBLIK ELBASAN

Sistemi shëndetësor në Bashkinë e Elbasanit monitorohet nga Drejtoria e Shëndetit Publik dhe Drejtoria e Shërbimit Spitalor.

Drejtoria e Shëndetit Publik Elbasan merr masat tekniko–organizative për mbajtjen në gatishmëri të shërbimit shëndetësor gjatë vitit.

Llogjistika paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	**Shpërndarja**			**Mjekë**			**Infiermerë**		
Elbasan	**Gjithsej**	**Lagje**	**Njësi Administrative**	**Gjithsej**	**Lagje**	**Njësi Administrative**	**Gjithsej**	**Lagje**	**Njësi Administrative**
Qendra Shëndetësore	16	4	12	80	52	28	259	109	150

SHËRBIMI SPITALOR

Burime njerezore dhe llogjistike të Shërbimi Spitalor në Bashkine Elbasan

Nr	Emërtimi	SpitaleGjiths	Personeli			Shtretër			Mjete					Morg	
			Gjithsej	Mjeke	Infermier	**Gjithsej**	NëSpitale	Urgjenca	**Gjithsej**	Autoulanc	Mjete te tiera	**Laborato**	**Salla operacion**	Sasia	Kapacitet i
1	Q. Spitalore Elbasan	1	378	81	297	439	415	24	9	8	1	0	3	1	3
2	S. Psiqiatrik	1	193	7	68	310	302	8	2	1	1	-	-	-	-
Totali		2	571	88	365	749	717	32	11	9	2	0	3	1	3

3.11 ARSIMI & MEDIAT

Në sektorin e arsimit, në Bashki funksionojnë:

Institucion e Arsimore	**Shpërndarja**		**Mesues**		**Nxënës**	
	Qytet	**Njësi Administrative**	**Qytet**	**Njësi Administrative**	**Qytet**	**Njësi Administrative**
9-vjeçare	21	77	482	608	6549	5247
Shkolla të mesme	6	2	189	21	3034	194
Shkolla të mesme të bashkuara (9-vjeçare + të mesme)	2	6	116	98	1260	902
Kopshte	27	71	136	89	2100	1254

Gjithashtu në Bashkinë e Elbasanit është në funksion Universiteti "Aleksander Xhuvani", me staf akademik efektiv prej 248 pedagogë dhe ku janë të regjistruar afersisht 11500 studentë.

Mediat

NR	Bashkia	Gazetat	Mediat Vizive	Mediat autovizive	Studio të mediave kombëtare
1	Elbasan	Elbasani Info Elbasani	"Skampa" TV BEST Channel	Klea Alsion Alfa	"Klan " TV "Ora " News "News 24" Vision Plus

4. RREZIQET POTENCIALE NGA FATKEQËSITË

4.1 FAKTE DHE PROBLEME ME FATKEQËSITË NË SHQIPËRI

Sistemi i emergjencave civile në Shqipëri ka evoluar me kohën, por në mënyrë jo lineare. Progresi është shoqëruar herë pas here me ndalesa, madje edhe me hapa prapa. Ky fakt si dhe mungesa e të dhënave të mjaftueshme e bëjnë analizën e tij të vështirë. Vlerësimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë i vitit 2003 dhe Plani Kombëtar i Emergjencave Civile, 2004 (PKEC-04) përbëjnë dy hapa të rëndësishëm që hodhën bazat e këtij procesi, ndërsa një numër projektesh të sponsorizuara nga Banka Botërore, OKB dhe BE, midis viteve 2010 e 2018, të fokusuara në vlerësimin dhe ngritjen e kapaciteteve qenë hapa të rëndësishëm përpara, të cilat gjithashtu ofruan informacion të rëndësishëm në mënyrën se si ky sistem funksionon në Shqipëri dhe ç'mbetet për të bërë në të ardhmen.

Gjatë dekadave të shkuara, Shqipëria është goditur mesatarisht nga një fatkeqësi natyrore madhore në vit. Në 30 vjet, midis 1980 dhe 2010, janë regjistruar 23 fatkeqësi të tilla. Prej tyre, nëntë fatkeqësi kanë qenë përmbytje, katër tërmete dhe tre goditje nga temperaturat ekstreme. Gjatë kësaj periudhe, për shkak të këtyre fatkeqësive 163 njerëz humbën jetën ndërsa rreth 4 milionë u prekën në një masë apo në një tjetër. Efekti i fatkeqësive natyrore në Shqipëri amplifikohet nga shkalla relativisht e lartë e varfërisë, mungesa e mirëmbajtjes së infrastrukturës, ndërtimet e pasigurta dhe praktikat e shfrytëzimit të tokës, të lidhura këto me urbanizimin e shpejtë, shfrytëzimin e keq të burimeve natyrore (kullotave, pyjeve, shtretërve të lumenjve, etj) gjatë kalimit nga një ekonomi e kontrolluar nga shteti në një ekonomi të tregut të lirë.

Atyre u shtohen mungesa e burimeve materiale dhe niveli i ulët i koordinimit midis agjencive që kanë përgjegjësi ligjore në emergjencat civile, ndërsa sistemit të edukimit dhe informimit i mungon përfshirja e nevojshme dhe influenca në institucionet shtetërore dhe në popullsinë shqiptare në tërësi.

Shqipëria është një vend me probabilitet relativisht të lartë të goditjes nga fatkeqësitë natyrore. Ajo renditet ndër vendet me risk të lartë ekonomik ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh. Rreth 86% e territorit të saj ku gjenerohet mbi 88.5% e PBB, është e ekspozuar nga dy a më shumë fatkeqësi natyrore. Humbjet ekonomike të shkaktuara nga këto fatkeqësi midis 1974-2006, janë përllogaritur mesatarisht në 68.7 milionë USD në vit, ose rreth 2.5% e PBB. Midis viteve 1989 e 2006, tërmetet dhe përmbytjet zënë përkatësisht 17% dhe 31% të fatkeqësive të ndodhura në Shqipëri. Në shkallë botërore, Shqipëria zë vendin e 41-të për rrezikun ndaj rrëshqitjeve të dheut, të 43-tin për tërmetet dhe të 58-tin për thatësirat.

Rreziqet nga fatkeqësitë natyrore për Shqipërinë janë: gjeologjike (tërmete, rrëshqitje dheu, shkëmbinjsh); hidrometeorologjike (përmbytje, shira të rrëmbyer, thatësira, stuhi bore, orteqe apo bllokim nga bora, stuhi ere); bio-fizike (zjarre në pyje, epidemi), ndërsa ato të shkaktuara nga njeriu konsistojnë në: shpërthime, përmbytje e fatkeqësi teknologjike. Shqipëria ndeshet gjithashtu me një numër problemesh mjedisore, të cilave u shtohet ekzistenca edhe e zonave me rrezik të lartë për shkak të ndotjes (hot-spote).

Shqipëria karakterizohet nga shkallë e lartë sizmike. Së bashku me disa vende të tjera të Ballkanit Lindor e Juglindor, ajo ka pësuar po thuajse çdo vit një tërmet me magnitudë ≥ 6.5 ballë të shkallës rihter. Shtatë qytetet më të mëdha të Shqipërisë futen në zonën me probabilitet 75% prej këtij rreziku. Rreth 10% e territorit shqiptar konsiderohet "e paqëndrueshme", objekt i rrëshqitjes së dherave.

Sistemi lumor në Shqipëri paraqet riskun më të madh për përmbytjet. Ato ndodhin zakonisht gjatë periudhës nëntor-mars, në të cilën në Shqipëri bie rreth 80-85% sasisë vjetore të shirave. Përmbytja e Ultësirës Perëndimore (sipas skenarit më të keq në 100 vite) mund të prekë seriozisht 20 rrethe, 110 komuna, 341 fshatra, 85500 banesa (në rreth 7.9 milionë m2) rreth 565 mijë njerëz. Në Janar 2010, në rajonet Shkodër e Lezhë, u përmbytën rreth 14,000 hektarë dhe 1200 godina, ndërsa 12,000 njerëz u desh të evakuoheshin nga banesat. Në Shkurt 2015 u përmbytën rreth 3,000 ha dhe mbi 600 banesa në njesën

perëndimore e jugperëndimore të vendit. Nga këto përmbytje u prekën rreth 42,000 persona, ndërsa rreth 600 familje u desh të evakuoheshin.

Momentalisht janë rreth ***630 sisteme rezervuarësh me diga në Shqipëri***, prej të cilave, **307** konsiderohen ose me diga të larta **(lartësia ≥ 15 m)** ose rezervuarë të mëdhenj. Lëvizjet e popullsisë dhe zgjerimi i qyteteve ka çuar në rritjen e përqëndrimit të popullsisë dhe vlerave materiale në rrjedhjet e poshtme të lumenjve. Shpërthimi i tetë digave të mëdha, në zonën qendrore të Shqipërisë, vlerësohet të prekë të gjithë qytetin e Elbasanit, Lushnjës dhe Divjakës.

Rreziqet nga rënia e dëborës ndodhin kryesisht nga nëntori në mars, në zonat malore të Veriut, Verilindjes, Juglindjes dhe Jugut. Problemet më tipike janë bllokimet e rrugëve (për shkak të gjendjes së keqe të tyre dhe mirëmbajtjes së pamjaftueshme) si dhe orteqet. Popullsia që banon në zona të tilla (ku ka reshje bore deri 30 cm) varion nga 12% (355 mijë banorë) në 32% (rreth 1 milion banorë). Një situatë e tillë zgjat më shumë se 30 ditë dhe për popullsinë e prekur paraqet probleme serioze nga pikëpamja e ushqimit dhe mbështetjes shëndetësore. Në Shqipëri, një nga vendet mesdhetare që preket më shumë nga zjarret, pyjet zënë rreth 29% të sipërfaqes. Në vitin 2007, sipërfaqja totale e djegur (për shkaqe natyrore apo nga njeriu) arriti 127 mijë hektarë, por ishte ndjeshëm më e vogël në 2008, me rreth 19,254 ha dhe ka ardhur duke u ulur çdo vit. Në lidhje me rreziqet nga epidemitë, situata është relativisht e favorshme, për shkak të kontrolleve të vijueshme dhe zbatimit të masave preventive. Megjithatë, sërish ekzistojnë një numër problemesh për shkak të kushteve higjieno-epidemiologjike (të cilat shkaktojnë sëmundje ngjitëse, ndotje të ujit, ajrit e truallit) kapacitete të pamjaftueshme mikrobiologjike në nivel lokal, etj. Aktualisht për Shqipërinë, rreziqe teknologjike konsiderohen: ndotjet industriale, shkarkimet toksike, aksidentet automobilistike, shpërthimet në uzina dhe rrjedhjet e kimikateve. Sidomos materialet dhe substancat e rrezikshme që mbahen në kushte të papërshtatshme, në pjesë të ndryshme të vendit, paraqesin një rrezik real në kuadrin e fatkeqësive industriale. Faktorët shtesë të rrezikut, të tillë si situata ekonomike, dëmtimi i infrastrukturës, migrimi masiv (me pasojat e tij të përqendrimit të popullsisë në zona të pasigurta urbane dhe bumin e ndërtimeve) shpërdorimi i pyjeve, i burimeve natyrore ujore dhe ndotja mjedisore, të gjitha së bashku, rritin gjithashtu vulnerabilitetin ndaj popullsisë dhe ekonomisë shqiptare.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

4.2 KONTEKSTI KULTUROR

Në Shqipëri, sjellja e popullsisë (mënyra e jetesës) shpesh ka kontribuar në rritjen e efekteve të fatkeqësive në vend. Kjo evidentohet qartë në faktet e përmendura më lart për urbanizimin e pakontrolluar e kaotik të ndodhur në dy dekadat e fundit. Një tjetër sfidë është dominimi i "mentalitetit të komandimit", në vend të mentalitetit të iniciativës, hapjes, koordinimit dhe kooperimit. Gjithashtu mungon një kulturë solide vullnetarizmi. Të gjitha këto tipare kulturore janë shpjeguar kryesisht me ndikimin për një kohë të gjatë të "qasjes së shtetit të centralizuar". Aktualisht, Kryqi i Kuq Shqiptar (KKSH) dhe Qendra Vullnetare e Emergjencave Civile, janë të vetmet organizata vullnetare në vend me kapacitete reale dhe struktura të tilla që kanë një ndikim të ndjeshëm në rastet e emergjencave civile.
Një kulturë e re sigurie dhe qëndrueshmërie ndaj fatkeqësive duhet të futet jo vetëm në të gjitha nivelet e institucioneve, por edhe në popullsinë shqiptare në tërësi, sepse asaj "*i mungon ndërgjegjësimi ndaj RRF, për rrjedhojë, rreziqet dhe dobësitë nuk kuptohen si duhet*". Gjithashtu, urbanizimi kaotik (përgjithësisht në injorim të kodeve sizmike dhe zonave të rrezikshme) mungesa e mirëmbajtjes të infrastrukturës, sidomos të sistemeve të drenazhimit, etj, ndikojnë në rritjen e frekuencës dhe pasojave të fatkeqësive. Nga ana tjetër, mungesa e kulturës dhe skemave publike/private të sigurimeve nga fatkeqësitë natyrore e përkeqësojnë më tej efektin negativ të fatkeqësive si dhe mundësinë e kohën për rikaverim. Gjithashtu, në popullsinë shqiptare ekziston ***"pritshmëria që në rastin e dëmtimit nga fatkeqësia natyrore të shtëpive, pasurisë, gjësë së gjallë apo produktit bujqësor, Qeveria do të kompensojë gjithë dëmet, në fakt, bazuar në legjislacionin shqiptar, kompensimi i mundshëm është jo më shumë se 50% të humbjeve"***.
Një tjetër problem konceptual por edhe praktik në lidhje me RRF&MC në Shqipëri është fakti që, përveç kapaciteteve për luftën ndaj zjarrit dhe shërbimit shëndetësor, gati të gjitha kapacitetet e tjera janë alokuar tek Forcat e Armatosura Shqiptare (FASH). Ndryshe nga përvoja e vendeve të tjera, në Shqipëri, FASH janë në fakt reaguesi i parë dhe më i besueshëm në rastet e emergjencave civile. Nga pikëpamja e RRF&MC, përveç "militarizimit" të operacioneve reaguese për emergjencat civile, që i vendosin një numër institucionesh të tjera në rol të margjinalizuar, kjo ka prodhuar vështirësi kur forcat pjesëmarrëse në këto lloj operacionesh bashkëveprojnë me organizata ndërkombëtare dhe pjesëmarrësit e tyre të dërguar në Shqipëri për asistencë.

4.3 RREZIQET POTENCIALE NGA FATKEQËSITË NË BASHKINË E ELBASANIT

Bashkia e Elbasanit është një nga bashkitë në Shqipëri me probabilitet relativisht të lartë të goditjes nga fatkeqësitë natyrore. Ajo renditet ndër bashkitë me risk të lartë ekonomik ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh.
Rreziqet nga fatkeqësitë natyrore për bashkinë e Elbasanit janë: gjeologjike (tërmete, rrëshqitje dheu, shkëmbinjsh); hidrometeorologjike (përmbytje, shira të rrëmbyer, thatësira, stuhi bore, orteqe apo bllokim nga bora, stuhi ere); bio-fizike (zjarre në pyje, etj) ndërsa ato të shkaktuara nga njeriu konsistojnë në: shpërthime, përmbytje e fatkeqësi teknologjike.
Ajo ndeshet gjithashtu me një numër problemesh mjedisore, të cilave u shtohet ekzistenca ende e zonave me rrezik të lartë për shkak të ndotjes (hot-spote).
Elbasani karakterizohet nga shkallë e lartë sizmiciteti. Nga statistikat ai ka pësuar po thuajse çdo vit një tërmet me magnitudë ≥ 6.5. Një pjesë e territorit të Bashkisë konsiderohet "i paqëndrueshme"; objekt i rrëshqitjes së dherave.
Sistemi lumor në Bashkinë Elbasan paraqit riskun më të madh për përmbytje. Ato ndodhin zakonisht gjatë periudhës nëntor-mars, në të cilën në Shqipëri bie rreth 80-85% sasisë vjetore të shirave.
Momentalisht në bashkinë e Elbasanit ka një siperfaqe ujore rreth 650 ha, të cilat përbëhen nga liqene natyrore dhe rezervuare, ujëmbledhesa të ndërtuar për qëllime vaditje, janë rreth 22 diga me lartësi (6 m – 30 m).
Rreziqet nga rënia e dëborës ndodhin kryesisht nga nëntori në mars, në zonat malore të Veriut, Verilindjes, Juglindjes. Problemet më tipike janë bllokimet e rrugëve (për shkak të gjendjes së keqe të rrugëve dhe mirëmbajtjes së pamjaftueshme). Një situatë e mundshme (bllokim nga bora), për popullsinë e prekur, paraqet probleme serioze nga pikëpamja e ushqimit dhe mbështetjes shëndetësore.
Bashkia e Elbasanit ne stinën e nxehtë është prekur shumë nga zjarret në pyjet dhe kullota të cilat mund të jenë shkaktuar për shkaqe natyrore apo nga veprimtaria njerëzore

FATKEQËSITË NË VITE.
Bazuar në përvojën dhe eksperiencën e krijuar, fatkeqsitë që kanë prekur Bashkinë e Elbasanit janë:
Përmbytje.
Problematike mbeten përmbytjet në Nj. Adm. Labinot Fushë, Papër nga daljet e lumit Shkumbin. Për qytetin e Elbasanit mbetet problematikë zona e Varrezave ajo e Fushës Mbret, Lagja Vullnetari dhe ish NSHU e qytetit të Elbasanit, nga vërshimi i përrenjve Zaranik dhe Manazdere. Në Nj. Adm. Bradashesh, në zonën e Fabrikës Çimentos ka patur permbytje nga vërshimi përroit të Postokavës.
Nga vërshimet e lumit Shkumbin, rrezikohet gërryerja e tokës dhe përmbytje në fshatrat e fushës së Elbasanit (Bujqëz, Jagodinë, Muriqan në Nj. Adm. Shirgjan).
Për mbrojtjen nga përmbytjet dhe gërryerjet dalin disa problematika si më poshtë:
Përroi Zaranikës mbetet problematik. Është riparuar këto vitet e fundit rreth 38 % e shtratit të tij, çka do të thotë se mbetet akoma i pa stabilizuar. Gjatë vitit 2012, 2013 e në vazhdim është bërë i mundur riparimi i çarjeve të mëdha, ndërkohë që gjatë gjithë gjatësisë së tij, baza përroit të Zaranikës është çarë rreth 1 metër gjerësi dhe 40-60 cm thellësi. Njëkohësisht diga e tij është çarë dhe ka dalë jashtë funksioni si pasojë e mbushjes me aluvione duke grumbulluar materiale të ngurta me lartësi rreth një metër mbi pragun e shkarkuesit. Kjo bën të mundur vërshimin e ujit në brigjet anësore duke rrezikuar rreth 300 shtëpi që gjenden atje.
Përsa i përket argjinaturave në lumin Shkumbin mbeten të pa mbuluara me argjinature fshatrat Vidhas, Jagodië, etj. Momentalisht në këto segmente nuk ka rrezik imediat, megjithatë është organizuar vrojtimi i përhershëm i tyre nga Bordi i Kullimit dhe Ujitjes.

Përsa i përket përrenjve malore që përshkojnë fushën e Elbasanit në luginën e Shkumbinit, (rreth 15 përrenj), në Nj.Adm. Shushicë, Papër, etj, mbeten problem masat e inerteve që sjellin nga shpatet e tyre duke bllokuar kolektorët.

Rrëshqitje e tokës (terrenit).
Si rrjedhojë e reshjeve të rëna me intensitet vitet e fundit, kemi patur rëshqitje masive të tokës, kryesisht në Njësitë Administrative. Rreziku mbetet evident. Ka patur rrëshqitje në fshatin Cërujë te Komunës Funar, në fshatin Guri i Zi të Njësisë Administrative Labinot Mal, në fshatrat Polis dhe Shelcan të Njësisë Administrative Shushicë, në fshatrat Lleshan, Pobrat, Maskarth të Njësisë Administrative Gjinar etj. Për pasojë ka patur dëmtime të objekteve të banimit duke i bërë të pa banueshme si pështembull, 12 shtëpi në fshatin Pobrat të Njësisë Administrative Gjinar të cilat u rrënuan krejtësisht, 8 shtëpi në fshatin Polis i Vogël të dëmtuara rëndë dhe 3 shtëpi të dëmtuara rëndë në fshatin Shelcan të Njësisë Administrative Shushicë, rrëshqitje massive toke dhe dëmtim banesash në fshatin Gurabardh dhe Shemhill të Njësisë Administrative Bradashesh, 9 shtëpi në fshatin Zavalinë të Njësisë Administrative Zavalinë etj.
Theksojmë se, si rezultat i shirave të kohëve të fundit ka riaktivizim të rrëshqitjeve në zonat e mësipërme. Për pasojë kemi patur dëmtime të tokave bujqësore. Rreziku mbetet evident në të gjitha vëndet që përmendëm më sipër.

Bllokimi nga bora.
Gjatë sezonit të dimrit, reshjet e borës paraqesin rrezik bllokimi të rrugëve në Bashkinë e Elbasanit për Njësitë Administrative: Labinot Mal, Funar, Gracen, Gjinar e Zavalin.
Rrezik bllokimi paraqesin gjithashtu disa segmente të akseve rrugore nacionale dhe rurale.

Tërmete.
Bashkia e Elbasanit preket nga lëkundjet e herëpasherëshme të tokës dhe përfshihet në zonë sizmike. Në vitet e fundit ka patur tërmete me dëme materiale veçantërisht në disa Njësi Administrative të Bashkisë.

Zjarret.
Prania e zjarreve ka qenë prezente në gjithë Bashkinë e Elbasanit. Janë konstatuar zjarre në disa objekte banimi në qytetin e Elbasanit, në ullishtën e qytetit dhe pyjet në Njësit Administrative Labinot Mal, Labinot Fushë, Shushicë, Tregan, Gracen, Zavalinë. Në të gjithë rastet kemi patur dëmtime në pyje, kullota, ullishta, pemtari dhe objekte banimi.

Llojet e fatkeqesive që kanë prekur Bashkinë e Elbasanit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Llojet e fatkeqësive	Ndikimet e shkaktuara
Tërmetet	Ndërmjet shekullit III para Krishtit dhe deri më sot Shqipëria është goditur nga 55 tërmete të forta me intensitet I -VIII të shkallës MSK-64 nga të cilët 15 kanë qenë me I –IX të shkallës MSK. Nga këto tërmete, që kanë prekur teritorin e bashkisë Elbasan duke shkaktuar dëme në njerëz dhe materiale mund të përmendim: **18 Dhjetor 1920**, tërmeti i rënë në Elbasan me 14 të vdekur, 300 të plagosur, 173 shtëpi të shkatërruara. Lëkundje janë ndjerë, por me intesitet të vogël dhe pa dëme materiale dhe në ato raste kur epiqendrat kanë qenë në zona të ndryshme të Shqipërisë si në: **16.11.1982** tërmet i rënë në rajonet e Fierit, Beratit, Lushnjes, por që është ndier në Elbasan **9.01.1988**, tërmeti i rënë në Tiranë pa dëme materiale, është ndjerë në rrethinat e Elbasanit

	19.05.2014 tërmeti i rënë në Belësh me magnitude 5.2 shkalla Rihter. Nga ky tërmet pati dëme në materiale në disa njësi administrative të Bashkisë Elbasan, nuk pati dëme në njerëz.
Zjarret	Në vite, prania e zjarreve ka qenë e pranishme në të gjithë Bashkinë e Elbasanit. Në të gjithë rastet kemi patur dëmtime në pyje, kullota, ullishta, pemtari si dhe në banesa.
Rrëshqitje masive të tokës	Bashkia e Elbasanit ka si tipar paqëndrueshmërinë masive të tokës që shkaktohet prej faktorëve natyrorë (veprimi mekanik e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, reshjet, veprimi sizmik, etj). Rrëshqitja e tokës kushtëzohet nga reshjet e dendura ose të zgjatura të shiut, tërmetet, shkrirja e shpejtë e borës si dhe nga veprimtaria njerëzore. Rrëshqitje masive të tokës, ka patur në Njësitë Administrative: Funar (2005): fshatrat Branesh, Bixëlle dhe Cërrujë, Labinot Mal (2005): në fshatrat Xibrakë dhe Guri Zi, Bradashesh (2005): fshatrat Gurabardh dhe Shenmihll, Shushicë (2010): fshatrat Polis i Vogël dhe Shelcan, Gjinar (2010): fshatrat Pobrat, Maskarth. Në vitin 2015 kemi riaktivizim të rrëshqitjes së aksit rrugor Elbasan-Gjinar, duke shkaktuar dëmtimin plotësisht të rrugës si dhe rrëshqitje në Nj. Adm. Zavalinë në fashtrat Nezhan, Zavalinë.
Bllokimi nga Dëbora	Bashkia e Elbasanit është i njohur si një vend me shtrirje kodrinore, malore, për bimësinë e paktë të pyjeve në shumë krahina dhe për rëniet e dendura të dëborës. Reshjet e dëborës, veçantërisht të vitit 2012, çuan në bllokimin e disa komunave të Elbasanit. Për pasojë u bllokuan disa fshatra të Nj. Adm. Labinot Mal dhe të Nj. Adm. Funar.
Përmbytjet	Përmbytjet në përgjithësi në bashkinë e Elbasanit janë kryesisht nga vërshimi i përrenjve malore dhe pjesërisht i lumit Shkumbin. Si rezultat i vërshimit të lumit Shkumbin, në vitin 2010 ka patur gërryerje të tokës në Nj. Adm. Shushicë (fshatrat Polis i Vogël, Shushicë), Nj. Adm. Shirgjan (në fshatin Jagodinë), Nj. Adm. Gjergjan (në fshatin Muriqan).

Nga analizat sasiore dhe cilësore të natyrës dhe të rrethanave të ndodhive të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore kemi bërë vlerësimin e rrezikut dhe klasifikimin e tij.
Nga ngjarjet e ndodhura në vite, situatat emergjente klasifikohen si situata rutinë, të cilat përballohen nga vetë institucionet e qeverisjes vendore.
Për situata që paraqesin rrezikshmëri, kemi bashkëpunuar me institucionet përkatëse për kryerjen e investimeve në ato objekte që paraqesin rrezikshmëri për mos përsëritjen e situatave të ngjajshme.
Rëndësi të veçantë do të ketë bashkëpunim me institucionin e prefektit për të hamonizuar bashkëpunimin me institucionet shtetërore në ndërgjegjësimin e komunitetit.

5. EMERGJENCAT CIVILE, STATUSI AKTUAL

Në nivel kombëtar, Këshilli i Ministrave (KM) aprovon strategjitë, politikat, planet dhe programet që lidhen me Reduktimin e Rrezikut të Fatkeqësive RRF&MC Mbrojtja Civile. Gjithashtu ai drejton dhe kordinon aktivitetet e të gjitha institucioneve të përfshira në një emergjencë civile.
Ministria e Brendshme (MB) zbërthen politikat në plane dhe i ekzekuton ato gjatë situatës së emergjencës.
Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) është institucioni kyç për menaxhimin e fatkeqësive. Ajo bashkëpunon me institucionet dhe agjencitë qëndrore, të përfshira në emergjencat civile dhe monitoron gjendjen e emergjencës në të gjithë territorin e Shqipërisë.
Qendra Operacionale Kombëtare për Emergjencat Civile, në varësi të AKMC, luan një rol të pazëvendësueshëm në të gjitha fazat e menaxhimit të emergjencave civile. Ajo është plotësuar me personel shërbimi 24 orë në 7 ditët e javës dhe monitoron situatën në të gjithë territorin shqiptar.
Zyrat e emergjencave civile dhe stacionet për mbrojtjen dhe shpëtimin nga zjarri në rrethe, raportojnë direkt tek kjo qendër.
Ministritë e linjës janë përgjegjëse për planifikimin dhe menaxhimin e emergjencave civile në përshtatje me fushën e tyre të përgjegjësisë.
Aktiviteti i tyre është i inkorporuar në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencës civile dhe sipas rastit, ato luajnë një rol drejtues apo mbështetës, në varësi të natyrës dhe fazës së emergjencës.
Prefektët, Kryetarët e Qarqeve janë përgjegjës për planifikimin dhe menaxhimin e emergjencës civile në njësitë e veta.
Nën kryesimin e tyre ngrihet dhe funksionon Komiteti i Emergjencës, me detyrë kryesore të koordinojë gjithë aktivitetet e njësisë së pushtetit lokal dhe OJQ-ve të angazhuara në atë emergjencë.
Në secilin nga 12 qarqet (nivel prefekture) funksionon një Zyrë për Emergjencat Civile me përgjegjësi për planifikimin dhe koordinimin e reagimit ndaj emergjencës dhe të lidhura me rrjetin e radiove të shërbimit zjarrfikës.
Kryetari i Bashkisë është përgjegjës për planifikimin dhe menaxhimin e emergjencës civile në teritorin e Bashkisë.
Nën kryesimin e tij ngrihet dhe funksionon Komiteti i Emergjencës, me detyrë kryesore të koordinojë gjithë aktivitetet e njësive administrative dhe OJQ-ve të angazhuara në atë emergjencë.

5.1 STRUKTRURAT E DREJTIMIT DHE TË MENAXHIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE kRIZAVE NË NIVEL QENDROR NË SHQIPËRI (sdmeck)

SDMECK në Shqipëri përbëhet nga struktura të përhershme dhe të përkohshme në nivel qendror, qarku dhe lokal. Nëpërmjet këtyre strukturave, çdo ministri, drejtori ose institucion, aktualisht, ka role dhe përgjegjësi të veçanta për të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave. Këto role dhe përgjegjësi ndahen shpesh ndërmjet dy ose më shumë institucioneve, të cilat merren, për shembull, me çështje të tilla, si: furnizimin me ujë, hapjen a kanaleve, ngritjen e mureve mbajtëse, digat ose pritat, si dhe me çështje të tjera. Për të krijuar një pamje më të qartë dhe për arritjen e një bashkërendimi sa më funksional të roleve dhe të përgjegjësive të këtyre strukturave, ku përfshihen institucione shtetërore dhe joshtetërore. Këto role dhe përgjegjësi tashmë janë të përfshira në planet specifike ekzistuese për emergjencat civile të hartuara nga këto institucione. Kur këto institucione kanë rol të caktuar në fazën e përgjigjes, pothuajse në më të shumtën e rasteve ato do të kenë rol korrespondues në fazat e tjera të ciklit të menaxhimit të emergjencave, duke përfshirë këtu parandalimin dhe lehtësimin.

5.2 PËRGJEGJËSITË NË NIVEL KOMBËTAR

Këshilli i Ministrave (KM)
Këshilli i Ministrave drejton **SDMECK**-në në Shqipëri. Ai miraton strategjitë, politikat dhe programet, të cilat kanë si qëllim parandalimin, lehtësimin, përgatitjen dhe përgjigjen ndaj situatave të emergjencave civile.
• Informon presidentin e Republikës dhe Kuvendin e Shqipërisë për situatën e krijuar, rreziqet që paraqiten dhe për masat e marra deri në këtë moment.
• Kur është e nevojshme, kërkon nga Kuvendi i Shqipërisë miratimin e akteve ligjore.
• Nëse është e nevojshme, vendos rialokimin e fondeve shtetërore dhe i propozon Kuvendit të Shqipërisë ndryshimin e ligjit ekzistues"Për buxhetin".
Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të neneve 4, 5, 10 dhe 11, të Ligjit Nr. 8756, 26.03.2001, "Për emergjencat civile", marrëveshjet ndërkombëtare dhe konventat, Këshilli i Ministrave mori **Vendimin Nr. 965**, datë **02.12.2015,** "Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e emergjencave civile dhe krizave", ku u përcaktuan *Strukturat e Drejtimit dhe Menaxhimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në Nivel Qendror.*

Komiteti i Koordinimit të Emergjencave Civile dhe Krizave (KKECK).
Krijohet pranë KM. KKECK aktivizohet me urdhër të Kryetarit në çdo rast EC apo krize,kur vlerësohet se për përballimin e tyre kërkohet bashkërendimi i veprimeve dhe bashkëpunim më i gjerë midis më shumë se një ministrie.
KKECK është organi më i lartë për koordinimin e veprimeve të të gjitha strukturave shtetërore dhe private dhe të burimeve materiale dhe financiare për përballimin e EC dhe krizave.
Përbërja e Komiteti të Koordinimit të Emergjencave Civile dhe Krizave është si më poshtë:

• Zëvendëskryeministri	- Kryetar
• Ministri i Punëve të Brendëshme	- Zëvendëskryetar
• Ministri i Mbrojtjes	- Anëtar
• Ministri i Punëve të Jashtme	- Anëtar
• Ministri i Financave	- Anëtar
• Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	- Anëtar
• Ministri i Energjisë dhe Industrisë	- Anëtar
• Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural & Administrimit të Ujrave	- Anëtar
• Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë & Sipërmarrjes	- Anëtar
• Ministri i Arsimit & Sportit	- Anëtar
• Ministri i Shëndetësisë	- Anëtar
• Ministri i Mjedisit	- Anëtar
• Ministri i Zhvillimit Urban	- Anëtar
• Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	- Anëtar
• Ministri i Drejtësisë	- Anëtar
• Ministri i Kulturës	- Anëtar
• Ministri i Integrimit Europian	- Anëtar
• Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	- Anëtar
• Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	- Anëtar
• Drejtori i Përgjithshëm i Emergjencave Civile	- Anëtar
• Drejtues të Pushtetit Vendor	- Anëtarë

• Në varësi të nevojave,në mbledhjet e KKECK ftohen edhe përfaqësues nga institucione shkencore dhe monitoruese, OJQ etj.
KKECK mblidhet nga Kryetari, sa herë gjykohet e nevojshme.
Të drejtën e propozimit për mbledhjen e KKECK, përveç kryetarit e ka edhe çdo minister, sipas fushës së përgjegjësisë dhe llojit të emergjencës apo krizës.

Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) në Ministrinë e Mbrojtjes, luan rolin e Sekretariatit Teknik të KKECK.
Komiteti i Koordinimit të Emergjencave Civile dhe Krizave bashkërendon aktivitetet e të gjitha institucioneve të përfshira në të gjitha etapat e përgjigjes ndaj situatës së emergjencës civile.
Këto aktivitete janë:

- Përgatit dhe drejton apel për ndihmë ndërkombëtare në rast se është e nevojshme, procedurat e të cilit ndiqen nga Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ).
- Bashkërendon veprimet dhe aktivitetet e institucioneve të strukturave qendrore, vendore, Kryqit të Kuq Shqiptar (KKSH), organizatave vullnetare dhe donatorëve.
- Kërkon përfshirjen e plotë të institucioneve të përfshira në PKEC, si dhe angazhimin e tyre në të gjitha veprimet e nevojshme për përballimin e situatës së emergjencës civile.
- I kërkon Këshillit të Ministrave përdorimin e rezervave shtetërore, përcakton mënyrën e përdorimit të tyre në zonën e goditur nga emergjenca, si dhe përcakton mënyrat dhe procedurat për përdorimin e burimeve materiale dhe financiare që vihen në dispozicion për përballimin e emergjencës.
- Drejton procesin e vlerësimit te dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, analizon mundësitë e riaftësimit të zonës/ave të goditura dhe i propozon Këshillit të Ministrave rrugët e zgjidhjes.
- Në zbatim të detyrave dhe funksioneve të tij, **(KKECK** -ja nxjerr vendime, urdhra dhe udhëzime, të cilat kanë fuqi vepruese për sa kohë zgjat gjendja e Emergjencës Civile .
- Përfundon aktivitetin e tij në momentin kur mbaron gjendja e emergjencës civile.
- Për drejtimin e operacioneve të përgjigjes ndaj emergjencave civile, **KKECK** -ja cakton drejtuesin qendror të operacionit (DQO).

Zyra Operacionale e Situatës (ZOS) është strukturë pranë Kryeministrit për mbledhjen e informacionit për EC dhe krizat.Detyra kryesore e ZOS është hartimi i raporteve analitike për Kryeministrin, KM dhe KKECK si dhe mbajtja e komunukumit të vazhdueshëm ndërmjet Kryeministrisë, MM (AKMC) Zyrës së Informacionit të Menaxhimit të Emergjencave Civile dhe Krizave(ZIMECK), Qendrave Operacionale dhe KKT.
Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në **MM** është autoriteti kryesor për planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e Emergjencave Civile.
Nën drejtimin e Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në **MM**, Krijohet dhe funksionon Komisioni Teknik Këshillimor (**KTK**), i cili këshillon për parandalimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe riaftësimin ndaj emergjencave civile dhe krizave,si në rastet kur nuk është shpallur gjendja e emergjencave civile, ashtu edhe në rastet kur është shpallur.
KTK kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe ka në përbërje përfaqësues të ministrive, strukturave në varësi të tyre dhe intitucioneve, si më poshtë vijon:

- Ministria e Punëve të Brendëshme
- Ministria e Mbrojtjes
- Ministria e Punëve të Jashtme
- Ministria e Financave
- Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
- Ministria e Energjisë dhe Industrisë
- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural & Administrimit të Ujrave
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë & Sipërmarrjes
- Ministria e Arsimit & Sportit
- Ministria e Shëndetësisë
- Ministria e Mjedisit
- Ministria e Zhvillimit Urban
- Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
- Ministria e Drejtësisë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

- Ministri e Kulturës
- Ministria e Integrimit Europian
- Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike
- Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore
- Drejtues të Pushtetit Vendor
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së shtetit
- Drejtoria e Koordinimit me Prefekturat
- Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit
- Drejtoria e Policisë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin
- Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit.
- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
- Instituti i Shëndetit Publik
- Instituti i Fizikës Bërthamore

KTK-ja mblidhet nga Drejtori i Agjansisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, sa herë gjykohet e nevojshme, por **jo më pak se një herë në 3 muaj.**
Në varsi të nevojave, në mbledhjet e **KTK**-së ftohen edhe përfaqësues nga institucione shkencore dhe monitoruese, organizata jo-qeveritare, etj.
Komisioni Teknik Këshillimor ka përgjegjësi:
a) Të shqyrtojë strategjitë, politikat dhe programet në fushën e Mbrojtjes Civile, Shëndetit Publik, Pasurisë, Vlerave Kulturore dhe Mjedisit nga ndikimet e fatkeqsive natyrore apo njerzore.
b) Të përgatisë dhe zhvillojë programe edukimi për strukturat e emergjencave civile dhe publikun fushën e mbrojtjes civile.
c) Të shqyrtojë dokumentin e vlersimit të rreziqeve dhe të mundësitë për përballimin e tyre.
d) Të shqyrtojë planet për përballimin e emergjencave civile të përgatitura nga institucionet shtetërore dhe jo-shtetërore,si dhe të rekomandojë përfshirjen e tyre në Planin Kombëtar të Përballimit të Emergjencave Civile.
e) Tu propozojë Institucioneve të përfaqësuara në KTK, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, masat për parandalimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe riaftësimin ndaj emergjencave civile

Përgjegjëstë ndërinstitucionale për përballimin e Emergjencave Civile dhe Krizave
Në të gjitha Ministritë që kanë përfaqësues në **KKECK,** ngrihen dhe funksionojnë zyrat e informacionit dhe menaxhimit të emergjencave civile dhe krizave (**ZIMEK**)
Në MM funksionin e ZIMEK e mbulon AKMC dhe Qendra e Bashkuar Operacionale. Ministri përcakton paraprakisht kapacitetet njerëzore dhe llogjistike për përballimin e emergjencave civile dhe krizave në nivel ministrie. ZIMEK dhe Qendrat Operacionale janë organe përgjegjëse të Menaxhimit të Emergjencave Civile dhe Krizave.

Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) në **MM,** nëpërmjet Qendrës Kombëtare Operacionale (**QKOEC**), drejton dhe komandon në mënyrë të përqëndruar të gjitha kapacitetet njerëzore dhe logjistike, të parashikuara në planet e përballimit të emergjencave civile.
Në situatat e emergjencave civile dhe krizave, komunikimi ndërinstitucional mbahet duke përdorur kanalet zyrtare të komunikimit. Në rastet e komunikimit verbal, ZOS, ZIMEK/Qendrat Operacionale regjistrojnë dhe ruajnë të gjitha bisedat.
Çdo ministër është përgjegjës për organizimin e planizimit dhe përballimit të dhe ZIMEK-së. Emergjencave Civile në fushën e përgjegjësisë së tij, nëpërmjet Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile.
Ministrat delegojnë autoritet drejtimi dhe komandimi te ZIMEK/Qendrat Operacionale nëpërmjet të cilit autorizojnë punonjësit përkatës për të përdorur kapacitetet njerëzore dhe llogjistike për përballimin e emergjencave civile dhe krizave në rast emergjence civile.

Punonjësit e autorizuar sipas pikës së mësipërme aktivizojnë me urdhër dhe kërkesë të Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC), kapacitetet e parashikuara për Emergjencë Civile. Në rastin më të parë të mundshëm, por asnjëherë më vonë se 2 orë nga marrja e njoftimit ata lajmërojnë ministrin përkatës për masat e marra për përballimin e emergjencës civile ose të krizës. Për përballimin e emergjencave civile dhe krizave me specifika të veçanta, me kërkesë të **AKMC**, mund të angazhohen edhe autoritete dhe institucione të tjera shtetërore, përveç atyre të përcaktuara në VKM Nr. 965 datë 02.12.2015.

Komunikimi me publikun

- Kur nuk është shpallur gjendje e Emergjencës Civile, komunikimi me publikun bëhet nga MM.
- Kur është shpallur gjendje e Emergjencës Civile, komunikimi me publikun bëhet i përqëndruar nga zyra e Kryeministrit.

Struktrurat Operacionale kryesore të Autoriteteve dhe Institucioneve Shtetërore përgjegjëse për përballimin e Emergjencave Civile dhe Krizave

1-Ministria e Punëve të Brendëshme

- Drejtoria e Përgjithëshme e Policisë së Shtetit (DPPSH)
- Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC)
- Drejtoria e Përgjithëshme e Rezervave Materiale të Shtetit
- Drejtoria e Policisë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin
- Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT)

2-Ministria e Mbrojtjes

- **Strukturat e Rajonale** (Batalioni i Mbrojtjes Rajonale) Kukës, Shkodër, Mat, Gjirokastër, Berat, Korçë pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.
- Njësia e Helikopterëve pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.
- Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit

3-Ministria e Financave

- Drejtoria e Përgjithëshme e Doganave

4-Ministria e Transportit dhe e Infrastrukturës

- Drejtoria e Politikave të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta
- Autoriteti Rrugor Shqiptar
- Organi Kombëtar i Investigimeve të Aksidenteve dhe Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil
- Drejtoria e Përgjithëshme Detare
- Instituti i Transportit
- Drejtoria e Përgjithëshme e Ujësjellës-Kanalizimeve
- Drejtoria e Përgjithëshme e Shërbimit të Transportit Rrugor
- Autoriteti i Aviacionit Civil
- Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar

5-Ministria e Energjisë dhe Industrisë

- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
- Agjensia Kombëtare Bërthamore
- Reparti i Inspektim dhe Shpëtim Minierave
- OSHEE/ OST/ KESH

6-Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave

- Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë
- Bordet e Kullimit
- Organi Kombëtar i Ushqimit
- Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV)

7-Ministria e Zhvillimit Ekonomok, Turizmit,Tregëtisë dhe Sipërmarrjes

- Agjensia Kombëtare e Turizmit

- Agjensia Kombëtare e Bregdetit

8-Ministria e Shëndetsisë

- Autoriteti Shëndetsor Rajonal Tiranë
- Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)
- Zyra e Mbrojtes nga Rrezatimet (ZMR) pranë Institutit të Shëndetit Publik
- Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut
- Njësia e Transportit Mjeksor me Helikoter
- Agjensia Kombëtare e Baranave dhe Pajisjeve Mjeksore
- Drejtoritë e Shëndetit Publik (11 Rajonale dhe 24 Rrethi)

-Komisioni i Mbrojtes nga Rrezatimet

9-Ministria e Mjedisit Ministria e Zhvillimit Urban

-Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.

- Agjensia Kombëtare e Mjedisit
- Agjensia Rajonale Mjedisore
- Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
- Drejtoritë e Shërbimit Pyjor
- Agjensitë e Ujit dhe Baseneve
- Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare

10-Ministria e Zhvillimit Urban

- Drejtoria e Shërbimeve Urbane dhe Strehimeve

11-Ministria e Drejtësisë

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

12-Universiteti Politeknik i Tiranës

- Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit

Në rast të Emergjencave Civile, Ekipi i Menaxhimit të Emergencave Civile dhe Krizave funksionon mbi bazën e katër sektorëve kryesorë, të cilët janë:

- 1-Sektori i informacionit (personeli i përhershëm i **QKOEC**-së, zëdhënësi),
- 2-Sektori i planifikimi,
- 3- Sektori Operacional
- 4- Sektori i Logjistikës

5.3 STRUKTRURAT E DREJTIMIT DHE TË MENAXHIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE kRIZAVE NË NIVEL RAJONAL DHE VENDOR NË SHQIPËRI

Sistemi i Menaxhimit te Emergjencave Civile (SMEC) përbëhet nga struktura të përhershme, të përkohëshme, në nivel qarku dhe vendor.

Strukturat e përhershme:

Në përbërje të adıninistrates së Prefektit funksionon Sektori i Emergjencave Civile

Struktrurat e drejtimit dhe të Menaxhimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në nivel Qarku

Detyrat e Prefektit sipas Ligjit Nr. 45/2019. "Për Mbrojtjen Civile" dhe të Ligjit Nr. 107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut"

Prefekti

Prefekti është përgjegjës për drejtimin e strukturave parandalimin, menaxhimin, rehabilitimin e pasojave në rastet e emergjencave civile.

Prefekti ka për detyrë:

a) Të organizojë dhe të bashkërendojë punën për hartimin e planeve të përgatitjes për emergjencë civile në qark dhe për zbatimin e masave të mbrojtjes.

b) Të grumbullojë dhe të përpunojë të dhënat e nevojshme nga bashkitë për zbatimin e detyrave të planizimit dhe përballimit të emergjencave civile.

c) Të ndjekë dhe të kërkojë nga organet vartëse skemat e lajmërimit dhe të funksionimit të tyre.

d) Të parashikojë burimet dhe rezervat e nevojshme materiale dhe financiare, për sistemimin e popullsisë në raste emergjence nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera.

e) Të realizojë organizimin, bashkërendimin dhe pajisjen e forcave operacionale.

f) Të ndjekë realizimin e detyrave për lehtësimin e efekteve të emergjencës civile dhe për organizimin e ndërhyrjes për të vepruar.

g) Të ndjekë riaftësimin nga fatkeqësitë natyre ose nga fatkeqësitë e tjera.

h) Të analizojë gjendjen e planizimit të emergjencave civile dhe të njoftojë Departamentin e Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave për emergjencat civile që ndodhin në Qark.

i) Të paraqesë kërkesë për ndihmë në qarqet fqinjë dhe në instancat qendrore kur situitat e emergjencave civile janë përtej mundësive apo kapaciteteve të qarkut, duke kërkuar të shpallet gjendja e emergjencës civile në një pjese ose në të gjithë teritorin e qarkut.

j) Të caktojë drejtuesin e operacionit për përballimin e emergjencës civile brenda qarkut të tij.

- Monitoron dhe menaxhon situatën emergjente nëpërmjet koordinimit të strukturave qendrore të pranishme në këtë nivel, të cilat janë të përfshira në planin e emergjencave civile të qarkut.
- Thërret komisionin e emergjencave civile ne qark (KECQ).
- Mban kontakte të vazhdueshme dhe bashkërendon veprimet me MM, MPB-me (DPPEC), me KNEC-in si dhe me DQO-ne, në vartësi të situatës dhe me Kryeministrin.

Organizimi në Qark.

1. Në çdo qark, nën drejtimin e Prefektit, ngrihet një komision i qarkut me detyrë bashkërendimin e veprimtarive të autoriteteve të qarkut dhe të organizatave vullnetare.
2. Ministri i Punëve të Brendëshme përcakton përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe përgjegjësitë e këtij komisioni.
3. Prefekti mban regjistër për specialistët në qark, me të cilët ai këshillohet kur gjykohet e nevojshme.
4. Këshilli i Qarkut është i përfshirë në menaxhimin e E.C. dhe Krizave,duke bashkëpunuar me Administratën e Prefektit dhe KPPECQ, si dhe autoritetet e Bashkive.

Këshilli i Qarkut kryen këto detyra:

-Angazhon administratën dhe strukturat e tij aktive në procesin e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara dhe të nevojave,si dhe përballimin e situates emergjente.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

-Në bashkëpunim me srukturat e autoriteteve vendore, përcakton vendet për krijimin e vendbanimeve të përkohëshme, magazinat e përkohëshme dhe pikat e shpërndarjes, terrenet për varreza masive dhe nevoja të tjera të mundëshme.

Shërbimi i Emergjencës Civile në nivel Qarku.

1. Në çdo Qark, nën drejtimin e Prefektit, funksionon shërbimi i emergjencës civile, si pjesë përbërëse e sistemit të planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile, në përputhje me përcaktimin e pikës 13 të nenit 2 të këtij ligji.
2. Rregullat, mënyra e funksionimit, të drejtat dhe detyrat, si dhe përgjegjësitë e shërbimit të emergjencës civile përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.
3. Në bazë të **VKM. Nr.965, datë 02.12.2015** *"Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e emergjencave civile dhe krizave"*, **pika 23,** në përbërje të strukturës së administratës së Prefektit ngrihet dhe funksionon "Sektori i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave.

ORGANIZIMI NË BASHKI

Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në Nivel Bashkie

Në bazë të UDHËZIMIT Nr. 15, datë 10.07.2003 i Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, për "Ngritjen e Komisionit të Planifikimit të Emergjencave Civile në Bashki dhe Komuna" i cili bazohet në nenin 13, pika 2, të ligjit Nr. 8756, 26 mars 2001, "Për emergjencat civile", si dhe të pikës 5/a, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 655 dt. 18.12.2000, "Për ngritjen dhe funksionimin e strukturës së sistemit kombëtar të planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile", me urdhër të Kryetarit të Bashkisë krijohet dhe funksionon ***Komisioni Vendor i Emergjencave Civile oë Bashkinë Elbasan,*** i cili ka në përbërje:

Kryetari i Bashkisë	Kryetar
Nënkryetari	Zv/Kryetar
Drejtori i Emergjencave Civile	Sekretar
Përgjegjësi i Sektorit të PMNZSH	Anëtar
Shefi i Komisarjatit të Policisë Elbasan	Anëtar
Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Infrastrukturore	Anëtar
Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Operacionale	Anëtar
Drejtori i Agjensisë së Shërbimeve Publike	Anëtar
Drejtori i Shëndetit Publik	Anëtar
Drejtori i Kulturës Rinisë dhe Sportit	Anëtar
Drejtori i Shërbimit Territorit Urban (Specialisti i Transportit)	Anëtar
Drejtori i Zyrës Juridike	Anëtar
Drejtori i Buxhet Financës	Anëtar
Përfaqësuesi i Kryqit të Kuq	Anëtar

Në përbërje të këtij komisioni janë edhe Administratorët e Njësive Vendore, Kryetaret e Fshatrave për ngjarjet që ndodhin në zonat që kanë nën administrim.

Detyrat dhe mënyra e funksionimit të Komisionit Vendor të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në bashkinë e Elbasanit.

A. Detyrat.
   1) Komisioni i planifikimit dhe përballimit të emegjencave civile planifikon, organizon, koordinon dhe kontrollon të gjithë masat parandaluese, lehtësuese dhe rehabilituese për përballimin e emergjencave civile në territorin e bashkisë.
   2) Komisioni harton dhe miraton planet e përballimit të emegjencave civile në territorin e Bashkisë dhe i dërgon ato për aprovim e koordinim tek Prefekti i Qarkut.

3) Komisioni bashkëpunon me Komisionin e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në Qark për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera si dhe riaftësimin e zonave të dëmtuara.
4) Komisioni bashkërendon veprimtaritë për organizimin dhe pajisjen e forcave të ndërhyrjes në raste emergjente.
5) Komisioni evidenton burimet materiale dhe financiare shtetërore e joshtetërore, si dhe përcakton mënyrën e përdorimit të tyre në situata emergjente.
6) Komisioni ndjek e zbaton urdhërat, udhëzimet dhe detyrat që i ngarkohen drejtpërdrejt ose me delegim nga strukturat qëndrore të emegjencave civile.
7) Komisioni jep informacion pranë Qendrës Kombëtare të Emegjencave Civile, në situata emergjente dhe ngarkon sekretarin e tij, për të dhënë informacion në periudhë normale.
8) Komisioni përgatit dhe përpunon programe trajnimi, me skenarë situatash emergjente për përgatitjen e personelit që menaxhon emergjencat civile, si dhe të komunitetit.

B. Funksionimi
1) Komisioni funksionon në situata normale dhe situata emergjente.
2) Organizimi, radha e mbledhjeve, takimeve, konsultimeve rendi i ditës si dhe gjithë modalitetet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e tij, propozohen nga Kryetari dhe miratohen në mbledhjen e parë të Komisionit.
3) Komisioni mblidhet sa herë e sheh të arsyeshme në situata normale dhe qëndron i mbledhur kur shfaqen situata të emegjencave civile.
4) Sekretari i komisionit, merret me përgatitjen e të gjithë materialeve të mbledhjeve të rradhës së komisionit.

Drejtuesi i Operacionit në Bashki (DOB)

Në situatën e emergjences civile, burimet materiale dhe njerëzore te listuara në planet e emergjencave të Bashkisë, vendosen nën autoritetin e drejtuesit të operacineve në Bashki. Ai është përgjegjës për menaxhimin e operacioneve të emergjencave civile dhe kryen këto detyra:
Bashkërendon strukturat qëndrore në nivel lokal, si dhe strukturat e tjera qendrore ose ndërkombetare që vijnë në ndihmë.
Mban lidhje të rregullta dhe kontakte të vazhdueshme me drejtuesit e tjere të operacioneve në nivel vendor (Bashkive fqinje) dhe të qarkut, informon dhe kërkon asistencë nga KPPECQ-ja dhe DQO-ja.

KRYETARI I BASHKISË

↓

Komisioni Vendor i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në Bashki

→ **Drejtuesi i Operacionit në nivel Bashkie**
Qendra Operacionale në nivel Qarku

→ **Sek. Planifikimit**

→ **Sekt. Operacional**

→ **Sekt. Lodjistikës**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Drejtuesit e Njësive Administrative kanë përgjegjësi për përgatitjen, planifikimin dhe operacionet e përgjigjes ndaj situatave emergjente që ndodhin në territotin e tyre. Menaxhimi i emergjencave civile bëhet në përputhje me planet e emergjencave ose planet e gadishmerisë që ato përgatitin dhe rifreskojnë periodikisht.
Të gjitha Njësitë Administrative krijojnë dhe mbajnë një sistem të:

- Njoftimit të hershëm dhe informimit të strukturave kryesore.
- Alarmit dhe evakuimit të popullsisë.
- Skuadrave, grupeve dhe strukturave të tjera aktive të përgatitura për të parandaluar, për të lehtësuar dhe për t'u përgjigjur në raste të emergjencave civile.
- Ndërmarrin dhe administrojnë aktivitetet e rehabilitimit për zonën e prekur nga emergjenca.

Komisioni Vendor i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në Bashki (KVPPECB) përgjigjet për marrjen e masave për parandalimin, lehtësimin, përgjigjen dhe riaftësimin e zonës së dëmtuar.
KVPPECB drejton dhe kordinon aktivitete të dhënies së ndihmës, strehimit të përkohshëm, dhënien e ndihmës së parë, shpërndarjen e ndihmave, vlerësimin e dëmeve dhe evidntimin e kërkesave për ndihmë, ruajtjen e higjenës dhe furnizimi me ujë, mirëmbajtjen e kanalizimeve, trajtimin e viktimave, pritjen dhe trajtimin e grupeve të kërkim shpëtimit dhe grupeve të vullnetarëve, si dhe probleme të tjera që lidhen me përballimin e emergjencave civile.

KRYETARI I BASHKISË

↓

Komisioni Vendor i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në Bashki

→ **Drejtuesi Operacional në nivel Bashkie**
Qendra Operacionale në nivel Bashkie

→ **Sekt. Operacioneve**

→ **Sekt. Logjistikës**

→ **Strukturat e Ndërhyrjes në Bashki**

→ **Strukturat Qendrore të Përgjigjes në Nivel Lokal**

→ **Strukturat Qëndrore**

→ **Kryqi i Kuq, Grupet Ndërkombëtare, Vullnetarët, Donatorët**

Komisioni Vendor i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në Bashki (KVPPECB) është përgjegjës për:

- Hartimin e masave për parandalim, lehtësiin, përgatitjen, mbrojtjen dhe përgjigjen ndaj emergjencave civile.

- Sigurimin e vendstrehimeve të përkohshme të sigurta.
- Vlerësimin e dëmeve dhe të nevojave.
- Mbajtjen e kushteve higjenike duke siguruar furnizimin me ujë, mirëmbajtjen e kanalizimeve dhe kujdesin për viktimat.
- Bashkërendimin dhe mbështetjen për grupet e kërkim-shpëtimit dhe të vullnetarëve.
- Çështje të tjera që kanë për qëllim përgjigjen efektive ndaj situatës së emergjencës civile.

Në Bashki veprojnë: struktura monitoruese/njoftuese, struktura vepruese/aktive dhe struktura mbështetëse.

Këto struktura në misionin e tyre kanë detyra në të gjitha fazat e menaxhimit të emergjencave civile dhe bashkëpunojnë ngushtësisht me njëra-tjetrën në përballimin e emergjencave.

Srukturat monitoruese.

Struktura monitoruese në Bashki jane: Salla Operative e Policisë, Shërbimi Zjarrfikës, Srukturat e EC në administratën e Prefektit, Drejtoria e Emergjancave Civile në Bashki, stacioni hidrometeorologjik e sizmik.

Strukturat vepruese aktive.

Strukturat kryesore aktive ose forcat operacionale janë: Forcat Vepruese Aktive (Komisariati i Policisë Elbasan), SHMNZSH, Shërbimi Ambulator dhe Shërbimi Spitalor të cilët kryejnë funksionet e tyre në parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile. Këto struktura janë forca të shërbimit të mbrojtjes civile në varësi të prefektit e të Kryetarit të Bashkisë. Gjithashtu pjesë e strukturave të EC vepruese është dhe vetë komuniteti.

Strukturat mbështetëse.

Strukturat mbështëtese në Bashki janë: Inspektoriati Shtetëror i Pyjeve, Mjedisit dhe Ujrave, Drejtoria Rajonale e Bordit të Kullimit Korçë (Sektori Elbasan), OSHEE, OST, Nj.T.L, Drejtoria Rajonale e Buqesisë, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Drejtoria Rajonale e Arsimit, Rajoni Qendror Rrugor Tiranë, Drejtoria Rajonale e Rezevave Materiale të Shtetit, Agjensia Rajonale e Mjedisit, Grupet vullnetareve, KKSH, Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, OJF-të.

Sistemi Shërbimit të Emergjencave Civile të Bashki.

SSHECB është pjesë e SKSHEC-se dhe është tërësia e strukturave, burimeve njerëzore dhe materiale, shtetërore dhe jo shtetërore, të cilat angazhohen për përballimin e situatave emergjente.

Ai përbëhet nga struktura të përhershme dhe të përkohëshme të cilat, në vartësi të kapaciteteve, aktivizohen sipas situatave që mund të krijohen. Me aktivizimin e këtij sistemi sigurohet një përgjigje e përshtatshme dhe e menjëhershme për të gjitha llojet e fatkeqësive edhe nëse nuk është dhënë alarmi për rritjen e gadishmërisë.

Shpërndarja dhe Transmetimi i Informacionit Publik.

Informimi i publikut është element thelbësor i njoftimit të hershëm, parapërgatitjes dhe këshillimit të komunitetit. Informimi i publikut mund të luaj rol të rëndësishëm në shpëtimin e jetës së njerëzve dhe pasurisë së tyre në raste emergjencash civile. Qartësia, korrektësia dhe shpejtësia e dhënies së informacionit është mjaft e rëndesishme në raste të emergjencave civile e cila sigurohet në nivel qëndror e lokal nëpërmjet njoftimeve periodike të QKOEC, QOECQ-në, Drejtorisë së Emergjencave Civile në Bashki dhe DOB-së.

Çështjet financiare.

Situatat e EC sjellin ndërlikime financiare afatshkurtër dhe afatgjatë; organet e qeverisjes fondet i kanë të kufizuara. Problemet për përballimin e kostove financiare në fazën e përgjigjes dhe në vazhdimësi janë të strukturave qëndrore që janë në emergjencë. Megjithatë masat duhet të jenë të planifikuara paraprakisht dhe të jenë të aplikueshme për strukturat dhe shërbimet e përfshira në zgjidhjen e çështjeve të emergjencave civile.

Në të gjitha organet e pushtetit vendor dhe strukturat duhet të ekzistojnë plane dhe marrëveshje në mënyrë që të mbulojnë automatikisht kostot për marrjen e mjeteve të transportit, shoferëve dhe karburantit, për të mundësuar vlerësimet e menjëhershme të situatës dhe përgjigjen e menjëhershme ndaj situatës emergjente.

Rimbursimi i menjëhershëm i shpenzimeve të personelit të emergjencave në fazën e parë të përgjigjes së menjëhershme.
Lidhja e kontratave ose marrëveshjeve paraprake në kohë të qetë që vihen në zbatim në kohë emergjencash civile.
Këto bëjnë të mundur lejimin e shërbimeve, psh, atë të makinerive të rënda që të kërkohen urgjentisht tek kontraktoret dhe pagës që behet në një fazë të mëvonshme siç parashikohet në marreveshje.
Sipas mundësive financiare është e nevojshme të parashikohen kostot e mundshme të përgjigjes ndaj emergjencave duke marrë për bazë përvojat e kaluara, stërvitjet stimuluese dhe të përfshihen në buxhetin vjetor në zë të veçantë. Për përdorimin e këtij fondi duhet krijuar akses në çeljen e tij dhe përdorimin në mënyrë sa më fleksibël në kohë emergjente.

Raportimet dhe vlerësimet.
Raportimet për situatën merren nga institucionet dhe strukturat e ndryshme dhe për t'u njehsuar, në mënyrë që ato të pasqyrojnë të gjithë informacionin që kërkohet, formularët standartë të raporteve për situatën, dëmet dhe nevojat janë paraqitur në manualet e dërguara nga MPVD-ja dhe janë dërguar modelet nga zyra e EC të Prefektit të qarkut në të gjitha institucionet dhe organet e pushtetit vendor, të cilët janë:
Formulari i njoftimit të parë.
Raporti i të dhënave të para për fatkeqësinë.
Kërkesë për ministritë e linjës për raste emergjence.
Formularët e vlerësimit të menjëhershëm të nevojave dhe dëmeve që jepen në manualet e emergjencave civile, janë mjete praktike, nëpërmjet të cilave merret informacion për nevojat e menjëhershme dhe dëmet e shkaktuara, për plotësimin e të cilit duhet të kontribojnë në mënyrë aktive të gjithë autoritetet përkatëse.
Formulari i raportit të të dhënave të para për fatkeqësinë duhet të përgatitet nga grupet e përbashkëta të vlerësimit. Sidoqoftë, para kësaj, nga ana e Prefektit (Zyra e EC) dhe i Kryetarit të Bashkisë (drejtuesit i EC), duke përdorur të njëjtin format, çdo kontribut i mundshëm është mjaft i rëndësishëm. Në situatë të tejskajshme, mund të bëhen ndërhyrje të menjëhershme paraprake si: evakuimi në masë i popullsisë, operacione kërkim-shpëtimi, dhënia e ndihmës mjeksore dhe aktivitete të tjera prioritare, përpara ose gjatë bërjes së vlerësimit të nevojave.
Vlerësime të tjera pasuese do të bëhen duke përdorur të njejtën metodologji dhe mënyre pune, por më të detajuara në bazë të informacioneve të grumbulluara.

Rikthimi në gjendjen normale
Rikthimi në gjendjen normale përkufizohet si:
Terësia e të gjithë masave për të siguruar që jeta dhe prona e komunitetit të prekur të rivendoset në të njejtin nivel si edhe përpara situatës së emergjencës civile.
Çeshtjet e rikthimit në gjëndjen normale trajtohen në ligjin nr 45/2019, në të cilin faza cilësohet me termin "riaftësim" dhe nënkupton masat dhe veprimet që kryhen për rikthimin në gjëndjen e mëparshme të rajonit (territorit) të prekur nga fatkeqesia".
Megjithëse faza e rikthimit në gjëndjen normale vjen pas fazës së përgjigjes, ajo është gjithashtu e lidhur ngushtë me fazën tjetër të ciklit të emergjencave, parandalimin dhe lehtësimin dhe në këtë mënyrë mbyllet cikli i menaxhimit të emergjencave.
Faza e rikthimit në gjendjen normale është zakonisht koha për të promovuar veprimet e lehtësimit, për të kërkuar në mënyre aktive mbështetjen për aktivitetet e këtij procesi në të arthmen, sepse kujtesa e pasojave të emergjencës është ende e freskët për të gjithë komunitetin e prekur dhe strukturat e përfshira.
Rikthimi në gjendjen normale është gjithashtu edhe një kohë për të vlerësuar efektivitetin e planeve të emergjencave dhe të veprimeve të ndërmarra në kuadër të përgjigjes.
Rikthimi në gjendjen normale fillon nga momenti i deklarimit të përfundimit të situatës së emergjences civile, mund të duhen ditë, muaj ose vite për të realizuar rikthimin e plotë në normalitet. Ka raste negative kur rikthimi i plotë në gjendjen normale nuk mund të bëhet si rezultat i humbjes së jetëve të njerëzve, gjësë së gjallë ose kur objektet e banimit dhe infrastruktura e shkatërruar nuk mund të ndërtohen më. Për

këtë arsye, çështjet e rikthimit në gjendjen normale kanë nevojë për angazhime afatshkurtra dhe aftgjata zhvillimi.

Largimi dhe zvogëlimi i rreziqeve direkte.

Vlerësimi teknik dhe informacioni i saktë është i domosdoshëm për t'u siguruar që rreziku i ardhur si rezultat i shfaqies së dukurive që shkakton situatën e emergjencës civile, nuk është më evident ose intensiteti i tij është zvogëluar deri në nivele të pranueshme dhe të sigurta. Gjithashtu, vlerësimi dhe informacioni janë me rëndësi të veçantë për konstatimin se nuk ka tregues të kthimit të menjëhershëm në nivelet e intensitetit të mëparshëm të rrezikut. Në varësi të dukurisë së mundshme të rrezikut në fjalë, strukturat monitoruese, etj, luajnë role të rëndësishme për vlerësimin e rreziqeve, për të bërë analizën dhe për të mbajtur e ruajtur lidhjet e tyre me institucionet rajonale shkencore.

Këto informacione duhet të plotësohen dhe të krahasohen nga vëzhgimet dhe të dhënat e mbledhura dhe të analizuara nga strukturat e emergjencave civile në zonat e prekura.

Këtu përfshihet informacion rreth:

Nivelit të ujrave në lumenj, rezervuare, në kanale dhe në zonën e përmbytur.

Treguesve për reshjet dhe prurjet.

Shpejtësisë së erës lokale/llojeve të drejtimit.

Ndryshimeve lokale të temperaturës.

Monitorimit të objekteve dhe të terreneve të cilat përbëjnë rrezik potencial.

Nivelit dhe shpeshtësisë të goditjeve sizmike pas asaj kryesore, etj.

Stabilizimi i pasojave që vijnë nga burime dytësore rreziku.

Stabilizimi i çdo dukurie dytësore të rrezikut të mundshëm është thelbësor për të siguruar rikthimin në gjendje normale. Vlerësimet e veçanta teknike si dhe konsultat janë të nevojshme për t'u bërë nga strukturat që kanë ekspertizë dhe kompetenca të veçanta, për të arritur rezultate në vlerësimin e dukurive dytësore të rrezikut.

Strukturat e specializuara përfshijnë:

Drejtoria Bujqësisë.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (Kontrollin e produkteve ushqimore, shërbimet veterinare).

Inspektoriati Shtetëror i Pyjeve, Ujërave dhe Mjedisit.

Autoriteti Rrugor Shqiptar Rajoni Qëndror (Rrugët nacionale).

Njësitë e Qeverisjes Vendore.

Drejtoria e Shëndetit Publik, Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor Parësor, Spitale, Shërbimi Farmaceutik etj.

Drejtoria e Policisë së Qarkut (Salla Operacionale të Emergjencave, Policinë e Rendit, Policinë Rrugore, Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë).

Agjensia Rajonale e Mjedisit.

OSHEE (Axhensitë Elektrike në rrethe, për furnizim-shpërndarjen e energjisë elektrike, etj).

Drejtoria Rajonale Arsimore (Për edukimin në sistemin arsimor dhe objektet shkollore).

Strukturat e dëmtuara dhe të shkatërruara.

Pajisjet dhe strukturat ndërtimore, infrastrukturore të shkatërruara si dhe ato të dëmtuara, që janë përtej mundësive për t'u riparuar menjëherë, janë sfida të pashmangshme në fazën e rikthimit në gjendjen normale. Kjo do të thotë që një pjesë e popullsisë nuk do të mund t'u kthehet menjëherë kushteve normale të jetës ose punës.

Këtu mund të përmendim zonat e shkatërruara nga zjarret ose toka bujqësore të përfshira nga përmbytjet apo të mbushura me aluvione. Niveli i ulët i sigurimit të banesave pranë institucioneve përkatëse, nënkupton që, pas ndodhjes së një emergjence civile, si rezultat i së cilës dëmtohen një numur i madh banorësh, banorët e dëmtuar janë në vartësi vetëm të asistencës shtetërore ose të asaj humanitare.

Për rikthimin në gjendjen normale, kërkohet marrja e masave si më poshtë:

Këshillimi. Sigurimi i informacionit të nevojshëm dhe këshilla për banorët që e kanë të pamundur kthimin në shtëpitë apo në zonat e tyre të banimit.

Strehimi. Sigurimi i burimeve të nevojshme për strehimin e menjëhershëm dhe në vazhdimësi të popullsisë, derisa të gjendet një strehim i përhershëm.

Asistenca. Sigurimi i asistencës së vazhdueshme derisa banorët, grupet apo komuniteti i prekur të jetë në gjendje të fitojnë një masë sigurie dhe besimi në vetvete.
Rindërtimi. Sigurimi i të gjitha hapësirave të mundëshme për gjetjen e materialeve të ndërtimit dhe të shërbimeve, atje ku rindërtimi ose ndërtimi i pjesëshëm është i mundur.
Shembja. Sigurimi i kushteve të tilla që ndërtesat e dëmtuara apo pjesërisht të shkatërruara që përbëjnë rrezik, të mund të bëhen të sigurta apo të shemben fare, nëse është e nevojshme.
Zhvendosja. Atje ku kthimi nuk është i mundur të sigurohet, dhënia e të gjitha mjeteve të mundëshme për të zhvendosur banorët në një vendbanim më të përshtatshëm, të sigurtë, nga të njëjtat shkaqe rreziku ose rreziqe që mund të shkaktojnë emergjenca civile të ngjajshme me to.

6. KAPACITETET E BASHKISË PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE PËR PËRGJIGJEN NË RASTE TE EMERGJENCAVE CIVILE

Në Bashkinë e Elbasanit, kapacitetet operacionale kryesore në lidhje me RRF&MC, përbëhen nga forca e mjete të dala nga:

- Policia e Shtetit.
- Shërbimi për Mbrojtjen dhe Shpëtimin nga Zjarri.
- Shërbimi i Urgjencës (shëndetësore).
- Drejtoria e Rezervave Shtetërore.
- Struktura të tjera monitoruese dhe operacionale.

Kapacitetet e Bashkisë së Elbasanit Për Menaxhimin Emergjencave Civile dhe Krizave

Gjendja e burimeve njerëzore dhe logjistike aktuale në Bashkinë Elbasan në Sektorin Publik dhe Privat, që angazhohen në raste emergjencash civile për Vitin 2021

Nr	Subjektet publike private dhe i organizatave te ndryshme	Burimet njerëzore dhe logjistike														
		Personel	Eskavator	Fadroma	Vinça	Makina transporti të llojeve të ndryshme	Mjete Zjarrëfikese	**Borëpastruese**	Pompa thithëse Uji	Autoambulanca	Laborator për analiza Uji i Pijshem	Laborator për Ushqimin	Nr i shtretërve për evakuim, (Spitale,	Ambjente të Lira për evakuim në m2	Çadër për strehim	Kapaciteti per Grumbullim personash
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11	12	13	14	15	16	17	18
1	Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Elbasan	100				10										
2	Drejtoria Rajonale e Bordit të Kullimit Korçë	15	4			3										
3	Drejtoria Rajonale Qëndrore Tiranë															
	"Viktoria Invest"		1			3		1								
	Alko Impekx		1			3		1								
	Selami shpk		1			3		1								
4	Drejtoria e Ujësjellësit Elbasan	152				2			1							
5	OSHEE Elbasan	222			1	9										
6	OSHEE Nj. T. Lartë	73				4										
7	O.S.T. Elbasan	67			1	6										
8	Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Elbasan	49				1										
9	AKU Elbasan	22				1										

10	Inspektoriati Shtetëror i Pyjeve dhe Mjedisit Elbasan	36				1										
11	A.Z. Mbrojtura Elbasan	24														
12	Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik Elbasan	494										1				
13	Drejtoria e Shërbimit Spitalor Elbasan	377				2					8		430			
14	Drejtoria Rajonale e Rezervave të Shtetit	12				10										
	Labinot Fushë													40000		
	Depo Magazinimi													1200		
15	Ish Reparte Ushtarake															
	Zaranika													120000		
	Ullishta													200000		
	Shkumbini													25000		
	Fushë Mjekës													100000		
16	Bashkia Elbasan	532	37	18	7	86			5							
17	Drejtoria e Trajtimit të Studenteve (3 konvikte)												1270			
18	Konvikti i Pedagogjikes												300			
19	Hotele, Motele												800			
20	Vende për grumbullim popullate															
	Elbasan Arena															3500
	Pallati i Sportit Elbasan															500
21	Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi Elbasan	31				1	3		3							
	TOTALI	**2206**	**44**	**18**	**9**	**145**	**3**	**3**	**9**	**0**	**8**	**1**	**2800**	**486200**	**0**	**4000**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në nivel Bashkie

Nr	Pozicioni	Emer Mbiemër		Tel. Fix.	Celular
1	Kryetari i Bashkisë	Gledian Llatja	Kryetar		**0674011599**
2	Nënkryetari i Linjës	Irland Sina	Nenkryetar		**0686361623**
3	Drejtori i Emergjencave Civile	Ndriçim Sinani	Sekretar		**0694901627**
4	Përgjegjësi i Sektorit të PMNZSH	Tajar Alla	Anetar		**0694111034**
5	Shefi i Komisariatit të Policisë Elbasan	Alfred Cenaj	Anetar		**0694105493**
06	Drejtori i Shëndetit Publik	Ermira Urupi	Anetar		**0674524202**
7	Drejtori i Qëndrës Spitalore	Luan Rrapi	Anetar		**0672074894**
8	Drejtori i Zyrës Arsimit Elbasan	Ermir Cela	Anetar		**0697801932**
9	Drejtori i Për. i Sh.I.	Servo Mehmeti	Anetar		**0696705544**
10	Drejtori i Për. i Sh.O.	Alba Cani	Anetar		**0692022717**
11	Drejtori i A.Sh.P.	Edvin Palloshi	Anetar		**0697444434**
12	Drejtori i A.Sh.P.V.B.	Shpëtim Çullhaj	Anetar		**0674567988**
13	Drejtori i Kulturës Rinisë dhe Sportit	Jonajda Doci	Anetar		**0685367033**
14	Drejtori i Sh.T.U.	Taulant Sinanaj	Anetar		**0692065227**
15	Drejtori i Buxhet Financës	Alketa Merkja	Anetar		**0695558300**
16	Drejtori i Zyrës Juridike	Arben Hoxha	Anetar		**0696594432**
17	Kryeispektor i Policies Bashkiake	Erzen Osmani	Anetar		**0698872635**
18	Pergjegjes i Arsimit Parashkollor	Evis Stafa	Anetar		**0695286590**
19	Përf. i Kryqit të Kuq	Ened Llapushi	Anetar		**0672199472**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Kontaktet e Administratorëve të Njësive Administrative

NR	Bashkitë	Nj. Administrative	Emer Mbiemer	Celular
1	Elbasan	Nr 1	Dorina Roseni	**069 5595021**
		Nr 2	Elsid Zyma	**069 6537966**
		Nr 3	Eugert Salla	**069 3027629**
		Nr 4	Arben Demiri	**068 2779223**
		Nr 5	Agron Lulja	**0693346058**
		Nr.6	Gëzim Keçi	**068 2123043**
		Bradashesh	Andi Liçi	**069 8363181**
		Funar	Olitian Haka	**068 5284991**
		Gracen	Fadil Salla	**068 8430820**
		Gjinar	Irakli Toçi	**068 6379160**
		Labinot-Mal	Hatixhe Pema	**069 5886047**
		Labinot-Fushë	Astrit Hazizi	**068 2031246**
		Papër	Erald Gjeli	**069 5705695**
		Shirgjan	Ylli Dushku	**069 2777971**
		Shushicë	Gëzim Ruda	**068 5108604**
		Tregan	Manjola Rexhepi	**068 5320794**
		Zavalinë	Ervis Dedja	**069 6263545**
		Gjergjan	Resul Hoxha	**068 6458676**

Kontaktet e lajmërimit të Shërbimit MNZSH në Bashki

Nr.	Pozicioni	Emer Mbiemer	Tel.Zyre	Tel.Shtepi	Celular
I	Komandant Stac.Elb	Tajar Alla	**054253333**	**054 256611**	**06941 11034**
2	-Salla operative e M.N.Z.SH				**069 4132670**

Kontaktet e lajmërimit të Drejtorisë së Emergjencave Civile në Bashki

Nr	Pozicioni	Emer Mbiemer	Tel. Zyre	Tel. Shtepi	Celular
1	Drejtor	Ndriçim Sinani			**069 7804007**
2	Përgj. sektori	Baftjer Shypheja			**069 3105377**
3	Përgj. sektori	Xhevair Kapllani			**069 2120263**
4	Specialist	Irida Hoxholli			**069 3791909**
5	Specialist	Yzeir Miraka			**069 5160114**
7	Specialiste	Ester Hysaj			**069 9193898**
8	Specialist	Halit Çehu			**069 5382035**
9	Specialiste	Megi Dishani			**069 9912638**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Kontaktet e lajmerimit të specialistëve të Emergjencave Civile Prefekturë

Nr	Pozicioni	Emer Mbiemer	Tel. Zyre	Tel Shtepi	Celular
1	Përgj.EmergjencaveCivile	Edvin Gjata	054252020		069 5205997
2	Spec.EmergjencaveCivile	Minella Verushi	054252020	051 322773	069 2175959

Kontaktet e lajmerimit të Specialistet e MFSH rajoni qëndror rrugor

NR	Emer Mbiemer	Tel.Zyre	Celular
1	Ismail Ruci		069 47 99 399
2	Gani Poci		069 25 32 233

Pika te tjera kontakti të gadishmerisë 24-orëshe

	Tel. Celular	Tel. Fiks
Salla Operative e Drejtorisë Policisë	069 41 10219 129	054 25 2600
-Salla operative e M.N.Z.SH	069 41 32676	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

7. FORMATET E RAPORTEVE DHE TË KËRKESAVE

Raporti i njoftimit të parë

FORMULARI 1

NJOFTIM I PARË
PËR KONSTATIMIN E FATKËQESIVE

Karakteri i njoftimit **U R G J E N T**

Nr. i Qendrës Operacionale _____.
Koha e plotësimit të formularit: në çastin që njoftoheni apo konstatoni ndodhjen e një fatkeqësie.
Qëllimi: Verifikimi i njoftimit, karakteri dhe lloji i fatkeqësisë, përmasat si dhe ndikimet e saj.
Plotësohet nga: persona përgjegjës, bazuar në vëzhgimin personal apo marrjen dijeni nga persona të përgjegjshëm.
Lloji i fatkeqësisë së konstatuar/ njoftuar:

Tërmetet ☐ Përmbytje ☐ Zjarr në banesa ☐
Shkatërrim dige ☐ Rrëshqitje masive dheu ☐ Aksidente ☐
Zjarr në pyje ☐ Bllokime nga bora ☐ Të tjera _____ ☐
Koha e ndodhjes së fatkeqësisë: ora_____ data_____
Vendndodhja: Në teritorin e _____
(qarkut, bashkisë, njësisë administrative, fshatit)
Cili është burimi i informacionit_____

A ka njoftim për viktima/të plagosur/të humbur? **PO** ☐ **JO** ☐
Keni informacion për dëme materiale/infrastrukturë? **PO** ☐ **JO** ☐
Kërkohet ndihmë urgjente e specializuar? **PO** ☐ **JO** ☐
A e keni njoftuar eprorin tuaj? **PO** ☐ **JO** ☐
Koha e plotësimit të formularit: ora_____datë_____
Personi informues_____me detryrë_____në_____(institucioni).
Vendndodhja e institucionit, Qarku_____ bashkia/ Nj. Administrative
_____fshati_____
Numuri i telefonit tuaj apo mënyrë tjetër komunikimi_____

Njoftuesi

_____

Raporti i të dhënave të para për emergjencën

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

FORMULARI 2

RAPORT I TË DHËNAVE TE PARA PËR FATKEQËSINË

Karakteri i informacionit: **I RËNDËSISË SË VECANTË**

Rëndësia e plotësimit të formularit: bëhet përcaktues për njohjen më në detaje të llojit të fatkeqësisë dhe shërben për marrjen e masave urgjente apo për plotësimin e kushteve për shpalljen e gjendjes së emergjencave civile kombëtare.
Koha e plotësimit: jo më vonë se 24 orë nga çasti i ndodhjes së fatkeqësisë.
Vëmendja kryesore: ripohimi i vertetësisë së informacionit të parë për ndodhjen e fatkeqësisë, vendndodhjen e saktë të saj, shtrirjen territoriale si dhe i vërtetësisë nësë është shoqëruar me pasoja.
Lloji i fatkeqësisë së konstatuar:

Tërmet ☐ Përmbytje ☐ Zjarr në banesa ☐
Rrëshqitje masive dheu ☐ Aksident ☐ Zjarr në pyje ☐
Bllokime nga bora ☐ Shkatërrim dige ☐ Të tjera_____ ☐
Koha e ndodhjes së fatkeqësisë: ora_____, data _____
Vendondodhja: Në territorin e _____
(Qarkut, Bashkisë, Nj.Administrative, Fshatit)
Cili është burimi i informacionit_____
Saktësia e informacionit_____(i saktë, ndoshta i saktë, i dyshimtë)
Cilat janë aktivitetet e ndërmarra nga strukturat lokale deri në çastin e raportimit?_____
A janë evidentuar kërcënime dytësore si rrjedhoje e fatkeqësisë? _____

Dëmtime në njerëz:
Numuri i viktimave: i vërtetuar _____ i pavërtetuar_____
Numuri i të zhdukurve: i vërtetuar_____ i pavërtetuar _____
Numuri i të plagosurve rëndë: i vërtetuar _____ i pavërtetuar_____

Dëmtime në objekte

Të shkatërruara: objekte banimi kolektive	**PO** ☐	**JO** ☐
Shtëpi private	**PO** ☐	**JO** ☐
Spitale	**PO** ☐	**JO** ☐
Konvikte	**PO** ☐	**JO** ☐
Të dëmtuara rëndë objekte banimi kolektive	**PO** ☐	**JO** ☐
Shtëpi private	**PO** ☐	**JO** ☐
Spitale	**PO** ☐	**JO** ☐
Konvikte	**PO** ☐	**JO** ☐

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Dëmtime në infrastrukturë

Rrjeti i furnizimit me ujë, _____(shkatërruar, dëmtime të rënda, dëmtime të lehta) me/pa ndërprerje të furnizimit me ujë.
Rrjeti i furnizimit me energji elektrike, _____(shkatërruar, dëmtime të rënda, dëmtime të lehta) me/pa ndërprerje të furnizimit me energji.
Ura _____në rrugë nacionale (shkatërruar, dëmtime të rënda, dëmtime të lehta) me/pa ndërprerje të qarkullimit.
Segmenti rrugor/ rruga_____ (shkatërruar, dëmtime të rënda, dëmtime të lehta) me/pa ndërprerje të qarkullimit.
Kërkohet ndihmë _____(urgjente/ e menjëhershme) në zonën e_____ me/për _____.

Shënime të veçanta

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

Njoftimi bëhet sot, më ora_____datë _____
Nga_____me detyrë_____në_____ (institucioni).

Vendndodhja e institucionit, Qarku_____ Bashkia _____
Njësisë Administrative _____ fshati_____
_____

I n f o r m o i

_____
(Emër, Mbiemër, Pozicioni, Nënshkrimi dhe Vula e Institucionit)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Format–kërkese, drejtuar Kryeministrit ose Ministrit te Mbrojtjes për angazhimin e FA.

KËRKESË

Për: Z/Znj._____
Kryeministër/ Ministër i Mbrojtjes i RSH
Tiranë

Nga: _____

Z/Znj. Kryeministër/Ministër,

Më datë _____, në rajonin, zonën e qarkut _____nga zona e _____ deri në zonën e_____, si pasojë e reshjeve intensive, të rëna nga data _____ deri në datën _____, është përmbytur një teritor i konsiderueshëm sipërfaqie toke bujqësore si dhe fshatrat _____. Niveli i ujrave është rritur deri në _____m, në zonat e banuara deri ____ m.

Nisur nga vështirësitë e konstatuara nga grupi i vlerësimit, i ngritur me urdhër të _____, nga vazhdimi i pandërprerë i reshjeve edhe në këto çaste si dhe nga parashikimi i motit për ditët në vazhdim, gjendja e konstatuar konsiderohet tepër e vështirë, si për banorët, bagëtinë, të mbjellat dhe për subjektet e tjera private që kryejnë aktivitet në këto zona.
Grupi i vlerësimit i ngarkuar për këtë qëllim konstaton se:
Rrezik emergjent paraqet zona e fshatrave _____, banorët e së cilës kërkohet të evakuohen jo më vonë se 12 orët e ardhshme.
Numuri i banorëve më në rrezik _____banorë
Numuri i banorëve në këtë zonë _____bagëti (të imta dhe të trasha).
Kemi përcaktuar vendin e vendndodhjes së të evakuarve, por në pamundësi të disponimit të mjeteve të posaçme të përshtatshme për ndërhyrje në zonat e përmbytura, mjete transporti, helikopterë për shpëtim, çadra për strehim familjar, personel mjeksor si dhe materiale të tjera për strehim të përkohshëm për rreth _____njerëz. Efektivi dhe mjetet e ndërhyrjes të llogaritet në bazë të numrit të banoreve dhe të bagetive të evidentuara më sipër.
Bashkëlidhur kësaj kërkese po ju dërgojmë edhe një hartë të zonës së prekur nga përmbytja, duke evidentuar rrugët, urat dhe vendet ku, për momentin, është i mundur afrimi i efektivave të FA më afër zonave të banimit të permbytura.
Jemi në pritje të ardhjes sa më të shpejtë të forcave e mjeteve të Ministrisë së Mbrojtjes.

Numuri i kontaktit _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

PUNOI: Irida Hoxholli Ndriçim Sinani

Lagja: Brig."17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa ". Tel.: +35554 400 152 E-email: bashkiaelbasan@elbasani.gov.al ëeb: www.elbasani.gov.al

1386

(10)

24.12.2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5188/2 **Prot.** **Elbasan më** 24 **.12.2021**

VENDIM

Nr. 130 **datë** 23 **.12.2021**

"Për mbylljen e institucioneve arsimore"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.12.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Arsimit, Trashëgimisë Kulturore dhe Turizmit, (Sektori i Arsimit Parashkollor), mbështetur në nenet 7, 8, 54 të ligjit nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" (i ndryshuar), si dhe në nenin 41 (pika 1) të ligjit nr.69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*" (i ndryshuar) dhe VKM nr.662 datë 08.10.2014 '*Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike*''.

VENDOSI:

1. Të miratojë mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare të mëposhtme:
   - Shkolla "Shmil", vartëse e shkollës 9-vjeçare "Ramë Karagjozi", Qerret;
   - Shkolla "Kryezjarth", vartëse e shkollës 9-vjeçare "Kuqan";
   - Shkolla "Xibresh", vartëse e shkollës "26 Shtatori", Gjinar;
   - Shkolla "Preçe e Poshtme", vartëse e shkollës së mesme të bashkuar "Ibrahim Çeka", Funar;
   - Shkolla "Gracen" , vartëse e shkollës 9-vjeçare "Gjormë";
   - Shkolla "Gjormë 1", vartëse e shkollës "Gjormë".

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Politikave të Arsimit, Trashëgimisë Kulturore dhe Turizmit.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Konceptoi:
Përgjegjësi i SAP: *E. Stafa*
Drejtoria Juridike: *A. Hoxha*
Zv/Kryetar: *V. Liço*

1387

24.12.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6173/1 **Prot.** **Elbasan** 24.12.2021

VENDIM

Nr. 136 **datë:** 23.12.2021

"Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" (pas vdekjes) i Elbasanit, zotit Astrit Lopari"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.12.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit Parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportit (Sektori i Turizmit dhe i Trashëgimisë Kulturore) *"Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" (pas vdekjes) i Elbasanit, zotit Astrit Lopari"*, mbështetur në nenin 54 (gërma "m") të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), si dhe në nenin 15 (pika 1, gërma "a" dhe pika 2, gërma "b") të ligjit nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar);

VENDOSI:

4. Ti japë titullin "Qytetar Nderi" (pas vdekjes) i Elbasanit, zotit Astrit Lopari, me motivacionin:

   "Për kontributin e dhënë në fushën e arsimit, të artit dhe të kulturës".

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Konceptoi:

Drejtoria e TPATKT: *E. Kraba* *A. Xhaja*

Drejtoria Juridike: *A. Hoxha*

Sekretari i Përgjithshëm: *A. Bylykbashi*

Zv/ Kryetar: *V. Liço*

1390
24.12.2021

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr 6174/1 Prot. Datë 24 .12. 2021

VENDIM

NR. 137, DATË 23. 12. 2021

MBI

"MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË ELBASAN PËR VITIN 2022"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin nr.115, datë 10.12.2021 "Për buxhetin e vitit 2022", pasi mori në shqyrtim materialet "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2021", të përgatitura nga Bashkia e Qytetit Elbasan nëpërmjet drejtorive të saj, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan,

VENDOSI

1. Të miratojë buxhetin e vitit 2022 për Bashkinë dhe institucionet vartëse të saj, në nivel programi, si më poshtë dhe sipas pasqyrave e materialeve bashkëlidhur :

1. Të ardhura gjithsej: 2,831,420 mijë lekë

2. Shpenzime gjithsej : 2,831,420 mijë lekë

2. Të miratojë kërkesat për projektet e investimeve për vitin 2022, me fondet e Zhvillimit të Rajoneve, sipas pasqyrës bashkëngjitur (tabela nr.9).

3. Të miratojë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Të miratoje programin buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024, "Tavanet e shpenzimeve", (tabela nr.2), "Parashikimi i te ardhurave 2022-2024", (tabela nr.2/1).

4/1. Të miratojë listën e investimeve në pritje, të cilat do të financohen në rast të gjetjes së burimeve financiare (tabela nr.10).

5. Kontributi i Bashkisë Elbasan për Këshillin e Qarkut për vitin 2021 është 1% mbi të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë.

7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2022.

SEKRETAR
Klajd Gripshi

KRYETAR
Hektor Çiftja

Dr.Buxhet Finance : A.Merkja

D.P.Sh.M : L.Dervishi

D.P.SH.O : D.Meta

D.P.SH.I : S.Mehmeti

D.P. Sh. O: B.Çabiri

D.P.P.Zh : A .Gashi

Dr.Juridike: A.Hoxha

Dr.T.T,V : Q. Tusha

Zv/kryetar : V. Liço

Zv/kryetar : I.Sina

Sek.Pergj.: A.Bylykbashi

Bashkia Elbasan **Buxheti i vitit 2022**

Tabela Nr. 1

Planifikimi i buxhetit sipas Njesive Shpenzuese per vitin 2022
(grant + te ardhura+ kredi)

ne mije leke

	Programi / Njesia shpezuese	Programi	Shpenzime personeli	Shpenzime operative	Shpenzime Kapitale	Totali buxhetit
1	Planifikim Menaxhim & Administrim	01110	**271,350**	**136,413**	**14,393**	**422,156**
	Bashkia		271,350	136,413	14,393	422,156
2	Çeshtje finaciare dhe fiskale	01120	**48,930**	**5,702**	**0**	**54,632**
	Bashkia		48,930	5,702		54,632
3	Pagesa per sherbimin e borxhit te brendshem	01710	**0**	**107,100**	**0**	**107,100**
	Bashkia			91,400		91,400
	Njesia Menaxhimit Banesave Sociale			15,700		15,700
4	Sherbimet e Policise Vendore	03140	**28,230**	**2,900**	**0**	**31,130**
	Bashkia		28,230	2,900		31,130
5	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	03280	**1,400**	**67,513**	**3,021**	**71,934**
	Bashkia		1,400	67,513	3,021	71,934
6	Mbeshtetje per zhvillimin ekonomik	04130	**120**	**0**	**0**	**120**
	Bashkia		120			120
7	Sherbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	04160	**2,790**	**600**	**0**	**3,390**
	Bashkia			200		200
	Agjensia e Sherbimeve Publike		2,790	400		3,190
8	Sherbimet bujqesore, inspektimi, siguria ushqimore	04220	**14,460**	**500**	**19,542**	**34,502**
	Bashkia		5,600	500		6,100
	Agjensia e Sherbimeve Publike		8,860		19,542	28,402
9	Menazhimi i infrastruktures se ujitjes dhe kullimit	04240	**8,300**	**0**	**6,524**	**14,824**
	Bashkia				4	4
	Agjensia e Sherbimeve Publike		8,300		6,520	14,820
10	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	04260	**4,907**	**22,314**	**43,234**	**70,455**
	Bashkia		4,907	22,314	43,234	70,455
11	Rrjeti rrugor rural	04520	**36,240**	**19,920**	**389,164**	**445,324**
	Bashkia			1,920	370,175	372,095
	Agjensia e Sherbimeve Publike		36,240	18,000	18,989	73,229
12	Transporti publik	04570	**22,900**	**26,047**	**15,000**	**63,947**
	Bashkia			10,047	15,000	25,047
	Agjensia e Sherbimeve Publike		22,900	16,000		38,900
13	Menaxhimi i mbetjeve	05100	**20,960**	**128,947**	**24,013**	**173,920**
	Bashkia			123,947	33	123,980
	Agjensia e Sherbimeve Publike		20,960	5,000	23,980	49,940
14	Menaxhimi i ujrave te zeza dhe kanalizimeve	05200	**0**	**0**	**12,526**	**12,526**
	Bashkia				12,526	12,526
	Agjensia e Sherbimeve Publike					0
15	Programe te mbrojtjes se mjedisit	05320	**7,830**	**428**	**0**	**8,258**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

	Bashkia		7,830	428		8,258
16	Planifikimi urban vendor	06140	**0**	**0**	**5,010**	**5,010**
	Bashkia				5,010	5,010
17	Sherbimet publike vendore	06260	**52,430**	**122,826**	**27,684**	**202,940**
	Bashkia			8,190	15,885	24,075
	Agjensia e Sherbimeve Publike		52,430	114,636	11,799	178,865
18	Furnizimi me uje	06330	**0**	**0**	**3,000**	**3,000**
	Bashkia				3,000	3,000
	Agjensia e Sherbimeve Publike					0
19	Ndriçim rrugesh	06440	**8,960**	**110,000**	**16,159**	**135,119**
	Bashkia					0
	Agjensia e Sherbimeve Publike		8,960	110,000	16,159	135,119
20	Sherbimet e kujdesit paresor	07220	**1,669**	**600**	**0**	**2,269**
	Bashkia					0
	Qendra Ekonomike e Arsimit		1,669	600		2,269
21	Sport dhe argetim	08130	**24,990**	**37,500**	**5,831**	**68,321**
	Bashkia			8,000	1,865	9,865
	Klubi Shumesporte		24,990	29,500	3,966	58,456
22	Trashegimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	08220	**45,646**	**32,800**	**5,010**	**83,456**
	Qendra e Artit		27,920	29,700	4,010	61,630
	Qendra e Trashegimise Kulturore		17,726	3,100	1,000	21,826
	Bashkia					0
23	Arsimi baze (perfshire parashkollor)	09120	**27,035**	**107,742**	**38,026**	**172,803**
	Qendra Ekonomike Arsimit		27,035	107,742	36,880	171,657
	Bashkia				1,146	1,146
24	Arsimi mesem pergjithshem	09230	**0**	**20,537**	**0**	**20,537**
	Qendra Ekonomike Arsimit			20,537		20,537
	Bashkia					0
25	Kujdesi social per personat e semure & aftesi te kufi	10140	**0**	**3,400**	**0**	**3,400**
	Bashkia			3,400		3,400
	Qendra Sociale "Balashe"					0
26	Sigurimi shoqeror (te moshuarit)	10220	**9,353**	**6,000**	**100**	**15,453**
	Qendra Sociale "Balashe"		9,353	6,000	100	15,453
27	Kujdesi social per familjet dhe femijet	10430	**37,877**	**27,600**	**4,184**	**69,661**
	Bashkia			7,900		7,900
	Qendra Ekonomike Arsimit		29,000	15,438	1,284	45,722
	Qendra Sociale "Balashe"		8,877	4,262	2,900	16,039
28	Strehimi social	10661	**3,260**	**6,970**	**250**	**10,480**
	Bashkia			6,750		6,750
	Njesia Menaxhimit Banesave Sociale		3,260	220	250	3,730
29	F.Rezerve & Kontigjenca	04980	**0**	**19,000**	**0**	**19,000**
	Bashkia			19,000		19,000
	Gjithsej :		**679,637**	**1,013,359**	**632,671**	**2,325,667**



Bashkia Elbasan **Buxheti i vitit 2022**

Tabela Nr. 1/1

Shpenzime nga transferta specifike per vitin 2022

ne 000/leke

	Programi / Njesite Shpenzuese	Programi	Shpenzime personeli	Shpenzime operative	Shpenzime Kapitale	Totali buxhetit
1	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	03280	31,089	5,000	16,677	52,766
	Bashkia (SHMZSH)		31,089	5,000		36,089
	Bashkia (Mbrojtja Civile)				16,677	16,677
2	Menazhimi i ujitjes dhe kullimit	04240	3,940	14,737	0	18,677
	Agjensia e Sherbimeve Publike		3,940	14,737		18,677
3	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	04260	11,181	1,500	0	12,681
	Bashkia		11181	1,500		12,681
4	Infrastruktura Rrugore Rurale	04520	13,878	5,000	0	18,878
	Agjensia e Sherbimeve Publike		13,878	5,000		18,878
5	Arsimi Baze (perfshire parashkollor)	09120	287,423	0	0	287,423
	Qendra Ek. Arsimit (personeli mesimor)		228,936			228,936
	Qendra Ek.Arsimit (stafi mbeshtetes)		58,487			58,487
6	Arsimi Mesem i Pergjithshem	09230	34,484	0	0	34,484
	Qendra Ek.Arsimit (stafi mbeshtetes)		34,484			34,484
						0
7	Arsimi Mesem Profesional	09230	8,549	12,000	22,162	42,711
	Qendra Ek.Arsimit (personeli konviktet)		8,549	12,000	22,162	42,711
8	Mbrojtja Sociale	10430	16,333	5,000	0	21,333
	Qendra Sociale "Balashe"		16,333	5,000		21,333
9	Menaxhimi i mbetjeve	05100	0	16,800	0	16,800
	Bashkia			16,800		16,800
	Gjithsej :		**406,877**	**60,037**	**38,839**	**505,753**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Bashkia Elbasan

Buxheti i vitit 2022

Tabela Nr. 2

Tavanet e shpenzimeve per vitet 2022-2024 (te ardhura + transferta e pakushtezuar dhe sektoriale)

ne 000/leke

Nr.	Emertimi programit	Programi	Viti 2022				Viti 2023				Viti 2024			
			Shpenzime personeli	Shpenzime te tjera korente	Shpenzime Kapitale	Totali programit	Shpenzime personeli	Shpenzime te tjera korente	Shpenzime Kapitale	Totali buxhetit	Shpenzime personeli	Shpenzime te tjera korente	Shpenzime Kapitale	Totali buxhetit
1	Planifikim Menaxhim & Administrim	01110	271,350	136,413	14,393	**422,156**	289,833	98,419	12,360	**400,612**	289,833	97,403	12,600	**399,836**
2	Çeshtje finaciare dhe fiskale	01120	48,930	5,702	0	**54,632**	48,246	5,454	2,200	**55,900**	48,246	5,563	3,000	**56,809**
3	Gjendja Civile	01170	0	0	0	**0**		718		**718**		740		**740**
4	Pagesa per sherbimin e borxhit te bre	01710		107,100		**107,100**	0	88,680	0	**88,680**	0	85,276		**85,276**
5	Sherbimet e Policise Vendore	03140	28,230	2,900	0	**31,130**	28,795	2,929	1,100	**32,824**	28,795	2,958	1,320	**33,073**
6	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civ	03280	32489	72,513	19698	**124,700**	29,765	86,057	2,200	**118,022**	29,765	86,917	2,640	**119,322**
7	Mbeshtetje per zhvillim ekonomik	04130	120	0	0	**120**	122	3,000	0	**3,122**	122	4,030	0	**4,152**
8	Sherbimi i tregjeve, akreditimi dhe in	04160	2790	600		**3,390**	2,744	1,565	6,600	**10,909**	2,744	1,581	7,920	**12,245**
9	Sherbimet bujqesore, inspektimi, sigu	04220	14460	500	19,542	**34,502**	14,739	705	12,100	**27,544**	14,739	712	14,520	**29,971**
10	Menazhimi i infrastruktures se ujitje	04240	12,240	14737	6,524	**33,501**	10,761	9,064	11,000	**30,825**	10,761	9,155	13,200	**33,116**
11	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	04260	16,088	23,814	43,234	**83,136**	15,912	15,716	27,500	**59,128**	15,912	15,873	33,000	**64,785**
12	Rrjeti rrugor rural	04520	50,118	24,920	389,164	**464,202**	51,266	22,624	284,619	**358,509**	51,266	23,816	311,843	**386,925**
13	Transporti publik	04570	22,900	26,047	15000	**63,947**	22,267	16,688	2,640	**41,595**	22,267	16,855	3,168	**42,290**
14	Menaxhimi i mbetjeve	05100	20,960	145,747	24,013	**190,720**	9,384	110,296	8,250	**127,930**	9,384	111,399	9,900	**130,683**
15	Menaxhimi i ujrave te zeza dhe kanal	05200	0	0	12,526	**12,526**			12,100	**12,100**	0	0	14,520	**14,520**
16	Programe te mbrojtjes se mjedisit	05320	7830	428	0	**8,258**	7,986	670	1,100	**9,756**	7,986	676	1,321	**9,983**

17	Planifikimi urban vendor	06140	0	0	5010	**5,010**			4,400	**4,400**	0	0	5,279	**5,279**
18	Sherbimet publike vendore	06260	52,430	122,826	27,684	**202,940**	50,704	95,073	33,000	**178,777**	50,704	96,024	39,600	**186,328**
19	Furnizimi me uje	06330	0	0	3,000	**3,000**	0	0	2,750	**2,750**	0	0	3,300	**3,300**
				4	Blerje kaldaje me pellet per ngrohje (3 cope)	QEA	1,070,000			1,070,000	Buxhet Bashkia
				5	Rikonstruksion ne objektet arsimore.	" "		8,900,000		8,900,000	Buxhet Bashkia
				6	Supervizim " "	" "		154,783		154,783	Buxhet Bashkia
				7	Kolaudim " "	" "	18,332			18,332	Buxhet Bashkia
				8	Blerje kondicionere per magazinen ushqimore	" "		185,000	0	185,000	Buxhet Bashkia
00	09230		231		**Totali :**		**13,961,837**	**0**	**0**	**13,961,837**	
				1	Rikonstruksion i shesheve sportive ne funksion te konviktit " Ymer Tola"	QEA	13,676,137			13,676,137	Buxhet Bashkia
				2	Supervizim " " "	" "	259,000			259,000	Buxhet Bashkia
				3	Kolaudim " " "	" "	26,700			26,700	Buxhet Bashkia
					TOTALI		**103,898,136**	**209,847,296**	**83,961,429**	**229,784,003**	



Bashkia Elbasan

Buxheti i vitit 2022

Tabela Nr. 7

Lista e njesive shpenzuese

Nr.	Njesia Shpenzuese	Kodi institucionit
1	Bashkia (administrata)	2109001
2	Qendra Ekonomike e Arsimit	2109008
3	Sport Klub Elbasani	2109012
4	Qendra e Artit	2109010
5	Qendra e Trashegimise Kulturore	2109020
6	Agjensia e Sherbimeve Publike	2109014
7	Qendra Sociale "Balashe"	2109017
8	Njesia e Menaxhimit te Banesave Sociale	2109021



BASHKIA ELBASAN

BUXHETI I VITIT 2022

Tabela Nr.8

TE ARDHURAT TOTALE TE BASHKISE ELBASAN (Plani I arkes)

ne 000/leke

Nr		PLAN VJETOR	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nentor	dhjetor
	TE ARDHURA	2022												
A	Trasheguar nga v.2021	133,617	133,617											
	Trasheguar grant + te ardhura 2021	100,000	100,000											
	Trasheguar grant specifik 2021	33,617	33,617											
B	TE ARDH.VENDORE (I+II+III+IV+V+VI)	1,424,985	115,487	115,657	130,821	115,712	115,662	130,898	111,285	126,265	116,021	115,890	115,634	115,653
I	TE ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	561,750	46792	46792	46892	46792	46792	46892	46793	46793	46903	46803	46703	46803
1	Tatimi thjeshtuar mbi fitimin e BV	6,000	500	500	500	500	500	500	500	500	500	500	500	500
2	Taksa mbi ndertesat	214,600	17900	17900	17900	17900	17900	17900	17900	17900	17900	17900	17800	17800
3	Taksa mbi token bujqesore	26,400	2200	2200	2200	2200	2200	2200	2200	2200	2200	2200	2200	2200
4	Taksa mbi truallin	27,000	2250	2250	2250	2250	2250	2250	2250	2250	2250	2250	2250	2250
5	Taksa mbi veprimtarine e sherbimit hotelier	7,000	580	580	580	580	580	580	580	580	590	590	590	590
6	Taksa e ndikimit ne infrastrukture	280,000	23300	23300	23400	23300	23300	23400	23300	23300	23400	23300	23300	23400
7	Taksa e tabeles	750	62	62	62	62	62	62	63	63	63	63	63	63
II	TE ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	109,000	9047	9047	9146	9047	9047	9146	9047	9047	9156	9057	9057	9156
1	Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise	7,000	580	580	580	580	580	580	580	580	590	590	590	590
2	Taksa vjetore e mjeteve te perdorura	70,000	5800	5800	5900	5800	5800	5900	5800	5800	5900	5800	5800	5900
3	Taksa e rentes minerare	2,000	167	167	166	167	167	166	167	167	166	167	167	166
4	Tatimi mbi te ardhurat personale	30,000	2500	2500	2500	2500	2500	2500	2500	2500	2500	2500	2500	2500
III	TE ARDHURA NGA TARIFAT	462,740	38,422	38,542	38,583	38,562	38,512	38,623	38,522	38,552	38,683	38,592	38,583	38,564
1	Tarife per zenien e hapesires publike	38,000	3170	3170	3160	3170	3170	3160	3170	3170	3160	3170	3170	3160
2	" pastrimi	185,000	15400	15400	15400	15400	15400	15400	15400	15400	15500	15400	15500	15400
3	" gjelberimi	45,000	3750	3750	3750	3750	3750	3750	3750	3750	3750	3750	3750	3750
4	" ndricimi	81,000	6750	6750	6750	6750	6750	6750	6750	6750	6750	6750	6750	6750
5	" mirembajtje infrastrukture ne Nj.Admin	5,220	435	435	435	435	435	435	435	435	435	435	435	435
6	" reklame	8,000	670	670	660	670	670	660	670	670	660	670	670	660
7	" veterinare	0												
8	" parkim automjete	40,000	3300	3300	3400	3300	3300	3400	3300	3300	3400	3300	3300	3400
9	" embleme bashkie	100		20		20		20		20		20		
10	" leje, certifikate transporti	2,000	170	170	160	170	170	160	170	170	160	170	170	160
11	" autorizim treg. karburanti + lende djege	9,000	750	750	750	750	750	750	750	750	750	750	750	750
12	" leshimin e vertetimeve	2,200	183	183	184	183	183	184	183	183	184	183	183	184
13	" autoriz., zgjatje orari ,etj	2,200	183	183	184	183	183	184	183	183	184	183	183	184
14	" formulare te pastrehe	30			10			10			10			
15	" sherbimi karrotresh	500	42	42	41	42	42	41	42	42	41	42	42	41
16	" leje perdorimi per objekte biznesi	2,000	170	170	160	170	170	160	170	170	160	170	170	160
17	" leje perdorimi per banim	1,200	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100
18	" certifikim relievi	1,000		100	100	100	100	100	100	100	100	100	50	50

19	" deklarim paraprak	1,300	100	100	100	100	100	100	100	100	100	130	130	140
20	" trajt.fasades ndertesave	1,200	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100
21	" aplikim leje zhvillimi	1,500	125	125	125	125	125	125	125	125	125	125	125	125
22	" hartim PDV per siperfaqen e prones	2,000	170	170	160	170	170	160	170	170	160	170	170	160
23	" shqyrtim dokumenta leje ndertimi	3,000	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250
24	" kantier ndertimi per objekt mbi 4 kat	5,500	460	460	460	460	460	460	460	460	460	460	450	450
25	" leshimin e dok.nga arkiva	200	17	17	16	17	17	16	17	17	16	17	17	16
26	" rrjetin e tubacion.ujrave bardha	2,200	183	183	184	183	183	184	183	183	184	183	183	184
27	" rrjetin e tubacion.ujrave zeza	290	24	24	24	24	24	24	24	24	24	24	25	25
28	" sherbimi per rrjetin kabllor	4,000	340	330	330	340	330	330	340	330	330	340	330	330
29	" uji pijshem	100		10		20		20		20		20		10
30	" ndotjes mjedisit	19,000	1580	1580	1590	1580	1580	1590	1580	1580	1590	1580	1580	1590
IV	**TE ARDHURA JO-TATIMORE**	**183,000**	**11522**	**11522**	**26411**	**11522**	**11522**	**26411**	**11522**	**26522**	**11511**	**11622**	**11512**	**11401**
1	Qera objekti	3,000	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250
2	Qera trualli (operatore telefonike)	2,500	210	210	210	210	210	210	210	210	210	210	200	200
3	Qera toke bujqesore	500	42	42	41	42	42	41	42	42	41	42	42	41
4	Qera toke pyjore	5,000	420	420	410	420	420	410	420	420	410	420	420	410
5	Gjoba ndertimi	20,000	1670	1670	1660	1670	1670	1660	1670	1670	1660	1670	1670	1660
6	Gjoba biznesi	10,000	830	830	840	830	830	840	830	830	840	830	830	840
7	Te ardhura nga legalizimet	97,000	8100	8100	8000	8100	8100	8000	8100	8100	8100	8200	8100	8000
8	Te ardhura nga shitja e aseteve (FK)	45,000			15000			15000		15000				
V	**TE ARDHURA INSTITUCIONET**	**78,935**	**7238**	**7287**	**7322**	**7323**	**7322**	**7359**	**2935**	**2884**	**7301**	**7350**	**7312**	**7302**
1	**Qendra Ekonomike Arsimit**	**51,955**	**5052**	**5051**	**5051**	**5052**	**5051**	**5088**	**684**	**683**	**5051**	**5089**	**5051**	**5052**
	Te ardhura nga Cerdhet	9,680	968	968	968	968	968	968			968	968	968	968
	Te ardhura nga kopeshtet	34,074	3400	3400	3400	3400	3400	3437			3400	3437	3400	3400
	Te ardhura nga qerate	8,201	684	683	683	684	683	683	684	683	683	684	683	684
2	**Te ardhura Klubi Shumesporte**	**1,030**	**86**	**86**	**86**	**86**	**86**	**86**	**86**	**86**	**85**	**86**	**86**	**85**
	Te ardhura nga qira objekti	1,030	84	84	84	84	84	84	84	84	84	84	84	84
3	**Qendra e Artit**	**500**	**0**	**50**	**50**	**50**	**50**	**50**	**50**	**0**	**50**	**50**	**50**	**50**
	Te ardhura nga biletat	400		40	40	40	40	40	40		40	40	40	40
	Te ardhura okupim salle	100		10	10	10	10	10	10		10	10	10	10
4	**Qendra e Trashegimise Kulturore**	**100**	**0**	**0**	**20**	**20**	**20**	**20**	**0**	**0**	**0**	**10**	**10**	**0**
	Te ardhura Trashegimia Kulturore	100			20	20	20	20				10	10	
	Te ardhura Biblioteka	0												
5	**Agjensia e Sherbimeve Publike**	**17,350**	**1430**	**1430**	**1455**	**1445**	**1445**	**1455**	**1445**	**1445**	**1455**	**1445**	**1445**	**1455**
	Te ardhura sherbimet publike	150			15	15	15	15	15	15	15	15	15	15
	Te ardhura M.Varreza	10,000	830	830	840	830	830	840	830	830	840	830	830	840
	Tarife sherbimi per subjektet qe kryejne pun	7,200	600	600	600	600	600	600	600	600	600	600	600	600
6	**Te ardhura nga Banesat Sociale me Qira**	**8,000**	**670**	**670**	**660**	**670**	**670**	**660**	**670**	**670**	**660**	**670**	**670**	**660**
	Te ardhura nga qirate	8,000	670	670	660	670	670	660	670	670	660	670	670	660
VI	**TE ARDHURA FUNKSIONET SPECIFIKE**	**29,560**	**2466**	**2467**	**2467**	**2466**	**2467**	**2467**	**2466**	**2467**	**2467**	**2466**	**2467**	**2427**
1	Te ardhura nga Zjarrfikesja	2,300	191	192	192	191	192	192	191	192	192	191	192	192
2	Te ardhura nga Sherbimi Pyjor	22,500	1875	1875	1875	1875	1875	1875	1875	1875	1875	1875	1875	1875
3	Te ardhura Ujitja dhe Kullimi	4,760	400	400	400	400	400	400	400	400	400	400	400	360
C	**TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR (grant)**	**711,855**	**213,557**			**177,964**			**163,727**			**156,608**		
D	**TRANSFERTA SPECIFIKE (grant)**	**472,136**	**141,641**	**0**	**0**	**118,034**	**0**	**0**	**108,591**	**0**	**0**	**103,870**	**0**	**0**
	Konviktet e arsimit parauniversitar	28,749	8625			7187			6612			6325		

	Arsimi parashkollor, personeli mesimor	228,936	68681			57234			52655			50366		
	Arsimi parashkollor, stafi mbeshtetes	58,487	17546			14622			13452			12867		
	Arsimi parauniversitar	34,484	10345			8621			7931			7586		
	Mbrojtja nga zjarri	36,089	10827			9022			8300			7940		
	Mbrojtja sociale	21,333	6400			5333			4907			4693		
	Administrimi I pyjeve	12,681	3804			3170			2917			2790		
	Rruget rurale	18,878	5663			4720			4342			4153		
	Ujitja dhe kullimi	15,699	4710			3925			3611			3454		
	Menaxhimi I mbetjeve urbane	16,800	5040			4200			3864			3696		
E	**Te ardhura nga huamarrja 2021**	**88,827**		**30000**	**25000**		**10000**		**10000**		**10000**		**3827**	
	TOTAL TE ARDHURA :	**2,831,420**	**604,301**	**145,657**	**155,821**	**411,710**	**125,662**	**130,898**	**393,603**	**126,265**	**126,021**	**376,368**	**119,461**	**115,653**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 5209 Prot. Elbasan, më 25.10. 2021

Lënda: Kërkesë për mbështetje financiare në zbatimin e projektit:
"Shërbime lëvizëse komunitare për të moshuar:
të vetmuar ose me aftësi të kufizuar, Bashkia Elbasan".

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
TIRANË

Të nderuar përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, na lejoni në rradhë të parë t'ju falenderojmë për bashkëpunimin e frytshëm që institucioni ynë ka patur me Ju në realizimin e projekteve komunitare me vlerë të shtuar shërbimesh për qytetin tonë.

Në kuadër të këtj bashkëpunimi shprehim interesin tonë institucional për të aplikuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për projektin strategjik: ***Shërbime lëvizëse komunitare për të moshuar: të vetmuar ose me aftësi të kufizuar, në gjashtë lagjet e Bashkisë Elbasan dhe në dy njësitë administrative si: Labinot Mal dhe Gjinar.***

Shprehim gadishmerinë tonë për ta mbështetur këtë projekt në shumën **1,512,000 lekë** (ose 12.57%) nga **12,024,000 lekë** që kërkon implementimi i tij.

Implementimi i këtij projekti strategjik do të mundësojë ofrimin e shërbimeve levizëse me standarte për të moshuar të vetmuar apo me aftësi të kufizuar.

Duke Ju falenderuar

Konceptoi: Pergj Projektevę Znj.Kristina.Kreka
Pranoi: Dr. P.SM. Z.Olsi.Gega
Konfirmoi: Nënkryetar. Z.Ervin.Muçó

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN -

KRYETARI
Gledian LLATJA

1388

24.12.2021

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Nr.6302/prot
/3

Elbasan më 24.12. 2021

VENDIM

Nr.138 /datë 23/ 12 /2021

Për miratimin e Memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Evropës, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Elbasan për zbatimin e programit ROMACTED faza e II, si një nisiativë e Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.12.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar "*Për miratimin e Memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Evropës, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Elbasan për zbatimin e programit ROMACTED",* mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), në ligjin nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në R.Sh.",

VENDOSI

1 Të miratojë "***Memorandumin e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Evropës, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Elbasan për zbatimin e programit ROMACTED, faza e dyte"***

2 Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar dhe drejtorite e tjera sipas programeve.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit.

Drejtori K.Social Sh.Lika

Drejtori D. Juridike A. Hoxha

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja

1389
24.12.2021

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Nr.6108/prot
/3

Elbasan më 24 .12. 2021

VENDIM

Nr.139/datë23/ 12 /2021

Për miratimin e Marveshjes se bashkepunimit ndermjet Fondacionit "Save the children" dhe Bashkise Elbasan per zbatimin e projektit 'Rrugëtimi i adoleshentëve dhe të rinjve drejt mirëqënies, fuqizimit dhe qëndrueshmërisë', në bashkinë Elbasan, përkatësisht në Qendrën Komunitare Rome por dhe në bashkepunim me qendrat e tjera komunitare si pjesë e shërbimeve komunitare.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.12.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar "***Për miratimin e Marveshjes se bashkepunimit ndermjet Fondacionit "Save the children" dhe Bashkise Elbasan per zbatimin e projektit 'Rrugëtimi i adoleshentëve dhe të rinjve drejt mirëqënies, fuqizimit dhe qëndrueshmërisë', në bashkinë Elbasan, përkatësisht në Qendrën Komunitare Rome por dhe në bashkepunim me qendrat e tjera komunitare si pjesë e shërbimeve komunitare"",*** mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), në ligjin nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në R.Sh.",

VENDOSI

1 Të miratojë "***Marveshjen e bashkepunimit ndermjet Fondacionit "Save the children" dhe Bashkise Elbasan per zbatimin e projektit 'Rrugëtimi i adoleshentëve dhe të rinjve drejt mirëqënies, fuqizimit dhe qëndrueshmërisë', në bashkinë Elbasan, përkatësisht në Qendrën Komunitare Rome por dhe në bashkepunim me qendrat e tjera komunitare si pjesë e shërbimeve komunitare***" .

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar dhe Drejtoria e Qendres Sociale Balashe(QKRome).
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit.

Drejtori K.Social Sh.Lika

Drejtori Juridik A. Hoxha

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Hektor Çiftja

Save the Children

SAVE THE CHILDREN

Nr. 1001/514 Prot.

Elbasan, me _____.___.__ _

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

Nr. 6108 Prot.

Elbasan, me 14.12.2021

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot më datë ___ /___ / 2021 lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet palëve:

Save the Children, me adresë: Rr. Mihal Popi, Ndertesa 7, ish Pallatet I Maji PO Box 8185, Tirane, Albania; regjistruar si person juridik, Fondacion, me nr. Vendimi 3041, datë 05/11/1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; me nr. NIPT-i J 92308003D, përfaqësuar nga **Znj. Anila Meço**, në cilësinë e Drejtores, këtej e tutje e cilësuar si **Save the Children**

dhe

Bashkisë Elbasan, me adresë: Rr. 11 Nëntori, Elbasan, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Elbasan, **Z.Gledian Llatja**, këtej e tutje e cilësuar si **Bashkia.**

HYRJE

Në Janar 2016, Save the Children prezantoi ne Shqipëri, përkatësisht në bashkite Cerrik dhe Vau i Dejes, si dhe ne shkollat profesionale një projekt 5-vjeçar "Fuqizimi i të Rinjve" – për t'i ofruar mundesi të rinjve nga shtresa vulnerabël të aftësohen në mënyrë të qëndrueshme drejt rrugëtimit të tyre në moshën madhore me qëllim ndërprerjen e ciklin të varfërisë. Save the Children në partneritet me Organizatën Jofitimprurëse 'Ndihmë për Fëmijët' ndërmorën nisma dhe aktivitete në drejtimi të ofrimit të mundësive këtyre të rinjve për shkollim e aftësim profesional, aftësim për jetën; integrim në tregun e punës dhe program trajnimi mbi sipërmarrjen; mbështetje me pajisje, materiale e ngritje kapacitetesh në 2 shkolla profesionale (në Cërrik & Vou i Dejës); ndihmësë në përmirësimin e kurikulës së shkollës profesionale 'Bazat e Sipërmarrjes – për klasat 12 e 13'. Ky projekt i erdhi në ndihmë më shumë se 1041adoleshentëve dhe të rinjve duke ndikuar në zhvillimin e tyre personal e profesional, punësim, vetëpunësim dhe përmirësim të situatës së tyre ekonomike. Ne vitin e 4rt dhe të 5të, projekti e zgjerua në mënyrë të kufizuar ne bashkitë Malësi e Madhe, rrethinat e bashkisë Shkodër, zonat periferikë të bashkisë Elbasan si dhe ne Gramsh.
Duke u bazuar në përvojën e mirë të krijuar gjatë 5 viteve të zbatimit të projektit, dokumentuar nëpërmjet studimeve dhe vlerësimeve mbi efektivitetin e ndërhyrjeve dhe impaktin tek përfituesit,

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – BASHKIA ELBASAN

Save the Children

Save the Children së bashku me Organizatën Partnere hartuan fazën e dytë të projektit. Faza e dytë ka në fokus adoleshentët dhe të rinjtë të ndikuar thellësisht nga varfëria, pabarazia dhe diskriminimi si dhe familjet e tyre me qëllim fuqizimin e tyre në drejtëim të përmirësimit të mirëqënies nga ana arsimore, shëndetësore, mbrojtjes dhe mundësive për zhvillim e punësim dinjitoz. Faza e dytë do të zbatohet në bashkitë Elbasan, Shkodër dhe Dibër por do të ketë ndikim dhe ne bashkitë fqinje, si: Bulqizë, Cërrik, Gramsh dhe Malësi e Madhe. Qasja në zbatimin e projektit do të jetë partneriteti dhe bashkëpunimi i ngushtë me njesitë e qeverisjes vendore (bashki dhe njesitë e tyre vartëse) si dhe institucionet vartëse të Agjencive Kombëtare në fushën e arsimit, formimit profesional e punësimit.

Palët bien dakord si më poshtë vijon:

NENI 1
Emërtimi, fusha dhe vendi i veprimtarisë

1.1. Projekti '**Rrugëtimi i adoleshentëve dhe të rinjve drejt mirëqënies, fuqizimit dhe qëndrueshmërisë**' do të zhvillojë aktivitet e veta në bashkinë Elbasan, përkatësisht në Qendrën Komunitare Rrapishtë por dhe në bashkepunim me qendrat e tjera komunitare si pjesë e shërbimeve komunitare nën "Drejtorinë e Shërbimeve Sociale" të kësaj Bashkie.

NENI 2
Objekti

2.1 Objekt i kësaj Marrëveshje është bashkëpunimi dhe përcaktimi i angazhimit të ndërsjellë midis Save the Children dhe Bashkisë Elbasan në realizimin me sukses të projektit **"Rrugëtimi i adoleshentëve dhe të rinjve drejt mirëqënies, fuqizimit dhe qëndrueshmërisë"** këtej e tutje cilësuar si ***Projekti***, që do zbatohet në Bashkinë Elbasan, i cili ka per qëllim madhor 'Fuqizimin e adoleshentëve dhe të rinjve në drejtim të përmirësimit të mirëqënies nga ana arsimore, shëndetësore, mbrojtjes dhe mundësive për zhvillim e punësim dinjitoz'. Fokus i ndërhyrjeve janë të rinjtë dhe të rejat të ndikuar thellësisht nga varfëria, pabarazia dhe diskriminimi si dhe të rinjte me aftësi të kufizuara.

2.2 Qendra Komunitare Rrapishtë me bazë komunitare në bashkëpunim me qendrat e tjera komunitare do të zgjerojë veprimtarinë e saj për të ofruar vec aktiviteteve me karakter mbrojtjen sociale per komunitetin dhe shërbime gjthëpërfshirëse për të rinje e të rejat sipas pikës 2.1 me lart që kanë të bëjne me aftësimin për jetën e të rinjve, mbeshtetje për vazhdimin e shkollës dhe mos-braktisje te saj nga adoleshentet, sherbime të tjera (menaxhim rastesh) ne pergjigje te nevojave te te rinjve dhe familjeve te tyre. Për të bërë të mundur ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse, stafi i Qendrës do t'i përmbahet përshkrimit punës i përditësuar sipas shërbimeve të reja që do të orfohen nga kjo qendër në bashkëpunim të ngushtë me koordinatorin lokal të projektit dhe të mbështetur nga Projekti.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Save the Children

NENI 3
Baza ligjore

3.1 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi bazohet në Ligjin nr. 139/2015 "PËR VETËQEVERISJEN VENDORE", Ligji PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS Nr. 18/2017; Ligji "PËR RININË" NR. 75/2019, Ligji nr. 121/2016 "PËR SHËRBIMET E KUJDESIT SHOQËROR NE REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

NENI 4
Qëllimi

4.1 Projekti "**Rrugëtimi i adoleshentëve dhe të rinjve drejt mirëqënies, fuqizimit dhe qëndrueshmërisë**", i financuar nga Bvlgari, do të zbatohet nga organizata Save the Children, në partneritet me Bashkinë Elbasan. Organizata Save the Children do te partnerizohet dhe me Organizatën Ndihmë për Fëmijët e cila do te mbujojë aspekte zbatuese teknike se bashku me Save the Children në lidhje me Sherbimet për adoleshentë e të rinj me bazë komunitare.

4.2 Qëllimi i përgjithshëm dhe rezultatet afatmesme jane:

Qëllimi i përgjithshëm është 'Fuqizimi i adoleshentëve dhe të rinjve në drejtëim të përmirësimit të mirëqënies së tyre.
Rezultatet afatmesme jane: 1. Paradalimi i dhunes dhe abuzimit ndaj adoleshenteve dhe te rinjve ne kontektin familjar dhe ne komunitet; 2. Rritja e qendrueshme e mundësive për jetesë e punësim si dhe iniciativa sipërmarrëse për të rinjt e të rejat më të prekur/a nga pabarazia e diskriminimi me fokus të rejat nga minoritetet dhe atë rinjtë me aftësi të kufizuara; 3. Njesitë e qeverisjes lokale janë të afta të zhvillojnë dhe zbatojnë politika dhe shërbime që mbështesin kalimin e suksesshëm të të rinjve në moshën madhore (>18 vjeç).

NENI 5
Shërbimet dhe organizimi

5.1 Në Qendren Komunitare Rrapishtë, por dhe në qendra të tjera komunitare ose departamente të tjera pjesë e shërbimeve sociale do të zgjerohet veprimtaria që të bëhet e mundur ofrimi i shërbimeve të meposhtme për adoleshentë nga mosha 11-15 vjec dhe të rinj/reja 16-22 vjeç, përshirë dhe ata me aftësi të kufizuara:

5.1.1 Shërbime direkte për adoleshentët dhe të rinj/reja:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

- *Vlerësim dhe hartim i planeve individuale zhvillimore për ata persona që nuk ndjekin shkolle/kurse aftesimi/praktika pune ose nuk janë në status punesimi*
- *Aftësim i të rinjve/rejave nëpërmjet programit të aftësimit për jetën (vetë-vlerësim pozitiv;vetë-kontroll; aftësi sociale e komunikuese; aftësi të zgjidhjes së problemeve dhe marrjes së vendimeve të duhura*
- *Aftësimi i të rinjve/rejave nëpërmjet programeve për menaxhimin e parasë, përgatitjes për punësim, etj*
- *Ofrimi i njohurive mbi migrimin e sigurtë; ceshtje të të drejtave dhe mbrojtje nga dhuna përfshirë atë në familje, abuzimi, shfrytëzimi, etj,*
- *Aftësim nëpermjet programit të Lidershipit dhe pjesëmarrjes aktive*
- *Këshillim ose orientim për drejtimin shkollor/studimor; karierë ose punësim të adoleshentëve e të rinjve që mbarojnë arsimin bazë dhe ata qe mbarojnë arsimin e mesëm, si dhe prindërit e tyre nëpërmjet 'Ditëve të hapura' – në bashkëpunim me strrkturat lokale (Bashki, Zyra Pune, Arsim Profesional)*
- *Mbështetje pas shkolle për adoleshtë/e të moshave 10-14 vjeç të cilët kanë vështirësi në ndjekjen e shkollës dhe rrezikojnë ta braktisin atë*

5.1.2 Shërbime direkte për të rritur dhe familjet (prindër të adoleshentëve dhe të rinjve/rejave):

- *Aftësimi i prindërve për të përmirësuar komunikimin dhe marrëdhëniet pozitive me fëmijët e tyre nëpërmpjet programit të prindërimit pozitiv;*
- *Përmirësimi i komunikimit me fëmijët e tyre nepërmjet krijimit të grupeve të prindërve*
- *Mbështetje reaguese për familjet më në nevojë (të evidentuara nga shërbimet sociale si në rrezik) për t'iu përgjigjur nevojave imediate të të rinjve/rejave dhe familjeve të tyre.*

5.1.3 Shërbime të tjera si:

- *Evidentimi i mundësive për krijim fondesh sociale të përbashkëta nga projekti, bashkia, AKPA e sektori privat për punësimin e të rinjve/rejave pjesë e skemave mbështetese ekonomike ose paaftësisë*

5.2 ***Stafi, organizimi i punojësve të qendrës:***

5.2.1 Përshkrimet e punës për punonjësit e qendres komunitare përditësohen e miratohen nga departamentet kompetente qe te permbajnë dhe punën direkte per organizim sesionesh trajnimi dhe keshillimi në përputhje me shërbimet e lartpërmendura

Save the Children

5.3 ***Orari i funksionimit të qendrës***

Orari i funksionimit te Qendres krijon mundesira qe aktivitete të caktuara me te rinjte/rejat të planifikuara pas orarit zyrtar, për arsye të përshtatjes me nevojat e të rinjve/rejave të mund të zhvillohen pa pangesa burokratike

NENI 6
Detyrimet e palëve

6.1 ***Save the Children merr përsipër:***

- Pas vlerësimit të nevojave për pajisje të tjera në përputhje me kërkesat e aktiviteteve të shërbimeve të përmenduara në Nenin 5 t'i ofrojë pajisjet e nevojshme, Qendrës Komunitare
- Pas vlerësimit të nevojave për materiale kancelarike në Qendër në përputhje me kërkesat e aktiviteteve të shërbimeve të përmenduara në Nenin 5, të pajisë Qendrën me materialet e nevojshme në bazë periodike
- Të ofrojë mundësitë për kualifikimin e nevojshëm të stafit të Qendrës Komunitare për ofrimin cilësor dhe efektiv të shërbimeve të lartpërmendura për adoleshentët dhe të rinjtë/rejat.
- Të ofrojë asistencë teknikë direkte në vendin e punës për personelin e Qendrës në partneritet me Shoqatën Ndihme për Fëmijët.
- Të bashkëpunojë dhe bashkërendojë punën me stafin e Qendrës Komunitare në hartimin e planit vjetor të aktiviteteve për të integruar shërbimiet e lartpërmendura si pjesë integrale e ofrimit të shërbimeve sociale komuniteteve përkatëse nga ana e Bashkisë
- Të ofrojë asistencë teknike drejtorisë përkatese të shërbimeve sociale në përditësimin e Përshkrimit të Punës së stafit të Qendrës komunitare në përputhje me shërbimet e lartpërmendura në Nenin 5.
- Të mbështesë Qendrën komunitare me të gjitha materialet e nevojshme specifike për aktivitetet e lartpërmendura, logjistikën përkatëse si dhe publikime (manuale, broshura, fletëpalosje, etj) dhe materiale të tjera informuese për të rinj/reja, prindër, mesues, e anëtarë të tjerë të komuniteteve si përfitues të shërbimeve
- Të kontribuojë së bashku me Bashkinë në koordinimin e bashkëpunimit midis aktorëve publikë dhe jopublikë (institucione, OJF), si dhe përfaqësuesit e bizneseve në drejtim të orientimit për arsim e formim profesional e të përgjithshëm si dhe punësimit dinjitoz të të rinjve, me fokus grupet më në nevojë.
- Të ndajë më departamentin përkatës të shërbimeve sociale, raporte programatike të progresit dhe impaktit që këto shërbime kanë për popullatën e synuar si dhe të organizojnë takime pune të përbashketa për të diskutuar mbi arritjet dhe sfidat.
- Të sigurojë që në cdo botim, postim apo promovim në media apo media sociale të cilat

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Save the Children

lidhen drejtpërsëdrejti me aktivitetet e mbështetura nga Projekti në baskëpunim me Bashkinë, të shoqerohet nga logot perkatese apo njohjen e organizatave/institucioneve të cilat kryejnë aktivitetin

6.2 *Bashkia merr përsipër*:

- Pas vlerësimit të nevojave nga ana e Save the Children, të sigurojë mbështetjen e saj brenda kuadrit ligjor për mirëfunskionim e aktiviteteve dhe mire-menaxhimin e burimeve materiale.
- Të mundësojë praninë fizike (post fizik pune) të koordinatorit lokal të projektit dhe të krijoje hapësirat e nevojshme për vendosjen e furniturave që kërkohen për këtë post pune.
- Të garantojë ofrimin e shërbimeve cilësore edhe nga Qendra të tjera Komunitare si ofrues shërbimi i mandatuar i Bashkisë dhe matjen e progresit së bashku me Save the Children.
- Të lehtësoje bashkëpunimin midis Qendrës Komunitare dhe projektit në bërjen e planeve vjetore të aktiviteteve në lidhje me shërbimet e lartpërmendura në Nenin 5,.
- Të bashkëpunojë me Save the Children për kryerjen e vlerësimeve të brendshme për arritjen standarteve të ofrimit te shërbimeve komunitare dhe ne përfundim të cdo gjashtemujori të organizojnë takime pune të përbashketa për të diskutuar mbi arritjet dhe sfidat
- Të bashkëpunojë me Save the Children për hartimin e një plani të përbashkët të qëndrueshmërisë me qëllim marrjen përsipër të tërësisë së shërbimeve të lartpërmendura nga ana e bashkisë.
- Të përditësoje e miratojë Përshkrimin e Punës së anëtareve të stafeve të Qendrës Rinore dhe Qendrave të tjera komunitare për të lehtësuar kryerjen e aktiviteteve të lartpërmendura
- Të garantojë kapacitetet e nevojshme profesionale në marrjen përsipër për të kryer aktivitetet e lartpërmendura pas përfundimit të projektit
- Të kontribuojë së bashku me Save the Children në koordinimin e bashkëpunimit midis aktorëve publikë dhe jopublikë (institucione, OJF), si dhe përfaqësuesit e bizneseve në drejtim të orientimit për arsim e formim profesional e të përgjithshëm si dhe punësimit dinjitoz të të rinjve, me fokus grupet më në nevojë.
- Bashkia garanton qëndrueshmërinë e të gjithë stafit të Qendrës komunitare për t'iu përgjigjur me efektivitet nevojave të popullatës së pikësynuar
- Të sigurojë që në cdo botim, postim apo promovim në media apo media sociale të cilat lidhen drejtpërsëdrejti me aktivitetet e mbështetura nga Projekti në baskëpunim me Bashkinë, të shoqërohet nga logot përkatese apo njohjen e organizatave/institucioneve të cilat kryejnë aktivitetin

REPUBLIKA E SHQIPËRISË, BASHKIA ELBASAN

Save the Children

NENI 7
Zbatimi i Marrëveshjes

7.1 Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, për të qenë partnerë në zbatimin e Projektit dhe të punojnë së bashku për realizimin me sukses të aktiviteteve të tij. Takime periodike do të realizohen midis stafeve përgjegjëse të Save the Children dhe Bashkisë për ecurinë dhe arritjet e objektivave të Projektit.

Neni 8
Kohëzgjatja

8.1 Kjo Marrëveshje shtrin efektet për periudhën 01 Nëntor 2021 – 30 Shtator 2026 dhe do të jetë efektive përgjatë këtij Projekti.

Neni 9
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

9.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me mirëkuptim, me bisedime ndërmjet tyre, deri në gjetjen e një zgjidhje të përbashkët.

Neni 10
Hyrja në fuqi

10.1 Kjo Marrëveshje pas nënshkrimit të saj nga palët, miratohet nga Këshilli Bashkiak Elbasan.
10.2 Hartohet në tre kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe.

Save the Children

Anila Meço

Drejtore

Bashkia Elbasan

Gledian Llatja

Kryetari i Bashkisë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
Drejtoria Juridike

Nr._____ Prot. **Elbasan, më____.____. 2021**

MEMO

Mbi Marrëveshje bashkëpunimi midis Bashkisë Elbasan dhe fondacionit "Save the Children", mbi projektin "Rrugëtimi i adoleshentëve dhe të rinjve drejt mirëqenjes, fuqizimit dhe qëndrueshmërisë" nr 1001/514 Prot.

Kryetarit të Bashkisë
Këtu

Qëllimi, objekti dhe detyrimet e parashikuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi, përfshihen ne funksionet e veta të Bashkisë parashikuar ne nenet 24, 28 të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", konkretisht funksionet e Bashkisë në fushën e shërbimeve sociale dhe në fushën e zhvillimit ekonomik vendor. Duke qenë se kjo marrëveshje lidhet për një afat 5-vjeçar, dhe në dispoziat e saj parashikohet që Bashkia do të garantojë kapacitetet e nevojshme profesionale në marrjen përsipër të aktiviteteve pas përfundimit të projektit, marrveshja duhet miratuar edhe në këshillin bashkiak, (pas nënshkrimit) sikurse është parashikuar edhe në nenin 10 të saj.
Kompetenca e Kryetarit të Bashkisë në nënshkrimin e kësaj marrveshje bazohet në nenet 8, 9, 10, e 64 të ligjit të sipërcituar.

Për Drejtorinë Juridike
Drejtori
Arben Hoxha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
Drejtoria Juridike

Nr._____ Prot. **Elbasan, më____.____. 2021**

MEMO

Mbi Marrëveshje bashkëpunimi midis Bashkisë Elbasan dhe fondacionit "Save the Children", mbi projektin "Rrugëtimi i adoleshentëve dhe të rinjve drejt mirëqenjes, fuqizimit dhe qëndrueshmërisë" nr 1001/514 Prot.

Kryetarit të Bashkisë
Këtu

Qëllimi, objekti dhe detyrimet e parashikuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi, përfshihen ne funksionet e veta të Bashkisë parashikuar ne nenet 24, 28 të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", konkretisht funksionet e Bashkisë në fushën e shërbimeve sociale dhe në fushën e zhvillimit ekonomik vendor. Duke qenë se kjo marrëveshje lidhet për një afat 5-vjeçar, dhe në dispoziat e saj parashikohet që Bashkia do të garantojë kapacitetet e nevojshme profesionale në marrjen përsipër të aktiviteteve pas përfundimit të projektit, marrveshja duhet miratuar edhe në këshillin bashkiak, (pas nënshkrimit) sikurse është parashikuar edhe në nenin 10 të saj.
Kompetenca e Kryetarit të Bashkisë në nënshkrimin e kësaj marrveshje bazohet në nenet 8, 9, 10, e 64 të ligjit të sipërcituar.

Për Drejtorinë Juridike
Drejtori
Arben Hoxha

1376
24.12.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
Këshilli Bashkiak

Nr. 6341/1 **Prot.** **Elbasan, më** 24.12.2021

Vendim 12
Nr 140 23 **/2021**

Mbi përcaktimin e procedurës dhe agjentit tatimor për mbledhjen e tarifave të parkimit

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 23/12/2021, pasi shqyrtoi draft-marrëveshjen me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për mbledhjen e tarifës së parkimit dhe gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake për këtë qëllim, si dhe relacionin e paraqitur nga administrate e Bashkisë, bazuar ne ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" nenet 8, 9, 23, 54 të tij, ligjin 8378 datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor I Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin 9632 datë 30.10.2008"Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

Vendosi

-1 Të miatojë mbledhjen e tarifave të parkimit dhe gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake për këtë qëllim, nga Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, si agjent tatimor.

2- Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor do të përfitojë 5% të shumës së arkëtuar nga mbledhja e të ardhurave sipas pikës I të këtij vendimi.

3-Të miratojë Akt-Marrëveshjen ndëmjet Bashkisë Elbasan dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, sipas drafti bashkangjitur këtij vendimi

4-Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Financës dhe të Ardhurave, Sektori I Transportit dhe Policia Bashkiake me zbatimin e këtij vendimi

5- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

D.T.T.M.A	Q. Tusha
DP.....	L. Dervishi
Drejt. Juridike	A. Hoxha
Zv/Kryetar	I. Sina

Sek. K. Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari
Hektor Ciftja

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkinelbasan@elbasani.gov.al ëeb:ëëë.elbasani.gov.al*

6347/2
05.01.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 1376/1 **Prot** **Elbasan, më** 31.12.**2021**

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.140, datë 23.12.2021 "Mbi përcaktimin e proçedurës dhe agjentit tatimor për mbledhjen e tarifave të parkimit", konfirmoj në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
Majlinda PERRIU

I.gj.Brigada "17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel.054252138 ëëë.prefektielbasan.gov.al, e-mail: prefekti.elbasan@mb.gov.al

DPSHTRR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN
Nr. _____ Prot.
Elbasan më, ___.___.2021

D.P.SH.T.RR
Nr. _____ Prot.
Tiranë më, ___.___.2021

AKT - MARRËVESHJE

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 8378 date 22.07.1998 "Kodi Rrugor"; VKM-së nr. 343, dt. 21.07.1999 "Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor", Statutit të DPSHTRR si dhe VKB nr.____, datë _____"Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet D.P.SH.T.RR dhe Bashkisë Elbasan

Lidhur sot më datë ___/___/_____, midis,

Bashkisë Elbasan, me seli në adresë: Rruga "11 nëntori" Elbasan, është institucion që realizon të drejtën e shtetasve për mbrojtje shoqërore në Republikën e Shqipërisë. Institucion publik i pavarur, organizimi dhe funksionimi i të cilit rregullohet me Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, përfaqësuar nga Kryetari i saj ***z.Gledian Llatja,***

Dhe

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR (referuar si DPSHTRR) me seli në adresën: Rr." Muhedin Llagani" Nr.10, Tiranë, është institucion shtetëror, me statusin e personit juridik publik, me vetëfinancim, në varësi të ministrit përgjegjës për punët publike dhe transportet, i krijuar sipas Vendimit nr.343, dt. 21.07.1999 "Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor" të Këshillit të Ministrave, i përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, **z.Blendi GONXHJA,**

Neni 1
Objekti i marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka si objekt mbledhjen e Tarifës Vjetore të Parkimit për autoveturat familjare, subjekteve private dhe shtetërore pronarët e të cilëve sipas regjistrit të gjendjes civile i përkasin Bashkisë Elbasan, referuar "pikës 1-2c, Tabelës H, Tarifat Vendore të Transportit", paketa Fiskale Bashkia Elbasan si dhe detyrimeve të pashlyera të gjobave të automjeteve, të vendosura nga Policia Bashkiake Elbasan si sanksion i kundravajtjeve administrative, për llogari të Bashkisë Elbasan.

Neni 2
Tarifat dhe Gjobat

D.P.SH.T.RR do të mbledhë për llogari të Bashkisë Elbasan :

- Tarifën Vjetore të Parkimit për autoveturat familjare, subjekteve private dhe shtetërore pronarët e të cilëve sipas regjistrit të gjendjes civile i përkasin Bashkisë Elbasan, referuar " pikës 1-2c, Tabelës H, Tarifat Vendore të Transportit"

- Gjobat e pashlyera si sanksion i kundravajtjeve administrative të automjeteve nga struktura e Policisë Bashkiake.

Neni 3
Detyrime të D.P.SH.T.RR

3.1 D.P.SH.T.RR do të mbledhë Tarifën Vjetore të Parkimit për autoveturat familjare subjekteve private dhe shtetërore pronarët e të cilëve sipas regjistrit të gjendjes civile i përkasin Bashkisë Elbasan, si dhe gjobat e pashlyera të automjeteve, të vendosura nga Policia Bashkiake si sanksion i kundrvajtjeve administrative, për llogari te Bashkisë Elbasan.

3.2 D.P.SH.T.RR do të derdhë në degën e thesarit, për llogari të bashkisë Elbasan shumat e mbledhura,duke zbritur perqindjen e saj si agjent tatimor, brenda datës 15 të muajit pasardhës.

3.3 D.P.SH.T.RR do të përfitojë **5 (pesë) %** të shumës së arkëtuar si agjent tatimor, çdo muaj.

3.4 D.P.SH.T.RR, do t'ju kërkojë pronarëve/përdoruesve të mjeteve që paraqiten për shërbimin e kontrollit teknik dhe ndyshimit të pronësisë të mjetit, likujdimin e detyrimeve të parashikuara në objektin e kësaj marrëveshje, pranë drejtorive të saj rajonale.

Neni 4
Detyrimet e Bashkisë Elbasan

4.1 Bashkia Elbasan do të miratojë Tarifën Vendore të Parkimit, për çdo vit, përpara vitit ushtrimor buxhetor dhe do t'ia dërgojë D.P.SH.T.RR (kopje të vendimit përkatës të Këshillit Bashkiak).

4.2 Bashkia Elbasan do t'i japë D.P.SH.T.RR të gjithë informacionin e nevojshëm, në lidhje me tarifën vendore të parkimit si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm në funksion të objektit të kësaj marrëveshje.

4.3 Bashkia merr përsipër dhe ka detyrimin e krijimit të një sistemi për komunikimin dhe ngarkimin e detyrimit sipas objektit të kësaj marrëveshje, në kohë reale me sistemin e DPSHTRR-së.

4.4 Deri në realizimin e pikës 4.3, Bashkia Elbasan do t'i dërgojë D.P.SH.T.RR, në mënyrë periodike, në çdo datë ____ të muajit me anë të shkresës zyrtare shoqëruar me CD dhe elektronikisht në adresën dpshtrr@dpshtrr.gov.al, databazën e gjobave të pashlyera.

4.5 Bashkia merr përsipër sqarimin e përdoruesve të automjeteve në rastet kur janë të paqartë në lidhje me pagesen e Tarifës Vendore të Parkimit dhe detyrimet për gjobat.

Neni 5
Detyrime të përbashkëta

5.1 Palët në marrëveshje do të bëjnë rakordime mujore në lidhje me detyrimet e mbledhura dhe debitorët e krijuar.

5.2 Përsa më sipër, një rakordim i përgjithshëm do të bëhet në fund të çdo viti.

5.3 Debitorët e mundshëm të krijuar do të mbarten në vitin pasardhës dhe Bashkia do t'u fngarkojë në sistem e-dpshtrr përdoruesve debitorë të mjeteve edhe detyrimin e prapambetur.

5.4 Informacioni vjetor do të jetë i detajuar sipas kategorive të mëposhtme:

a)automjete që kanë shlyer detyrimet,
b)automjete që s'kanë shlyer detyrimet.

Neni 6

Afati dhe kohëzgjatja

6. Kjo marrëveshje lidhet për një afat 2 (dy) vjet, me të drejtë përsëritje dhe do të hyjë në fuqi në datë _____ pas miratimit nga Këshilli Bashkiak.

Neni 7
Zgjidhja e marrëveshjes

7.1 Në rast mosrespektimi të detyrimeve respektive në këtë marrëveshje, secila nga palët ka të drejtë të tërhiqet dhe të kërkojë zgjidhjen e marrëveshjes. Pala që kërkon zgjidhjen e marrëveshjes ka detyrimin të njoftojë palën tjetër jo më pak se tre muaj përpara zgjidhjes së saj. Ky afat mund të mos respektohet nësë të dy palët bien dakort për zgjidhjen e saj.

7.2 Në rast se ndonjë akt ligjor apo nënligjor, vendim i këshillit bashkiak, apo çdo akt tjetër i organeve kompetente i cili ndikon dhe e bën të pamundur zbatimin e kësaj marrëveshje, miratohet dhe hyn në fuqi, bashkia do të tërhiqet nga kjo marrëveshje.

7.3 Një të drejtë të tillë e ka edhe D.P.SH.T.RR nëse këto akte e detyrojnë atë.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin nga palët, pas miratimit të saj nga këshilli Bashkiak.

BASHKIA ELBASAN

Përfaqësuar nga Kryetari

z. Gledian LLATJA

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT RRUGOR
Përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm

z. Blendi GONXHJA